Ku janë paratë për të drejtat e grave?

Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor



Përkrahur nga

KVINNA KVINNA

Sweden Sverige

© Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2020

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet, derisa autorët dhe publikuesit e raportit citohen në përdorimin e raportit.

Autorët: Nicole Farnsworth, Nerina Guri, Donjeta Morina dhe Taya Kohnen për Rrjetin e Grave të Kosovës

Ky publikim është realizuar me mbështetje financiare nga Fondacioni Kvinna till Kvinna. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërish pikëpamjet e Fondacionit ose të Qeverisë së Suedisë.

Dizajnuar nga Rrjeti Grave të Kosovës dhe Night Design

Printuar nga Night Design në Prishtinë, Kosovë, duke përdorur shtypin ekologjik.

Ku janë paratë për të drejtat e grave?

Trendet e financimit në Ballkanin Perëndimor

MIRËNJOHJE

Në Ballkanin Perëndimor tetë organizata për të drejtat e grave bashkëpunuan për të hulumtuar dhe shkruar këtë raport e që janë: Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare, Qendra e Grave Autonome (Serbi), Qendra për të Drejtat e Grave (Bosnje dhe Hercegovinë), Rrjeti i Grave të Kosovës, Rrjeti Kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Maqedoni e Veriut), Të drejtat për të gjithë (Bosnje dhe Hercegovinë), Pescanik (Serbi) dhe Qendra për të Drejtat e Grave (Mali i Zi).

Partnerët identifikuan nevojën për këtë hulumtim gjatës punës së tyre dhe takimit strategjik me organizatat e tjera për të drejtat e grave në vitin 2018. Më pas morën mbështetje nga Fondacioni Kvinna till Kvinna për të realizuar këtë hulumtim. Secila organizatë gjithashtu ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në këtë hulumtim në kuptim të kohës dhe energjisë. Hulumtuesit që kontribuan janë si në vijim:

Shqipëri: Ines Leskaj, Danjela Shkalla, Eneda Cenko

Bosnje dhe Hercegovinë: Maida Omercehajic, Selma Badzic, Edina Sejmenovic, Tea Pripoljac

Kosovë (dhe hulumtimi në nivel rajonal): Nicole Farnsworth, Nerina Guri, Donjeta Morina, Taya Kohnen, Angelika Arutyunova, Liridona Sijarina, Besarta Breznica, Leonora Aliu, Qëndresa Tërshani, Donjeta Arifi, Valmira Rashiti, Etleva Malushaj, Sara Nicole Baxley, Adelina Berisha

Mali i Zi: Maja Raicevic, Marija Glomazic

Maqedoni e Veriut: Elena Dimushevska, Monika Cekalovik, Ana Pejovska

Serbi: Marina Iles, Aleksandra Nestorov, Jovana Markulic, Snezana Jakovljevic, Tina Ciric, Milkana Pavlovic

Ekipi i hulumtimit falënderon 71 donatorë dhe 241 organizata për të drejtat e grave që ndanë kohën e tyre të vlefshme dhe e bënë të mundur këtë hulumtim.

Autoret shprehin mirënjohjen e tyre ndaj rishikuesve të jashtëm për mendimet dhe komentet e tyre, përfshirë këtu Brigitta Jaksa, Dr. Elisabeth Klatzer, Dr. Elizabeth Villagomez, Giulia Pasquinelli, Monica Erwér, Tenzin Dolker dhe Shoqatën për të Drejtat e Grave në Zhvillim si dhe të gjithë pjesëmarrësit e hulumtimit që kontrolluan dhe vërtetuan pjesët e raportit. Autorët falënderojnë ekipin e Rrjetit të Grave të Kosovës për mbështetjen e tyre të vazhdueshme gjatë gjithë këtij procesi, e në veçanti Igballe Rogovën për inkurajimin dhe udhëzimet e saja, Lauren Hanna për lektorimin përfundimtar dhe Donjeta Berishën për ndihmën e saj në dizajnin e publikimit. Shumë falënderime shkojnë për Fondacionin Kvinna till Kvinna për besimin, durimin, këshillimet dhe mbështetjen e tyre.

PËRMBAJTJA

AKRONIMET 2

FJALOR I TERMAVE 4

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 7
GJETJET KYÇE 9
REKOMANDIMET KYÇE 11

HYRJE 14
Zotimet për financimin e barazisë gjinore dhe të OSHCG-ve 15
Pse ky hulumtim? 17
Metodologjia 20

Rreth këtij raporti 23

KONTEKSTI 24
Ligjet Kombëtare që ndikojnë në qasjen në financim 30
Përfundim: Konteksti 36

KUSH I FINANCON TË DREJTAT E GRAVE? 37
Financuesit aktivë në BP 37
Preferencat e OSHCG-ve sa i përket financuesve 80
Përfundimi: Kush i financon të drejtat e grave në BP? 84

TRENDET E FINANCIMIT 85
Trendet e përgjithshme në financim të OSHCG-ve 85
Fushat tematike ose sektorët e financuar 93
Financimi për grupet e synuara të caktuara 102
Financimi për strategji specifike 103
Shumat e financimit 105
Kornizat kohore të financimit 107
Qasjet dhe çështjet e financimit 109
Financimi i planifikuar në të ardhmen për BP 114
Përfundimi: Trendet e financimit 116

PSE DUHET MBËSHTETUR OSHCG-TË? 117
Forcimi i përpjekjeve drejt demokracisë dhe të drejtave të njeriut 117
OSHCG-të adresojnë pabarazitë dhe padrejtësitë e vazhdueshme 118
OSHCG-të si krijuesit e ndryshimeve 120
Pikëpamjet e financuesve rreth rëndësisë, efikasitetit, efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe ndikimit të OSHCG-ve 131
Një ekuilibër delikat: Financimi i OSHCG-ve, OJQN-ve dhe organizatave multilaterale 135
Përfundim: Pse të mbështeten OSHCG-të? 140

REKOMANDIMET 141
Për OSHCG-të 141
Për financuesit 141
Për BE-në 143
Për Qeveritë 145
Për Koordinimin 145

PUNIMET E CITUARA 147

SHTOJCAT 156
Shtojca 1. Përshkrimi i mostrës dhe të dhënat e tjera 156
Shtojca 2. Pjesëmarrësit e hulumtimit 159
Shtojca 3. Metodologjia e detajuar 165
Shtojca 4. Financuesit nga të cilët OSHCG-të raportuan të kenë marrë fonde 171

AKRONIMET

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
AWC	Qendra e Grave Autonome
AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare
AWID	Shoqata për të drejtat e grave në zhvillim
BeH	Bosnja dhe Hercegovina
CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
RrPZ	Rregullorja e Përbashkët Zbatuese e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (për financim të jashtëm)
OShC	Organizatat e shoqërisë civile
DAC	Komiteti i Ndihmës për Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
DESK	Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
EIDHR	Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut
PE	Parlamenti Evropian
BE	Bashkimi Evropian
DBE	Delegacioni i BE-së
ZBE	Zyra e BE-së
FBeH	Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës
FEMM	Komiteti i Parlamentit Evropian për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore
FIGAP	Mekanizmi Financiar për Zbatimin e Planit të Veprimit Gjinor të Bosnje dhe Hercegovinës
FOSM	Fondacioni për Shoqërinë e Hapur në Maqedoni
GAP	Plani i Veprimit Gjinor të BE-së
GIZ	*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit*
OJQOQ	Organizatat "jo-qeveritare" të orientuara nga qeveria
IAMANEH	Shoqata Ndërkombëtare për Shëndetin e Nënës dhe Kujdesin Neonatal
ICT	Komunikimet në internet dhe Teknologjia
OJQN	Organizatat joqeveritare ndërkombëtare
IOM	Zyra Ndërkombëtare për Migracionin
IPA	Instrumenti i BE-së për Para-anëtarësim
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqërinë e Hapur
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
FGK	Fondi i Grave të Kosovës
MFF	Korniza Financiare Shumëvjeçare e BE-së
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
LGBTQIA+	Identitetet lezbik, gej, biseksual, transgjinor, queer, interseks, aseksual dhe të tjerë
MS	Shtetet Anëtare të BE-së
NA	Nuk Aplikohet
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PRAG	Udhëzues Praktik i Komisionit Evropian
RWF	Fondi i Grave për Rindërtim
Sida	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

SDG	Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm
PSShS	Paketa Statistikore për Shkencat Sociale
SWD	Dokumenti i Punës i Stafit
MB	Mbretëria e Bashkuar
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krimet
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projektit
UN OHCHR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projektit
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
SH.B.A.	Shtetet e Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
BP	Ballkani Perëndimor
OSHCG	Organizata të Shoqërisë Civile për të Drejtat e Grave

FJALOR I TERMAVE

Ky fjalor shpjegon termat kyçe të përdorura në këtë publikim.

Organizatat bilaterale: Në përgjithësi, ky term përfshin organizatat jofitimprurëse dhe agjencitë qeveritare që marrin fonde nga vendi i tyre për t'i përdorur ato në një vend tjetër. Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe ambasadat janë shembujt e financuesve bilateralë. Në këtë publikim, termi i referohet vetëm financuesve të lidhur me qeverinë e jo organizatave ndërkombëtare jofitimprurëse, të përfshira në kategorinë e organizatave joqeveritare ndërkombëtare (OJQN).

Mbështetja thelbësore: I referohet financimit të pakufizuar, fleksibël që organizatat të mund të përdorin ashtu si e shohin të përshtatshme për misionin e tyre dhe për të arritur vizionin e tyre. Organizatat mund ta përdorin atë për të mbuluar shpenzimet administrative, për infrastrukturën, programet, aktivitetet e përditshme ose për stafin esencial.

Financimi i drejtpërdrejtë: Komisioni Evropian përdor këtë term për t'iu referuar fondeve të shpërndara pa thirrje të hapur për propozime ose proces konkurrues.[1]

Feminist: Ky term i referohet përpjekjeve në mbështetje të feminizmit. Ky publikim, edhe pse i vetëdijshëm për rëndësinë e kësaj fjale, përfshirë edhe larminë e përkufizimeve dhe kuptimeve të feminizmit, përdor këtë term për t'iu referuar veprimeve të ndryshme drejt arritjes së barazisë sociale, politike, ekonomike dhe personale të të gjitha gjinive.

Financuesit: Në këtë publikim, ky term përfshin çdo organ apo person publik ose privat që ofron fonde, duke përfshirë por jo kufizuar në individë (p.sh.: anëtarët e ndonjë organizate ose anëtarët e publikut të gjerë, si përmes 'mbështetjes së masës', qeveri, grupe fetare, korporata, fondacione, fonde të grave, organizata bilaterale, organizata multilaterale dhe OJQN-të.

Fondet: Këtu, ky term i referohet të gjitha llojeve të mbështetjes financiare që OSHCG-të mund të marrin, duke përfshirë, ndër të tjera, grantet, kontratat dhe donacionet individuale.

OJQN: Organizatat joqeveritare ndërkombëtare janë organizata që veprojnë përtej kufijve. Shembuj të OJQN-ve përfshijnë Save the Children dhe Olof Palme. Në këtë raport, termi OJQN-të nuk i referohet organizatave multilaterale, siç janë agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

Organizata vendore: Në këtë publikim, termi zakonisht i referohet organizatave *me seli* në një vend të caktuar të Ballkanit Perëndimor, por që mund të funksionojë në çdo nivel gjeografik (p.sh.: fshat, qytet, nivel komunal, kantonal, rajonal, kombëtar dhe/ose ndërkombëtar). Termi "vendor" ka tendencë të përdoret në kontrast me termin "ndërkombëtar", si gjatë referimit të OJQN-ve. Duke iu referuar ndonjë organizate të caktuar si "organizatë vendore" nuk nënkupton që organizata punon *vetëm* brenda vendit që e ka bazë. Në fakt, disa organizata "vendore" të përfshira në këtë hulumtim mund të identifikohen si OJQN-të, duke qenë se ato veprojnë përtej kufijve. Kur iu referuan organizatave që punojnë vetëm në nivelin lokal brenda shtetit, siç është në fshatra ose qytete, autoret u përpoqën ta bëjnë diferencimin e qartë në kontekstin e diskutimit.

[1] Komisioni Evropian, Udhëzues praktik, 15 korrik 2019.

Organizatat shumëpalëshe ose multilaterale: Ky term i referohet organizatave ndërkombëtare të përbëra nga tre ose më shumë kombe që punojnë së bashku për një qëllim të përbashkët.[2] Shembuj të organizatave multilaterale janë Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Lëvizja: Duke pranuar se ato nuk janë domosdoshmërish e njëjta gjë, ky hulumtim i përdori termat lëvizja e grave dhe lëvizja feministe në vend të njëra tjetrës për t'iu referuar një serie të qëndrueshme të përpjekjeve të përbashkëta nga akterë të shumtë, shpesh të ndryshëm, veçanërisht nga aktivistët dhe organizatat e të drejtave të grave, drejt qëllimeve të përbashkëta feministe të barazisë sociale, politike, ekonomike dhe personale si dhe barazisë midis të gjitha gjinive.

Financimi normativ: Në këtë raport, ky term i referohet financimit të siguruar nga niveli qendror, kantonal, lokal ose niveli tjetër i qeverisë së një vendi. I referohet skemave specifike të rikuperimit të kostos të parashikuara me ligj, siç është një linjë e përhershme e buxhetit për shërbimet e përfitimeve publike. Pra, financimi nuk i nënshtrohet vendimit vjetor të qeverisë. Për shembull, një ofrues i shërbimeve mund të aplikojë për kosto njësi normative për person e asistuar me një shërbim të caktuar, duke dëshmuar që shërbimi është përdorur. Shërbimi i ofruar mund të financohet me një çmim për njësi, siç është standard "për shtrat" në një strehimore. Ndërkohë, politikat e tilla duhet të marrin parasysh faktin që strehimoret duhet të qëndrojnë të hapura dhe nuk mund të mbyllen kur personat nuk kanë nevojë për shërbimet e tyre.

Ngushtimi i hapësirës: Termi i referohet kufizimeve shtetërore ose jo shtetërore mbi lirinë e shprehjes, lirinë e tubimit.[3] Kjo përfshinë situata kur puna e OSHCG-ve është gjithnjë e më shumë e kriminalizuar dhe/ose e burokratizuar. Kjo gjithashtu mund t'i referohet konteksteve që mundësojnë një mjedis për sulme ndaj mbrojtësve të të drejtave njerëzore të grave.

Gratë: Gjatë këtij hulumtimi, ekipi dhe autoret morën parasysh se gratë nuk janë homogjene, por të ndryshme. Faktorë të shumtë, të kryqëzuar dhe ndonjëherë të ndërlidhur, formojnë identitetin, pozicionin dhe mundësitë në jetën e secilës grua.[4] Kjo përfshin aftësinë e saj fizike, moshën, përkatësinë etnike, orientimin seksual, edukimin dhe nivelin klasor. Strukturat ekzistuese diskriminuese të pushtetit mund të bashkëveprojnë, duke ndikuar ndryshe në qasjen e secilës grua në mundësi. Në këtë hulumtim është bërë përpjekje të përdoret një perspektivë ndërsektoriale, duke shqyrtuar dhe analizuar qasjen në burime për grupet e ndryshme të grave dhe gratë të cilat i shërbejnë ato.

Fondet e grave: Në këtë hulumtim, ky term i referohet organeve të financimit, qëllimi kryesor i të cilave është të sigurojnë fonde për organizatat e përqendruara në avancimin e të drejtave të grave, në veçanti por ndoshta jo vetëm për organizatat e udhëhequra nga gratë. Edhe pse shpesh konsiderohen fondacione, fondet e grave dallojnë nga fondacionet e tjera për shkak të fokusit të tyre eksplicit në përpjekjet e financimit për avancimin e të drejtave të grave. Ky publikim përfshin disa diskutime mbi fondet e grave në pjesën ku diskutohen fondacionet. Për më tepër, duke pasur parasysh fokusin e këtij raporti dhe gjetjet e mëparshme që sugjerojnë se fondet e grave kanë tendencë të funksionojnë veçanërisht mirë në arritjen dhe adresimin

[2] Projekti Borgen, "What is a Multilateral Organization?", faqja e internetit e projektit Borgen, qasur më 18 maj 2020.
[3] Ky përkufizim është nxjerrë nga Wassholm, C., Suffocating the Movement: Shrinking Space for Women's Rights, Fondacioni Kvinna till Kvinna, 2018.
[4] Ky përkufizim është huazuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna për kategorinë e "grave".

e nevojave shpesh unike të organizatave për të drejtat e grave,[5] ky hulumtim i diskuton gjithashtu edhe fondet e grave ndaras, si lloj unik i financuesit.

Organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHCG): Në këtë hulumtim, ky term i referohet grupeve që punojnë në drejtim të avancimit të të drejtave të grave, duke përfshirë grupet formale dhe joformale, të regjistruara dhe të paregjistruara. Në këtë publikim përdoret akronimi i shkurtuar OSHCG për t'iu referuar organizatave të shoqërisë civile të përqendruara në të drejtat e grave.

[5] Shoqata për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID), *Watering the Leaves, Starving the Roots: The Status of Financing for Women's Rights Organizing and Gender Equality*, faqe 90, 2013.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në linjën e parë të frontit për të adresuar pabarazitë gjinore të përhapura e që ekzistojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) janë organizatat për të drejtat e grave (këtu e tutje të referuara si "OSHCG"). Ato janë krijueset e ndryshimeve, avokueset, ofrueset e shërbimeve, mësueset dhe ekspertet që kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në disa ndryshime të nivelit social, politik, ligjor, ekonomik dhe individual në vendet e tyre dhe më gjerë. OSHCG-të mbesin të pozicionuara mirë për të vazhduar adresimin e pabarazive të përhapura gjinore në BP dhe më gjerë. Për këtë punë, OSHCG-të kërkojnë burime. Ky raport shqyrton fondet e disponueshme për punën e tyre.

Komisioni Evropian (KE), Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian dhe Shtetet Anëtare (ShA) të Bashkimit Evropian (BE) janë angazhuar për avancimin e barazisë gjinore në veprimet e tyre të jashtme përmes Planit të Dytë të Veprimit të BE-së për Barazi Gjinore ("GAP II"), në mesin e politikave dhe zotimeve të tjera. BE-ja është e pozicionuar mirë për avancimin e barazisë gjinore në BP, ku qeveritë janë zotuar të ndjekin agjendën e politikave të BE-së dhe BE-ja ndan kontribute të konsiderueshme financiare. Disa donatorë të tjerë gjithashtu janë zotuar për avancimin e barazisë gjinore përmes financimit të tyre të jashtëm.

Përkundër këtyre angazhimeve, **ekzistojnë informacione minimale në lidhje me shpenzimet aktuale për barazi gjinore, të drejtat e grave dhe OSHCG-të**. Informatat e tilla janë të rëndësishme për vlerësimin e zbatimit të GAP II dhe informimit të përgatitjes së Kornizës së re Financiare Shumëvjeçare të BE-së (MFF), Instrumentit të ndihmës së para-anëtarësimit (IPA) III dhe GAP III. Ato gjithashtu mund të informojnë shtetet anëtare të BE-së dhe donatorët e tjerë në lidhje me nevojat e financimit për avancimin e barazisë gjinore në BP.

Ky hulumtim ka për qëllim të sigurojë informacione rreth trendeve të financimit në lidhje me barazinë gjinore dhe në mbështetje të OSHCG-ve në BP nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019 dhe për të kuptuar më mirë nevojat e financimit të OSHCG-ve. Metodologjia e përzier e bërë në vitin 2019 në gjashtë vendet e BP, përfshinte hulumtimin në tryezë, kërkesa për të dhëna dhe intervista me **71 donatorë** dhe **241 OSHCG të ndryshme**. Hulumtimi zbuloi se donatorët/financuesit priren që të kenë **mungesë të sistemeve për të përcjellë shpenzimet** për gratë dhe vajzat, të drejtat e grave, barazinë gjinore, përkatësisht OSHCG-të. Përdorimi i proklamuar i përfshirjes së perspektives gjinore, megjithëse pa buxhetim të përgjegjshëm gjinor pengoi përcjelljen e saktë të këtyre shpenzimeve. Prandaj, pavarësisht disa studimeve të rasteve mbi financuesit e veçantë, gjetjet vijnë kryesisht nga të ardhurat e raportuara të OSHCG-ve.

Përmbledhja e konteksteve në të cilat punojnë OSHCG-të sugjeron që nacionalizmi, popullzimi, konservatorizmi dhe lëvizjet shoqëruese kundër-gjinisë kontribuojnë në **ngushtimin e hapësirës** për aktivistët e të drejtave të grave dhe OSHCG-të. Vendet e BP kanë **mungesë të një mjedisi rregullues gjithëpërfshirës** për mbledhjen e fondeve për OSHCG-të nga individët dhe bizneset; dhënia individuale mbetet minimale. Edhe pse ekzistojnë disa **skema të paqëndrueshme të granteve të qeverisë**, shtetet nuk kanë krijuar financim të qëndrueshëm për OShC-të. Për shembull, financim i mjaftueshëm, i qëndrueshëm normativ nuk ekziston për shërbime sociale me përfitime publike të cilat i ofrojnë OSHCG-të me përvojë, siç është strehimi për personat që përjetojnë dhunë. As nuk ka diskutim të mjaftueshëm se si shtetet mund të krijojnë një fond të tillë me ç'rast do të shmangin korrupsionin, nepotizmin dhe politizimin, duke ruajtur kështu rolin e OSHCG-ve si mbikëqyrës të pavarur. Duke pasur parasysh kontekstin politik dhe financiar, OSHCG-të, jo befasisht, ende mbështeten shumë në fondet e huaja.

Në përgjithësi, fondet për OSHCG-të në BP duhet se kanë **rënë nga viti 2014 deri në 2016**, por më pas janë rritur. OSHCG-të kishin **të ardhura mesatare vjetore prej**

55,773 € për periudhën 2014 deri në 2018. Megjithatë, kjo u ndërrua nga tetë organizata që kishin të ardhura vjetore më shumë se 500,000 €. **Të ardhurat mesatare vjetore** ishin vetëm **6,000 €**. Shumica e OSHCG-ve kanë përjetuar periudha në të cilat **nuk kishin burime të mjaftueshme** (**82%**), kurse **35% nuk e përmbushën buxhetin e tyre të planifikuar në 2018**. Më pak se gjysma e OSHCG-ve të intervistuara kishin plane emergjente në rast se humbin fonde. Mungesat e fondeve kanë bërë që OSHCG-të të vonojnë pagesat, të mbajnë staf që punon pa pagesë, të ndërprejnë programet dhe madje të mbyllin dyert e organizatës.

Mjedisi i financimit në BP mbetet **i fragmentuar** me një bollëk të donatorëve të angazhuar dhe rrallë mirë të koordinuar. Shumica e fondeve që OSHCG-të morën nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019 **buronin nga organizatat multilaterale** (>21%) **dhe ato bilaterale** (>24%), të shpërndara shpesh përmes organizatave të tjera multilaterale, fondeve të grave ose organizatave. Fondet e grave (11%) dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare (OJQN-të) (8%) gjithashtu siguruan burime të konsiderueshme për OSHCG-të. Qeveritë (5%), fondacionet ndryshe nga fondet grave (5%) dhe OJQ-të lokale (1%) ofruan relativisht më pak mbështetje. **Shuma mesatare e grantit ose e kontratës ishte 32,786 €**, megjithëse ekzistonin dallime thelbësore midis organizatave. Financimi nga individët dhe anëtarët e OSHCG-ve përbënte më pak se 0.3% të fondeve të tyre dhe nga sektori fitimprurës më pak se 0.2%. Donatorët ishin të prirë të mos kenë plane të qarta për financimin në të ardhmen. Përveç fondeve të grave, disa donator kanë ndarë fonde për barazinë gjinore ose OSHCG-të.

Në mesin e fushave tematike të financuara, **adresimi i dhunës me bazë gjinore mori më së shumti fonde,** që përbën të paktën 27% të financimit të raportuar për OSHCG, pasuar nga financimi për të drejtat e njeriut (14%), mbështetje të përgjithshme organizative (5%), fuqizim ekonomik (5%), paqe, siguri dhe pajtim (5%), adresimin e nevojave të mbijetuarve të dhunës seksuale (4%), demokraci dhe qeverisje (3%), të drejtat e fëmijëve (3%) dhe shëndetin (3%), që janë ndër fushat e tjera që marrin më pak fonde. **Asnjë fushë nuk dukej të kishte fonde të mjaftueshme**. Fushat që kanë marrë fonde të pamjaftueshme të identifikuara nga OSHCG-të janë: fuqizimi ekonomik i grave; adresimi i dhunës me bazë gjinore; udhëheqja e grave, fuqizimi dhe pjesëmarrja në politikë; qasja në arsim; shëndeti; të drejtat e personave me aftësi të kufizuar; ndërtimi i paqes; të drejtat e punës dhe punëtorëve; trafikimi i qenieve njerëzore; arti; të drejtat për tokë, pronë dhe kushte të banimit; demokracia dhe qeverisja; punë humanitare dhe emergjente; migrimi; të drejtat mjedisore dhe drejtësia; të drejtat e lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, trans, queer, interseksit, aseksualëve dhe të drejtave të tjera (LGBTQIA +); Komunikimet në internet dhe Teknologjia në Internet (TIK); të drejtat seksuale dhe shëndeti; dhe gratë në media. OSHCG-kishin tendencë t'i japin prioritet **strategjive kyçe, avokimit dhe ofrimit të shërbimeve**, veçanërisht ndihmën e personave që përjetojnë dhunë. OSHCG-të kishin mungesë fondesh për ofrimin e shërbimeve, avokimin, kërkimin shkencor, shërbimet juridike dhe psikoterapinë.

Ekzistojnë dëshmi minimale sa i përket asaj se cilat janë modalitetet e financimit që funksionojnë më mirë për mbështetjen e OSHCG. **"Një koktej i modaliteteve" që përfshin mbështetje thelbësore, grante për projekte dhe nën-grante** për OSHCG-të më të vogla mund të funksionojë më së miri në adresimin e nevojave të OSHCG-ve të ndryshme. **Financimi shumëvjeçar dhe mbështetja thelbësore mund të kontribuojnë në veprimet strategjike më afatgjata,** fleksibilitet gjatë situatave të vështira politike, kapacitetet e ngritura, qëndrueshmëri organizative dhe në arritjen e ndryshimeve pozitive që kërkojnë angazhim afatgjatë. Përdorimi i kontratave në vend të granteve, mund të çojë në instrumentalizimin e OSHCG-ve për interesa të donatorëve dhe konkurrencë sesa për bashkëpunim drejt ndryshimit shoqëror. Kufizimet e rrepta të fondeve në kostot e burimeve njerëzore mund të ulin efektivitetin, zhvillimin e kapaciteteve dhe efikasitetin e OSHCG-ve. OSHCG-të u përpoqën të sigurojnë ndarjet e kostove të kërkuara duke pasur parasysh që një numër i vogël i donatorëve ofrojnë mbështetje të tillë dhe OSHCG-të rrallë kanë burime të tyre në dispozicion që duhet të jenë të mjaftueshme për këtë qëllim.

Ekzistojnë disa arsye për financimin e OSHCG. Në kontekstin aktual politik, OSHCG-të janë ndër zërat kryesorë që kërkojnë qeverisje të mirë dhe promovojnë të drejtat e njeriut. Pabarazitë gjinore mbeten të përhapura në BP dhe OSHCG-të janë në pozicion të mirë për t'i adresuar ato, përfshirë përmes hulumtimit të bazuar në dëshmi, avokimit, propozimeve të politikave, monitorimit të qeverisë dhe ofrimit të benefiteve publike. Dëshmitë tregojnë se OSHCG-të kanë kontribuar në disa ndryshime sociale, duke sugjeruar që **mbështetja e OSHCG-ve do të thotë investim në ndryshim shoqëror**. Gjithashtu, ekzistojnë dëshmitë e rëndësisë dhe efikasitetit të OSHCG-ve. Edhe pse ato kanë qenë efektive dhe kanë pasur ndikim në sjelljen e ndryshimit, situata politike, reagimi i ashpër patriarkal, qasja e dobët në burime dhe shterimi emocional e fizik i aktivistëve mund të cenojnë efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e tyre afatgjate.

GJETJET KYÇE

- 9% e OSHCG-ve të intervistuara kurrë nuk kanë marrë fonde (22); ato punuan në baza vullnetare.
- Të ardhurat mesatare vjetore ishin 55,773 €, ndërsa të ardhurat mesatare vjetore ishin 6,000 €.
- OSHCG-të rurale dhe ato që i shërbejnë grave me aftësi të ndryshme kishin të ardhura mesatare vjetore që ishin afërsisht shtatë herë më të ulëta se të ardhurat e OSHCG-ve të tjera.
- 46% e OSHCG-ve kurrë nuk kanë pasur fonde shumëvjeçare dhe vetëm një e treta kishin fonde shumëvjeçare në vitin 2018.
- Shumica e OSHCG-ve (82%) kanë pasur periudha në të cilat nuk kishin burime të mjaftueshme dhe 35% nuk përmbushen buxhetet e tyre të planifikuara në 2018.
- Që prej vitit 2014, 28% kanë humbur mbështetjen nga donatorë që i kishin përkrahur historikisht.
- Mungesat e fondeve kanë bërë që OSHCG-të të vonojnë pagesat, të kenë staf që punon pa pagesë, të ndërprenë programet dhe të mbyllin dyert e tyre.
- 31% kanë qenë në rrezik të mbyllin organizatat e tyre për shkak të mungesës së fondeve.
- Sistemet e menaxhimit të të dhënave të donatorëve/financuesve priren të mos përmbajnë variabla për matjen e saktë të shpenzimeve për barazinë gjinore, të drejtat e grave dhe përkatësisht OSHCG-të.
- Përpjekjet drejt përfshirjes së perspektives gjinore kanë tendencë t'i bëjnë të paqarta shpenzimet aktuale.
- Nga 240 dokumente të veprimit IPA II të BE-së për BP, 56% nuk e kishin të caktuar shënuesin gjinor. Nga ata që e kishin, vetëm 47% ishin të shënuar saktë. Kjo sugjeron që shënuesi gjinor nuk ofron informacion të saktë në lidhje me financimin drejt barazisë gjinore në PB. Një shënim korrigjues ilustroi që vetëm 3.7% e dokumenteve të veprimit kishin shënues gjinor 1 ose 2; objektivi i GAP II për vitin 2020 është 85%.
- Shumica e fondeve që OSHCG-të raportuan se i kanë pranuar, kanë ardhur nga organizatat multilaterale (>21%) dhe ato bilaterale (>24%), të shpërndara shpesh përmes organizatave multilaterale të tjera, fondeve të grave ose organizatave.
- Fondet e grave (11%) dhe OJQN-të (8%) gjithashtu ofruan burime të konsiderueshme.
- Qeveritë (5%), fondacionet (5%) dhe organizatat lokale (1%) ofruan relativisht më pak mbështetje. Financimi i barazisë gjinore dhe OSHCG-ve duket se përfshin një pjesë shumë të vogël të fondeve qeveritare të ofruara për shoqërinë civile në vendet e BP.

- Shtetet e BP nuk kanë krijuar fonde të qëndrueshme për shoqërinë civile, përfshirë ato për shërbime të përfitimeve publike të ofruara nga OSHCG-të me përvojë, siç janë strehimoret për personat që përjetojnë dhunë.
- Ekziston shqetësimi për korrupsionin qeveritar dhe nepotizmin në shpërndarjen e fondeve për shoqërinë civile, si dhe në lidhje me sigurimin e autonomisë së OSHCG-ve dhe mbrojtjes së aftësive të tyre të avokimit kur marrin fonde shtetërore.
- Donatorët/financuesit priren të mos kenë plane të qarta për financime në të ardhmen.
- Individët dhe anëtarët kanë ofruar më pak se 0.3% të fondeve të OSHCG-ve, ndërsa sektori fitimprurës ka ofruar më pak se 0.2%.
- Adresimi i dhunës me bazë gjinore ka marrë më së shumti fonde (27%), por ajo dhe shume fusha të tjera mbesin pamjaftueshëm të financuara.
- 29% e OSHCG-ve mendonin se fondet në dispozicion nuk adresonin prioritetet e tyre.
- Ekzistojnë prova minimale se cilat modalitete të financimit funksionojnë më së mirin ë mbështetjen e OSHCG-ve.
- "Një koktej modalitetesh" që përfshin mbështetje thelbësore, grante për projekte dhe nën-grante për OSHCG-të më të vogla, ndoshta mund të kontribuojë në plotësimin e nevojave të OSHCG-ve të ndryshme.
- Financimi shumëvjeçar dhe mbështetja thelbësore kontribuojnë në veprime më strategjike, afatgjate, fleksibilitet gjatë situatave të vështira politike, kapacitetet e ngritura, qëndrueshmëri organizative dhe arritjen e ndryshimeve pozitive që kërkojnë angazhim afatgjatë.
- Ekzistojnë provat e pavarura të verifikueshme për rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin e OSHCG-ve dhe qëndrueshmërinë e disa aspekteve të punës së tyre.

REKOMANDIMET KYÇE

Për OSHCG-të

- **Të ndajnë fuqinë. T'i ndajnë burimet.** Mbështetni në mënyrë aktive dhe avokoni për fonde që promovojnë solidaritet se sa konkurrencë.
- **Të avokojnë bashkërisht për burime më të mira**, përfshirë edhe për kujdesin ndaj aktivistëve të të drejtave të grave dhe OSHCG-ve, në drejtim të mbështetjes së lëvizjes.
- P**ërmirësoni transparencën** sa i përket shpenzimeve dhe ndikimit më të mirë të dokumentit.

Për donatorët/financuesit

- Të mbështesin zhvillimin e një "**ekosistemi financimi**" gjithëpërfshirës, dinamik që plotëson nevojat e OSHCG-ve të ndryshme. Investimi në një ekosistem të tillë mund të rrisë ndjeshëm ndikimin politik dhe shoqëror të OSHCG-ve dhe të kundërveprojë me klimën aktuale të ngushtimit të hapësirës.
- **Të bashkëpunojnë më shumë me fondet e grave** për të shpërndarë grante OSHCG-ve më të vogla.
- Të **nxisin dialog më të thellë** me OSHCG-të për nevojat e tyre për financim, mënyrat për të adresuar nevojat e tyre dhe metodat më të mira për avancimin e barazisë gjinore.
- **Të ndajnë e planifikojnë fondet në të ardhmen** posaçërisht për avancimin e barazisë gjinore dhe, kur është e mundur, në mënyrë eksplicite për OSHCG-të, t'u japin përparësi fondeve për të adresuar pabarazitë e dukshme të identifikuara përmes analizave gjinore.
- Të vazhdojnë të financojnë OSHCG-të, veçanërisht përmes **mbështetjes shumëvjeçare, financimit thelbësor**, granteve dhe **financimit më fleksibël**. Të alokojnë financimin për mbështetjen e OSHCG-ve me **ndarje të kostove**. Të lejojnë kontributet të dokumentuara mirë në natyrë të kontribuojnë në ndarjen e kostove.
- **Të përmirësojnë koordinimin e donatorëve** dhe strategjizimin e përbashkët për avancimin e barazisë gjinore.
- Kur është e mundur, **të përdorin fondin investues** dhe **raportim të përbashkët** me donatorët e tjerë drejt minimizimit të ngarkesave administrative.
- Të kërkojnë **analizën** e detyrueshme **gjinore *ex ante*** dhe integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha programet.
- **Të përmirësojnë sistemet për përcjelljen e shpenzimeve** për barazinë gjinore, të drejtat e grave, gratë dhe vajzat dhe mbështetje direkte për OSHCG-të, përkatësisht duke përdorur praktika më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, të përmirësojnë masat e fondeve të alokuara dhe të shpenzuara.
- **Të kërkojnë nga qeveritë përfituese të përfshijnë perspektivën gjinore** në programet e financuara përmes financimit të jashtëm, si pjesë e marrëveshjeve të financimit.

Për BE-në

- Siç rekomandohet nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore, të prezantojnë "detyrimin për **shpenzimin në barazi gjinore, ngritje të kapaciteteve** në mes të zyrtarëve përkatës për **përfshirjen e perspektives gjinore në MFF** dhe proceset buxhetore dhe për kryerjen e **analizës gjinore të buxhetit** të të gjitha programeve të financimit për të analizuar ndikimin e tyre në barazinë gjinore".
- Të vendosin **kërkesa më të fuqishme, detyruese për avancimin e barazisë gjinore përmes financimit të jashtëm,** duke siguruar që si në IPA III ashtu edhe në

Instrumentin e Fqinjësisë, Zhvillimit dhe të Bashkëpunimit Ndërkombëtar është integruar perspektiva gjinore. Brenda këtyre rregulloreve:

- Të kërkojnë **vlerësimet *ex ante* të ndikimit gjinor** për të gjitha veprimet; dhe që këto analiza informojnë qëllimet, treguesit dhe objektivat e qarta drejt barazisë gjinore;
- **Të planifikojnë financim për barazi gjinore** sikur ishte planifikuar për mjedisin;
- Të bëjnë të detyrueshëm **buxhetimin e përgjegjshëm gjinor**;
- Të kërkojnë që **<u>të gjitha</u> vlerësimet të shqyrtojnë efektet në barazinë gjinore**; dhe
- Të kërkojnë **përcjellje dhe raportim të rregullt të shpenzimeve aktuale** për barazinë gjinore, gratë dhe vajzat dhe OSHCG-të.

- Me qëllim të ndërtimit në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme të kapaciteteve të OShC (G)-ve brenda vendeve përfituese të IPA-së, të përfshijnë **kushtëzimet në kriteret e pranueshmërisë së të gjithë** mbështetjes **së Fondit të BE-së për Shoqërinë Civile (E*U Civil Society Facility*)**, duke siguruar që këto fonde mbështesin vetëm organizatat lokale të regjistruara në vendet përfituese me përvojë që punojnë në këto vende.
- **Të planifikojnë programin vjetor për avancimin e barazisë gjinore** në sektorët e identifikuar përmes analizave gjinore.
- Drejt sigurimit të përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha programet në përputhje me GAP II (dhe potencialisht GAP III), të vendosin procedura dhe procese më të standardizuara të **rishikimit të cilësisë së barazisë gjinore të të gjitha programeve** në nivelet e EUD dhe EC, duke kërkuar që standardet e caktuara të përmbushen dhe të dhënat relevante për barazinë gjinore në programin të futen në sistemet e BE-së për menaxhimin e të dhënave.
- Si pjesë e **mbështetjes direkte buxhetore për qeveritë përfituese, gjithmonë të kërkojnë së paku një tregues që lidhet me avancimin e barazisë gjinore**.
- Nëpërmjet dialogut politik lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, **të inkurajojnë veprimet e qeverisë për të përmirësuar barazinë gjinore**, përfshirë edhe përmes shpërndarjes së duhur të burimeve për këtë qëllim.
- Si pjesë e zhvillimit të sektorit të shërbimeve të mirëqenies sociale, të mbështesin shtetet për të krijuar **fonde normative më të qëndrueshme për ofruesit e shërbimeve** që ndihmojnë personat që kanë përjetuar dhunë, siç janë skemat e rikuperimit të kostos. Gjatë hartimit të programeve të tilla, të sigurojnë pjesëmarrjen dhe njohjen e ekspertizës së OSHCG-ve që kanë përvojë në ofrimin e shërbimeve të tilla.

Për qeveritë

- **Të zbatojnë zotimet në** ligjet, politikat, programet dhe buxhetet me perspektivë gjinore të integruar, duke përfshirë përdorimin e duhur të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Duke vepruar kështu, **të angazhojnë OSHCG-të**, duke u siguruar atyre fonde të mjaftueshme dhe kompensim për ekspertizën e tyre.
- **Të përmirësoj kornizat ligjore dhe mundësojnë dhe krijojnë hapësirë për OShC-të të mbledhin fonde** nga individët dhe bizneset, si dhe të paguhen për ekspertizën e tyre.
- **Të krijojnë fonde të qëndrueshme**, të tilla si fonde normative, përmes një linje të përhershme buxhetore për të mbështetur rikuperimin e kostos për shërbimet e përfitimeve publike të ofruara. Të alokojnë burimet për OSHCG-të autonome, veçanërisht për ofruesit e shërbimeve të përfitimeve publike me ekspertizë që ka të bëjë me adresimin e dhunës me bazë gjinore, drejt sigurimit të burimeve të qëndrueshme për këto shërbime thelbësore të parapara me Konventën e Stambollit.
- **Të ndajnë fonde** për hulumtime, duke përfshirë analizën *ex ante* gjinore, ekspertizën gjinore, monitorimin e pavarur dhe vlerësimin nga OShC (G)-të.

- Të sigurojnë **dhënie transparente dhe të drejtë të fondeve**. Të vendosin masa për të lehtësuar rreziqet e keqpërdorimit, siç janë thirrjet e hapura me kritere të qarta të përzgjedhjes, angazhimi i vlerësuesve të pavarur dhe sigurimi i mekanizmave funksional të ankesave.
- Të bëjnë të **qasshme** të dhënat sa i përket **shpenzimeve të dhëna shoqërisë civile**.

Për koordinimin

- Të iniciojnë një përpjekje të koordinuar **për t'i mbajtur më të përgjegjshëm të gjithë donatorët/financuesit** për të bashkëpunuar në planifikimin e përbashkët të mbështetjes për avancimin e barazisë gjinore. Të kërkojnë **reduktimin e duplikimit dhe të përmirësojnë** përdorimin **efikas, efektiv dhe ndikues** të burimeve të kufizuara.
- Të identifikojnë mundësitë për përdorim më të mirë të **fondeve investuese dhe raportimit të përbashkët**, drejt përdorimit më efikas të burimeve njerëzore si për donatorët ashtu edhe për OSHCG-të.

Fotografia: Marija Jankovic

Feministja Natallija Llaptosheviq avokon me zë të lartë për të drejtat e grave gjatë marshimit në Ditën Ndërkombëtare të Gravë më 8 mars 2018, në Beograd.

HYRJE

Organizatat për të drejtat e grave (këtu e tutje të referuara si "OSHCG") janë në linjën e parë të frontit të adresimit të pabarazive gjinore të përhapura në BP.[1] OSHCG-të janë ndër zërat kryesorë që kërkojnë të drejtat e njeriut dhe qeverisje të mirë. Ato janë krijueset e ndryshimeve, ofrueset e shërbimeve të përfitimeve publike, hulumtueset, mësueset dhe ekspertet. Duke pasur parasysh ekspertizën e tyre dhe dekadat e përvojës, ato janë të pozicionuara mirë për të vazhduar adresimin e pabarazive ekzistuese gjinore në rajon. Megjithatë, puna e tyre e rëndësishme kërkon burime. Ky raport shqyrton resurset në dispozicion. Ky kapitull prezanton raportin, duke paraqitur zotimet ekzistuese për financimin e barazisë gjinore dhe OSHCG, arsyet e kryerjes së këtij hulumtimi dhe metodologjinë e përdorur. Ai përmban një përmbledhje të kapitujve që pasojnë.

[1] Për detaje shtesë dhe dëshmi të kontributit të tyre, shih kapitullin Pse të mbështeten OSHCG-të?. Teksti me ngjyrë vjollcë në këtë raport përmban vegëzën (hyperlink) që i drejton lexuesit tek burimi ose pjesa e referuar. Teksti i plotë i vegëzave është në pjesën Punimet e cituara.

Zotimet për financimin e barazisë gjinore dhe të OSHCG-ve

Ekzistojnë disa zotime ndërkombëtare në lidhje me financimin e OSHCG-ve, rrjeteve dhe lëvizjeve. Në vitin 1995, me Deklaratën e Pekinit dhe Platformën u kërkua nga qeveritë të krijojnë një mjedis mbështetës financimi për OSHCG-të, rrjetet e grave dhe grupet feministe.[2] Kjo deklaratë sugjeronte që arritja e barazisë gjinore në gjithë botën varet nga disponueshmëria e burimeve nga qeveritë, mekanizmat e financimit multilateral dhe bilateral.[3] Disa qeveri në mbarë botën, përfshirë edhe ato në të gjitha vendet e BP, kanë ratifikuar ose janë zotuar për të zbatuar Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW).[4] Sipas rekomandimit të përgjithshëm 28 të shtetet duhet të inkurajojnë dhe mbështesin financiarisht OSHCG-të.[5] Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 2493 njeh kontributin e OSHCG-ve ndaj grave, paqes dhe sigurisë.[6] Rezoluta kërkon rritje të fondeve për gratë, paqen dhe sigurinë, përfshirë mbështetjen për OSHCG-të.[7] Barazia gjinore është një qëllim me vete në mesin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të KB (OZHQ) që do të arrihet deri në vitin 2030 dhe është e përfshirë në të gjitha objektivat e tjera ku është integruar perspektiva gjinore.[8] Disa agjenci të KB kanë strategji të barazisë gjinore dhe plane veprim.[9]

Të gjitha qeveritë e BP-së gjithashtu janë zotuar ose kanë ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit.[10] Ajo bën thirrje shteteve të financojnë OSHCG-të, pasi ato janë ofruesit e shërbimeve me përvoje dhe me ndjeshmëri gjinore që mbështesin gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë. Ajo gjithashtu inkurajon shtetet të ndajnë burimet si ato njerëzore ashtu edhe ato financiare për zbatimin e politikave të ndryshime, përfshirë aktivitetet e OSHCG-ve.[11]

BE-ja dhe shtetet anëtare njohin barazinë gjinore si vlerë themelore.[12] Kjo është veçanërisht e rëndësishme për BP, duke qenë se vendet e BP kanë shprehur interesimin e tyre për t'u anëtarësuar në BE. Këshilli i Bashkimit Evropian ka ardhur në përfundim se të drejtat e grave dhe të vajzave, barazia gjinore dhe fuqizimi i grave duhet të jenë në thelb të agjendës së pas vitit 2015.[13] Ai ka theksuar se barazia gjinore është si një qëllim në vetvete ashtu edhe

---

[2] *Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim*, 1995, neni 350.
[3] Po aty, neni 36.
[4] OSBE, *OSCE-led Survey on Violence Against Women: Main Report*, OSCE, 2019, faqe 14. Edhe pse Kosova nuk mund të ratifikojë CEDAW, duke pasur parasysh statusin e saj politik, ajo ka inkorporuar CEDAW në Kushtetutën e saj dhe është zotuar ta zbatojë atë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 22). Në BeH, CEDAW është pjesë e Shtojcës 1 të Kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Mali i Zi ka Ligjin për Ratifikimin e Konventës për Eliminim e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1981); si pasardhës i shteteve të mëparshme, ajo u bë anëtare e Konventës në vitin 2006, pas shpalljes së pavarësisë (Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, *Report on implementation of the Convention on the Elimination of all forms of Discrimination against Women*, shkurt 2010, faqe 2. Ngjashëm, Serbia, u bë anëtare e Konventës në vitin 2001.
[5] Rekomandimet e përgjithshme e CEDAW 28.
[6] UNSCR 2493, për gratë, paqen dhe sigurinë , 2019.
[7] Po aty, neni 5.
[8] Kombet e Bashkuara, *The Sustainable Development Goals Report*, 2019.
[9] Shih UNDP, *UNDP Gender Equality Strategy 2018-2021*, dhe UNICEF, *Gender Action Plan 2018-2021*.
[10] Këshilli i Evropës, Seria e Traktatit- nr. 210, Stamboll, 2011. Të gjitha qeveritë përveç Kosovës kanë ratifikuar Konventën e Stambollit. Kosova nuk mund ta ratifikojë atë për shkak të statusit të saj politik, por ajo është zotuar ta zbatojë Konventën përmes Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit 2016-2020, e hartuar bazuar në kërkesat e Konventës së Stambollit. Shih gjithashtu: Gavric, S. for European Women's Lobby, "Mapping of Policies and Legislation on Violence Against Women and the Istanbul Convention in Kosovo," faqe 3.
[11] Neni 8.
[12] Neni 1 i Traktatit të Lisbonës, Amending the Treaty on European Union and the Treaty Establishing the European Community, 2007.
[13] Këshilli i Bashkimit Evropian, *Council Conclusions on Gender in Development*, 2019, faqe 3.

mjet për të arritur zhvillim të qëndrueshëm. Si prioritet i politikave për veprim të jashtëm dhe bashkëpunim për zhvillim, BE-ja gjithashtu është përpjekur të harmonizojë punën e saj drejt barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave me procesin e Financimit për Zhvillim të KB-së.[14]

BE-ja ka kuptuar që, pavarësisht progresit, vazhdojnë të qëndrojnë disa pabarazi ndërmjet grave dhe burrave në rajone të ndryshme. Për shembull, gratë dhe vajzat përbëjnë shumicën e të varfërve në botë, përballen me dhunë me bazë gjinore dhe mbeten të nënpërfaqësuara në qeveri dhe vendimmarrje.[15] Për të adresuar pabarazitë, BE-ja është zotuar që të avancojë barazinë gjinore përmes dialogut politik dhe shpenzimeve financiare siç ceket në Planin e dytë për barazi gjinore (GAP II),[16] Qasja gjithëpërfshirëse e BE-së ndaj zbatimit nga BE-ja të Rezolutave të 1325 dhe 1820 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (në vazhdim "Qasje gjithëpërfshirëse"),[17] në Qasjen e Re Strategjike të BE-së për Gratë, Paqe dhe Siguri (në vazhdim "Qasja strategjike"), dhe Planin shoqërues të Veprimit.[18] Komiteti i Parlamentit Evropian (PE) për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore (Komiteti FEMM) gjithashtu ka kërkuar përdorimin e treguesve specifikë gjinorë dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë në të gjitha shpenzimet e BE-së.[19] Në Strategjinë e fundit të BE-së për Barazi Gjinore, KE propozoi që Korniza Financiare Shumëvjeçare (KFSh) të sigurojë integrimin e një dimensioni gjinor në të gjithë KFSH dhe më konkretisht në instrumente te ndryshme të financimit dhe garantimit buxhetor të BE-së.[20]

Ndërkohë, BE-ja ka njohur rolin e rëndësishëm që luajnë OSHCG-të në avancimin e barazisë gjinore. GAP II parasheh që BE-ja dhe shtetet anëtare do të fuqizojnë "organizatat e vajzave dhe grave dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut" përmes "mbështetjes së pjesëmarrjes së organizatave të grave si agjentë përgjegjësie në proceset buxhetore, legjislative dhe të hartimit të politikave në të gjitha nivelet".[21] BE-ja është zotuar të "sigurojë kufizime minimale administrative për qasje në fonde nga organizatat lokale të shoqërisë civile, brenda kufijve të Rregullores Financiare të BE-së."[22] Më tej, ai ka thanë se "fondet e drejtpërdrejta, të besueshme dhe të parashikueshme të dhëna përmes granteve ose financimit afatgjatë mund të bëjnë ndryshim në krijimin e kushteve për lëvizjet qytetare (grassroots) dhe organizatat e shoqërisë civile" për të zbatuar Agjendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë.[23] Kështu që, BE synon të përdorë qasjen të bazuar në nevoja dhe tu japë përparësi granteve

---

[14] Po aty

[15] Zhvillimi Ndërkombëtar, *Implementing the European Union Gender Action Plan: Challenges and Opportunities*, Bashkimi Evropian, 2019.

[16] KE, Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Dokumenti i Punës i Stafit të Përbashkët (SWD), *Gender Equality and Women's Empowerment: Transforming the Lives of Girls and Women through EU External Relations 2016-2020*, SWD (2015) 182 final, 2015, përfshirë Objektiven 18. Shih gjithashtu, Këshilli i Bashkimit Evropian, *Gender Action Plan 2016-2020 - Council conclusions*, paragrafi 10.

[17] Këshilli i Bashkimit Evropian, Bruksel, 1 dhjetor 2008.

[18] Këshilli i Bashkimit Evropian, Council Conclusions on Women, Peace and Security, Bruksel, 10 dhjetor 2018, Shtojca 1, *EU Strategic Approach to Women, Peace and Security*, faqe 50. BE-ja, shtetet anëtare dhe kontraktuesit e financuar nga BE-ja duhet të zbatojnë Qasjen Strategjike, e cila kërkon analiza gjinore, përfshirjen e perspektivës gjinore në programe dhe vlerësimin e ndjeshëm gjinor në veprimet e jashtëm të BE-së. Për të plotësuar Qasjen Strategjike të BE-së, BE-ja miratoi *Action Plan on Women, Peace, and Security* në vitin 2019.

[19] *Report on EU Funds for Gender Equality*, 2016/2144(INI), 2017. Më konkretisht, ata kërkuan: "që treguesit specifikë gjinorë të aplikohen në fazat e përzgjedhjes, monitorimit dhe vlerësimit të projektit për të gjitha veprimet (nismat) që marrin fonde nga buxheti i BE-së" dhe "vlerësimin e detyrueshëm të ndikimit gjinor si pjesë e kushtëzimit të përgjithshëm ex-ante, dhe për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë të përfituesve dhe pjesëmarrësve".

[20] *A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025*. Zotimet e ngjashme u ngritën në Rezolutën EP të 19 nëntorit 2013, siç është cituar në Institutin Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), *Gender Budgeting: Mainstreaming Gender into EU Budget and Macroeconomic Policy Framework,* Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian,2018, faqe 21.

[21] KE, GAP II, faqe 11 dhe Objektiva 18.

[22] Këshilli i Bashkimit Evropian, *Council Conclusions on Women, Peace and Security*, faqe 50.

[23] Po aty

direkte për projektet e barazisë gjinore të udhëhequra nga OShC-të lokale, veçanërisht për organizatat e grave.[24] Të gjitha vendet që aspirojnë të bëhen shtete anëtare të BE-së, përfshirë gjashtë vendet e BP, gjithashtu duhet të përpiqen të veprojnë në përputhje me Politikën e Zhvillimit Rajonal dhe të Kohezionit të BE-së pas 2020[25]

Në BP, BE-ja dhe shtetet e saj anëtare kanë ndikim unik në avancimin e barazisë gjinore, duke pasur parasysh përkushtimin e vendeve të BP për t'u anëtarësuar në BE dhe investimet e dukshme të BE-së në BP përmes portofolit të Instrumentit për Para-anëtarësim (IPA), në mesin e modaliteteve tjera të financimit si Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) dhe Instrumenti që kontribuon në Stabilitet dhe Paqe. Meqenëse ky është financimi nga BE, BE-ja mund të kërkojë që të gjitha shpenzimet e tilla të informohen përmes vlerësimeve të detyrueshme *ex ante* të ndikimit gjinor dhe të përfshijnë integrimin e perspektivës gjinore.[26] Disa shtete anëtare të BE-së gjithashtu kanë bërë zotime për avancimin e barazisë gjinore përmes mbështetjes financiare bilaterale.[27]

Pse ky hulumtim?

Duke marrë parasysh zotimet e përshkruara në pjesën paraprake, informacioni mbi modelet e financimit të BE-së në BP është i rëndësishëm për vlerësimin e zbatimit të GAP II, si dhe për informimin e MFF, GAP III dhe IPA III me analizën gjinore.[28] Hulumtimi u përpoq të sigurojë informacione dhe rekomandime në kohë për të informuar këto politika. Përveç kësaj, BE, shtetet anëtare dhe donatorët e tjerë kanë shprehur interesimin e tyre për të mësuar më shumë rreth situatës së financimit dhe nevojave që lidhen me barazinë gjinore dhe OSHCG-të në BP.[29] Informacioni i tillë mund të mbështesë një planifikim të përmirësuar ndërmjet donatorëve/financuesve për të koordinuar më mirë burimet drejt përmbushjes së zotimeve dhe qëllimeve që kanë të bëjnë me barazi gjinore. Ai mund të informojë përgatitjen e strategjive të reja për BP.

Aktualisht, duket se nuk ekziston asnjë detyrim apo metodë e dakorduar për të ndjekur/përcjellë shpenzimet që lidhen me barazinë gjinore. Rregullorja e Përbashkët Zbatuese e BE-së lidhur me financimin e jashtëm ka kërkuar monitorim në lidhje me mjedisin, por ka kërkesa shumë jo të mjaftueshme për barazinë gjinore.[30] Një rregullore krejtësisht 'e verbër" ndaj barazisë gjinore nuk kërkon analizë të ndikimit gjinor për të informuar shpenzimet

---

[24] Po aty

[25] KE, *Regional Development and Cohesion Policy Beyond 2020: The New Framework at a Glance*, 2018. Agjenda e pas vitit 2020 përfshin krijimin e kushteve për barazinë gjinore, të cilat vlejnë për Fondin Social Evropian +, Fondin Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe Fondin e Kohezionit (EC, "*Annexes to the Proposal for a Regulation of the Parlamenti Evropian and of the Council laying doën common provisions on the European Regional Development Fund, the European Social Fund Plus, the Cohesion Fund, and the European Maritime and Fisheries Fund and financial rules for those and for the Asylum and Migration Fund, the Internal Security Fund and the Border Management and Visa Instrument*", 2018, faqe 25). Ndërsa kjo mund të shërbejë si një pikë hyrjeje për integrimin e perspektivës gjinore në agjendën e financimit të pas vitit 2020, EIGE ka paralajmëruar që fokusi në balancë punë-jetë dhe barazinë gjinore në punësim mund të minojë integrimin gjinor në sektorët e tjerë (*Gender Budgeting: Mainstreaming Gender into the EU Budget and Macroeconomic Policy Frameëork*, 2018).

[26] Kjo inkurajohet nga GAP II, si dhe nga Komiteti PE FEMM (*Report on EU Funds for Gender Equality*, 2016/2144(INI), 2017).

[27] Intervistat me financuesit në Kosovë, Serbi, Shqipëri dhe në rajon, 2019. Për më shumë informacion, shih: *Kush i financon OSHCG-të? Financuesit bilateralë.*

[28] GAP II, 4.1 kërkon dhe Komiteti PE FEMM ka rekomanduar që të gjitha fondet t'i nënshtrohen "vlerësimit të detyrueshëm të ndikimit gjinor si pjesë e kushtëzimit të përgjithshëm ex-ante".

[29] Komentet e bëra nga shtetet anëtare dhe financuesit gjatë lansimit të ngjarjeve në BP në vitin 2018 nga, N. Farnsworth dhe I. Banjska për RrGK-në, *Mind the GAP: An Independent Evaluation of the Implementation of the EU Gender Action Plan II in Western Balkan Countries*, 2018.

[30] Common Implementing Regulation (CIR) No. 236/2014 of the Parlamenti Evropian dhe e Këshillit "përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të për financimin e veprimeve të jashtme", 2014.

si pjesë e një kushtëzimi të përgjithshëm ex-ante,[31] e as nuk bën thirrje për vlerësime të ndikimit gjinor në të gjitha vlerësimet. Edhe pse është propozuar një objektiv për të drejtuar 25% të shpenzimeve të BE-së në MFF të ardhshëm (2021-2027) drejt objektivave klimatike, barazia gjinore ka zotime relativisht më të dobëta.[32] Propozimi fillestar i KE për MFF e re përfshin zotime dhe angazhime më të ulëta se vlera e 1% e parashikuar tashmë për barazinë gjinore nga Fondet Strukturore dhe Investuese të BE-së.[33]

Duke pasur parasysh kornizën e dobët rregullatore, monitorimi i shpenzimeve për barazinë gjinore dhe OSHCG-të është dëshmuar të jetë sfidues. Monitorimi fillestar i pavarur i zbatimit të GAP II në vitin 2017 zbuloi se ekzistonin të dhëna minimale për përcjelljen e progresit në treguesit e GAP II në lidhje me financimin.[34] Për më tepër, Rishikimi Afatmesëm i IPA II nuk përmbante ndonjë analizë gjinore, edhe pse GAP II kishte planifikuar ta bënte, me qëllim të informimit të treguesve për "financimin e dedikuar për të përmirësuar rezultatet për vajzat dhe gratë".[35] Të vetmin tregues që KE përdor aktualisht për të monitoruar alokimet e buxhetit drejt barazisë gjinore është Shënuesi Gjinor i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) (shih Kutinë 1).[36]

Megjithatë, rishikimi i 240 dokumenteve të veprimit për BP të IPA II që janë publike tregoi se 56% të këtyre nuk kishin të përfshirë fare shënuesin e gjinisë.[37] Nga ato që kishin shënuesin gjinor, vetëm 47% ishin shënuar saktë. Pra, Shënuesi Gjinor nuk jep informacion të saktë sa i përket financimit drejt barazisë gjinore.[38] Për më tepër, sistemet e BE-së përdorin shënuesin vetëm për të matur alokimet, që mund të dallojnë nga shpenzimet. Pra, BE-ja nuk ka informacione të sakta mbi shpenzimet për barazinë gjinore dhe OSHCG-të, të cilat mund të informojnë politikat dhe programet e ardhshme.

---

[31] Kjo u rekomanduar nga Komiteti PE FEMM (2016/2144(INI), 2017). Analiza gjinore gjithashtu kërkohet për të caktuar shënuesin e duhur të gjinisë të OECD.

[32] Parlamenti Evropian, *Long-term EU budget: MEPs Lay Doën Funding Priorities for Post-2020 Budget*, 2018, dhe IGE, *Gender Equality Deserves More than 1%*, 2019.

[33] EIGE, *Gender Equality Deserves More than 1%*, 2019.

[34] Farnsworth dhe Banjska, *Mind the GAP*.

[35] Ky është treguesi GAP II 3.1.1. lidhur me Rishikimin Afatmesëm, shih publikimin e RrGK-së *A Gendered Reading of the 'External Evaluation of the Instrument for the Pre-Accession Assistance'*, 2017.

[36] Informacionet në kuti janë nxjerrë nga intervistat (2019).

[37] RrGK, Përmbledhja e politikës (pa titull), 2020. Bazuara në vlerësimi e të gjitha dokumenteve të vendit dhe ato rajonale për 2014-2020, në: Komisioni Evropian, uebfaqe, European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations, "Instrument for Pre-accession Assistance", qasur në prill 2020.

[38] Përtej BPAGE hulumtimi global tregon që disa projekte përmbushin kriteret minimale të OECD për Shënuesin e Gjinisë 1 dhe 2. Ekziston një hendek i gjerë mes financimit të vetë-raportuar drejt barazisë gjinore midis donatorëve dhe shifrave aktuale (Grabowski, A. and Essick, Page, *Are they really gender equality projects? An examination of donors' gender-mainstreamed and gender-equality focused projects to assess the quality of gender-marked projects*, 2020).

Kutia 1. Shënuesi i gjinisë i OECD

Shënuesi i gjinisë i OECD është një mjet që përdoret për të vlerësuar shkallën në të cilën programet dhe projektet synojnë barazinë gjinore. Shënuesi përdor shkallën prej tre pikësh për të vlerësuar nëse projektet targetojnë barazinë gjinore si objektiv primar (shënuesi i gjinisë 2), objektiv sekondar (shënuesi i gjinisë 1) ose aspak (shënuesi i gjinisë 0). Analiza gjinore është e nevojshme për të shënuar veprimet në mënyrë të duhur.

Nga 71 donatorë të intervistuar për këtë hulumtim, 23 deklaruan se ata përdorin gjithmonë Shënuesin e gjinisë të OECD, ndërsa gjashtë prej tyre ndonjëherë e përdorin atë. Ndërkohë, 25 thanë që nuk e përdorin shënuesin. Në mesin e atyre që nuk përdorin shënuesin, pati një trend të përsëritur: ata priren të thoshin se ishte i panevojshëm sepse projektet kanë të integruar perspektivën gjinore. Kjo sugjeroi të kuptuarit jo të mjaftueshëm të qëllimit të shënuesit të gjinisë, i cili duhet të përdoret në të gjitha rastet.

Janë identifikuar disa sfida me përdorimin e Shënuesit të Gjinisë. Së pari, përdoruesit e tij nuk e kuptojnë fare atë dhe për këtë arsye i shënojnë keq projektet, duke kontribuar në të dhëna të pasakta Projektet e shënuara me një shënues gjinor 0 shpesh nuk janë të justifikuara, megjithëse ato duhet të jenë në përputhje me GAP II. Për më tepër, ai vetëm njeh objektivat dhe nuk merr parasysh aktivitete ose rezultate të menjëhershme drejt barazisë gjinore, të cilat mund ta bëjnë të vështirë aplikimin në programimin e BE-së, ku preferohen vetëm një ose më shumë objektiva.

Në vitin 2011, Shoqata për të drejtat e grave në zhvillim (AWID) bëri një sondazh global për të përcaktuar nevojat e financimit të organizatave të grave në gjithë botën, me titull "Ku janë paratë për të drejtat e grave?".[39] Pak OSHCG në BP morën pjesë sepse shumë pak prej tyre dinin për sondazhin ose kishin qasje në të në gjuhën e tyre. Rrjedhimisht, në vitin 2013, me mbështetjen e AWID dhe Fondacionit Kvinna till Kvinna, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe Alterhabitus administruan anketën e AWID përmes afro 130 intervistave drejtë për drejt në Kosovë, si studim rasti, për të kuptuar më mirë nevojat e organizatave që nuk kanë mundur të jenë pjesë online të Sondazhit Global. Hulumtimi tregoi se OSHCG-të që nuk morën pjesë në sondazhin e AWID shpesh kishin nevoja më të mëdha se ato që kanë marrë pjesë. Në veçanti, organizatat rurale janë përballur me kufizime për t'iu përgjigjur vlerësimeve të nevojave, si dhe për t'u qasur në fonde për shkak të qasjes së pamjaftueshme në internet dhe mos njohurisë së gjuhës angleze.[40] Studimi i AWID tani është i vjetërsuar dhe asnjë hulumtim tjetër i njohur nuk e shqyrton në mënyrë të plotë situatën e OSHCG-ve të ndryshme në BP.

Duke pasur parasysh mungesën e informacionit në dispozicion për trendet e financimit drejt barazisë gjinore dhe për OSHCG-të në BP, ky hulumtim synon të sigurojë informacion të tillë. Ai u përpoq të japë rekomandime të bazuara në prova për përmirësimin e qasjes në fonde për OSHCG-të e ndryshme.

[39] AWID, *Watering the Leaves, Starving the Roots: The Status of Financing for Women's Rights Organizing and Gender Equality*, 2013.
[40] Farnsworth, N. and Gashi, E., *Where's the Money for Women's Rights? A Kosovo Case Study*, RrGK dhe Alter Habitus – Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë, 2013.

Metodologjia

Ky hulumtim përdori një metodologji të ngjashme me atë të përdorur nga AWID, që është përshtatur me kontekstin e BP dhe qëllimet e këtij hulumtimi. Hulumtimi përfshin një qasje gjithëpërfshirëse për të kuptuar faktorë të ndryshëm që ndikojnë potencialisht në qasjen e OSHCG-ve në fonde. Pyetjet kryesore të hulumtimit përfshinin:

- Cilat çështje kontekstuale, përfshirë ligjet, politikat dhe/ose mjediset operative mbështesin ose pengojnë punën e OSHCG-ve?
- Si dhe pse donatorët/financuesit e ndryshëm mbështesin ose jo OSHCG-të dhe lëvizjet?
- Çfarë fonde kanë qenë në dispozicion për periudhën nga 2014 deri në 2019 për OSHCG-të, gratë dhe vajzat dhe përkatësisht barazinë gjinore?
- Cila është rëndësia e mbështetjes së OSHCG-ve dhe lëvizjeve, nëse ka? Sa relevante, efikase, efektive, të qëndrueshme dhe me ndikim besojnë donatorët se janë OSHCG-të?

Sa i përket pyetjes së tretë, ekipi ka bërë diferencimin midis katër llojeve të financimit. Financimi për **barazi gjinore** nuk përfshin domosdoshmërish fonde direkte për gra dhe vajza ose të drejtat e grave. Për shembull, mund të jetë financimi i përpjekjeve për të ndryshuar normat sociale midis djemve. Financimi për **të drejtat e grave** do të përpiqej të kontribuonte drejtpërdrejtë për avancimin e të drejtave të grave. Financimi për **gra dhe vajza** do të përfshinte të gjitha fondet që përfitojnë gratë dhe vajzat. Ai mund ose nuk mund të kontribuojë në të drejtat e grave ose barazi gjinore, në varësi të qëllimeve të financimit të ofruar. Për shembull, gratë mund të përfitojnë nga ndihma humanitare, por kjo jo domosdoshmërish kontribuon në avancimin e barazisë gjinore brenda komunitetit të tyre duke ndryshuar normat sociale ose avancuar të drejtat e tyre më gjerësisht. Me fjalë të tjera, përfitimi nga mbështetja nuk barazohet domosdoshmërish me ndryshimin e normave gjinore ose me avancimin e të drejtave të grave. Financimi i **OSHCG-ve** mund të kontribuojë në barazinë gjinore, avancimin e të drejtave të grave dhe/ose mbështetjen e grave dhe vajzave. Megjithatë, fondet për secilën nga këto nuk duhet domosdoshmërish të shpërndahen përmes OSHCG-ve; ato mund të shpërndahen gjithashtu edhe përmes akterëve të tjerë. Përcjellja e të katër llojeve të financimit mund të ofrojë informata të dobishme, përfshirë këtu edhe ato që lidhen me politikat e lartpërmendura.

Hulumtimi u përqendrua në grupet dhe organizatat për të drejtat e grave (të referuara si OSHCG-të), të cilat ekipi i hulumtimit i hipotezoi si nxitës kryesorë të ndryshimit shoqëror drejt barazisë gjinore.[41] Siç është shpjeguar në Fjalorin e termeve, për këtë hulumtim, OSHCG-të ishin përcaktuar të përfshijnë grupe formale dhe joformale, të regjistruara dhe të paregjistruara, *qëllimi kryesor* i të cilave është avancimi i të drejtave të grave. Ka pasur informacione të pakta sa i përket financimit të lëvizjeve në BP, sipas pyetjeve të hulumtimit, kështu që gjetjet fokusohen më shumë në OSHCG-të.

Termi "financuesit/donatorët" është përkufizuar të përfshijë çdo organ publik ose privat ose person që ofron fonde, siç përshkruhet në Fjalorin e termeve. Meqenëse pak financues siguruan të dhëna mbi financimin dhe të dhëna të pakta ishin në dispozicion në internet, gjetjet vijnë kryesisht nga shpenzimet e raportuara të OSHCG-ve. Duke pasur parasysh natyrën e të dhënave në dispozicion, si dhe zotimet e lartpërmendura të financuesve, raporti përqendrohet në financime multilaterale dhe bilaterale. OSHCG-të kanë forma të tjera të të ardhurave, por ato janë të kufizuara. Shqyrtimi i dhënies filantropike dhe teknikat e

[41] Kjo hipotezë u bazua në observimet personale, si dhe në Htun, M. and Weldon L., "*The Civic Origins of Progressive Policy Change: Combating Violence against Women in Global Perspective*, 1975–2005", *American Political Science Review*, 106, faqe 548-569, 2012.

mbledhjes së fondeve për OSHCG-të dhe të drejtat e grave do të mund të ishte një studim në vete dhe ishte përtej këtij hulumtimi.

Metodologjia përfshinte metoda të përziera të hulumtimit, duke përfshirë hulumtimin në tryezë; një rishikim të politikave dhe kornizave ligjore; intervista të drejtë për drejta me OSHCG-të duke përdorur pyetje të strukturuara dhe gjysmë të strukturuara të bëra në gjuhët lokale; dhe intervistat me 71 financues të ndryshëm të përzgjedhur duke përdorur mostra të ndryshueshme në pyetjet e hulumtimit.[42] Ekipi u përpoq të intervistonte tërë popullsinë e OSHCG-ve aktive në gjashtë vende të BP në pesë vitet e fundit, pavarësisht nga ajo nëse kishin apo jo fonde. Ekipi kontaktoi të gjitha OSHCG të identifikueshme. Megjithatë, disa nuk u përgjigjen ose morën pjesë edhe pas disa përpjekjeve për t'i kontaktuar. Në total, ekipi intervistoi 240 OSHCG të ndryshme me diskutime mesatarisht rreth 1.5 orë.[43] Gjithsej, mostra përfshinte rreth 69% të popullatës së tërë të OSHCG-ve që njihen të jenë aktive në BP. Siç ilustron Grafiku 1, shumica e pjesëmarrësve në hulumtim nga OSHCG ishin të vendosur në Kosovë (46%), pasuar nga Maqedonia e Veriut (15%), Bosnja dhe Hercegovina (BeH) (13%), Serbia (13%), Shqipëria (10%) dhe Mali i Zi (3%).

Grafiku 1. Numri dhe përqindja e të anketuarve nga OShCG sipas vendit



Në përgjithësi, mostra pasqyronte popullsinë e vlerësuar të OSHCG-ve në BP, me Kosovën që kishte OSHCG më aktive se vendet e tjera. Duke marrë parasysh mbipërfaqësimin e Kosovës në mostër, ku është relevante, gjetjet janë të paraqitura si në numra real ashtu edhe në përqindje. Ngjyrat e përdorura në Grafikun 1 për secilin vend përdoren në tërë raportin. Fakti që përafërsisht 108 OSHCG (31% të mostrës së planifikuar) dhe 31 financues (30%) nuk morën pjesë në këtë hulumtim, mund të kontribuojë në disa paragjykime në marrjen e mostrave.

Siç ilustron Tabela 1, shkalla relativisht më e ulët e përgjigjeve në Shqipëri dhe BeH do të thotë që OSHCG-të nga këto vende mund të jenë pak të nën përfaqësuara, krahasuar me vendet e tjera.

[42] Shtojca 2 rendit të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim.
[43] Për të gjithë grafikët n = 239 përveç nëse është thënë ndryshe. Në grafikun 1, n = 241 sepse një organizatë nga Serbia mori pjesë në hulumtimin cilësor, por nuk dha informacion sasior. Një OSHCG shtesë në Serbi dha informacion financiar, por nuk ishte në dispozicion për intervistë. Në total, morën pjesë 241 OSHCG.

Tabela 1. Intervistat e planifikuara dhe të zhvilluara sipas vendit								
Vendi	OSHCG-të					Financuesit		
	Pop. e planifikuar	% e pop.	Mostra e plotësuar	% e mostrës	Shkalla e përgjigjes	Planifikuar	Plotësuar	Shkalla e përgjigjes
Shqipëri	50	14%	23	10%	46%	12	8	67%
BeH	68[44]	20%	32	13%	47%	19	11	58%
Kosovë	140	40%	111	46%	79%	20	20	100%
Mali i Zi	10	3%	8	3%	80%	14	6	43%
Maqedonia e Veriut	40	11%	36	15%	90%	17	7	41%
Serbi	40	11%	30	13%	75%	14	13	93%
Rajonal	NA		NA			6	6	100%
Gjithsej	**348**		**240**		**69%**	**102**	**71**	**70%**

Në mesin e të anketuarve të OSHCG, 46% konsideruan ofrimin e shërbimeve një ndër strategjitë e tyre prioritare. Në Mal të Zi, Shqipëri, Serbi dhe BeH, shumica e OSHCG-ve që morën pjesë në këtë studim, kanë ofruar shërbime (shih Grafikun 2). Ndër arsyet e marrjes pjesë në këtë studim, OSHCG-të kanë shprehur shqetësimin se disa ofrues të shërbimeve të OSHCG janë përballur me sfida të konsiderueshme financimi dhe madje kanë mbyllur dyert e organizatave, duke i vënë gratë dhe fëmijët në rrezik të madh. Prandaj, disa gjetje fokusohen në pozicionin e ofruesve të shërbimeve të OSHCG. Megjithatë, OSHCG-të e ndryshme morën pjesë në studim dhe gjetjet në përgjithësi i referohen të gjitha OSHCG-ve, Përveç nëse specifikohet ndryshe.

Grafiku 2. Numri dhe pjesa e OShCG-ve që ofrojnë shërbime direkte



Hulumtuesit përdorën një mjet elektronik për sondazh, Kobo Collect, për të regjistruar të dhënat sasiore; ata gjithashtu morën edhe shënime. Ekipi ka analizuar të dhënat cilësore duke koduar gjetjet në një dokument të përbashkët, sipas pyetjeve të hulumtimit. RrGK ka pastruar dhe analizuar të dhënat sasiore nga Kobo Collect duke përdorur Pakon Statistikore për Shkencat Sociale (PSShS). Ekipi përdori Excel-in për të analizuar të dhënat sasiore që kanë të bëjnë me fondet të cilat OSHCG-të raportuan se i kanë marrë. Për të analizuar fondet me kalimin e kohës, kur të dhënat nuk ishin në dispozicion, RrGK supozoi, ndoshta në mënyrë të pasaktë, një shpërndarje të barabartë të fondeve për vit për grante shumëvjeçare. Të gjitha valutat u konvertuan në euro bazuar në kursin mesatar për 2014-2019. Ekipi përfundoi shumicën e hulumtimit deri në vjeshtë të vitit 2019, raporti përmban gjetje indikative për vitin 2019, por OSHCG-të mund të kenë pranuar financim shtesë pas mbledhjes së të dhënave. Për

[44] Në BeH, 68 OSHCG u menduan se ishin aktive në fillim të hulumtimit. Sa i përket Koordinatorit të Rrjetit të Grave në BeH, 36 OSHCG ishin aktive që nga janari 2019. Megjithatë, u mbajt numri i synuar fillestar bazuar në mundësinë që 68 mund të kenë qenë aktive në vitet e mëparshme dhe se disa OSHCG ndoshta mund të mos të jenë anëtare të rrjetit të grave.

t'u kujtuar lexuesve se të dhënat e vitit 2019 mund të jenë jo të plota, grafikat përmbajnë linja nga 2018 deri në 2019. RrGK-ja ka hartuar raportin përfundimtar dhe anëtarët e ekipit të hulumtimit rishikuan raportin.

Kufizimi i hulumtimit ishte mungesa e të dhënave të sakta që kanë të bëjnë me fondet e shpërndara OSHCG-ve. Vetëm 85% e OSHCG-ve pjesëmarrëse dhe 31% e financuesve të intervistuar (22) siguruan të dhënat e kërkuara. Disa OSHCG kishin evidentim të dobët të regjistrave ose i konsideruan konfidenciale informacionet e tilla, duku refuzuar t'i ndajnë ato. Sa i përket të dhënave të financuesve, në BeH, asnjë nga financuesit nuk dorëzoi informacion të tillë dhe në Shqipëri e bëri vetëm një. Disa financues kishin sisteme të dobëta të përcjelljes së të dhënave, që nuk mund të bënin ndarjen e financimit sipas gjinisë ose pranuesit (OSHCG-të). Disa thanë që ndarja e të dhënave në këtë mënyrë do të merrte shumë kohë, gjë që njëjtë sugjeron sisteme të dobëta. Financuesit vazhdimisht vërenin sfidë në matjen e shpenzimeve në programet që përfshijnë integrimin gjinor, pasi buxhetet rrallë ndahen në mënyrë të qartë. Kështu ata sugjeruan që më shumë fonde ishin dhënë për barazinë gjinore, por ata nuk mund ta matnin atë. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave të krahasueshme nga financuesit, raporti përmban vetëm studime të rasteve individuale për disa financues.

Në analizën e financimit të OSHCG-ve, të dhënat e paqarta gjithashtu kontribuuan në kufizime. Në kodimin e të dhënave, ekipi nuk ka mundur t'i atribuojë afërsisht 2.2% të fondeve të raportuara sektorëve ose fushave specifike. Përkundër përpjekjeve për të kontrolluar të dhënat me të anketuarit, mos përgjigjet ose përgjigjet e paqarta mund të kenë kontribuar në gabimet në kodimin e të dhënave. Duke marrë parasysh këto kufizime, gjetjet që kanë të bëjnë me shpenzimet janë ilustruese, por jo gjithëpërfshirëse. Megjithatë, ato ofrojnë një tregues interesant të trendeve të financimit.

Përmes triangulimit të metodave, të të dhënave dhe hulumtuesve, si dhe kontrolleve të pjesëmarrësve është bërë përpjekja të forcohet vlefshmëria dhe besueshmëria. Ekipi mban qëndrim se i gjithë hulumtimi përfshin pak subjektivitet, pasi është bërë nga njerëzit me pika të veçanta të përfitimit. Prandaj, hulumtuesit aplikuan refleksivitetin, duke u përpjekur që në mënyrë transparente të dokumentojnë dhe raportojnë paragjykimet e mundshme. Ekipi pranon se ka paragjykime të mundshme të qenësishme lidhur me aktivistët që kryen këtë hulumtim dhe kështu përdorën triangulimin drejt validimit të gjetjeve. Shtojca 3 përmban përshkrimin e plotë të metodologjisë.

Rreth këtij raporti

Autorët kanë huazuar titullin e këtij raporti nga AWID, duke bërë pyetjen e përgjithshme të hulumtimit: "Ku janë paratë për të drejtat e grave?". Raporti së pari diskuton se si kontekstet politike dhe sociale ndikojnë në OSHCG-të. Pastaj, ai shqyrton financuesit e ndryshëm të angazhuar në mbështetjen e barazisë gjinore dhe OSHCG-ve në BP. Kapitulli në vijim paraqet trendet e financimit, duke përfshirë shumat, fushat tematike, grupet e synuara, strategjitë, afatet kohore dhe qasjet. Në fund, raporti diskuton arsyen për mbështetjen e OSHCG-ve, duke përfshirë pikëpamjet e financuesve për rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e tyre, sipas kritereve të Komitetit të OECD për Zhvillimin e Ndihmës (DAC). Raporti përmbyllet me rekomandime për OSHCG-të, financuesit dhe koordinimë përmirësuar.

Aktivistët protestojnë kundër femicidit përpara Ministrisë së Punës në Beograd në vitin 2017. Rrallë herë qeveritë i japin përparësi adresimit të dhunës ndaj grave si një kërcënim serioz për sigurinë.

KONTEKSTI

Ky kapitull shqyrton kontekstin më të gjerë shoqëror, politik dhe financiar, për t'iu përgjigjur pyetjes së hulumtimit: "Cilat çështjet kontekstuale, përfshirë ligjet, politikat dhe/ose mjediset operative mbështesin ose pengojnë punën e OSHCG-ve?" Së pari, ai shqyrton trendet globale të financimit. Pastaj, diskuton se si konteksti politik në BP kontribuon në ngushtimin e hapësirës për OSHCG-të. Në fund, ai diskuton ligjet kombëtare që ndikojnë në qasjen e OSHCG-ve në burime.

Trendet globale të financimit

Edhe pse ky hulumtim përqendrohet në OSHCG-të në BP, modelet më të gjera të shpenzimit mund të ndikojnë në trendet rajonale. Ekzaminimi se si shpenzohen fondet është i dobishëm për të kuptuar fushën e ngushtë të fondeve të disponueshme për ndryshime sociale dhe veçanërisht për lëvizjen e grave. Në përgjithësi, disa qeveri kanë vazhduar tu japin përparësi shpenzimeve ushtarake se sa atyre sociale; ato arritën 1.8 trilion dollarë në vitin 2018.[45] Në kontrast, shpenzimet globale atë vit për shëndetësi dhe arsim ishin 38 miliardë $, përkatësisht 2.2 miliardë dollarë.[46] Shpenzimet e fokusuara në barazinë gjinore janë vlerësuar të jenë afërsisht 4.6 miliardë dollarë në 2016-2017.[47] Kuptimi neoliberal i sigurisë supozon se shpenzimet ushtarake do të parandalojnë pasigurinë. Sidoqoftë, kjo qasje tradicionale ndaj sigurisë me gjasë largon shpenzimet nga investimet në zhvillim njerëzor dhe një nocion më të

[45] Të gjitha referencat në dollarë të Shteteve të Bashkuara. "World Military Expenditure Grows to $1.8 trillion in 2018", cituar në Miller, K. and Jones, R., *Toward a Feminist Funding Ecosystem*, AWID, 2019.
[46] Cituar në Miller and Jones: *Financing Global Health 2018: Countries and Programs in Transition*, dhe UNESCO, *Migration, Displacement and Education: Building Bridges, Not Ëalls*.
[47] OECD, *Aid in Support of Gender Equality and Women's Empowerment: Donor Charts*, 2019, faqe 6. AWID përfshiu vetëm projektet e Shënuesit të Gjinisë 2 të OECD me barazinë gjinore si "objektivi kryesor". Vendet anëtare të OECD raportuar 40 milion dollarë shtesë në fonde e zotuara, me barazi gjinore si një objektiv të rëndësishëm. Megjithatë, ekzistojnë disa çështje me Shënuesi e Gjinisë të OECD (shih Kutinë 1), kështu që kjo shifër nuk është aq e besueshme.

gjerë të sigurisë dhe mirëqenies së njerëzve. Shembulli klasik është dhuna ndaj grave në shtëpi. Në nivel global, një nga tre gra kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri.[48] Dhuna në familje mbetet e përhapur edhe në mungesë të luftës, por shtetet rrallë i japin përparësi fondeve për adresimin e dhunës në familje si çështje "sigurie". Globalisht, financuesit bilateral dhe multilateral historikisht kanë qenë burim më i besueshëm dhe i rëndësishëm i financimit për barazinë gjinore dhe OSHCG-të.[49] Në vitin 2013, AWID konstatoi se shpenzimet e tyre përbënin 27% të fondeve për organizatat e grave (shih Grafiku 3).[50] Ndërkohë, qeveritë lokale dhe kombëtare përbënin 20%, fondacionet private 15%, OJQN-të 7% dhe fondet e grave 5%. Afro 4% e mbështetjes financiare ishte e vetë-gjeneruar.

Grafiku 3. Financimi i AWID, 2013



Sektori privat duket se është një akter në rritje në mesin e financuesve të shoqërisë civile.[51] Disa financues të tillë njohin se raca, gjinia, klasa, aftësia e kufizuar dhe përkatësia etnike janë të lidhura thellësisht. Këta donatorë po e riformulojnë narracionin për të përfaqësuar realitetet e jetuara të grave dhe vajzave të ndryshme.[52] Megjithatë, kjo e shoqëruar me popullaritetin e integrimit gjinor mund të paraqesë sfida që fondet të arrijnë në të vërtetë tek vajzat dhe gratë ose OSHCG-të. Për shembull, fondacionet private dhanë 9.4 miliardë dollarë për avancimin e të drejtave të njeriut në mes të vitit 2011 dhe 2015, me 23% të caktuar për gra dhe vajza, por nuk është e qartë se sa prej këtyre shkuan pikërisht tek OSHCG-të.[53]

AWID ka ardhur në përfundim që OShC-të operojnë brenda "ekosistemeve të financimit" që funksionojnë me "mundësi të ndryshme të gjenerimit të të ardhurave që përputhen me shumëllojshmërinë e nevojave që kërkon ndryshimi shoqëror."[54] Ata kanë sugjeruar që një shumëllojshmëri e financuesve dhe modalitetet e tyre të kombinuara ndihmojnë në sigurimin e një pune efikase dhe të qëndrueshme për barazinë gjinore. Pastaj, për të kuptuar më mirë se cilat lloje të financimit përputhen në mënyrë të duhur me kontekstet e ndryshme, është e nevojshme të gjurmohet dhe vlerësohet se si funksionon caktimi i burimeve, duke përfshirë rajonet ku ai mund të jetë posaçërisht "i dobët, i shtrembëruar dhe/ose i fragmentuar."[55]

---

[48] Organizata Botërore e Shëndetësisë, *Global and Regional Estimates of Violence Against Women: "Prevalence and Health Effects of Intimate Partner Violence and Non-Partner Sexual Violence"*.
[49] Arutyunova, A. dhe Miller, K., *Count Me In! Money & Movements Convening*, 2018.
[50] Po aty, nxjerrë nga AWID, *Watering the Leaves, Starving the Roots*, 2013, faqe 114. Kjo paraqet burimet kryesore të financimit dhe kështu arrin në 78%. Publikimi nuk tregoi burimet e tjera të financimit
[51] Miller dhe Jones, *Toward a Feminist Funding Ecosystem*, AWID, 2019.
[52] Po aty. Për shembull, shih Fondacionin Ford, *Challenging Inequality: Gender, Race and Ethnic Justice*, 2019.
[53] Hagen-Dillon, A., *Where are the Gaps, Opportunities, and Challenges? Comparing Funding Trends from the Women's Funds Community*, Rrjeti i Financuesve të Drejtave të Njeriut, 2018.
[54] Nxjerrë nga koncepti i Michael Edward, në *Toward a Feminist Funding Ecosystem, t*ë Miller dhe Jones faqe 6.
[55] Po aty

Ky hulumtim synon t'u përgjigjet këtyre pyetjeve. Sidoqoftë, ekipi shpejt zbuloi se në BP ekzistojnë shumë pak informacione të krahasueshme lidhur me fusha të ndryshme të një "ekosistemi të mundshëm të financimit". Sistemet tatimore nuk mbështesin aq dhurimet individuale apo nga korporatat.[56] Për më tepër, vendet e BP renditen në vendin më të ulët në botë për dhurimet si bamirësi. Indeksi Botëror i Dhënies në vitin 2019 renditi Kosovën si më të mirën në rajon në vendin 62 nga 126 vendet e renditura, të pasuar nga BeH në vendin 91, Maqedonia e Veriut në 96, Shqipëria në vendin 105, Mali i Zi 119, dhe Serbia në vendin 123.[57] Kjo nuk është shenjë e mirë për mbledhjen e fondeve të konsiderueshme nga individët. Ekzistojnë informacione të pakta për kushtet dhe mjedisit që mundëson ose jo dhënien individuale ose nga korporatat *veçanërisht* për OSHCG-të dhe të drejtat e grave, që mund të përfshijnë pengesa të shtuara. Ky hulumtim zbuloi pak informacione në lidhje me ndërmarrjet shoqërore ose shërbimet që gjenerojnë të ardhura, megjithëse shembuj të modaliteteve të tilla të financimit në fakt ekzistojnë në rajon. Kështu, duke marrë parasysh kufizimet, ndërsa është i vetëdijshëm për faktin se ekzistojnë metoda të tjera të mbledhjes së fondeve, ky hulumtim fokusohet në organizatat multilaterale dhe bilaterale, duke pasur parasysh zotimet e tyre për politika dhe faktin që ato mbesin ndër financuesit më të mëdhenj në BP. Diskutohen edhe financuesit e tjerë.[58] Gjetja kryesore është që praktikat më të mira të menaxhimit të të dhënave dhe hulumtimet e mëtejshme janë të nevojshme për të zhvilluar një ekosistem financimi në BP.

OSHCG-të në të gjithë rajonin kanë shprehur shqetësimin e tyre për financuesit që po largohen nga BP. Derisa disa financues konsiderojnë se konfliktet rajonale janë relativisht të përfunduara ose të normalizuara, disa prej tyre kanë zhvendosur financimin në rajone dhe zona të tjera në krizë.[59] OSHCG-të në Shqipëri, BeH dhe Kosovë vërejtën se prania e financimit nga ambasadat ndërkombëtare është zvogëluar. Në të gjithë rajonin, veçanërisht në **Shqipëri**, OSHCG-të gjithashtu vërejtën se donatorët kanë tendencë të financojnë organizatat më të mëdha, veçanërisht organizata ombrellë, OJQN-të, ose agjencitë e KB.[60] Të dhënat sasiore nga ky hulumtim ilustrojnë se të paktën 13% e fondeve të identifikuara të OSHCG, ndoshta më shumë, arritën tek OSHCG-të përmes ndërmjetësve.[61] Përdorimi në rritje i firmave private dhe konsulentëve individualë për punën e barazisë gjinore, sesa OSHCG-të, gjithashtu largon burimet nga organizatat

> **Ne kemi parë një model të shkëputjes së donatorëve nga vendi ynë dhe alokimi i ri i fondeve për tema të tjera është një model.**
>
> OSHCG, BeH

> **Shumica e financuesve nuk ndajnë para drejtpërdrejt për OShC-të, por për ndërmjetësuesit lokalë, agjencitë e KB-së, që shpërndajnë më tej fondet me kriteret e tyre.**
>
> OSHCG, BeH

> **Është e nevojshme të gjendet një mënyrë për të punuar së bashku për të parandaluar mbivendosjen në aktivitete dhe harxhimin e parave.**
>
> OSHCG, Maqedonia e Veriut

[56] Shih diskutimin në pjesën Ligjet Kombëtare.
[57] Charities Aid Foundation, *World Giving Index: Ten Years of Giving Trends*, tetor 2019.
[58] Për më shumë informata rreth përbërjes së fondeve nga financuesit e ndryshëm, shih *Who Funds Women's Rights?*
[59] Intervista, OSHCG, Maqedonia e Veriut, 2019.
[60] Për më shumë informacione dhe diskutime, shih: A Delicate Balance: Financing WCSOs, INGOs and Multilaterals.
[61] Më shumë fonde shkuan tek OSHCG-të përmes ndërmjetësve në Maqedoninë e Veriut (18% e fondeve në vend), BeH (15%) dhe Serbia (14%) sesa në Shqipëri (12%), Kosovë (10%) dhe Mali të Zi (6%).

dhe lëvizjet. Këto trende kontribuojnë në ngushtimin e hapësirës për OSHCG-të duke kufizuar qasjen e tyre në burime.

Të intervistuarit gjithashtu vërejtën dobësi në koordinimin e financuesve, duke kontribuar në përdorimin joefikas të burimeve të kufizuara. Në raportin e tyre të vitit 2018 "Shoqëria Civile: Humbur në Përkthim", hulumtimi i Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile konstatoi se pejzashi i financimit i OShC-ve në BP është i tejngopur me financuesit që ofrojnë shuma të vogla të parave.[62] Si rezultat, ekziston një grumbull i nismave të financuesve për çështje të caktuara me mungesë të përgjithshme të bashkëpunimit për të shmangur duplikimin dhe koordinimin.[63]



Aktivistët protestojnë kundër femicidit para Ministrisë së Punës në Beograd në vitin 2017.

[62] Haynes, R., Ireland, V., Duke, J., *Funding Civil Society Organisations & Networks: Promising Approaches to Financing Development in the 21st Century*, Forus International, 2019.
[63] Po aty

Konteksti politik: Pasiguritë dhe ngushtimi i hapësirës

Të gjitha vendet e BP i kanë bërë të qarta qëllimet e tyre për t'u anëtarësuar në BE. Megjithatë, tensionet rajonale po vazhdojnë. Edhe pse Marrëveshja e Prespës sinjalizoi përparim për **Maqedoninë e Veriut** dhe Greqinë,[64] tensionet midis **Serbisë** dhe **Kosovës** vazhdojnë të mbesin. **BeH** është në një ngërç mes shumë mosmarrëveshjeve etnike. Në **Mal të Zi**, ligji i ri i propozuar nga Qeveria, i hartuar për rregullimin e lirive fetare, ka ndezur tensionet në mes të Qeverisë dhe Kishës Ortodokse Serbe, duke tendosur kështu marrëdhëniet midis **Serbisë** dhe **Malit të Zi**.[65] OSHCG-të **shqiptare** thanë se politika agresive përkeqëson tensionet ekzistuese në mesin e qytetarëve shqiptarë dhe kontribuon në dhunë. Ndërkohë, situata përgjithësisht jostabile politike në BP pengon investimet e huaja dhe rritjen ekonomike.

> **Ekziston një fuqizim i konservatorizmit në nivel global, gjë që e bën të vështirë për OSHCG të bëjë kompromis dhe të luftojë trendet kufizuese së financimit dhe korrupsionin institucional.**
>
> OSHCG, Serbi

> **Trendet që pengojnë punën e OSHCG-ve përfshijnë ri-tradicionalizmin, ngritjen e fashizmit, fuqizimin e patriarkatit, grupet konservatore, si dhe fuqizimin e grupeve fashiste klerikale.**
>
> OSHCG, Serbi

> **Etnonacionalizmi është ai nga ku vijnë të gjitha problemet e tjera. Kjo përfshin kthimin ne vlerat regresive tradicionale: "rikthimin e gruas në shtëpi ".**
>
> OSHCG, BeH

Zhvillimet politike siç janë nacionalizmi dhe popul lizmi ndikojnë dhe rrezikojnë shpesh punën e shoqërisë civile.[66] OSHCG-të në të gjithë rajonin, por veçanërisht në **BeH**, **Maqedoninë e Veriut** dhe **Serbi**, thanë se pikëpamjet konservatore po bëhen gjithnjë e më të zakonshme. OSHCG-të vërejtën regresion ndaj agjendave tradicionale që ndikojnë negativisht në të drejtat themelore dhe liritë e grave. "Fundamentalizmi, konzervatizmi dhe vlerat tradicionale në rritje [po e] ngulfatin lëvizjen e grave", tha një OSHCG. "Pikëpamjet konservatore janë bërë të zakonshme dhe kjo po krijon […] baza për degradimin shoqëror të grave," tha një tjetër.[67] Lëvizjet nacionaliste dhe anti-gjinore i vënë në rrezik të drejtat e grave dhe aktivistët e të drejtave të grave.[68] Aktivistët kanë qenë të ndaluar fizikisht të lëvizin lirshëm, të kërcënuar dhe/ose të ngacmuar në të gjitha vendet e BP.[69]

Në vitin 2017, Fondacioni Kvinna till Kvinna zhvilloi një sondazh online duke i pyetur mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave në 32 vende se si janë prekur ata nga ndryshimi i hapësirës qytetare.[70] Më shumë se 60% e të anketuarve thanë se "hapësira e tyre për të

---

[64] Marrëveshja e Prespës u nënshkrua në qershor të vitit 2018, me përkrahjen e KB-së, nga Kryeministrat, Zoran Zaev dhe Alexis Tsipras, të Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Greqisë. Sipas marrëveshjes, Maqedonia u bë e njohur si Republika e Maqedonisë e Veriut, një ndryshim që Greqia parashikoi se duhet të pasqyrohet në kushtetutën e Maqedonisë. Në janar 2019, më shumë se dy të tretat e parlamentit maqedonas miratuan ndryshimin. Parlamenti Grek miratoi zyrtarisht ndryshimin në 25 Janar 2019 (Britannica, *Prespa Agreement: Balkan History*, 2019).

[65] Maksimovic, S., *Montenegrin Law on Religious Freedom: Polarization that Benefits the Government(s)?*, Portal European Western Balkans, 13.01.2020.

[66] More-Hollerweger et al., ERSTE Stiftung Studies, *Civil Society in Central and Eastern Europa: Monitoring 2019*, 2019, faqe 7. Ndarja dhe përdorimi i fondeve publike u konsideruan problematike në Serbi, BeH dhe Rumani, me disa, megjithëse më pak, çështje të raportuara në Mali të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë.

[67] Intervista, OSHCG, BeH, 2019.

[68] Intervistat, aktivistët, 2019. Shih gjithashtu, Wassholm, C., faqe 29, 33.

[69] Wassholm, C., faqe 33; dhe Kvinna till Kvinna, *Women's Rights in the Western Balkans*, 2019.

[70] Wassholm, C. Për shembull, një organizatë nga BeH, tha se është "e pamundur të organizohen ngjarje në sheshin kryesor për shkak të zbatimit të kufizuar të Ligjit për Tubime Publike" (Intervista, 2019). Një OSHCG nga Maqedonia e Veriut ndau informata rreth ngushtimit të hapësirës për grupet LGBTQIA+ (Intervista, 2019).

vepruar si aktivist është ngushtuar". Zvogëlimi i hapësirës politike dhe burimeve shoqëruese për veprim është referuar si "ngushtimi i hapësirës". Ngushtimi i hapësirës shqetësoi OSHCG-të në gjithë BP, veçanërisht në **BeH** dhe **Serbi**.

> **Nuk ka vullnet politik. Vetëm mosinteresim total.**
>
> OSHCG, Mali i Zi

"Mungesa e vullnetit politik" për të mbështetur OSHCG-të dhe të drejtat e grave politikisht dhe financiarisht ishte temë e vazhdueshme në të gjithë rajonin. OSHCG-të kishin tendencë të mendojnë se qeveritë nuk ishin mbështetëse për shoqërinë civile. Ata vërejtën mungesë të mbështetjes politike në zbatimin e dobët të ligjeve dhe politikave, veçanërisht ato që lidhen me të drejtat e njeriut dhe fuqizimin e grave. Politikanët nuk e konsideruan avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në mesin e prioriteteve të tyre, që OSHCG-të besonin se do të bëhej më problematike me kalimin e kohës, duke pasur parasysh trendet më të gjera, të lartpërmendura politike.

Në përgjithësi, sundimi i dobët i ligjit, marrëdhëniet e pushteti të bazuara në lidhjet familjare dhe strukturat jodemokratike partiake pengojnë zhvillimin pozitiv shoqëror.[71] OSHCG-të thanë se korrupsioni, nepotizmi dhe mungesa e njohjes ose e kuptimit të rolit të shoqërisë civile, të gjitha kontribuojnë në kufizimin e fondeve qeveritare në dispozicion për nisma për të drejtat e grave.[72] OSHCG-të gjithashtu raportuan për shpërndarjen e fondeve publike organizatave të orientuara nga qeveria (GOOJQ-të).[73] Për shembull, partitë politike në **BeH** raportohet se po krijojnë organizatat e tyre, duke i devijuar fondet nga OSHCG-të.[74] Ngjashëm, në **Kosovë** ekzistojnë shqetësime për korrupsionin; për shkak të nepotizmit dhe ndikimit politik, "vetëm ata që kanë lidhje marrin grante", ishte një nga vërejtjet nga një OSHCG.[75] Duke pasur parasysh pasigurinë e mbështetjes së qeverisë, zvogëlimi i fondeve të huaja mund të vë OSHCG-të në rrezik.

OSHCG-të mendojnë se politikanët kanë frikë nga implikimet e fuqizimit të grave dhe/ose nuk e kuptojnë barazinë gjinore dhe kërkesat e OSHCG-ve. Prandaj, politikanët nuk janë të gatshëm që të drejtojnë mbështetjen financiare për OSHCG-të.[76] Traditat patriarkale të ngulitura thellë,[77] frika nga "feminizmi" si qasje radikale dhe stereotipat negativ të promovuar nga qeveria minojnë punën e OSHCG-ve.[78] Për shembull, fushata shpifëse nga ish qeveria në **Maqedoninë e Veriut** portretizoi OShC-të si "mercenar të huaj", "financuar nga Soros", duke penguar kështu mbështetjen e mundshme të qytetarëve për organizatat e tilla, përfshirë OSHCG-të.[79] Në mënyrë të ngjashme, në **Serbi**, pas fushatave njollosëse dhe shpifëse, disa njerëz mendojnë se OSHCG-të shkaktojnë divorc.[80] Keqkuptimet e tilla negative mund ta bëjnë të vështirë për OSHCG-të të transformojnë opinionin publik, nxisin ndryshim shoqëror ose të sigurojnë fonde, si për shembull përmes dhënies individuale.

---

[71] Ambasada e Suedisë: Prishtinë, *Multidimensional Poverty Analysis, Kosovo 2017*, 2017.
[72] Intervistat, OSHCG-të, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, 2019.
[73] Wassholm, C., faqe 7.
[74] Intervista, OSHCG, BeH, 2019.
[75] Intervista, OSHCG, Kosovë, 2019.
[76] Intervistat, OSHCG-të, Kosova dhe Mali i Zi, 2019.
[77] Intervista, financues, Kosovë, 2019.
[78] Kështu ishin tema të përsëritura në intervistat në rajon.
[79] Intervista, OSHCG, Maqedonia e Veriut, 2019.
[80] Intervista, OSHCG, Serbia, 2019.

Ligjet Kombëtare që ndikojnë në qasjen në financim

Ligjet kombëtare mund të ndikojnë në qasjen e OSHCG-ve në fonde.[81]Shqyrtimi i hollësishëm i kornizave ligjore rregullatorë që lejojnë ose pengojnë OSHCG-të të zgjerojnë qasjen e tyre në burime ishte përtej qëllimit të këtij hulumtimi. Kjo pjesë është nxjerrë nga intervistat dhe hulumtimi i shpejtë në tryezë për të dhënë një përmbledhje.

Burimet për zbatimin e zotimeve ligjore

Në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi ekzistojnë zotimet ligjore për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.[82] Që nga viti 2012, Maqedonia e Veriut ka një strategji për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.[83] Nëse vendet do të aplikonin plotësisht buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, ai do të kontribuonte në shpërndarjen më të barabartë të fondeve, duke siguruar potencialisht burime për OSHCG-të.

Vendet e BP gjithashtu kërkojnë ose të paktën inkurajojnë që ligjet dhe/ose politikat kanë të integruar perspektivën gjinore.[84] Nëse qeveritë përfshijnë perspektivën gjinore në të gjitha ligjet, ata do të duhen të alokojnë burimet për zbatimin e zotimeve për barazinë gjinore. Kjo do të mund të sigurojë burime për OSHCG-të si ekspertë, zbatues, ofrues të shërbimeve, monitorues dhe vlerësues të programeve të qeverisë. Për më tepër, qeveritë do të mund të kompensojnë OSHCG-të për ekspertizën

> **Fondi ndërkombëtar nuk do të jetë gjithmonë në dispozicion. Duhet të ekzistojë një kornizë ligjore [për financimin e OSHCG-ve].**
>
> OSHCG, Maqedoni e Veriut

> **Ndonjëherë besoj se më shumë kohë u kushtoj çështjeve financiare sesa atyre programatike.**
>
> OSHCG, Shqipëri

---

[81] Kornizat ligjore gjithashtu pengojnë punën e OShC-ve në përgjithësi, megjithëse nuk janë elaboruar këtu. Një sondazh i 1,758 organizatave në Evropën Lindore zbuloi se OSHC në BeH, ndër të tjera, mendonin se korniza ligjore kufizonte operacionet e tyre (More-Hollerweger et al., 2019, faqe 8-9). Hulumtimi për këtë raport identifikoi shembujt. Ligji për Ndihmën Juridike Falas në Serbi minon punën e OSHCG-Të duke lejuar vetëm avokatët në njësitë e vetëqeverisjes lokale të ofrojnë ndihmë juridike, duke diskriminuar kështu avokatët bazuar në vendin e tyre të punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 87/2018, Neni 9, "Ofruesit", në gjuhën serbe). Avokatët që punojnë për grupet e të drejtave të njeriut, përfshirë OSHCG-të, të cilët e kanë kryer këtë shërbim në mungesë të një ligji adekuat për gati 20 vjet, do të ndalohen të ofrojnë këto shërbime për personat më në nevojë. Shteti ka të ngjarë të mos ketë mundësi të sigurojë shërbimet e ndihmës juridike, duke lënë kështu të pambrojtur personat të cilët nuk mund të paguajnë për ndihmë juridike (Koalicioni PrEUgovor Alarm, *Coalition prEUgovor Report on Progress of Serbia in Chapters 23 and 24*, 2018, faqe 58). Komiteti i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut YUCOM ka shprehur shqetësime se Ligji drejtpërdrejt ndikon në të drejtën për qasje të barabartë në drejtësi (*Projektligji për ndihmën juridike falas kufizon të drejtën e qasjes në drejtësi* , 2018). Implikimet financiare dhe ligjore janë të gjëra, duke dëmtuar kështu OSHCG-të dhe grupet e cenueshme që ato shërbejnë. Në BeH, policia përdori Ligjin për Rendin Publik dhe Paqen e Republikës Serbe nr. 11/15 Ligjin për Tubimet Publike të Republika Serbe nr. 118/08 për të marrë në pyetje aktivistët që organizuan një protestë paqësore në Ditën Ndërkombëtare të Grave, 8 mars 2019.

[82] Shqipëri: Ligji 68/2017 për financat e vetëqeverisje vendore , Neni 2.8, 36.4.c), dhe 54.i). Kosovë: Ligji për Barazi Gjinore , Neni 3.1.17, 5.1.5, 8.1.4., 8.1.8, 12.2.2. Serbi: Ligji për sistemin buxhetor , Neni 2, paragrafi 58v dhe 4.4.

[83] Maqedonia e Veriut: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Strategy for introducing Gender Responsive Budgeting in the Republic of Macedonia 2012-2017.

[84] Shqipëri: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, *National Strategy and Action Plan on Gender Equality*, 2016-2020, objektivat 1.4, 2.1.2, 2.1.5, 2.2.5, 2.2.6, 2.2.9, 4.1.3, 4.1.4, 4.2.1. Kosovë: Law on Gender Equality, Neni 3.1.16, 5.1.3, 8.1.4, 8.1.8, 12.2.2. Mali i Zi: Law on Gender Equality, Neni 3. BeH: Law on Gender Equality in Bosnia and Herzegovina Consolidated Version nr. 16/03 dhe 102/09, Neni 24.b), 27.a), 27.b). Në Serbi, ky detyrim ekziston për politika përmes Ligjit për sistemin buxhetor , i cili gjithashtu prezanton buxhetimin e

e tyre, të tilla si në grupe punuese qeveritare për projektligjet, duke kryer vlerësimet e ndikimit gjinor *ex ante* dhe mbështetur integrimin e perspektivës gjinore në programet e qeverisë. Disa kërkesa të financuesve për qeveritë ndaj programeve të përfshirjes së perspektivës gjinore, veçanërisht kur përfshihen në politika, siç është nga miratimi i programeve të financuara nga IPA, mund të krijojnë mundësi për financim. OSHCG-të mund të ofrojnë mbështetje teknike në programet e përfshirjes së perspektivës gjinore dhe zbatimin e zotimeve për avancimin e barazisë gjinore. Megjithatë, në praktikë, OSHCG-të raportojnë se qeveritë nuk i kanë zbatuar në mënyrë të duhur këto dispozita.[85] Financimi nga qeveria ekziston kryesisht në formën e granteve ad-hoc ose procedurave të tenderimit, nëse fare ekziston, e jo si mbështetje e institucionalizuar, e qëndrueshme.

Ligjet për barazinë gjinore dhe shërbimet sociale krijojnë mundësi për kontraktimin e OSHCG-ve nga qeveria si ekspertë ose ofrues të shërbimeve. Megjithatë, tema e vazhdueshme në të gjithë rajonin ishte se natyra përgjithësisht "e verbër" ndaj gjinisë së ligjeve përkatëse pengon financimin normativ e ofrimit të shërbimeve publike, parandalimin dhe rehabilitimin, gjë që janë funksione thelbësore të shumë OSHCG-ve. Siç u përmend, të gjitha qeveritë kanë ratifikuar ose zotuar për zbatimin e CEDAW, dhe sipas Rekomandimit të Përgjithshëm të CEDAW 28, shtetet duhet të inkurajojnë dhe mbështesin financiarisht OSHCG-të.[86] Të gjitha qeveritë e BP gjithashtu janë zotuar të zbatojnë ose kanë ratifikuar Konventën e Stambollit, e cila ka kërkesa specifike për palët shtetërore për të mbështetur OSHCG-të.[87]

OSHCG-të e specializuara në shërbime të tilla përmendën disa sfida në zbatimin e këtyre dispozitave (shih Kutinë 2). Shpesh qeveritë miratojnë ligje dhe politika të tilla, por pastaj nuk alokojnë ose nuk i bënë të qasshme fondet e nevojshme për zbatimin e tyre.

---

përgjegjshëm gjinor. Shi gjithashtu, Qeveria e Republikës së Serbisë, Njësia e Përfshirjes Sociale dhe Reduktimit të Varfërisë, *Guidance for Social Impact Assessment*.

[85] Intervistat, OSHCG-të.

[86] Për detajet për secilin vend, shih Hyrje.

[87] Po aty

Kutia 2. Financimi normativ për fituesit e shërbimeve që adresojnë dhunën

Për dekada me radhë, në mungesë të shërbimeve shtetërore, OSHCG-të ishin ndër akterët e vetëm që siguronin strehim, linjat SOS dhe mbështetje tjera për gratë dhe fëmijët që vuajnë nga dhuna në familje, trafikimi dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore (kryesisht dhuna ndaj grave *sepse* janë gra). Shpesh pas propozimeve të politikave dhe avokimit nga OSHCG-të, qeveritë e BP kanë krijuar ligje në lidhje me dhunën në familje dhe trafikimin.[1] Me ratifikimin e Konventës së Stambollit, qeveritë duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar ofrimin dhe financimin e shërbimeve për personat që kanë pësuar dhunë. Pas zotimeve të tilla qeveritare, disa financues të huaj që kanë financuar më parë strehimoret dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve të OSHCG kanë ndërprerë financimin bazuar në supozimin se shteti do të marrë përsipër përgjegjësinë për të financuar këto shërbime.

OSHCG-të besojnë se kjo tërheqje e fondeve ndodh shumë shpesh dhe pa vëmendje të mjaftueshme për t'u siguruar që qeveritë krijuan strategji funksionale dhe korniza normative për financim të qëndrueshëm të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve. Diskutimi i pamjaftueshëm është zhvilluar me financues të huaj, akterë qeveritarë dhe ekspertët të OSHCG mbi atë se si saktësisht qeveritë do të financojnë shërbimet e tilla. Bisedat nuk kanë adresuar çështje të ndjeshme, si mënyra për të ruajtur pavarësinë dhe rolet thelbësore të mbikëqyrjes të ofruesve të shërbimeve të OSHCG, nëse ata varen nga fondet e shtetit. Duke pasur parasysh natyrën private dhe shpesh të fshehur të dhunës, mbështetja e grave që kanë pësuar dhunë në qasjen në drejtësi është ndër mënyrat e vetme për të monitoruar performancën institucionale në trajtimin e rasteve të tilla. OSHCG të financuara nga qeveria kanë shprehur shqetësimin se ato janë të heshtura nga ata që të kërkojnë përgjegjësi nga institucionet me performancë të dobët, nga frika (dhe ndonjëherë nga kërcënimet direkte) se fondet e tyre mund të tërhiqen. Çështja e OSHCG-ve se janë të varura ose kontrollohen nga qeveritë sepse ato varen nga fondet e qeverisë nuk janë adresuar sa duhet në disa korniza ekzistuese të financimit. Për më tepër, shqetësimet e vazhdueshme erdhën nga OSHCG-të se nepotizmi, korrupsioni dhe/ose OShC-të mbështetëse politike të qeverisë marrin tenderë, edhe kur ata kanë mungesë të ekspertizës.

Në **Serbi**, Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale hapi një thirrje për propozime në tre raste të veçanta për vënie në funksionin të linjës telefonike SOS të financuar nga qeveria për personat që vuajnë nga dhuna, drejt përmbushjes së kërkesave të Konventës së Stambollit. Megjithatë, Ministria e ndërpreu çdo thirrje për shkak të parregullsive, përfshirë ato të identifikuara nga Qendra Autonome e Grave, një OSHCG e specializuar në këtë punë.[2] Në fund, Ministria vendosi të mos prokurojë shërbime të ekspertëve, por të ndajë fonde drejtpërdrejtë një institucioni qeveritar nën juridiksionin e tij.[3] Është shqetësuese që në atë kohë, punonjësit e institucionit kishin mungesë trajnimi, përvoje dhe licencave të nevojshme për funksionimin e linjës telefonike SOS, sipas Konventës së Stambollit.[4] Kjo do të mund të rrezikonte që gratë të marrin shërbime me cilësi të dobët. Ndërkohë, OSHCG-të me shumë përvojë, tashmë të licencuara nga Ministria kishin mundur të ofronin këto shërbime po që se procedura e tenderimit do të ishte kryer në mënyrë të duhur.[5]

OSHCG-të kanë shprehur shqetësimin se futja e financimit shtetëror në mënyra të tilla si kjo do të mund të përdorej për të "zhdukur" OSHCG-të me përvojë me dekada në ofrimin e shërbimeve publike, duke zëvendësuar shërbimet e tyre me cilësi më të ulët ose me shërbime shtetërore jo-ekzistente, ose me shërbime mediokre me pragje të larta që diskualifikojnë shumicën e grave nga marrja e shërbimeve të tilla (p.sh. vetëm të mbijetuarat me fëmijë të vegjël mund të kenë qasje në shërbime). Kështu, ato kanë bërë thirrje për diskutime të mëtejshme për hartimin e duhur të shërbimeve të cilat ato mund të kontribuojnë në mënyrë kuptimplote bazuar në ekspertizën e tyre me dekada.

---

[1] Për më shumë informacion në lidhje me ndryshimet ligjore në të cilat kontribuuan OSHCG-të, shih Pse të mbështeten OSHCG-të?.

[2] Qendra e Grave Autonome (AWC), "Open Questions to the Ministry of Labour, Employment, Veteran and Social Affairs", 2018.

[3] Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale të Republikës së Serbisë, Vendimi, "Decision to withdraw the open call for associations to provide SOS helpline services for Women Who have experienced violence", Beograd, 2017.

[4] AWC, "The Ministry of Labour Violates the Laws: A Letter from the AWC to the Public Procurement Directorate", 2018.

[5] Macanović, V. "Where have the decades of ëork of Women's organizations disappeared", 2017.

Për shembull, në Federatën e **Bosnjës dhe Hercegovinës** (FBeH), Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje parasheh 70% të financimit për shtëpi të sigurta nga fondet federale dhe 30% nga buxheti kantonal.[1] Megjithatë, midis mospasjes së fondeve dhe mungesës së analizave të sakta të kostos, Ligji nuk është zbatuar siç duhet.[2] Në **Mal të Zi**, nuk ka fonde specifike të ndara për shërbime të specializuara, të tilla si linja telefonike SOS për viktimat e dhunës ose për strehimoret për gra, të ofruara tani nga OSHCG-të. Përkundrazi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale zgjedh ofruesit e tillë të shërbimeve përmes prokurimit publik, ftesës publike ose partneritetit publik-privat, sipas Ligjit për Mirëqenie Sociale dhe të Fëmijëve.[3] Në **Shqipëri**, Fondi Social i krijuar kohët e fundit u mundëson komunave të përdorin fondet e shtetit për shërbime social për gra, fëmijët në nevojë, të moshuarit dhe kategoritë e cenuara.[4] OSHCG-të mund të aplikojnë për grante për ofrimin e shërbimeve sociale përmes këtij mekanizmi të ri financiar, megjithëse asnjëra nuk duket se ka marrë ende fonde të tilla.[5]

Në **Kosovë**, fondet ad-hoc të ofruara përmes raundeve të granteve kanë bërë që strehimoret të kenë boshllëqe në fonde që zgjasin disa muaj, duke i detyruar ato të mbyllen dhe t'i vënë gratë dhe fëmijë në rrezik të madh të dhunës. Sipas Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, qeveria duhet "të ndajë buxhet të përhershëm për strehimoret, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet, përfshirë këshillimin dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës".[6] Pasi Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) nuk arriti ta zbatojë këtë si duhet, në vitin 2019 parlamenti miratoi një linjë të veçantë të buxhetit për të mbështetur strehimoret, pas avokimit të OSHCG-ve.[7] Megjithatë, MPMS vazhdoi me skema të ngjashme të granteve për ofruesit të shërbimeve të OSHCG, duke mos zbatuar si duhet Strategjinë ose linjën e buxhetit të aprovuar nga parlamenti.[8] Vetëm pas avokimit shtesë u ndanë fondet, megjithëse në fund të vitit.[9]

Kështu, derisa shumica e vendeve të BP kanë skema ad hoc të granteve, qeveritë nuk kanë krijuar financim të qëndrueshëm për shoqërinë civile, përfshirë OSHCG-të e ndryshme. Për ofruesit e shërbimeve, financimi normativ përmes një linje të përhershme të buxhetit do të mund të mbështeste rikuperimin e kostos për shërbimet e ofruara.[10]

Ligjet dhe procedurat e vështira tatimore

OSHCG-të cituan disa shembuj të kornizave ligjore që kufizojnë punën e tyre. Ligjet tatimore paraqesin sfida për OSHCG-të në të gjitha vendet e BP, ku disa OSHCG paguajnë tatime me shuma të ngjashme si ato të kompanive private. Për shembull, ndërsa OShC-të shqiptare

---

[1] Law on Protection from Domestic Violence of the Federation of BeH nr. 20/2013, Neni 35.
[2] Intervistat, OSHCG-të, 2019.
[3] Në bazë të nenit 72 të Ligjit Law on Social and Child Welfare, nr. 27/13, 1/15, 42/15, 47/15, 56/16, 66/16, 1/17, 31/17, 42/17, dhe 50/17 17.
[4] Këshilli i ministrave, Decision "for Creation and Functionalisation of a Social Fund", 2018, Vendimi 23.02.2018.
[5] Korrespondenca me AWEN, 2020. Fondi sapo ka filluar të implementohet. OSHCG-të thanë gjithashtu se projekt-ndryshimet për Ligjet për dhunën në familje dhe ndihma juridike në Shqipëri përfshijnë sigurimin e fondeve për shërbime të specializuara; nëse kalohen, ata mund të lehtësojnë qasjen në burime për OSHCG-të (Intervista, 2019). Nga fundi i vitit 2019, qeveria nuk i kishte finalizuar ende këto ligje.
[6] Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit , faqe 37. Komunat gjithashtu duhet të ndajnë burime për "strehimin social: për viktimat e dhunës në familje, dhe në raste të veçanta ata duhet të ofrojnë ndihmë materiale për fëmijët dhe familjet në nevojë" (Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare , Neni 1). Strategjia nuk ia cakton qartë përgjegjësinë për financim Ministrisë ose komunave (faqe 38, linja e buxhetit 4.3.4).
[7] Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-133 për Ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës 2019, Linja e buxhetit: 01500 1060, "Shpenzimet themelore për strehimoret".
[8] RrGK, "Letër shqetësuese nga Strehimoret e Kosovës për Koordinatorin Nacional ", 2019 .
[9] RrGK, "Advocacy Leads Kosovo's New Government to Establish Budget Line for Shelters", mars 2020.
[10] Për një shpjegim të "financimit normativ", shih Fjalorin.

duhet të kompensohen pjesërisht për shpenzimet e Tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH),[11] procesi i gjatë dhe i vështirë për të kërkuar rimbursim merr kohë gjë që i largon nga aktivizmi i tyre.[12] Më tej, vendimi i qeverisë së Shqipërisë për rimbursimet vlen vetëm për fondet IPA II; rimbursimi i TVSH-së për instrumentet e tjera të BE-së ose veprimet e ndryshme që financohen nga donatorët nuk janë të rregulluara me ligj. Në secilin rast individual, duhet të nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit (MM) ndërmjet Ministrisë së Financave dhe donatorit. Sipas një studimi të mbikëqyrjes së sektorit të gjerë, OShC-të nuk trajtohen sipas përcaktimit të tyre jofitimprurës dhe për këtë arsye skema e rimbursimit të TVSH-së për projektet e financuara nga IPA nuk ka pasur sukses.[13] Sistemet e rimbursimit në të gjithë vendet e BP janë komplekse dhe marrin kohë, por veçanërisht në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi.

> **OSHC-të barazohen me sektorin privat dhe trajtohen si biznese private që i nënshtrohen ligjeve të njëjta si kompanitë private.**
>
> OSHCG, Maqedoni e Veriut

> **Ndonjëherë besoj se më shumë kohë u kushtoj çështjeve financiare sesa atyre programatike.**
>
> OSHCG, Shqipëri

Mjedisi rregullator që mundëson dhënie filantropike

Përveç faktorëve socialë dhe kulturorë, filantropia varet nga një mjedis i favorshëm ligjor dhe rregullator.[14] Hulumtimi i shpejtë nga tryeza sugjeron që asnjë prej vendeve të BP nuk ka një kornizë koherente legjislative për të lehtësuar mbledhjen sistematike të fondeve duke targetuar donatorët publik dhe të korporatave. **Shqipëria** ka një Ligj mbi sponsorizimet me stimuj që bizneset të japin donacione në fusha të caktuara të interesit publik, siç është kultura, arti dhe sporti.[15] Sistemi tatimor lejon donacionet ndërmjet 3% dhe 5% të fitimit para tatimit, në varësi të llojit të aktiviteteve të sponsorizuara. Sidoqoftë, lista e aktiviteteve të zbritshme përfshin vetëm aktivitete humanitare, kulturore ose artistike, ose mbështetje organizatave që fokusohen në sport, arsim, mjedis, letërsi, shkencë dhe hulumtim; ajo nuk përfshin qartë mbështetje organizatave që punojnë për demokraci dhe të drejtat e njeriut.

Në **BeH**, sponsorizimet dhe donacionet rregullohen me Ligjin mbi të ardhurat për bizneset Corporate Businesses dhe Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat Personale. Zbritjet tatimore janë të lejueshme deri në 3% të të ardhurave bruto vjetore për donacionet në para ose në natyrë.[16] Megjithatë, donatorët individualë që nuk janë sipërmarrës nuk mund të kualifikohen për zbritjet tatimore në donacionet e tyre.

Në **Kosovë**, disa ligje kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të filantropisë, duke sjellë kështu konfuzion. Organizatat e interesit publik lirohen nga tatime për aq sa ato përdorin të ardhurat e tyre vetëm për të çuar përpara qëllimin e tyre të përfitimit publik, përfshirë të ardhurat që rrjedhin nga donacionet dhe grantet.[17] Individët dhe personat juridikë mund të zbresin deri në 10% të të ardhurave të tyre të tatueshme për donacionet për qëllimet të

---

[11] MM i nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave në Shqipëri dhe Komisionit Evropian.
[12] Intervista, OSHCG, Shqipëri, 2019.
[13] Hoxha, J., Tavani, K., Topi, A., Keruti, K., *Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development: Country Report for Shqipëri 2017*, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2018.
[14] Instituti Hudson, *The Index of Philanthropic Freedom 2015*.
[15] Shqipëri, Ligji për sponsorizimin (me me ndryshime).
[16] FBeH Law on Corporate Income Tax dhe FBeH Law on Personal Income Tax.
[17] Republika e Kosovës, Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ, Ligji nr. 06/L-043.

specifikuara të përfitimit publik.[18] Tatimpaguesit që bëjnë donacione në fushat të veçanta mund të kenë një zbritje shtesë prej 10% të të ardhurave të tyre.[19]

Në **Mal të Zi**, sipas ligjit të tatimit mbi të ardhurat, OJQ-të janë të liruara nga tatimet mbi grante, donacione, tarifat e anëtarësimit dhe burimet jo ekonomike të të ardhurave.[20] "Ligji për tatimin mbi të ardhura parasheh që OJQ-të të lirohen nga taksimi i të ardhurave nga aktivitetet e tyre ekonomike deri në 4,000 €, me kusht që të gjitha të ardhurat e liruara nga tatimi të ndahen për objektivat parësore statutore për të cilat objektiva u krijua organizata."[21] Korporatat dhe individët mund të zbresin deri në 3.5% të të ardhurave të tyre bruto për kontribute për qëllime mjekësore, arsimore, shkencore, fetare, kulturore, sportive, humanitare dhe mjedisore.[22]

Në **Maqedoninë e Veriut**, ligji nuk e njeh statusin e organizatave që punojnë për përfitime sociale, por vetëm për projektet dhe donacionet. OShC-të, "shoqatat e qytetarëve" dhe fondacionet kanë të drejtë të marrin donacione nëse përfshihen në aktivitete që mbështesin dhe promovojnë qëllimet e përfitimit publik.[23] Korporatat mund të zbresin deri në 5% të të ardhurave të tyre të tatueshme për qëllimet e përfitimit publik, ndërsa individët mund të zbresin deri në 20% të të ardhurave të tyre të tatueshme për dhënie për qëllimet e përfitimit publik.

Serbia ofron mundësi për dhënie nga korporatat. Ligji për tatimin mbi të ardhurat e korporatave përcakton që shpenzimet në bilancin e tatimpaguesit mund të njihen si shpenzime deri në maksimum 5% të të ardhurave të përgjithshme për: 1) qëllime shëndetësore, arsimore, shkencore, humanitare, fetare dhe sportive, mbrojtje të mjedisit, si dhe për përfitimet e dhëna institucioneve dhe/ose ofruesve të shërbimeve të mbrojtjes sociale të themeluara në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen sociale; dhe 2) ndihmë humanitare, d.m.th., eliminimin e pasojave që vijnë nga rastet emergjente.[24] Shpenzimet në investime kulturore, përshirë aktivitetet kinematografike, deri në 5% të të hyrave totale, njihen si shpenzime në bilancin e tatimit të tatimpaguesit. Ligji nuk e njeh në mënyrë të qartë statusin e organizatave jofitimprurëse për qëllime të përfitimeve sociale. Prandaj, OShC-të duhet të aplikojnë për zbritjet tatimore për secilin donacionin të pranuar. Dhuratat nën ekuivalentin e 900 dollarëve të dhëna nga një donator i vetëm lirohen nga tatimi mbi të ardhurat.[25] Ligji për tatimin mbi të ardhurat personale nuk lejon lirimin nga pagesat e tatimit për dhënie individuale.[26] Ligji për tatimin mbi të ardhurat është i paqartë sa i përket dhuratave për mbështetje institucionale jofitimprurëse që veprojnë në interes të publikut.[27] Organizatat jofitimprurëse lirohen nga tatimi mbi grantet, tarifat e anëtarësimit, donacionet dhe burimet jo-ekonomike të të ardhurave.[28]

Kornizat më gjithëpërfshirëse ligjore do të mund të lehtësojnë mbledhjen e fondeve për OSHCG-të. Megjithatë, miratimi i një legjislacioni të tillë do të kërkonte që legjislaturat të njohin nevojën për të rritur besimin e publikut dhe mbështetur OShC-të. Kjo nuk duket e mundshme, apo e lehtë, duke marrë parasysh kontekstin e lartpërmendur politik, në mes të ngushtimit të hapësirës për shoqërinë civile. Aktivistët po i përballojnë kufizimet në kornizën ligjore dhe zbatimin e saj, duke avokuar për ndryshime në ligje që pengojnë punën e tyre. Kjo përfshin avokimin përmes raporteve, deklaratave publike, ngjarjeve, aksioneve në rrugë, pjesëmarrjes në konferenca, rrjetëzimit dhe presionit mbi media.

---

[18] Republika e Kosovës, Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave , Ligji nr. 06/L-105, Neni 11, paragrafi 5.
[19] Po aty
[20] Republika e Malit të Zi, Parliament of the Republic of Montenegro, Law on Tax on Income of Natural Persons Law No. 01-3873/2.
[21] Po aty
[22] Republika e Malit të Zi, Parliament of the Republic of Montenegro, Corporate Income Tax Law No. 065/01.
[23] Catalyst Balkans, Tax Laws Affecting Philanthropy in the Countries of South Europe, 2013.
[24] Ministria e Financave e Republikës së Serbisë, Guideline for Tax Benefits of Donors, 2019, Beograd, faqe 2.
[25] Koeshall, N. for Catalyst Balkans, *Regional Report Balkan Countries.*
[26] Po aty Golubovic, Dragan, cited in Catalyst Balkans, faqe 50.
[27] Po aty
[28] Non-profit Law in Serbia, 2019.

Përfundim: Konteksti

Prioritetet e financimit global dhe konteksti i përgjithshëm politik kontribuojnë në sfida për shumë OSHCG në qasjen e tyre ne fondet e huaja, fondet e qeverisë dhe donacionet individuale. Jostabiliteti politik i shoqëruar me trendet më të mëdha drejt nacionalizmit dhe popullzimit kanë krijuar hapësirë për rritjen e konservatorizmin dhe lëvizjet anti-gjinore. Këta faktorë kontribuojnë në ngushtimin e hapësirës për aktivistët e të drejtave të grave dhe OSHCG-të. Në disa vende, ligjet për tatime krijojnë barriera financiare për OSHCG dhe procedurat e gjata kontribuojnë në përdorimin joefikas të kohës. Asnjë prej vendeve nuk ka një mjedis të përgjithshëm rregullator për procesin strategjik, të qëndrueshëm të OSHCG për mbledhjen e fondeve nga individët dhe bizneset, dhe klima aktuale politike nuk sugjeron që ndryshimet e tilla ligjore do të jenë të lehta për t'u arritur. Ndërsa ekzistojnë disa skema ad-hoc të granteve, qeveritë nuk kanë vendosur financim të qëndrueshëm për shoqërinë civile. Financimi i qëndrueshëm, siç është financimi normativ, nuk ekziston për shërbime jofitimprurëse për përfitime publike, padyshim, të ofruara më së miri nga OSHCG-të me përvojë. Diskutimi i pamjaftueshëm sillej rreth asaj sesi shtetet mund të krijojnë më mirë fond të qëndrueshëm për shoqërinë civile, ndërsa shmang korrupsionin, nepotizmin dhe politizimin, si dhe duke ruajtur rolin e vëzhguesit të pavarur të OSHCG-ve. Autonomia është thelbësore për punën e rëndësishme të OSHCG-ve në mbajtjen përgjegjës institucionet për avancimin e të drejtave të njeriut, përmirësimin e qasjes në drejtësi për grupet e cenueshme dhe forcimin e sundimit të ligjit. Procesi i para-anëtarësimit në BE, i shoqëruar me instrumentet e tjera ndërkombëtare të përshkruara në Hyrje, mund të paraqesë disa mundësi për forcimin dhe institucionalizimin e mbështetjes së qeverisë për OShC(G)-të. Kjo përfshin vendosjen e masave për burime transparente dhe të drejta të caktimit të burimeve. Gjithashtu mund të përfshijë avokimin për të institucionalizuar proceset për bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile, të cilat mund të kontribuojnë në financim më të përshtatshëm për OSHCG-të.

Photo: Marija Jankovic

Aktivistët protestojnë kundër femicidit para Ministrisë së Punës në Beograd 2017. Autonomia e OShCG-ve dhe është thelbësore për mbajtjen përgjegjës institucionet për të avancuar të drejtat e njeriut.

KUSH I FINANCON TË DREJTAT E GRAVE?

Ky kapitull shqyrton se cilët financues janë të angazhuar në ofrimin e mbështetjes financiare për OSHCG-të në BP. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave të tjera, gjetjet kanë dalë kryesisht nga të dhënat e siguruara nga 85% të OSHCG-ve që morën pjesë në hulumtim. Të anketuarit përbënin 69% të popullsisë së të gjithë OSHCG-ve të njohura që veprojnë në rajon gjatë kësaj periudhe, përfshirë shumicën e OSHCG-ve më të mëdha, aktive.[29] Edhe pse nuk janë gjithëpërfshirëse, gjetjet japin tregues të trendeve të financimit. Vit 2019 nuk kishte përfunduar në kohën e hulumtimit, kështu që gjetjet për vitin 2019 janë indikative, por jo gjithëpërfshirëse. Studimet e rasteve për financuesit e ndryshëm nxirren nga të dhënat e ofruara nga po këta financues, në mesin e burimeve të tjera. Kapitulli gjithashtu diskuton llojet e financuesve që OSHCG-të preferojnë dhe arsyet e preferencave të tyre.

Financuesit aktivë në BP

Bazuar në të dhënat e OSHCG-ve, disa financues të ndryshëm kanë mbështetur OSHCG-të në rajon midis 2014 dhe mesit të vitit 2019 me më shumë se 1,963 grante, kontrata dhe donacione të ndryshme. Grafiku 4 tregon fondet e përgjithshme që OSHCG-të raportuan t'i merrnin nga financuesit nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019. Përafërsisht 21% të fondeve të OSHCG-ve erdhën nga shumë financues për të cilat shuma e saktë e marrë nga secili financues ishte e paqartë.[30] Bazuar në informacionin përshkrues të ofruar, shumica e këtyre fondeve rrjedhin nga financues multilateral dhe bilateral. Grafikët dhe narrativat që vijojnë e ilustrojnë këtë përmes përdorimit të simboleve 'më i/e madh/e se" (">"), të cilat tregojnë se financuesit multilateralë dhe bilateralë ka mundësi që ofruan më shumë fonde sesa indikohet.

Grafiku 4. Gjithsej fonde të pranuara nga OShCG sipas Llojit të Financuesit



[29] Për ndarjen sipas vendit, shih Shtojcën 3.

30 Për shembull, një OSHCG do të shprehte që një iniciativë ishte financuar nga një organizatë multilaterale si dhe nga një qeveri në BP, por nuk ndante sa mbështetje ofruan secila Me gjithë përpjekjet për të sqaruar të dhëna të tilla, ekipi nuk mori informacione të mjaftueshme për t'ia atribuuar këtë financim një kategorie të veçantë të financuesve.

OSHCG-të raportohet se kishin marrë më së shumti mbështetje nga organizatat multilaterale gjatë kësaj periudhe (>13 milion €), duke përbërë >21% të të gjithë mbështetjes financiare të raportuar. Mbështetësi tjetër më i madh direkt i OSHCG-ve ishin fondet e grave (€12.5 milion €),[31] që përbëjnë 20% të fondeve të raportuara. Shumë nga fondet e tyre kanë ardhur fillimisht nga financuesit bilateralë (shih Grafikun 5). Financuesit bilaterale dhanë OSHCG-ve >12% të fondeve (>7.4 milion €). OJQN-të ofruan 10% (6.2 milion €), që u pasuan nga fondacionet me 7% (4.2 milion €), qeveritë e BP me 5% (2.9 milion €) dhe OJQ-të lokale me 2% (1.1 milion €). Sektori fitimprurës, siç janë bizneset, dhanë 0.4% (263,579 €). Individët dhe anëtarët kontribuuan me 0.3% (188,511 €).

Grafiku 5 paraqet fondet nga burimi i tyre fillestar, d.m.th, burimi i fondeve të financuesit, aty ku janë të identifikueshme.[32] Nga ky këndvështrim, OSHCG-të morën shumicën e fondeve nga financuesit bilateralë që arrin shumën e përgjithshme prej >14.9 milion € (>24%), pasuar nga ata multilateralë me >13.2 milion € (>21%). Përafërsisht 11% erdhën nga fondet e grave (7.1 milion €). Kur krahasohet me Grafikun 4, kjo sugjeron që rreth 44% të financimit të fondeve të grave për OSHCG-të buronin kryesisht nga financuesit bilateralë dhe, megjithëse në një masë më të vogël, nga ata multilateralë. Një nga shembujt më të qartë është Fondacioni Kvinna till Kvinna, i cili përfshihet në Grafikun 4 në mesin e fondeve të grave. Në Grafikun 5, shumica e fondeve të Kvinna till Kvinna hyjnë në kategorinë bilaterale, pasi Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) është burimi fillestar i këtyre fondeve. Pra, në Grafikun 5, shuma e fondeve të OSHCG që buronin nga fondet e grave zvogëlohet nga 20% në 11%. Në mënyrë të ngjashme, fondet e shpërndara nga OJQN-të dhe OJQ-të lokale zvogëlohen, pasi ato gjithashtu marrin fonde nga financuesit bilateralë ose ata multilateralë, duke i kaluar këto fonde tek OSHCG-të. Përqindjet dhe shumat e fondeve të financuesve të tjerë mbesin ngjashëm të vogla në krahasim.

Grafiku 5. Gjithsej fonde nga Financuesi burimor



[31] Për përkufizim të fondeve të grave, organizatave multilaterale, bilaterale dhe termave të tjerë në këtë kapitull, shih Fjalorin.
[32] Nuk ishte e mundur që të identifikohej burimi origjinal i financimit, por kjo është indikative. Natyrisht, financimi multilateral, siç është nga BE apo KB, gjithashtu buron nga ai bilateral, megjithëse ai mbahet ndaras këtu.

Përveç nëse nuk është cekur ndryshe, të gjithë Grafikët që vijojnë i referohen burimit fillestar të financimit, për ato që dihen. Financuesit bilateralë, veçanërisht përmes fondeve të grave, siguronin shumicën e fondeve të përgjithshme për OSHCG-të gjatë kohës (Grafiku 6).[33] Financimi bilateral u tejkalua vetëm në vitin 2015 nga financimi multilateral, pas një rënie në financim bilateral. Rënia mund t'i atribuohet krizës financiare globale dhe me shpenzime të shtrënguara nga shumë qeveri. Financimi multilateral tejkaloi përsëri atë bilateral në vitin 2018, që mund t'i atribuohet rritjes së fondeve në BE atë vit. Në vitin 2018, programi rajonalpër dhunën ndaj grave, i zbatuar nga UN Women e i financuar nga BE-ja filloi të jepte grante OSHCG-ve dhe OSHCG-të pranuan tre grante relativisht më të mëdha të financuara nga BE.

Grafiku 6. Fondet e shpërndara OShCG sipas Llojit të Financuesit në milionë



Financimi multilateral është rritur me kalimin e kohës, nga 1.9 milion € në 2014 në 2.7 milion € në 2018. Financimi nga fondacionet, përfshirë fondet e grave, ka mbetur mjaft konsistent gjatë kohës, megjithëse duke pasur rënie në mes të vitit 2014 dhe 2017 dhe rritje në 2018. Financimi nga OJQN-të duket se ka pësuar ulje me kalimin e kohës. Ndërsa fondet e qeverisë së BP për OSHCG-të duket se janë dyfishuar ndërmjet vitit 2014 dhe 2018, ato kanë mbetur relativisht minimale. Financimi nga OJQ-të lokale, individët, anëtarët dhe bizneset ka mbetur vazhdimisht minimal. Përsëri, financimi për vitin 2019 është vetëm indikativ.

Tabela 2 jep një përmbledhje të fondeve të shpërndara nga financues të ndryshëm. Qeveritë dhanë numrin më të lartë të granteve, kontratave ose llojeve të tjera të financimit. Ata gjithashtu kishin numër të ulët mesatar të fondeve dhe numrin e ulët të granteve të dhëna. Në anën tjetër të spektrit, financuesit multilateralë siguruan mesatarisht fonde më të mëdha dhe shpërndanë grantet më të mëdha.

[33] Për trendet e përgjithshme, shihni kapitullin mbi Trendet e financimit.

Tabela 2. Pasqyrë e fondeve të siguruara nga llojet e ndryshme të financuesve [34]								
	Organizatat multilaterale	Organizatat bilaterale	Fondet e grave	Fondacionet e tjera	OJQN-të	OJQ-të lokale	Qeveritë	Gjithsej
Fondet totale të ofruara (miliona)	€13.2	€14.9	€7.1	€3.3	€5.3	€6.9	€2.9	€62.0
Madhësia mesatare e fondit (mijëra)	€57	€41	€37	€35	€21	€10	€6	€33
Madhësia minimale e fondit	€128	€100	€250	€395	€49	€61	€9	€9
Madhësia maksimale e fondit (mijëra)	€965	€697	€502	€500	€174	€285	€116	€1,468
# e fondeve të dhëna	242	174	360	123	293	170	459	1963

Grafiku 7 tregon një përmbledhje të të gjitha fondeve që raportohen të janë marrë nga OSHCG-të nga vitit 2014 deri në mesin e vitit 2019 në secilin vend të BP, sipas llojit të financuesit, në miliona euro. Shumica e fondeve duket se janë shpërndarë OSHCG-ve në **BeH**, me një pjesë mjaft të balancuar të fondeve nga financuesit bilateralë, multilateralë, fondacionet dhe OJQN-të. OSHCG-të në **Kosovë** pranuan pjesën tjetër më të madhe të fondeve, të pasuar nga **Serbia**, **Shqipëria** dhe **Maqedonia e Veriut**, ku të gjithë kryesisht morën fonde nga financuesit bilateralë dhe ata multilateralë. OSHCG-të në **Mal të Zi** kanë marrë relativisht më pak burime, por kjo i atribuohet pjesërisht faktit që më pak OSHCG ekzistojnë në Mal të Zi sesa në vendet e tjera.



Grafiku 7. Gjithsej fonde të dhëna sipas vendit dhe llojit të financuesve në miliona

Grafiku 8 ilustron pesë sektorët ose fushat tematike që pranuan shumicën e fondeve.[35] Për të gjithë financuesit, Përveç fondeve të grave, fusha më e financuar ishte adresimi i dhunës me bazë gjinore. Ndërkohë, fondet e grave ofronin mbështetje më të përgjithshme, veçanërisht krahasuar me financuesit e tjerë. Financuesit bilateralë ofruan më shumë fonde

[34] Llojet e tjera të financuesve nuk janë përfshirë sepse gjetjet ishin shumë të çrregullta dhe të pakta për t'u portretizuar këtu. Në këtë tabelë, fondi i përgjithshëm i referohet shumës që ka origjinuar nga lloji i financuesit, ndërsa kolonat që vijojnë i referohen fondeve të shpërndara nga financuesit, por që jo domosdoshmërish kishin burimin nga ta.

[35] Shumat nën 50,000 € janë hequr për hir të lexueshmërisë.

për barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik sesa financuesit e tjerë. Seksionet që vijojnë shqyrtojnë më tej fondet e dhëna OSHCG-ve nga llojet e ndryshme të financuesve.



Financuesit multilateralë

Financuesit multilateralë që ofrojnë fonde për OSHCG-të në BP janë BE-ja, KB, Këshilli i Evropës dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).[36] Në mesin e financuesve multilateralë, BE-ja duket të ketë siguruar shumicën e fondeve për OSHCG-të (61%), që arrin shumën rreth 8.1 milion € në total nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019 (Grafiku 9). Kjo përshin situata të identifikueshme në të cilat BE ishte burim indirekt, fillestar i financimit për agjencitë e KB, fondet e grave, OJQN-të dhe OJQ-të lokale që më pas kaluan këto fonde tek OSHCG-të.[37]

Siç është ilustruar më parë (Grafiku 6), financimi multilateral duket se është rritur në mes të vitit 2014 dhe 2018.



Siç përshkruhet në Grafikun 10, mbështetja e BE-së ndaj OSHCG-ve duket të ketë rënë nga viti 2015 deri në vitin 2017, por

[36] Përfaqësuesit e KB dhe OSBE deklaruan në intervistat se nuk janë donatorë (2019). Sidoqoftë, ata janë të përfshirë këtu sepse sigurojnë fonde për OSHCG-të, dhe për këtë arsye referohen si financues.
[37] Edhe pse autorët u përpoqën të identifikojnë të gjitha rastet e tilla, mund të ekzistojnë raste shtesë që nuk pasqyrohen këtu.

më pas është rritur përsëri në vitin 2018. BE-ja siguroi financim përmes EIDHR, IPA II Civil Society Facility (Fondi i BE-së për shoqërinë civile), Instrumenteve të bashkëpunimit ndërkufitar, Erasmus dhe kontratave të tjera të IPA në nivel vendi dhe rajoni. Gjithashtu duke marrë parasysh këtu, BE siguroi fonde për disa OSHCG përmes UN Women.[38]

Grafiku 10. Fonde të dhëna nga financuesit multilateralë në miliona



[38] Në mënyrë të ngjashme, të dhëna të pamjaftueshme ishin në dispozicion për të përcaktuar burimin origjinal të të *gjitha* fondeve të KB të shpërndara në OSHCG-ve.

Studim rasti: BE dhe Financimi i Barazisë Gjinore në BP

BE-ja është zotuar për avancimin e barazisë gjinore me Qasjen Gjithëpërfshirëse të BE-së për Gratë, Paqe dhe Siguri, Qasjen Strategjike të BE-së për Gratë, Paqe dhe Siguri dhe GAP II, edhe pse këto janë politika mjaft të dobëta krahasuar me rregullore.[39] Në përgjithësi, këta përfshijnë zotimet për financimin e OSHCG-ve.[40] Megjithëse është Dokument i punës së stafit dhe në këtë mënyrë, nuk është ligjërisht i detyrueshëm, GAP II parasheh, në mënyrë tejet ambicioze, që shtetet anëtare do të "zotohen për të mbështetur arritjen" e GAP II.[41] Objektivi 3 parasheh "burime të mjaftueshme të ndara nga institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare për të përmbushur zotimet e BE-së për politikat gjinore." Për më tepër, GAP II u bën thirrje akterëve të BE-së, përfshirë shteteve anëtare, të raportojnë çdo vit për zbatimin e tij.[42]

5.8%

të Dokumenteve të Veprimit IPA II të BE-së përmbajnë analiza të mjaftueshme

56%

e Dokumenteve të Veprimit IPA II të BE-së i mungonte shënues gjinor

GAP II kërkon që të gjitha shpenzimet, programet dhe hartimet e politikave të informohen nga analiza gjinore.[43] Megjithatë, rishikimi i të gjithë **240** dokumenteve të veprimit IPA II për BP që janë publikisht në dispozicion, zbuloi se vetëm 5.8% kishin përfshirë analizën gjinore dhe 22.9% kishin disa analiza gjinore, megjithëse, të pamjaftueshme.[44] Siç u përmend, 56% të këtyre veprimeve nuk kishin të përfshirë ndonjë shënues të gjinisë të OECD. Nga ato që e kishin, analiza e pavarur demonstroi se vetëm 47% ishin të shënuar saktë.[45] Pas veprimeve të ri-shënimit, vetëm 3.3% kishin shënuesin e gjinisë 1 dhe 0.4% shënuesin e gjinisë 2. Ky rishikim sugjeroi gjithashtu se shpenzimet e IPA II në OSHCG dhe barazinë gjinore ishin të kufizuara. Vetëm 6.5% të Dokumenteve të Veprimit cekën qartë se burimet do të ndahen për OSHCG-të. Për më tepër, bazuar në Dokumentet e Veprimit, vetëm 0.04% e fondeve totale të IPA II ishin të parapara qartë për barazinë gjinore. Sistemet e tanishme të përcjelljes të BE-së nuk lejojnë matjen e saktë të shpenzimeve për barazinë gjinore ose të fondeve që përfitojnë OSHCG-të.

Për të vlerësuar nëse Qasja Gjithëpërfshirëse e BE-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë,[46] ose GAP II kanë pasur ndonjë ndikim në vendimet e donatorëve për financim në BP, financuesit nga BE dhe shtetet anëtare në BP u pyetën nëse dinin për këto politika dhe si kanë pasur ato ndikim në vendimet e tyre të financimit. Mostra nuk ishte përfaqësuese e të gjithë financuesve të tillë në BP, kështu që nuk është statistikisht e rëndësishme. Megjithatë, përgjigjet e financuesve mbesin të jenë indikative dhe interesante. Nga 18 financuesit të intervistuar që përfaqësonin BE-në ose shtetet anëtare, tetë (44%) thanë se këto politika nuk kishin ndikuar/informuar vendimet e tyre

---

[39] Për më shumë rreth mangësive të këtyre politikave, shih Farnsworth dhe Rashiti për RrGK, *Following Through on EU Commitments to Gender Equality: Lessons Learned from GAP II to Inform GAP III*, Prishtinë: 2019.
[40] Shih Hyrjen.
[41] GAP II, Objektivi 1, aktiviteti 1.3, faqe 20.
[42] GAP II, Objektivi 2, treguesi 2.4.4., faqe 22. Shih gjithashtu, faqet 16 dhe 39 mbi raportimin.
[43] GAP II, Objektivi 4.
[44] RrGK, Përmbledhje e politikës (e patitulluar), 2020.
[45] Gjithashtu, shih Hyrjen. Hulumtuesit nuk kanë informata se janë kryer analizat gjinore, parakusht për caktimin e një shënuesi gjinor. Prandaj, ndoshta më pak veprime u shënuan saktë.
[46] Hulumtuesit pyetën për Qasjen Gjithëpërfshirëse, sesa për Qasjen e Re Strategjike, sepse afati kohor i shqyrtuar ishte 2014 deri në 2019, kështu që ka më shumë të ngjarë që Qasja Gjithëpërfshirëse të ketë ndikuar në vendimet e financimit.

të financimit, ndërsa shtatë (39%) thanë se këto politika vetëm disi kishin ndikuar/informuar vendimet e tyre të financimit. Disa prej tyre shprehën se selitë e tyre me gjasë përdorën këto politika, por ata personalisht nuk e dinin se çfarë përmbajnë këto politika. Vetëm tre prej financuesve të BE-së dhe shteteve anëtare (17%), kryesisht financues suedez, thanë se këto politika në mënyrë thelbësore informuan/ndikuan në vendimet e tyre. Kishte disa shembuj specifikë mbi atë se financuesit kishin përdorur këto politika për të informuar strategjitë e tyre ose vendimet për financim. Ndërsa disa thanë se kishin integruar perspektivën gjinore në projektet e tyre tashmë të mbështetura, shumë pak përmendën financimin e programeve të reja drejt barazisë gjinore *si rezultat* të këtyre politikave.[47] Kështu, ndikimi i politikave si Qasja Gjithëpërfshirëse dhe GAP II për financimin e BE-së për barazinë gjinore, në BP duket të jetë *ad hoc* dhe i papërfillshëm.

[47] Vlerësimi afatmesëm i Civil Society Facility IPA II të BE-së gjithashtu arriti në përfundimin se integrimi gjinor është "deklarativ", por i mungonte "angazhimi i vërtetë" (Konsorciumi AETS, *Mid-term Evaluation of the Civil Society Facility for the Western Balkans and Turkey: Appendices*, 2017).

Studim rasti: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Zyra e Bashkimit Evropian (ZBE) mbështet Kosovën në përparimin drejt anëtarësimit në BE. Ajo mbështet dhe këshillon Qeverinë e Kosovës, duke kontribuar në zhvillim, si dhe në konsolidimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Ajo gjithashtu koordinon prezencat e tjera të BE-së në Kosovë, përfshirë atë të shteteve anëtare.[1] Ndihma financiare e BE-së financon disa sektorë: Demokracinë dhe Qeverisjen; Sundimin e Ligjit dhe të Drejtat Themelore (me nënsektorët e tij të Drejtësisë, Çështjeve të Brendshme, të Drejtave Themelore dhe Pakicave); Energjinë; Konkurrencën dhe Inovacionin; Edukimin, Punësimin dhe Politikat Sociale; Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural; dhe Bashkëpunimin Territorial dhe Rajonal.[2]

Ndërmjet viti 2014 dhe 2019, ZBE ndau 453 milion € për t'u shpërndarë në Kosovë.[3] Nga kjo shumë, rreth 0.6% të fondeve të alokuara ishin të përqendruara në barazi gjinore dhe të drejtat e grave (2.9 milion €). Veprimet në lidhje me barazinë gjinore arritën afërsisht 0.4% të të gjitha shpenzimeve të ZBE (1.9 milion €). Veprimet shtesë përfshinin integrimin e perspektivës gjinore si "çështje ndër-sektoriale",[4] por të dhënat për shpenzimet për barazi gjinore brenda këtyre veprimeve nuk ishin në dispozicion. BE nuk ka sisteme të vendosura për përcjelljen e fondeve të tilla.

0.6%

e fondeve të ZBE në Kosovë ishin alokuar për Barazi gjinore

0.4%

e shpenzimeve të ZBE në Kosovë mbështetën OShCDG-të

58%

e mbështetjes së ZBE për shoqëri civile financoi OShCDG

Të gjitha veprimet që fokusohen në barazi gjinore ishin brenda sektorit të Sundimit të Ligjit dhe nënsektorit të të Drejtave të Njeriut. Veprimet e mbështetura fokusoheshin në adresimin e dhunës me bazë gjinore, rritjen e pjesëmarrjes politike të grave, përmirësimin e të drejtave ekonomike dhe sociale të grave dhe avancimin e të drejtave LGBTQIA+. Përafërsisht 1% e të gjitha fondeve të ZBE gjatë kësaj periudhe duhej të shpërndaheshin shoqërisë civile dhe rreth 58% e këtij fondi të OShC ishte alokuar për OSHCG-të. Në përgjithësi, OSHCG-të morën përafërsisht 0.4% të shpenzimeve të përgjithshme të ZBE-së. Veprimet shtesë përfshinin nën-grante për OSHCG-të, por shumat e sakta nuk ishin të identifikueshme. Nga fondet e alokuara për barazinë gjinore, OSHCG-të duhej të merrnin përafërsisht 91% të fondeve.

Me madhësi të granteve që arrijnë mesatarisht shumën prej 237,000 € për një grant për dy deri në katër vjet, vetëm OShC-të më të mëdha me qarkullim të mjaftueshëm vjetor,[5] kapacitetet e menaxhimit financiar, aftësitë për të siguruar bashkë-financim dhe me aftësi të shkrimit në gjuhë angleze mund të aplikojnë për financim nga BE.[6] BE ka pranuar sfidat me të cilat përballet për të arritur tek organizatat më të vogla qytetare (bazë), duke synuar të adresojë këtë përmes inkurajimit të fortë ose kërkesave që përfituesit e saj të përdorin një pjesë të fondit të tyre për nën-grante.[7]

---

[1] Zyra e BE-së në Kosovë, faqe e internetit, "What We Do", qasur në prill 2020.
[2] KE, *Indicative Strategy Paper for Kosovë (2014-2020)*, 2014.
[3] Të dhëna të siguruara nga ZBE, Seksioni për Shoqërinë Civile, Media dhe Hulumtimi, Sekretariati i Seksionit, gusht 2019.
[4] Intervista, 2019.
[5] Sipas Udhëzuesit Praktik të KE-së EC Practical Guide, kjo ka tendencë të jetë kërkesë (neni 2.6.11.2).
[6] Kjo ishte gjithashtu një temë e përsëritur mes OSHCG-ve të intervistuara (2019).
[7] Intervista, 2019.

Siç u përmend, KB ka disa dokumente me të cilat zotohen për avancimin e barazisë gjinore dhe mbështetjen e OSHCG-ve, përfshirë Platformën e Pekinit për Veprime dhe CEDAW, ndër të tjera.[1] KB dhe agjencitë e saj siguruan përafërsisht 34% të financimit multilateral të identifikuar nga OSHCG-të (4.5 milion €). Financimi i KB për OSHCG-të u rrit qartë në mes të vitit 2014 dhe 2018 (Grafiku 10). OSHCG-të raportuan se morën më së shumti nga UN Women (1.4 milion €), që përbën 36% të mbështetjes së ofruar nga agjencitë e KB nga viti 2014 deri në mes të vitit 2019 (Grafiku 11).[2]

Kutia 3. Agjencitë e KB që financojnë OShCG

- ✓ Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)
- ✓ Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (UN OHCHR)
- ✓ Fondi i KB-së për fëmijë (UNICEF)
- ✓ Programi i KB-së për zhvillim (UNDP)
- ✓ Misioni i KB-së në Kosovë (UNMIK)
- ✓ Zyra e KB-së për drogën dhe krimin (UNODC)
- ✓ Zyra e KB-së për shërbimet e projektit(UNOPS)
- ✓ Fondi për popullsi i KB-së (UNFPA)
- ✓ Fondi i Mirëbesimi i KB-së për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave.
- ✓ UN Women
- ✓ Organizata Botërore e Shëndetësisë

Grafiku 11. Financimi i OShCG-ve nga agjencitë e KB në mijëra



Fondet e shpërndara nga financuesit multilateralë OSHCG-ve shkonin nga 128 € deri në 965,117 € me madhësi mesatare të fondeve prej 56,513 €. Shuma mesatare e dhënë nga BE për OSHCG-të ishte tre herë sa fondet mesatare të ofruara nga agjencitë e KB (Grafiku 12). Agjencitë e KB duket se kanë shpërndarë më shumë grante ose kontrata ("fonde") për OSHCG-të (Grafiku 13).

[1] Shih Hyrje.
[2] Disa OSHCG-të përmendën "Fondin e Mirëbesimit të KB", por nuk specifikuan se cili saktësisht. Potencialisht ato iu referuan Fondit të Mirëbesimit të KB për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave. Sidoqoftë, ai paraqitet veçmas në grafik. I themeluar nga Rezoluta e përgjithshme 50/166 e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së dhe administruar nga UN Women në emër të Sistemit të KB, Fondi i Mirëbesimit i KB për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave punon me OJQ-të, qeveritë dhe ekipet e vendit të KB.

Sipas të dhënave të OSHCG, OSHCG-të në **Serbi** duket se kanë marrë më shumë fonde si nga BE-ja ashtu edhe nga agjencitë e KB sesa ato në vendet e tjera, e pasuar nga **BeH** (Grafiku 14).[3]







[3] Ndonjëherë ky financim u shpërnda OSHCG-ve në vendet e tjera, i cili është paraqitur, sa mund të identifikohet nga të dhënat.

Grafiku 15 ilustron se fondet multilaterale brenda secilit vend duket se janë luhatur me kalimin e kohës, veçanërisht në **Serbi** dhe **BeH**. Në **Mal të Zi** dhe **Maqedoninë e Veriut**, fondet duket se janë rritur me kalimin e kohës, si dhe në **Shqipëri** dhe **Kosovë**, megjithëse me rënie në vitin 2018.



Sipas të dhënave të siguruara nga OSHCG-të, financuesit multilateralë kryesisht financuan përpjekjet për të adresuar dhunën me bazë gjinore. Fushat e tjera kryesore të mbështetura përfshinin të drejtat e njeriut dhe anëtarësimin në BE (Grafiku 16).



Financuesit bilateralë

Financimi bilateral që OSHCG-të raportuan të kenë pranuar, ka pasur luhajte me kalimin e kohës në **Kosovë** dhe në **Maqedoninë e Veriut** (Grafiku 17). Në të kundërtën, financimi nga financuesit bilaterale mbeti mjaft i qëndrueshëm në **BeH** dhe **Mal të Zi**. Në **Shqipëri**, financimi bilateral është rritur me kohë. OSHCG-të në **Kosovë** dhe **BeH** kishin tendencë të merrnin më shumë mbështetjet nga financuesit bilateralë se sa ato në vendet e tjera.

Grafiku 17. Financimi me origjinë nga organizatat bilaterale në mijëra



OSHCG-të identifikuan 18 financues bilateralë të ndryshëm nga të cilët ata kanë marrë fonde nga viti 2015 deri në mesin e 2019.[4] Kur u gjurmuan fondet nga burimet e tyre fillestare, **Suedia** dha më së shumti fonde OSHCG-ve (48% nga financimi bilateral), që arrinin shumën në gati 7.1 milion €, të shpërndara kryesisht përmes Fondacionit Kvinna till Kvinna (Grafiku 18). **Shtetet e Bashkuara** (SH.B.A.) të dyta dhanë më së shumti fonde me gati 2.7 milion € (18%). Financues të tjerë më të mëdhenj bilateralë përfshinin Zvicrën (7%) dhe Austrinë (6%). Kategoria "tjetër" përfshin të dhëna nga financuesit bilateralë të cilët ekipi i hulumtimit nuk ka mundur t'i ndajë me saktësi, kryesisht nga Gjermania, MB dhe Zvicra, siç paraqitet me shenjën "më i/e madh/e se" në Grafikun 18.

[4] Organizatat e tjera bilaterale mund të kenë siguruar fonde, megjithëse nuk u identifikuan përmes këtij hulumtimi.

Grafiku 18. Gjithsej fonde që burojnë nga organizatat bilaterale



Organizatat bilaterale të cilat OSHCG-të thanë se janë financuar, sipas vendit

Financuesi	Shqipëri	BeH	Kosovë	Mali i Zi	Maqedoni e Veriut	Serbi
Australia				✓	✓	✓
Austria	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kanada		✓	✓	✓		
Republika Çeke		✓				
Danimarka	✓		✓			
Finlanda			✓			✓
Franca	✓			✓	✓	✓
Gjermania	✓	✓	✓			
Luksemburgu			✓			
Holanda	✓	✓	✓		✓	✓
Norvegjia		✓				✓
Polonia				✓		
Sllovenia	✓					
Suedia	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Zvicra	✓	✓	✓		✓	✓
Turqia			✓			
MB		✓	✓			
SH.B.A.	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Financimi nga financuesit bilateralë ndryshon në mënyrë drastike, nga 100 € në 696,660 €, me fonde mesatar që arrinte shumën 29,865 € për grant ose kontratë. **SH.B.A.** financoi dukshëm më shumë nisma nga OSHCG-të (65) sesa financuesit e tjerë bilateralë (shih Grafikun 19). **Suedia** dhe **Austria**, mesatarisht ofruan grante ose kontrata më të mëdha se sa bënë financuesit e tjerë bilateralë (Grafiku 20).

Grafiku 19. Numri i fondeve nga organizatat bilaterale



Grafiku 20. Shuma mesatare e fondeve të dhëna nga organizatat bilaterale



Fushat kryesore tematike që financuesit bilateralë financuan përfshinin dhunën me bazë gjinore, barazinë gjinore dhe të drejtat e grave (Grafiku 21). Fushat e tjera në të cilat financuesit bilateralë kishin tendencë të shpërndajnë burime të konsiderueshme përfshinin mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit, të drejtat e njeriut, paqen, sigurinë dhe pajtimin.

Grafiku 21. Fushat kryesore tematike të financuara nga organizatat bilaterale

Studim i rastit: Civica Mobilitas e mbështetur nga Zvicra, Maqedonia e Veriut

Një shembull i mbështetjes bilaterale, Civica Mobilitas është programi i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që mëton të mbështesë shoqërinë civile në Maqedoninë e Veriut. Programi zbatohet nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Instituti Suedez për Administrim Publik. SDC është zotuar të avancojë barazinë gjinore dhe të drejtat e grave dhe vajzave, si një nga shtatë objektivat që udhëheqin aktivitetet e tyre.[5]

Në fazën e saj të dytë, nga 2014 deri në 2018, Civica Mobilitas shpenzoi €6 milion, 85% e të cilëve iu dhanë OShC-ve të ndryshme.[6] Gjithsej, 198 OShC morën mbështetje përmes 232 grante. Nga këto, 35 grante fokusoheshin në avancimin e barazisë gjinore (15%). Nga 5.1 milion € të shpërndara nga viti 2015 deri në vitin 2017, vetëm 8% shkuan OSHCG-ve (411,986 €). Përmes Platformës së Barazisë Gjinore në Maqedoninë e Veriut, OSHCG-të kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me fondet minimale në mbështetje të OSHCG-ve dhe barazisë gjinore.[7] Faza e tretë e programit do të mbulojë periudhën 2019-2022 me 4.4 milion €, 80% e të cilëve do t'i shpërndahen OShC-ve. Nga 35 grante tashmë të identifikuara për disbursim, shtatë prej tyre kanë barazinë gjinore si prioritet (20%).

Kjo analizë e shpejtë e Civica Mobilitas sugjeron që edhe kur qeveria e konsideron barazinë gjinore si prioritet, një përqindje relativisht e vogël të fondeve mund të shkojë për barazinë gjinore, dhe madje edhe më pak për OSHCG-të.

Vendimet organizative dhe/ose politike nga disa financues ose qeveritë e tyre duken se formësojnë mbështetjen për OSHCG-të. Për shembull, **SH.B.A.**, me fonde të ofruara përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe ambasadave të saj, është zotuar për promovimin e barazisë gjinore dhe avancimin e grave dhe vajzave.[8] Sidoqoftë, në një rast, kjo politikë në dukje ishte dëmtuar nga një vendim i USAID për të anuluar papritmas disa kontrata të hapura, të vazhdueshme me OSHC-të në Maqedoninë e Veriut në vitin 2019. Kjo kontribuoi në një rënie të konsiderueshme dhe të papritur të fondeve për disa OSHCG që punonin për arritjen e barazisë gjinore në vend.

Politikat e vendit, si ato të **Austrisë**, **Holandës**, **Zvicrës** dhe **Suedisë** ndikuan në prioritetet e financimit të këtyre donatorëve bilateralë.[9] Për shembull, një financues tha që theksi i tyre në të drejtat e njeriut buron nga kërkesat e programeve për adresnimin e të drejtave të grave dhe integrimin e komuniteteve pakicë.[10] Ngjashëm, politikat holandeze për të drejtat e njeriut kanë ndikuar në vendimin e tyre për të mbështetur përfshirjen dhe fuqizimin e grave.[11] Disa financues thanë që politikat e tyre kërkojnë financues të tjerë ndërkombëtarë, zbatues dhe kontraktorë që të adresojnë barazinë gjinore. Për shembull, politikat gjinore nga Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës raportohet se ndikuan në financuesit për të përdorur integrimin e perspektivës gjinore më shumë sesa projektet specifike që synojnë të drejtat e

[5] Konfederata Zvicerane, "Dispatch on Switzerland's International Cooperation 2017-2020: Key Points in Brief", 2016.
[6] Të dhëna të siguruara ngaCivica Mobilitas, 2019.
[7] Komunikimi me email, maj 2020.
[8] Faqja e internetit e USAID-it, *Gender Equality and Female Empowerment*, 10 korrik 2019, qasur më 16 dhjetor 2019.
[9] Intervista, financuesit bilateralë, 2019.
[10] Intervista, financues rajonal, 2019.
[11] Intervista, financues, Shqipëri, 2019.

Kutia 5 Qasja e ADA për integrimin gjinor

ADA ka përshtatur kornizën e saj ndërkombëtare dhe qasjen strategjike me kërkesat e EU GAP II. Integrimi gjinor është pjesë integrale e të gjithë sektorëve tematikë të ADA dhe strategjive të vendit. Objektivat e barazisë gjinore janë të integruara sistematikisht në të gjitha modalitetet e ndihmës, përfshirë ato që lidhen me dialogun politik dhe të politikave, financimin e përbashkët dhe mbështetje direkte buxhetore dhe financimin e sektorit (që përdoret në disa, megjithëse jo në të gjitha vendet). Të gjitha programet duhet t'i nënshtrohen rishikimit nga ekspertët gjinorë për të siguruar që projektet janë bazuar në analizën gjinore dhe përfshijnë perspektivën gjinore. Monitorimi përfshin raportimin e kërkuar mbi progresin drejt adresimit të rekomandimeve të ekspertëve gjinorë në dokumentet e projektit. Vëmendje për barazinë gjinore gjithashtu kërkohet në të gjitha vlerësimet e projekteve.

grave.[12] GIZ raportoi një qasje të ngjashme, të udhëhequr nga qeveria gjermane.[13] Përdorimi i perspektivës gjinore, sesa të programit të synuar, kishte tendencë të ishte një temë që përsëritej midis financuesve të intervistuar (shih Kutinë 4). Disa financues bilateralë si Sida ose Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) kërkojnë ose inkuraojnë fuqimisht që projektet të përmbajnë një komponent të barazisë (shih Kutinë 5). Ata gjithashtu kërkojnë që të gjitha programet t'i nënshtrohen kontrollit dhe monitorimit të cilësisë gjinore, sic parashihet në GAP II. Kërkesat e tilla të politikës mund të përfshijnë burime për OSHCG-të, si ekspertët për avancimin e barazisë gjinore. Për shembull, në Kosovë, ADA ka kontraktuar RrGK-në për të ofruar mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve për të gjithë përfituesit e ADA, duke i mbështetur ata për të përmirësojnë punën e tyre drejt arritjes së barazisë gjinore brenda programeve në sektorë të ndryshëm. ZBE në Kosovë është përpjekur për një mbështetje të ngjashme. Këta financues kuptuan që kompensimi financiar i OSHCG-ve për ekspertizën e tyre mund të lehtësojë përparimin e vetë financuesve në zbatimin e politikave të tyre. Edhe pse këshilltarët gjinorë të kualifikuar, konsultues dhe të kompensuar mbeten pozita të nevojshme të përhershme brenda organizatave të financuesve, puna e tyre mund të plotësohet nga OSHCG-të.

[12] Intervistat, financues, Maqedoni e Veriut, Kosovë, 2019.
[13] Intervista, financues, Kosovë, 2019.

Kutia 4. Integrimi gjinor

Më shumë se një qëllim në vetvete, integrimi gjinor është një strategji drejt arritjes së barazisë gjinore. Gjinia mund të përfshihet në ligjet, politikat dhe shpenzimet.[14] Ajo përfshin integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e përgatitjes, hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve. Analiza gjinore dhe vlerësimi *ex ante* i ndikimit gjinor mund të informojnë integrimin e duhur gjinor të programeve duke mbështetur identifikimin e objektivave të rëndësishme, rezultate e parashikuara dhe objektivat për të adresuar pabarazitë gjinore të identifikuara. Disa financues tani kërkojnë integrimin gjinor në programe. Në rajon, financuesit ofruan shembuj të përdorimit të tij për të përmirësuar perspektivën gjinore dhe barazinë gjinore brenda sektorëve si mjedisi dhe energjia, të cilët më parë kishin konsiderata në lidhje me barazinë gjinore.

Integrimi gjinor ka marrë disa kritika. Sipas Bankës Botërore "Përkundër optimizmit të hershëm, integrimi gjinor nuk ka arritur të përfshijë një orientim të barazisë gjinore në, ADN institucionale të shumicës së agjencive të zhvillimit".[15] Për më tepër, ata vërejtën që zotimet për avancimin e barazisë gjinore nuk kanë përfshirë përpjekje të mjaftueshme për "ndërtimin e kapaciteteve të stafit, ndarjen e fondeve adekuate dhe monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve". Ata vërejnë që nuk arrihet të bëhet "lidhshmëria" e integrimit gjinor me financimin.

Efektiviteti i integrimit gjinor ka të ngjarë të varet nga përdorimi i tij në praktikë. Derisa disa prej financuesve të intervistuar e përdorën atë për të siguruar vëmendjen ndaj cilësisë gjinore në sektorë të ndryshëm, të tjerët duket se e kanë bërë atë sa për 'sy e faqe'. Për shembull, një trend i përsëritur mes financuesve ishte se ata përdorin integrimin gjinor, në mënyrë që ata të mos lënë anash fondet specifike për barazinë gjinore ose OSHCG-të. Kjo paraqet një keqkuptim të konceptit të integrimit gjinor. Integrimi i duhur gjinor duhet të përfshijë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, i cili përfshin përdorimin e analizave gjinore për të informuar shpenzimet.[16] Për më tepër, në përputhje me praktikat më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, shumat e alokuara dhe të shpenzuara në gra dhe burra gjithashtu duhet të jenë transparente dhe të vlerësohen. Sidoqoftë, duke konfirmuar qëndrimin e Bankës Botërore, një trend i përsëritur mes financuesve ishte se shpenzimet e tyre drejt arritjes së barazisë gjinore të drejtat e grave nuk mund të mateshin me saktësi *sepse* ata kishin përdorur integrimin gjinor në mënyrë që "gjinia të jetë kudo.". Pa monitoruar dhe vlerësuar shpenzimet aktuale, është e vështire të vlerësohet nëse ka ndodhur integrimi gjinor. Siç u përmend, sistemet e dobëta të monitorimit dhe vlerësimit kanë kontribuar në përcjelljen e vështirë të burimeve për arritjen e barazisë gjinore si pjesë e këtij hulumtimi.

---

[14] EIGE, *What is Gender Mainstreaming*, faqja e internetit e qasur më 24 maj 2020.

[15] Grupi i Bankës Botërore, Barazia Gjinore, Ulja e varfërisë dhe Rritja Gjithëpërfshirëse, 2016-2023 Gender Strategy, faqe 23.

[16] Për më shumë informacion, shih: EIGE, *What is Gender Budgeting,* faqja e internetit e qasur më 27 maj 2020.

Studim rasti: Mbështetja e Sida për Barazinë Gjinore dhe OSHCG-të

Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) e bazon punën e saj në kornizën e politikave për bashkëpunim për zhvillim dhe ndihmë humanitare, e cila përfshin barazinë gjinore në mesin e fushave të saj prioritare,[1] si dhe në strategjitë shtetërore, rajonale dhe globale të përcaktuara nga qeveria suedeze. Sida ka ofruar BP ndihmë të vazhdueshme për zhvillim, që arrin shumë e përafërsisht 433.5 milion € nga fondet e përgjithshme të ndara në mes të vitit 2014 dhe 2019.[2] Nga kjo shumë, 120.8 milion € janë ndarë për shoqërinë civilë, që përbën 27.9% të fondeve të Sida për rajonin. Nga fondet e përgjithshme të ndara, 57.7 milion € ishin të fokusuara ekskluzivisht në avancimin e barazisë gjinore (13.3%).[3] Nga kjo shumë, Sida ofroi 30.3 milionë € OSHCG-ve që fokusoheshin në avancimin e barazisë gjinore, që përbën 7% të të gjitha fondeve të alokuara dhe të gjithë 52.5% të fondeve të Sida u alokuan vetëm për avancimin e barazisë gjinore.[4]

Kjo është një pjesë shumë e vogël e ndihmës totale që shkon për lëvizjen e të drejtave të grave dhe lëvizjet feministe. Kështu që, me të vërtetë do të dëshironim të shihnim një pjesë shumë më të madhe të ndihmës për zhvillim që mbështet punën e OSHCG-ve.

Përfaqësues/e nga Sida

Këto të dhëna i referohen vetëm veprimeve/aktiviteteve të shënuara me Shënuesin e Barazisë gjinore OECD-DAC 2, d.m.th, financimi ishte i fokusuar në mënyrë të qartë në avancimin e barazisë gjinore.[5] Të dhënat e paraqitura nuk përfshijnë fonde për veprime për Shënuesin e gjinisë 1, që do të thotë, veprimet që kanë një objektiv për avancimin e barazisë gjinore, ndër objektivat e tjera, por jo si qëllimin kryesor të veprimit. Si politikë, qeveria e Suedisë kërkon që të gjitha programet të kenë të përfshirë perspektivën gjinore, që do të thotë se disa veprime kanë Shënuesin e Gjinisë 1. Megjithatë, është e vështirë të përcaktohet nga projektet me Shënuesin e Gjinisë 1 shuma e saktë e shpenzimeve për barazinë gjinore, përkatësisht për OSHCG-të. Kështu që, Sida ka ndarë substancialisht më shumë fonde për avancimin e barazisë gjinore dhe OSHCG-të përtej asaj që është paraqitur këtu.

Duke marrë parasysh që këto të dhëna nuk janë të plota, kërkohet kujdes gjatë interpretimit të trendeve të financimit me kalimin e kohës. Duke e pasur parasysh këtë, fondet e Sida që ishin të fokusuara vetëm në avancimin e barazisë gjinore (financimi për Shënuesin e Gjinisë 2) duket se janë dyfishuar me kohë, nga €5.4 milion në vitin 2014 deri në 10.9 milion € në vitin 2019 (Grafiku 22). Sidoqoftë, si një pjesë e alokimeve totale, kjo është vetëm një rritje e lehtë nga 8.7% në vitin 2014 në 11.9% në vitin 2019. Financimi i OSHCG-ve që punojnë për avancimin e barazisë gjinore është rritur dukshëm në terma absolutë nga 4.7 milion € në vitin 2014 në 6.4 € në vitin 2018, megjithëse kishte rënë në 4.4 milion € në vitin 2019. Rritja prej 1.7 milion € paraqet një rritje prej 36% nga 4.7 milion € fillestare në vitin 2014. Sidoqoftë, si pjesë e fondeve të përgjithshme të Sida, rritja mbetet shumë e vogël: nga 7.6% në 8.2%. Është interesante që përqindja e fondeve të dedikuara për avancimin e barazisë gjinore, e ndarë OSHCG-ve është ulur ndjeshëm me kalimin e kohës, nga 87% të fondeve për barazi gjinore në vitin 2014 në 40% në vitin 2019. Kjo sugjeron për një trend në

[1] Qeveria e Suedisë, *Policy framework for Swedish development cooperation and humanitarian assistance*, 2016.
[2] Të dhënat e ofruara nga Sida, 2019.
[3] Kjo përfshin të gjitha projektet me Shënuesin e gjinisë 2.
[4] Kjo përfshin punën e OSHCG mbi veprimet e koduara si projekte me Shënuesin e gjinisë 2 me kodin e sektorit të OECD DAC "Organizatat dhe lëvizjet e të drejtave të grave dhe institucionet qeveritare".
[5] Për më shumë informata mbi Shënuesin e Gjinisë, shih Kutinë 1.

shpërndarjen e më shumë fondeve për iniciativa që kanë të bëjnë me barazi gjinore për pranuesit se sa për OSHCG-të.



Grafiku 22. Financimi i Sida sipas vitit dhe llojit në miliona

Fondet e Sida që synojnë barazinë gjinore janë të përqendruara në pesë sektorë. Në mes të vitit 2014 dhe 2019, Sida shpërndau pjesën më të madhe të këtyre fondeve tek "Qeveria dhe Shoqëria Civile" (40.1 milion €),[6] që përfshin 69.5% të fondeve të Sida për arritjen e barazisë gjinore (Grafiku 23). Financimi i barazisë gjinore në Industri arriti shumën prej 13.1 milion € (22.8%), në Pylltari 4.3 milion € (7.5%), dhe afërsisht 0.1% në Mbrojtjen e Mjedisit, dhe në Politikat dhe Rregulloret e Tregtisë dhe përkatësisht sektorët e rregullimit që kanë të bëjnë me tregtinë.[7]

Grafiku 23. Financimi i Sida për barazinë gjinore sipas sektorit në miliona

[6] Këta sektorë i referohen kategorive të përdorura në sistemin e menaxhimit të të dhënave Sida, të cilat përcaktohen dhe përdoren sipas kodeve të sektorit të përcaktuara nga.
[7] Financimi i lidhur me politikën tregtare nuk është reflektuar në grafik pasi që ekzistonte vetëm në vitin 2016 (50,692 €).

Qeveritë e BP

Shumica e qeverive të BP kanë ligje që mundësojnë mbështetjen e tyre financiare ndaj OSHCG-ve.[1] Siç vunë në dukje financuesit gjatë intervistave, përderisa mbështetjet e huaja mund të jenë të nevojshme për një periudhë kohore, eventualisht qeveritë lokale duhet të marrin përsipër financimin dhe të mbështesin shoqërinë civile.

> **Ne shpesh varemi nga donatorët dhe kjo mund të rrezikojë vazhdimin dhe qëndrueshmërinë e organizatave sepse nuk ka mbështetje financiare nga institucionet shtetërore. Statistikat duhet të fillojnë të mendojnë edhe për OSHC-të dhe shërbimet që ne ofrojmë.**
>
> OSHCG, Shqipëri

Qeveritë e BP nuk i kanë bërë publike të dhënat zyrtare gjithëpërfshirëse në lidhje me grante për barazinë gjinore dhe/ose OSHCG-të.[2] Prandaj, gjetjet në këtë pjesë nxirren kryesisht nga sondazhi i OSHCG-ve. Edhe pse mbështetja e buxhetit direkt nga financuesit bilateralë dhe multilateralë për buxhetet e qeverisë do të thotë që burimi fillestar i financimi nuk mund të përcaktohet përfundimisht, të dhënat sugjerojnë që shumica e fondeve të qeverisë vinin nga buxhetet e qeverisë, siç indikohet nga organet e ndryshme qeveritare që kanë financuar OSHCG-të.

Në mes të vitit 2014 dhe 2019, organet qeveritare në BP kanë ndarë 468 grante të ndryshme, kontrata ose forma të tjera të financimit për 96 OSHCG të ndryshme. Shumat silleshin nga 9 € deri në 115,801 €, ku secili fond individual ishte mesatarisht 9,616 € nga organet e qeverisë qendrore dhe 2,357 € nga organet e qeverisë lokale. Diferencat sipas vendeve janë të ilustruara në Tabelën 3.

Tabela 3. Fondet e qeverisë të ofruara OSHCG-ve sipas vendit, 2014 deri në mesin e vitit 2019

	Shqipëri	BeH	Kosovë	Mali i Zi	Maqedoni e Veriut	Serbi	Gjithsej
Fondet e përgjithshme të ofruara (në mijëra)	€70	€476	€1,124	€163	€499	€559	€2,890
Madhësia mesatare e grantit	€7,769	€6,257	€7,904	€6,515	€9,974	€3,604	€6,097
# i granteve/kontratave të dhëna nga qeveritë	9	76	144	25	50	155	459
# i marrësve OSHCG	3	14	43	6	12	18	96
# i OSHCG-ve në mostër	23	32	111	8	36	30	240
% i OSHCG- ve në mostër që marrin fonde nga qeveria	13%	44%	39%	75%	33%	60%	40%

[1] Për më shumë informacion, shih seksionin mbi "Ligjet nacionale që ndikojnë në qasjen në fonde".

[2] Hulumtuesit nuk mund të gjenin bazat e të dhënave gjithëpërfshirëse në internet për asnjë nga vendet. Vendet kishin të dhëna të disponueshme vetëm nga disa, organe qeveritare individuale dhe ministri. I Në disa raste, të dhënat mund të kërkohen nga ministritë individuale. Në Serbi, qeveria publikon raporte mbi fondet e siguruara për OShC-të nga organet qeveritare në nivelin kombëtar, krahinor dhe lokal. Sidoqoftë, ata nuk përmendin OSHC përfituese individualisht, por vetëm sipas sektorit ose vendndodhjes gjeografike (2016, në gjuhën serbe). Në Kosovë, qeveria menaxhon online një "Platformë për menaxhimin e ndihmës ", por ajo përfshin vetëm të dhëna nga financuesit e huaj dhe jo nga institucionet e Kosovës.

Qeveritë e BP kishin tendencë të sigurojnë më shumë fonde për OSHCG-të në **Kosovë**, **Serbi** dhe **Maqedoni të Veriut** sesa në vendet e tjera. Edhe pse të dhënat për vitin 2019 nuk janë të plota, financimi i OSHCG-ve nga ana e qeverive në BP duket se është rritur pak me kalimin e kohës. Sidoqoftë, kjo i atribuohet kryesisht rritjes së konsiderueshme në **Kosovë**, ku fondet e qeverisë për OSHCG-të janë, më shumë, se dyfishuar në mes të vitit 2014 dhe 2017 (Grafiku 24).

Grafiku 24. Fondet e dhëna drejtpërdrejt për OShCG-të nga qeveritë e PB



Rritja e konsiderueshme në **Kosovë,** në mesin e faktorëve të tjerë të mundshëm, mund t'i atribuohet pjesërisht avokimit të suksesshëm të OSHCG-ve për rritjen e fondeve qeveritare për strehimore. Kjo gjithashtu mund të jetë për shkak të disa iniciativave të OSHCG për të avokuar tek komunat dhe ministritë për mbështetje më të ekuilibruar gjinore, shoqëruar me mbështetjen për OSHCG-të për të aplikuar për subvencione qeveritare. Për shembull, RRGK ka ofruar trajnime për zyrtarët e qeverisë, si dhe anëtaret e saj të ndryshme,[1] përfshirë OSHCG të vogla dhe rurale, në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në mënyrë që ata të mund të interpretojnë shpenzimet qeveritare nga perspektiva gjinore, përfshire subvencionet qeveritare. Kjo, shoqëruar me avokimin e OSHCG, mund të ketë kontribuar në vetëdijësimin e disa zyrtarëve në lidhje me nevojën e shpërndarjes së subvencioneve në mënyrë të barabartë midis grave dhe burrave, si dhe ka pajisur OSHCG-të me mjete për të mbajtur zyrtarët më shumë përgjegjës ndaj zotimeve për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Përmes Fondit të Grave të Kosovës, OSHCG-të gjithashtu morën mbështetje për të ngritur kapacitetet e tyre në përgatitjen e ofertave dhe aplikacioneve për grante, si dhe për të ndihmuar OSHCG-të e tjera dhe gratë për ta bërë këtë, në mënyrë që t'i përgatisë më mirë që të aplikojnë për subvencione qeveritare.

Financimi i OSHCG-ve nga ana e qeverisë gjithashtu është rritur në **BeH**. Pavarësisht rritjeve fillestare, financimi nga ana e qeverisë në shumicën e vendeve të tjera ranë në vitin 2017 ose 2018, veçanërisht në **Serbi**. Ndërsa ishte e vështirë për t'u interpretuar direkt nga të dhënat, aktivistët besuan se arsyeja e mundshme për rënien e konsiderueshme te fondeve të qeverisë mund të ishte ngushtimi i hapësirës për OSHCG-të atje, motivuar nga rivendosja e vlerave tradicionale dhe roleve gjinore. Kjo duket se ka kontribuar në rënie të fondeve të dhëna për OSHCG-të nga qeveritë lokale, drejtimin e fondeve shtetërore tek OJQOQ-të dhe

[1] OSBE në Kosovë, Helvetas, UN Women, GIZ, dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike u kanë ofruar gjithashtu trajnime zyrtarëve qeveritarë në lidhje me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

financimin e institucioneve shtetërore në vend të OSHCG-ve. Fondet në **Maqedoninë e Veriut**, siç është raportuar nga OSHCG-të, patën luhatje të dukshme nga viti në vit; fondet në **Mal të Zi** gjithashtu shënuan luhatje, megjithëse ndjeshëm më pak.

Organet qeveritare që financuan OSHCG ishin të ndryshme.[2] Ngjashëm me financuesit e tjerë, qeveritë e BP duket se kanë ndarë dukshëm më shumë fonde për adresimin e dhunës me bazë gjinore se sa në fushat e tjera tematike (Grafiku 25).

Grafiku 25. Fushat tematike të financuara nga qeveritë



Në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore në **BeH**, Agjencia për Barazi Gjinore në BeH, si dhe Qendrat Gjinore të FBeH dhe Republika Srpska duhet të mbështesin OSHCG-të përmes granteve të vogla.[3] Në Dhjetor 2019, Agjencia për Barazi Gjinore njoftoi se do të ndajë afërsisht 41,000 € në kuadër të Mekanizmit Financiar për Zbatimin e Programit II të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore të Bosnjës dhe Hercegovinës (FIGAP), të mbështetur nga financimi i përbashkët bilateral nga qeveria suedeze, zvicerane dhe austriake.[4] Shuma maksimale e grantit është 7,661 € për grant, që zgjat deri në gjashtë muaj.[5] Ekzistenca e këtij Programi do të sugjeronte që disa nga fondet në Grafikun 24 në fakt burojnë nga burimet bilaterale. Sidoqoftë, thirrja e Programit për grante është e hapur për të gjithë OShC-të, jo vetëm OSHCG-të. Bazuar në intervistat me OSHCG-të, vetëm një OSHCG raportoi të merrte fonde nga FIGAP. Megjithëse shkalla e ulët e reagimit në BeH mund të kontribuojë në ndonjë mospërputhje, duket se shumica e fondeve të qeverisë për OSHCG-të në BeH kanë ardhur nga organet e tjera të qeverisë (97%). Gjatë intervistave, aktivistët për të drejtat e grave në BeH thanë që Programi FIGAP II ilustron se si OSHCG-të marrin vetëm një shumë të vogël të fondeve nga donatorë më të mëdhenj; këto fonde shpërndahen në shuma më të vogla përmes agjencive dhe jo gjithmonë mbërrijnë tek OSHCG-të.

Në **Mal të Zi**, qeveria shpërndan fonde për barazinë gjinore kryesisht përmes Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave, me 107,970€ prej 290,000€ (37%) të shpërndara në 10 OSHCG-të (24 OShC-të që morën fonde në vitin 2019).[6] Megjithatë, OSHCG-të thanë që fondet në dispozicion të tyre janë të pamjaftueshme dhe se vlerësuesit që janë të ulur në komisionet e përzgjedhjes shpesh u mungon ndjeshmëria dhe të kuptuarit e barazisë gjinore.[7]

Faqet që vijojnë përmbajnë studime të rasteve të organeve specifike qeveritare në Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Kosovë. Në përgjithësi, studimet e rasteve, të shoqëruara me gjetjet e tjera të hulumtimit sugjerojnë se financimi për barazinë gjinore, përkatësisht OSHCG-të, përfshin një pjesë shumë të vogël të fondeve qeveritare të ndara për shoqërinë civile në vendet e BP.

---

[2] Shtojca 4 përmban një listë.
[3] Ligji për Barazi Gjinore në Bosnjë e Hercegovinë Nr. 16/03 dhe 102/09, Neni 26(m) dhe Neni 27(1)(h).
[4] Për më shumë informata shih FIGAP (në gjuhën boshnjake).
[5] Po aty. Konvertuar në euro (prill 2020).
[6] Ministria e të Drejtave Njerëzore dhe të Pakicave të Malit të Zi, Decision on allocation of funds to projects / programs of non-governmental organisations in the field of gender equality, (në gjuhën malazeze) 11.10.2019.
[7] Intervista, OSHCG, Mali i Zi, 2019.

Studim rasti: Qeveria e Maqedonisë së Veriut

Vlerësohet që në vitin 2019, Maqedonia e Veriut kishte popullsi prej gati 2.1 milion banorë, 49.9% gra.[8] Nga viti 2014 deri në vitin 2019, Departamenti për Bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare në Sekretariatin e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut raportoi dhënien e 773,960€ për shoqërinë civile.[9] Sektorët e financuar përfshin rritjen e ekonomisë, punësimin dhe cilësinë e jetës; integrimin në BE dhe NATO; luftën kundër krimit dhe korrupsionit; sundimin e ligjit; ndotjen e ajrit; dhe investimi në invoacion, teknologji dhe arsim. Në vitin 2017 dhe 2018, në mes të ndryshimit të qeverisë, Qeveria nuk ka shpërndarë kurrfarë fonde. Departamenti shpërndau në total, 74,370€ për barazi gjinore ose të drejtat e grave, që përbën 9% të fondeve të dhëna për shoqërinë civile. Nga kjo, 64,370€ u shpërndan drejtpërdrejt OSHCG-ve, që arrin 8% të të gjitha fondeve të shoqërisë civile. Fushat tematike të mbështetura kryesisht përfshinin adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore, por gjithashtu edhe dhunën në familje dhe fuqizimin ekonomik të grave.

Përveç fondeve të dhëna nga departamenti i lartpërmendur, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale gjithashtu financoi OSHC-të. Nga viti 2014 deri në 2019, Ministria u ndau OSHC-ve një shumë totale prej 8.5 milion €. OSHCG-të që punojnë për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave pranuan vetëm 2.2% të këtyre fondeve.[10] Fondet për OSHCG-të kryesisht mbështetën projektet dhe shërbimet për të adresuar dhunën me bazë gjinore. Siç ilustron Grafiku 26, në terma absolutë, fondet për OSHCG-të u rritën nga më pak se 5,000€ në vitin 2014 në 91,000€ në vitin 2019. Si përqindje e financimit të OSHC, fondet specifike për OSHCG-të gjithashtu janë rritur pak me kalimin e kohës, nga 0.4% të fondeve të OSHC në vitin 2014 në 6.3% në vitin 2019. Për më tepër, granti mesatar i ndarë OSHCG-ve është rritur nga 4,626 € në vitin 2014 në 36,710 € në vitin 2019. Sidoqoftë, OSHCG-të ende marrin mesatarisht 73% më pak fonde në vit se sa marrin OSHC-të e tjera.

Grafiku 26. Financimi i OShC-ve dhe OShCG-ve nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në mijëra



Ministria siguroi më shumë fonde për OSHCG-të gjatë 2018, duke pasqyruar prioritetet e reja që pasuan ndryshimin e qeverisë në Maqedoninë e Veriut. Rasti i Maqedonisë së Veriut ilustron se si qasja e OSHCG-ve në financim brenda vendit të tyre mund të ndikohet ndjeshëm nga ndryshimet e qeverisë.

---

[8] Republika e Maqedonisë së Veriut, Zyra Shtetërore e Statistikave, *Women and Men in North Macedonia* , 2019.
[9] Të dhënat e marra nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, 2019.
[10] Ministria nuk i përcjell grantet për OSHCG-të, por ekipi i hulumtimit e llogariti këtë manualisht bazuar në informacionin e dhënë.

Studimi i rastit: Sekretariati Krahinor për Politika Sociale, Demografi dhe Barazi Gjinore në Vojvodinë, Serbi

Sekretariati Krahinor për Politika Sociale, Demografi dhe Barazi Gjinore në Vojvodinë, Serbi shpërndau gjithsej €711,794 në fonde nga viti 2014 deri në vitin 2019, përfshirë €637,475 për barazi gjinore. Përafërsisht 68% e fondeve të përgjithshme shkuan në OShC-të (€481,822); ndërsa pjesa tjetër duket se u ka shkuar punëdhënësve, siç janë për fuqizimin ekonomik të të mbijetuarve. Sekretariati raportohet se shpërndau këto fonde në dy fusha kryesore: fuqizimi ekonomik i grave të mbijetuara të dhunës dhe promovimi i barazisë gjinore. Disa fonde gjithashtu mbështetën shoqatat e grave. Sekretariati nuk përcjell shumën e fondeve të dhëna OSHCG-ve, kështu që është e paqartë nëse fondet shkuan tek OSHCD ose tek OShC e tjera. Në përgjithësi, në përputhje me trendet e përgjithshme të lartpërmendura në Serbi, financimi për barazi gjinore duket se ka rënë që nga viti 2017, ndërsa financimi i OShC-ve është zvogëluar që nga viti 2014 (Grafiku 27).

Grafiku 27. Financimi i barazisë gjinore, OShC-të, në mijëra



Studimi i rastit: Komuna e Junikut, Kosovë

Komuna e Junikut, e vendosur në pjesën perëndimore të Kosovës në rajonin e Gjakovës, është një komunë e vogël, me rreth 6,370 banorë.[11] Me një buxhet të përgjithshëm vjetor prej më pak se 1.8 milion euro në vitin 2019,[12] Juniku ka subvencione të kufizuara për të ofruar, që sillen mesatarisht €8,703 në vit, ndërmjet vitit 2016 dhe 2019.[13] Sipas zyrtarëve, 26% e €5,460 të subvencioneve të shpërndara në vitin 2016 ishin të drejtuara për mbështetjen e grave, veçanërisht subvencionet për mirëqenien sociale dhe atë mjekësore (që përbëjnë 47% të subvencioneve në këtë sektor). Në vitin 2017, 38% e subvencioneve (€2,300) mbështetën gratë, përfshirë: shtëpinë e sigurt për rastet e dhunës në familje, botimin e një libri nga një autore grua dhe mbështetjen për çështjet sociale dhe mjekësore. Megjithatë, gratë pranuan vetëm 20% të subvencioneve për mbështetje sociale dhe mjekësore në vitin 2018 dhe 42% në vitin 2019. Këto fonde nga të cilat përfituan gratë nuk janë domosdoshmërish të barabarta me fondet për avancimin e barazisë gjinore. Në mesin e fondeve të shpërndara, vetëm €200 shkuan për një OSHCG, shtëpinë e sigurt, që përbëjnë 3.3% të subvencioneve në vitin 2017, 0.6% përgjatë katër këtyre viteve.

Kjo analizë e shpejtë e shpenzimeve të Komunës së Junikut sugjeron që OSHCG-të lokale mund të marrin një pjesë të vogël të subvencioneve të shpërndara nga qeveria lokale. Përveç kësaj, hulumtimi sugjeron që qeveritë mund të mos e kuptojnë gjithmonë dallimin ndërmjet fondeve për gratë përfituese dhe fondeve për barazinë gjinore. Pra, ata mund të mos ndajnë burime shprehimisht për avancimin e barazisë gjinore.

---

[11] Republika e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Vlerësimi* , 2018.
[12] Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, *Buxheti Vjetor 2019*.
[13] Të dhënat e marra nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut, 2019.

OJQN-të

Në total, OJQN-të ofruan fonde OSHCG-ve në rajon 293 herë, që arrin shumë e përgjithshme prej 6.2 € milion nga viti 2014 deri në vitin 2019. Fondet silleshin nga €49 deri 173,693 €, me një shumë mesatare prej 21,322 €. OSHCG-të në **BeH** morën më shumë fonde nga OJQN-të sesa morën ato në vendet e tjera (shih Grafikun 28). OSHCG-të në **Kosovë** pranuan pjesën tjetër më të madhe të fondeve nga OJQN-të, pasuar nga ato në **Shqipëri**. Financimi nga OJQN-të është zvogëluar me kohë, veçanërisht në **BeH** dhe **Kosovë**. Përjashtimisht, ai është rritur në **Shqipëri**. Në vendet e tjera, fondet nga OJQN-të kanë mbetur mjaft të qëndrueshme, por minimale, nën 80,000 € në vit.

Grafiku 28. Fondet e shpërndara nga OJQN-të tek OShCG, në mijëra



Shumicën e fondeve që OSHCG-të raportuan të kenë marrë nga OJQN-të vinin nga Shoqata Ndërkombëtare për Shëndetin e Nënës dhe të Porsalindurve (IAMANEH), pasuar nga Care and Save the Children (Grafiku 29). OJQN-të që shpërndan fonde për OSHCG-të në disa vende të BP përfshinin Amica, Care, Caritas, IAMANEH, Medica mondiale, Olof Palme International, Save the Children, SEKA Hamburg, Swisscontact, Women Against Violence Europe Network dhe World Vision.[14]

[14] Për listën e të gjitha OJQN-ve që ofruan mbështetje sipas vendit, shih Shtojcën 4.

Grafiku 29. Fondet që OJQN-të dhënë direkt OShCG-ve, në mijëra



Ashtu si financuesit e tjerë, OJQN-të mbështetën kryesisht përpjekjet për të adresuar dhunën me bazë gjinore. Fushat e tjera tematike që ato mbështetën përfshinin demokracinë dhe qeverisjen, dhe fuqizimin e grave (Grafiku 30).

Grafiku 30. Sektorët e financuar nga OJQN-të



Fondacionet

Në total, fondacionet ofruan 483 grante për OSHCG-të në rajon, që përbënin shumë totale prej 17.7 milionë euro nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019. Shumat e granteve silleshin prej 250 € deri 501,914 €, me shumë mesatare prej 36,564 € për grant. Deri tani, në mesin e llojeve të ndryshme të fondacioneve, fondet e grave ofruan shumicën e granteve (Grafiku 31) përmes granteve që ishin mesatarisht të dytë sipas lartësisë së shumës (Grafiku 32). Në të kundërtën, fondacionet private priren të sigurojnë mesatarisht grante më të mëdha (42,845 € për grant).





Sektorët ose fushat te matike të mbështetura nga fondacionet ndryshonin disi nga ato të mbështetura nga fin ancuesit e tjerë; shumica e fondeve nga fondacionet duket se kanë mbështetur paqen, sigurinë dhe pajtimin (Grafiku 33). Përkrahja e fuqizimit ekonomik të grave mbeti sektori i dytë më i mbështetur.



Grafiku 34 tregon fondet që fondacionet dhanë direkt OSHCG-ve sipas vendit nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019, duke përjashtuar të dhënat nga fondet e grave, të cilat shqyrtohen veçmas në pjesën tjetër. Ai ilustron se fondet nga fondacionet kanë pasur luhatje me kalimin e kohës, veçanërisht në **Maqedoninë e Veriut**. OSHCG-të në **BeH** duket se kanë marrë relativisht më shumë burime nga fondacionet sesa OSHCG-të në vendet e tjera (€1.3 milion), të pasuara nga OSHCG-të në **Serbi** (€1.1). Edhe pse OSHCG-të në **Maqedoninë e Veriut** morën kontribute të konsiderueshme nga fondacionet në vitin 2015, përkatësisht nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Maqedoni (FOSM), kjo ra ndjeshëm në vitet që pasuan. Në kontrast me uljet e fondeve nga fondacionet në këto tre vende, OSHCG-të në **Kosovë** raportuan për një rritje të fondeve në mes të vitit 2016 dhe 2018. OSHCG-të në **Shqipëri** dhe **Mal të Zi** morën relativisht më pak burime nga fondacionet se sa OSHCG-të në vendet e tjera të BP (pra, nën 25,000 € në vit).



OSHCG-të raportuan të kenë marrë fonde nga fondacionet private, fondacionet politike dhe fondacionet lokale, ndër të tjera.[15] Mbështetja nga **fondacionet private** duket mjaft ad hoc në rajon. OSHCG-të në **Maqedoninë e Veriut** dhe **Serbi** morën relativisht më shumë fonde nga fondacionet private, por financimi ishte sporadik dhe u zvogëlua me kalimin e kohës. Nga fondacionet private, Fondacionet e Shoqërisë së Hapur ofruan 4% të fondeve. Duhet të theksohet se ndonjëherë fondet e tyre rrjedhin nga financuesit bilateralë, siç është financimi FOSM në Maqedoninë e Veriut nga USAID. Në raste të tjera, fondet e tyre erdhën direkt nga vetë Fondacioni për Shoqëri të Hapur, financuar kryesisht nga George Soros. **Fondacionet politike** mbështetshin OSHCG-të në **BeH** dhe fondet e tyre kanë pasur rënie me kalimin e kohës. Vendet e tjera të vetme në të cilat OSHCG-të duket se kishin marrë mbështetje nga fondacionet politike ishin **Serbia** dhe **Shqipëria**. Më shumë fonde nga **fondacionet lokale** përfituan OSHCG-të në **BeH** dhe **Kosovë** sesa ato në vendet e tjera.

[15] Për më shumë informata në lidhje me fondacionet që ofruan mbështetje, ju lutemi, shih Shtojcën 4.

Studim rasti: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) është fondacioni i regjistruar në vend. KFOS është anëtar i rrjetit ndërkombëtar të fondacioneve filantropike për shoqëri të hapur, i financuar nga filantropisti ndërkombëtar George Soros.[16] KFOS ka programe për Integrimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile dhe të drejtat e pakicave dhe romëve. Puna e tyre fokusohet në ngritjen e kapaciteteve, rritjen e zbatimit të politikave ekzistuese dhe zhvillimin e politikave të reja. KFOS zbaton projekte të hartuara nga vetë fondacioni, por gjithashtu mbështet OSHC-të me ndihmë financiare dhe operative. KFOS raportoi se kishte shpenzuar mbi 5 milion€ nga viti 2016 deri në 2019. Nga kjo shumë, €723,077 ishin për shpenzime administrative (14%) dhe 4.3 milion€ iu dhanë OSHC-ve (86%). Asnjëri nga 17 programet e financuara të OSHC nuk kishte si prioritet avancimin e barazisë gjinore dhe asnjë nuk u zbatua nga OSHCG-të.

Studim rasti: Fondacioni TRAG

TRAG është fondacioni rajonal që punon për zhvillimin e komunitetit, me seli në Serbi, dhe jep grante në BeH dhe gjithashtu në Mal të Zi.[17] Puna e tij përshin promovimin e filantropisë, ngritjen e kapaciteteve dhe grantet.[18] TRAG ofron grante në disa sektorë, përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe pylltarinë; arte dhe kulturën; zhvillimin lokal; shkencën dhe edukimin; mbrojtjen e mjedisit; të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe të drejtat e grave; dhe sigurinë.[19] Nga viti 2016 deri në 2018, TRAG ka dhënë €3.4 milion OShC-ve. Një shumë e konsiderueshme të këtij fondi mbështeti projekte për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, që përfshin 78% të të gjitha fondeve (afro €2.7 milion). Për më tepër, 64% e shumës totale iu dha OSHCG-ve (gati €2.2 milion). Kjo mund t'i atribuohet pjesërisht faktit që Fondacioni Oak Fondacioni, një fond i grave, ka përdorur TRAG si një ndërmjetës për të shpërndare fonde OSHCG-ve në BP që nga viti 2015. Fondacioni Oak financon programin e TRAG mbi çështje që prekin gratë. TRAG gjithashtu financon OSHCG-të përmes programeve të tij të tjera. Gjithsej 82% e të gjitha fondeve të dhëna për avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore shkuan direkt tek OSHCG-të. Në këtë kuptim, TRAG është disi unik në shumën e fondeve të dhëna për barazinë gjinore dhe OSHCG-të, krahasuar me fondacionet e tjera lokale që nuk janë fonde të grave.



[16] Shih më shumë informata për Fondacionet e Shoqërisë së Hapur këtu.
[17] Faqja e internetit e Fondacionit TRAG.
[18] Bjelanovic dhe Myers për CEE FC, Bratislava, "A Case Study of TRAG Foundation", 2017.
[19] Të dhënat e siguruara nga TRAG, 2019.

Fondet e grave shpërndanë shumicën e fondeve për OSHCG-të, deri tani, ndër llojet e ndryshme të fondacioneve, me kontribute që arrijnë afërsisht 7.1 milionë euro (68% të financimit nga fondacionet) nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019 (Grafiku 36). Fondacionet private siguruan 12% të fondeve të përgjithshme të fondacioneve për OSHCG-të. Fondacionet lokale shpërndanë 6% dhe fondacionet politike 1%.[20]

Grafiku 36. Grantet për OShCG-të nga llojet e fondacioneve



Fondet e grave

Kjo pjesë hedh një vështrim më të afërt në shumën e konsiderueshme të donacioneve të dhëna OSHCG-ve përmes fondeve të grave dhe në literaturën ekzistuese për rolin e veçantë që këto fonde mund ta kenë për të arritur tek OSHCG-të.[21] Siç është cekur, fondet e grave ofruan përafërsisht 7.1 milionë € për OSHCG-të në BP nga viti 2015 deri në mesin e viti 2019, që përfshin 11% të të gjitha fondeve për OSHCG-të. Kjo rritet në 12.5 milion €, 20%, të fondeve të dhëna direkt për OSHCG-të, kur nuk gjurmohen fondet në burimin e tyre fillestar.[22] Shuma mesatare e grantit ishte 37,250 €. Donacionet kanë mbetur mjaft konsistente me kalimin e kohës, ku OSHCG-të raportuan të kenë marrë, gjithsej, një mesatare prej 2 milion€ në vit, nga 2014 deri në 2017 nga fondet e grave. Kjo u rrit ndjeshëm në 2.7 milion€ në vitin 2018, kryesisht për shkak të rritjes së mbështetjes së organizatave në **Serbi** (Grafiku 36). OSHCG-të në **BeH** dhe **Serbi** raportuan që marrin ndjeshëm më shumë fonde nga fondet e grave sesa OSHCG-të në vendet e tjera.

[20] Grafiku i përgjithshëm nuk arrin në 100% sepse fondacionet që ekipi i hulumtimit nuk mundi t'i identifikojë si fonde politike, private, lokale, ose të grave nuk janë paraqitur këtu.
[21] AWID, *Watering the Leaves, Starving the Roots*, faqe 90.
[22] Shih shpjegimin e mëtutjeshëm në fillim të këtij kapitulli. Siç diskutohet atje, fondet e grave duket se kanë marrë pjesën më të madhe të fondeve të tyre nga financuesit bilateralë, veçanërisht Suedia.

Grafiku 37. Grantet nga fondet e grave sipas vendit, në mijëra



Disa fonde ndërkombëtare të grave mbështetën OSHCG-të në rajon (shih Kutinë 6). Fondet e grave të vendosura në BP përfshijnë Fondet e grave të **Kosovës** të RrGK-së, Fondin e Grave për Rindërtim në **Serbi** dhe Fondacionin Lara, Fondacionin CURE dhe Fondacionin për fuqizimin e grave në **BeH**. Ashtu si financuesit e tjerë, fondet e grave kryesisht ofrojnë mbështetjen më të madhe financiare për të luftuar dhunën me bazë gjinore (Grafiku 38). Në mënyrë unike, ata kishin tendencë të ofrojnë më shumë mbështetje të përgjithshme, përfshirë fonde thelbësore për OSHCG-të, në krahasim me financuesit e tjerë.

Kutia 6. Fondet ndërkombëtare të grave që mbështesin OShCGD-të

- ✓ Astraea
- ✓ cfd the feminist Peace Organisation
- ✓ Ecumenical Women's Fund
- ✓ Feminist Trust Fund
- ✓ *Filia die Frauenstiftung* Foundation
- ✓ Frida Young Feminists Fund
- ✓ Global Fund for Women
- ✓ Heart and Hand Foundation
- ✓ International Network of Women's Funds Prospera
- ✓ The Kvinna till Kvinna Foundation
- ✓ Mama Cash
- ✓ Mediterranean Women's Fund
- ✓ Millby Foundation
- ✓ Oak Foundation
- ✓ Operation 1325
- ✓ Philanthropy Advancing Women's Human Rights
- ✓ Rita Fund
- ✓ Urgent Action Fund

Historikisht, fondet e grave janë parë si partnerë të besueshëm dhe të respektuar për OSHCG-të, duke pasur parasysh fleksibilitetin dhe jetëgjatësinë e tyre në mbështetjen e lëvizjes së grave.[23] Fondet e grave shpesh janë të përkushtuara për të mbështetur popullatën e margjinalizuar dhe të nënpërfaqësuar që përndryshe do të kishin mungesë financimi.[24] Ato shpesh i japin përparësi strategjive që rrisin shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimit në mes të OSHCG-ve, duke kontribuar drejtpërdrejt në "ndërtimin e lëvizjes".[25] Meqenëse fondet e grave zakonisht ndajnë të njëjtin vizion si përfituesit e tyre, ato priren që t'u përshtaten nevojave të përfituesve.[26] Ky fleksibilitet u lejon atyre të financojnë si projekte të vogla ashtu edhe ato të mëdha që u mundësojnë pranuesve të përcaktojnë prioritetet e tyre.[27] Për më tepër, ata mund të veprojnë si një urë ndërmjet OSHCG-ve më të vogla dhe financuesve më të mëdhenj, duke mbështetur qasjen në burime për grupet më të vogla, komunikimin e nevojave financuesve më të mëdhenj dhe transparencën më të madhe në financim.[28] Në këtë kuptim, fondet e grave mund të luajnë rolin e "ambasadorit" për OSHCG-të që jo gjithmonë kanë qasje tek financuesit të shkallës më të gjerë.[29] Kjo gjithashtu mund të kontribuojë në qasje më të madhe në burime për OSHCG-të.

Grafiku 38. Fushat tematike të financuara nga fondet e grave



[23] Dallas Women's Foundation with Chambers Family Fund, *Creating a Women's Fund: A Philanthropic Strategy for Women and Girls, 2nd Edition*, Women's Funding Network, 2017.
[24] AWID, *Watering the Leaves, Starving the Roots*, faqe 88.
[25] Po aty, faqe 90.
[26] Intervista, OSHCG, BeH, 2019.
[27] Intervista, OSHCG, Serbi, 2019.
[28] Intervistat, OSHCG-të, Kosovë, Maqedonia e Veriut, 2019.
[29] AWID, *Watering the Leaves, Starving the Roots*, faqe 88.

Studim rasti: Fondacioni Kvinna till Kvinna

Fondacioni Kvinna till Kvinna është organizatë joqeveritare suedeze, e kategorizuar si fond i grave në këtë hulumtim.[30] Vizioni i tij është "një botë e paqes, e bazuar në barazinë gjinore dhe demokracinë, ku konfliktet zgjidhen pa dhunë, një botë në të cilën respektohen të drejtat e njeriut dhe të gjithë mund të ndjehen të sigurt dhe një botë në të cilën gratë kanë ndikim në vendimmarrje dhe marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë efektive në zhvillimin e shoqërisë".[31] Që nga viti 1993, Kvinna till Kvinna ka punuar për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e grave në më shumë se 20 vende. "Lindja" e tij si fondacion shoqëroi ngritjen e shumë OSHCG-në BP, pasi Kvinna till Kvinna mbështeti aktivistë të prekur nga rënia e ish-Jugosllavisë dhe luftërat në BP. Që atëherë, puna e saj është zgjeruar në Lindjen e Mesme, Kaukazin Jugor dhe në Afrikë.

> **Të drejtat e grave nuk mund të sigurohen pa lëvizjen e grave. Është e pamundur ta bësh këtë sot në Ballkanin Perëndimor.**
>
> Përfaqësuese e Fondacioni Kvinna till Kvinna

Kvinna till Kvinna bazon punën e saj në besimin e pranuar institucionalisht se aktivistët për të drejtat e grave kanë njohuri më të mira për prioritetet, nevojat dhe sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat që jetojnë në vendet e tyre.[32] Prandaj, Kvinna till Kvinna mbështet grupet dhe lëvizjet për të drejtat e grave sepse ato janë "absolutisht thelbësore dhe të rëndësishme" për të sjellë ndryshimin shoqëror, përkatësisht barazinë gjinore.[33] "I gjithë përparimi sa i përket mbrojtjes, parandalimit, legjislacionit dhe ndryshimit të qëndrimit mund të akreditohet në organizatat e grave. Legjislacioni nuk do të kishte ekzistuar pa organizatat e grave", thanë përfaqësuesit e Kvinna till Kvinna. Kvinna till Kvinna shpërndan fonde direkt partnerit të saj OSHCG-të, "duke i mundësuar atyre të bëjnë ndryshimet që duhet të bëjnë". Në praktikë, kjo nënkupton që organizatat partnere identifikojnë agjendën e tyre, përfshirë problemet dhe zgjidhjet e mundshme.[34]



Grafiku 39. Fondet e Fondacionit Kvinna till Kvinna të shpërndara në BP, në milionë

Në mes të vitit 2015 dhe 2019, Kvinna till Kvinna shpenzoi afro 8.2 milionë € në BP përmes kombinimit të programeve vendore dhe rajonale. Siç ilustron Grafiku 39, fondet janë rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2015, Përveç një rënie të vogël 2018. Të gjitha fondet e Kvinna till Kvinna fokusohen në avancimin e paqes, barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Fushat me përparësi të Kvinna till Kvinna përfshijnë adresimin e dhunës me bazë gjinore; gratë, paqen dhe sigurinë; dhe pjesëmarrjen e barabartë.

---

[30] Kvinna till Kvinna do të thotë "Grua për gruan" në Suedisht. Fondacioni gjithashtu identifikohet si një OJQN, por u kategorizua si fond i grave për qëllimin e këtij hulumtimi duke marrë parasysh dhënien e saj të konsiderueshme në BFAQE

[31] Kvinna till Kvinna, faqja e internetit, "Kvinna till Kvinna: Who We Are".

[32] Po aty

[33] Intervista, 2019.

[34] Rönngren, J. for Kvinna till Kvinna, *Making Achievements Last: Learning from Exit Experiences*, 2011.

Në mes të vitit 2015 dhe 2019, mbështetja e drejtpërdrejtë për partnerët e saj në rajon mbërrin më shumë se 2.9 milionë €, që përbën përafërsisht 79% të fondeve të shpërndara. Fondet e mbetura gjithashtu mbështetën OSHCG-të duke siguruar mundësi për rrjetëzim dhe ngritjen e kapaciteteve, si dhe duke mbështetur udhëtimet vjetore për avokim në Bruksel. Në shumicën e



vendeve, fondet e shpërndara partnerëve të Kvinna till Kvinna më shumë se u dyfishuan në mes të vitit 2015 dhe 2016 (Grafiku 40).

Kvinna till Kvinna ka një qasje disi unike në atë që nuk ka thirje të hapura për propozime, por përkundrazi zgjedh me kujdes partnerët e saj, duke siguruar mbështetje direkte më shumë se 130 organizatave partnere.[35] Aktivistët vërejtën se kjo qasje partneriteti kontribuon në solidaret brenda lëvizjes së grave sesa në konkurrencë për burimet, që mund të dëmtojë ngritjen e lëvizjes dhe progresin drejt qëllimeve të përbashkëta.[36] Pas vlerësimit, grantet zgjasin prej një deri në katër vjet, shpesh me grante pasuese për të njëjtat organizata. Kështu, disa OSHCG në BP kanë marrë mbështetje për më shumë se 25 vite. OSHCG-të treguan se kjo qasje e partneriteti afatgjatë u lejon atyre të punojnë për të bërë ndryshime afatgjate. Kvinna till Kvinna ka vërejtur që në mënyrë që OSHCG-të të zhvillojnë kapacitetet dhe identitetin e tyre, ato kanë nevojë për fonde të qëndrueshme, afatgjate.[37] Në përgjithësi, disa OSHCG në të gjithë rajonin theksuan qasjen e Kvinna till Kvinna për të mbështetur dhe besuar drejtpërdrejtë OSHCG-të si një praktikë e mirë. Vlerësimi i jashtëm i Keystone dhe vlerësimi i performancës së partneritetit në vitin 2016 gjithashtu rendit Kvinna till Kvinna në vendin e katërt nga 76 OJQN dhe financues të krahasueshëm për sa i përket "kënaqësisë së përgjithshme".[38] Përfaqësuesit e Kvinna till Kvinna theksuan se financimi thelbësor, afatgjatë, i parashikueshëm dhe financimi institucional është nevoja më e madhe e OSHCG-ve në tërë BP dhe ata përpiqen t'i përgjigjen kësaj nevoje përmes mbështetjes direkte.[39]

Edhe pse pak financues të intervistuar i dinin planet e tyre të ardhshme për rajonin, përfaqësueset e Kvinna till Kvinna thanë që ato planifikojnë të vazhdojnë të mbështesin rreth 40 organizata të tyre aktuale partnere në BP, duke u fokusuar në fusha të ngjashme tematike.[40] Ato planifikojnë të mbështesin organizata shtesë me zhvillim të kapaciteteve, mundësistë e rrjetëzimit dhe mbështetjen politike dhe avokuese.

---

[35] Kvinna till Kvinna gjithashtu ofron disa marrëveshje shërbimesh më të vogla dhe të shkurta. Faqja e internetit e Kvinna till Kvinna, "What We Do", qasur në prill 2020.
[36] RrGK Intervistat, 2019.
[37] Rönngren, J., 2011.
[38] Sondazhet për performancën, Sondazhet e Partneritetit për Zhvillim, "Partner Feed-back Report: Kvinna till Kvinna", 2016.
[39] Intervista, 2019.
[40] Po aty

Studim rasti: Fondi i Grave të Kosovës

RrGK është rrjet me 161 OSHCG anëtare të ndryshme në të gjithë Kosovën. Misioni i RrGK është të "mbështesë, mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave". Në përgjigje ndaj zhvendosjes së prioriteteve të donatorëve, tkurrjes së fondeve dhe procedurave të ndërlikuara të aplikimit për OSHCG-të lokale,[41] RrGK themeloi Fondin e Grave të Kosovës (FGK) në vitin 2012, fillimisht i mbështetur nga Fondacioni Kvinna till Kvinna. FGK siguron grante të vogla për OSHCG-të në Kosovë, deri në €5,000 për grant, €8,000 për partneritete ndërmjet OSHCG-ve, dhe më shumë kur këtë e lejon finacimi. Grantet u mundësojnë anëtareve të RrGK të bashkëpunojnë drejt qëllimeve të përbashkëta strategjike të RrGK-së, të identifikuar nga anëtaret e rrjetit.[42] Në vitin 2019, filloi shpërndarjen e granteve për OShC-të edhe në BP.

Një benefit i shtuar i Fondit është që stafi i tij ofron mundësi të vazhdueshme për zhvillim të kapaciteteve, përfshirë mbështetje aplikantëve për grante në hartimin e propozimeve, si dhe për marrësit e granteve, bazuar në nevojat e identifikuara. Kjo përfshin krijimin e kapaciteteve në menaxhimin e projekteve, menaxhimin organizativ dhe financiar, si avokimin. Procedura e aplikimit është e thjeshtë, që mundëson qasje për OSHCG më të vogla. Ndërkohë, ajo ofron mundësi për OSHCG-të të mësojnë rreth proceseve të aplikimit në mënyrë që ata të mund t'i përdorin aftësitë e tilla gjatë aplikimit tek financuesit e tjerë në të ardhmen. Aplikantët e pasuksesshëm marrin letra të hollësishme të përgjigjes negative nga Komisioni i Shqyrtimit të Graneteve të FGK-së, ku shpjegohet pse aplikacioni i tyre nuk u zgjodh. Stafi i RrGK-së siguron mentorim pasues për t'i ndihmuar të mësojnë, në mënyrë që të aplikojnë përsëri në të ardhmen. Qasja e RrGK- së për grantet e shoqëruar me ndërtimin e përshtatur të kapaciteteve është njohur si një praktikë e mirë nga përfituesit e saj, por edhe nga Qendra e KE e Ekspertizës Tematike për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.[43]

Që nga viti 2012, FGK ka ndarë 197 grante për 107 OSHCG, në vlerë prej €1,011,387. OSHCG-të kanë pasur 21,028 përfitues direkt, me disa nisma në vazhdim. Përveç kësaj, afro 200,000€ janë shpërndarë vetëm në vitin 2020. Shuma totale e shpërndarë luhatet çdo vit (Grafiku 41), pas RrGK duhet të sigurojë fonde nga financuesit e tjerë. Deri më tani,

Grafiku 41. Gjithsej grante të FGK në mijëra



[41] Farnsworth, N. dhe Gashi, E., 2013.
[42] RrGK, *Strategjia e RrGK-së 2019-2022*, 2018.
[43] RrGK, "Fondi shembullor i Grave të Kosovës ofron informata në nivel ndërkombëtar për programet e BE-së për dhënie të granteve ", faqja e internetit e RrGK-së, 2016.

financuesit më të mëdhenj kanë qenë BE, ADA dhe UN Women. Të gjitha fondet e shpërndara gjatë kësaj periudhe u shkuan OSHCG-ve. Pasi grantet janë shumë-dimensionale, përfshirë komponentët për ndëritimin e kapaciteteve dhe fuqizimin e pjesëmarrjes politike, bazuar në kërkesat e organizatave, shumica e fondeve kanë mbështetur fuqizimin ekonomik të grave, në vlerë të përgjithshme prej 173,000€ (34%) ndërmjet 2014 dhe 2019 (Grafiku 42).[44]

Grafiku 42. Grantet e FGK sipas sektorit dhe vitit në mijëra



[44] Shih RrGK, *Grante të vogla, ndryshime të mëdha* , dhe *Të drejtat e grave janë të drejta e njeriut : Grante të vogla, ndryshime të mëdha 2016-2017*.

Studim rasti: Fondi i Grave për Rindërtim, Serbi

Fondi i Grave për Rindër (FGR), me seli në Beograd, Serbi, mbështet aktivizmin feminist përmes katër modaliteteve të granteve.[45] Kjo përfshin 1) Grante për Mbështetje të Përgjithshme, të cilët ofrojnë fleksibilitet dhe liri për grupet e grave dhe aktivistët; 2) Žarana Papić bursa, për akademikët dhe aktivistët për të përmirësuar shkëmbimin intelektual që ka të bëjë me feminizmin, çështjet e grave dhe gjininë; 3) Grante të Fokusit të Veçantë për çështje specifike, sic është aktivizmi i grave rome dhe dhuna me bazë gjinore; dhe 4) Grante për reagim të shpejtë, që janë grante të vogla, urgjente të procesuara brenda 72 orëve. FGR ofron kategorinë e fundit të granteve në situata të paparashikueshme afatshkurta që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut, dhunën dhe diskriminimin e grave.[46] Të gjitha fondet e FGR fokusohen në avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Shumica e fondeve shkojnë tek OSHCG-të, megjithëse aktivistët individualë të të drejtave të grave përfitojnë gjithashtu, siç është nga Grantet për reagim të shpejtë ose nga bursat akademike. Nga viti 2014 deri në 2018, FGR ndanë një shumë totale prej €423,164. Që nga viti 2015, fondet që ata kanë shpërndarë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme (Grafiku 43).

RWF janë ekspertë të aktivizmit të grave, lëvizjes së grave dhe mënyrës së ndërtimit të lëvizjes së grave. Kjo është e rëndësishme sepse për të ndryshuar një shoqëri patriarkale, gratë duhet të mbështeten e posaçërisht OSHCG-të. Ekspertizë specifike kurrë nuk mund të gjendet në

Financues/e Ndërkombëtar

Grafiku 43. Grantet RWF të ndara, në mijëra



OJQ-të lokale

OSHCG-të në BP morën fonde nga disa OJQ-të lokale,[47] përfshirë OSHCG-të e tjera. Shuma e granteve sillej mesatarisht 10,001 € për secilin. Rrallë ishin OJQ-të lokale burim fillestar i financimit; fondet e tyre kanë mundur të përcillen/gjurmohen nga burimet e tjera, kryesisht nga financuesit multilateralë dhe atë bilateralë. Pra, disa nga fondet e paraqitura këtu, tashmë mund të jenë pasqyruar edhe në seksionet e mëparshme. Ata janë shqyrtuar veçmas për të reflektuar rolin e OJQ-ve lokale si financues.[48]

Gjetjet sugjerojnë që ndarja e konsiderueshme e burimeve ka ndodhur ndërmjet OSHCG-ve në vendet e BP. Nga OSHCG-të e intervistuara, 25 (10%) deklaruan se ato kishin ofruar nëngrante organizatave të tjera.

[45] Fondi i Grave për Rindërtim, faqja e internetit, "RWFund Programs", qasur në prill 2020.
[46] Po aty
[47] Termi OJQ përdoret në referencë të OJQ-ve lokale të diskutuara këtu si financues për të lehtësuar leximin. Asnjë diferencim tjetër nuk është bërë midis termave OShC dhe OJQ-të po në këtë botim.
[48] Për një listë të OJQ-ve lokale nga të cilat OSHCG-të raportuan të kenë marrë fonde, shih Shtojcën 4.

Relativisht më shumë OSHCG në **Kosovë** (7) dhe **BeH** (7) ofronin nën-grante sesa OSHCG-të e intervistuara në vendet e tjera (Grafiku 44).

Në **BeH**, OSHCG-të duket se kishin marrë më shumë fonde nga OJQ-të lokale se sa OSHCG-të në vendet e tjera (Grafiku 45). Financimi nga OJQ-të lokale ka pasur luhatje në shumicën e vendeve, Përveç në **Serbi** dhe **Mal të Zi** ku fondet, megjithëse minimale, u rritën pak me kalimin e kohës. Duke pasur parasysh shumën modeste, të pasigurt dhe të paqëndrueshme të fondeve të dhëna nga OJQ-të lokale, OSHCG-të nuk mund të mbështeten në to si një burim i qëndrueshëm i financimit.



Studim rasti: Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare

Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare (AWEN) është një rrjet i OShC me seli në Tiranë me dhjetë organizata anëtare në të gjithë Shqipërinë. Misioni i AWEN është që të "punojmë së bashku për të fuqizuar vajzat dhe gratë shoqërisht, ekonomikisht dhe politikisht për të marrë pjesë dhe realizuar të drejtat e tyre në të gjithë Shqipërinë".[49] AWEN i arrin qëllimet e veta përmes avokimit të përbashkët, partneriteteve, hulumtimit, zhvillimit të kapaciteteve të anëtarëve të tij, vetëdijesimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve të bartësve të detyrave për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore, shërbimet e specializuara të mbështetjes dhe fuqizimin e grave dhe vajzave. I themeluar në 2011, puna e AWEN fokusohet kryesisht në adresimin e dhunës me bazë gjinore.

> **Të qenit pjesë e AWEN na ka mundësuar që të jemi më të fortë dhe për këtë arsye edhe aktivitetet tona të lobimit dhe avokimit janë më të forta.**
>
> OSHCG, anëtare e AWEN

AWEN jep fonde kryesisht për anëtarët e tij të OSHCG dhe ndonjëherë për OSHCG-të e tjera të vogla. Të gjitha fondet fokusohen në avancimin e barazisë gjinore. Gjithsej, AWEN ka siguruar €987,072 OSHCG-ve në mes të vitit 2014 dhe 2019. Kjo ka përfshirë financim shumëvjeçar. Siç ilustron Grafiku 46, AWEN ende merr disa fonde nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, që burojnë nga Sida, për nismat rajonale avokuese që kanë të bëjnë me procesin e anëtarësimit në BE.



Fondacioni Kvinna till Kvinna këshilloi anëtarët e AWEN për ndërmarrjen hapave drejt krijimit të AWEN përmes mbështetjes afatgjate në rrjetëzim dhe ndërtimin e kapaciteteve. Kur Kvinna till Kvinna filloi të konsiderojnte ndërprerjen e mbështetjes financiare të saj për Shqipërinë, ata mbështeten AWEN në marrjen përsipër të rolit të tyre në shpërndarjen e fondeve OSHCG-ve, si një strategji e qëndrueshme dalëse.[50] Pas një vlerësimi të kapaciteteve dhe analize të thellë, Sida në Shqipëri filloi financimin e AWEN drejtpërsëdrejti, me fonde të ndara midis anëtarëve AWEN. Financimi direkt nga Sida i ka mundësuar AWEN që të rrisë shumat e granteve për anëtarët e tij. Ai gjithashtu ka kontribuar në stabilitet, me kalimin e

[49] Për deklaratën e plotë të misionit, shih: faqen e internetit të AWEN, "Historiku", qasur në prill 2020. Anëtaret e saj janë: 1) Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë; 2) Shoqata e grave dhe vajzave me probleme sociale, Durrës; 3) Unë, Gruaja, Pogradec; 4) Grua Gruas, Shkoder; 5) Agritra Vizioni, Peshkopi; 6) Forumi i Gruas, Elbasan; 7) Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Vlorë; 8) Shoqata Jona, Sarandë; 9) Linja e Këshillimit për Vajza dhe Gra, Tiranë; dhe 10) Qendra për Iniciativa Qytetare, Tiranë.

[50] Korrespondenca me financuesin dhe OSHCG, Shqipëri, 2020.

kohës. Kjo është e rëndësishme, duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të punës së anëtarëve, pasi shumë prej tyre janë ofrues të shërbimeve të përfitimit publik për personat që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore. Kjo gjithashtu ka mbështetur rritjen afatgjate të anëtarëve të AWEN sa i përket kapaciteteve organizative dhe financiare.

AWEN shërben kështu si një shembull interesant se si financuesit mund të ofrojnë donacione më të mëdha, të drejtpërdrejta OSHCG-ve për shpërndarje të mëtejshme ndërmjet OSHCG-ve të tjera. Një qasje e tillë që forcon solidaritetin mes OSHCG-ve, sesa konkurrencë, mund të kontribuojë në forcimin e lëvizjes së grave.

Sektori fitimprurës

Siç përshkruhet këtu, sektori fitimprurës përfshin bizneset që japin donacione direkt OSHCG-ve. Ai nuk përfshin fondacionet private,[51] të përshkruar më herët, megjithëse disa fondacione private morën fondet e tyre nga sektori fitimprurës (p.sh., Fondacioni IKEA ose Fondacioni Bayern). Më pak se 1% e financimit që OSHCG-të në rajon raportuan t'i kenë marrë, buronte nga sektori fitimprurës, që arrin shumën totale prej €148,465 në mes të vitit 2014 dhe 2019. Ndërkohë, OSHCG-të morën €263,579 nga sektori fitimprurës kur konsideruan fondet e shpërndara përmes akterëve të sektorit fitimprurës nga financuesit e tjerë (ilustruar në Grafikun 47). Dallimi midis fondeve që *burojnë* nga sektori fitimprurës (p.sh., donacionet nga bizneset lokale) dhe fondeve që kalojnë *përmes* sektorit fitimprurës mund t'i atribuohen kryesisht kontraktuesve që shpërndajnë fonde bilaterale. Për shembull, në Kosovë, OSHCG-të morën fonde nga kompania private Chemonics, e kontraktuar nga USAID, që paraqet rritje të fondeve të dhëna OSHCG-ve në Kosovë në vitin 2016 (shih Grafikun 47). Edhe pse fondet nga sektori fitimprurës mbeten minimale në të gjitha vendet, OSHCG-të në **Kosovë** (106,680 €), **Shqipëri** (57,400 €) dhe **Maqedoninë e Veriut** (52,597 €) duket se kanë marrë më shumë fonde nga sektori fitimprurës sesa OSHCG-të në vendet e tjera. Financimi nga ky sektor ka qenë disi jokonsistent nga viti në vit.

Financuesit fitimprurës nga të cilët OSHCG-të thanë se kishin marrë mbështetje në para të gatshme ishin BH Telekom dhe Lush në **BeH**; TEB banka, Kompania e Sigurimeve Dukagjini dhe KEDS kompania e energjisë elektrike në **Kosovë**; Hypo Alpe Adria Bank në **Mal të Zi**; Consulting DOO dhe Triglav Insurance në **Maqedoninë e Veriut**; dhe Instituti i transportit CIP, dyqanet GOMEX dhe industria e naftës në **Serbi**.

[51] Kjo është në një farë mase e vërejtshme për ekipin hulumtues, bazuar në hulumtimin në internet.



Individët, anëtarët dhe burimet e vetë-gjeneruara

OSHCG-të në BP kanë përdorur teknika të ndryshme për të gjeneruar të hyra nga burime tjera, duke përfshirë mbledhjen e fondeve nga individët, futjen e tarifave të anëtarësimit, mbështetja masive nga komuniteti (*crowd-sourcing*), dhënien përmes internetit, ofrimin e shërbimeve dhe organizimin e ngjarjeve ose aktiviteteve për mbledhjen e fondeve. Për shembull, në **BeH**, OSHCG-të kanë marrë donacione nga grupet joformale në Gjermani dhe Zvicër. OSHCG-të në **Serbi** kanë përdorur mbështetjen masive (*crowd-sourcing)*, të tilla si përmes *Donacije.rs* dhe Globalgiving. OSHCG-të në **Kosovë,** në mënyrë të ngjashme, kanë përdorur Network for Good, përmes një sponsori fiskal. Ngjarjet për mbledhjen e fondeve në të gjithë rajonin kanë gjeneruar të ardhura për aktivitete të ndryshme, veçanërisht ato më pak të financuara nga donatorë tradicionalë ose që kërkojnë fonde urgjente jashtë cikleve të rregullta të financimit të financuesve.

OSHCG-të raportuan emrat e më shumë se 36 individëve që i kishin mbështetur ato, dhe dhuratat individuale silleshin nga një euro deri në €21,500. Megjithatë, fondet nga individët dhe tarifat e anëtarësimit të kombinuara përbënin shumë të vogël 0.3% e të gjitha fondeve të gjeneruara nga viti 2015 deri në 2019, që kapin vlerën prej përafërsisht 188,511 €. Literatura ekzistuese sugjeron që kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të kulturës së dobët të lartpërmendur të dhënies në BP.[52] Mjedisi i papërshtatshëm ligjor dhe mungesa e stimujve tatimor gjithashtu pengojnë dhënien.[53] Hulumtimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me këtë temë dhe mundësitë për gjenerim të burimeve shtesë për OSHCG-të.

[52] Shih pjesën për Trendet globlale të financimit, veçanërisht Charities Aid Foundation, *World Giving Index*, 2019.
[53] Shih pjesën për Një mjedis rregulator që mundëson dhënie filantropike .

OSHCG-të në **Kosovë** dhe **BeH** mblodhën më shumë nga donatorët individualë dhe anëtarët sesa OSHCG-të në vendet e tjera. Ndërsa ky financim është zvogëluar në BeH, në Kosovë ai është rritur me kalimin e kohës (Grafiku 48). Që nga viti 2016, fondet nga individët gjithashtu janë rritur pak në **Serbi**. Ndjeshëm më shumë fonde vinin nga donacionet individuale se sa nga anëtarët në këto vende. OSHCG-të në vendet e tjera të BP nuk raportuan të kenë marrë ndonjë donacion financiar nga individët ose anëtarët nga viti 2014 deri në 2018.[54]



Megjithëse, thuajse nuk përmendet, disa OSHCG-të dhanë shembuj të ofrimit të shërbimeve për të gjeneruar fonde. Në **Shqipëri**, **Kosovë** dhe **Maqedoninë e Veriut** OSHCG-të raportuan kryerjen e hulumtimeve dhe sondazheve të opinionit publik. Në **Kosovë** dhe **Mal të Zi**, ato ofruan shërbime këshillimi që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. OSHCG-të thanë se kontratat të tilla të shërbimit mund të ndihmojnë në gjenerimin e të hyrave shtesë, më fleksibile. Në **Shqipëri**, një OSHCG ka shfrytëzuar një restorant lokal për të gjeneruar fonde. Në **Kosovë**, një strehimore për gra shiti produktet e bëra nga gratë atje për të mbuluar shpenzimet, veçanërisht në situata emergjente. Një organizatë tjetër në BeH tha se ata gjeneruan fonde përmes sipërmarrjes sociale dhe "Diplomatski Bazaar", një bazaar në të cilën diplomatët bëjnë ushqim dhe shesin produkte të punuara me dorë të grave. Edhe pse fondet e tilla kanë ndihmuar OSHCG-të të plotësojnë boshllëqet në fonde, ato kanë qenë të pamjaftueshme për t'i financuar plotësisht organizatat. Për më tepër, disa aktivistë shprehën shqetësimin se ofrimi i shërbimeve mund të largojë energjinë dhe vëmendjen nga prioritetet e tyre strategjike organizative.[55]

[54] Të dhënat nga 2019 ishin shumë jo të plota për t'u përfshirë.
[55] Intervistat, OSHCG-të, 2019.

Preferencat e OSHCG-ve sa i përket financuesve

Kur u pyetën se cilët financues preferojnë dhe pse, OSHCG-të në të gjitha vendet tentonin të mos kenë preferenca të forta në lidhje me atë se kush i financon ato, për sa kohë që financuesit mbështesin qëllimet e tyre. Sidoqoftë, siç ilustron Grafiku 49, një përqindje pak më e lartë e OSHCG-ve deklaruan se do të preferonin të marrin fonde nga financuesit multilateralë (44%), pasuar nga ata bilateralë (41%), fondet e grave (34%), qeveria lokale (28%) dhe qeveritë kombëtare (28%). Më pak preferonin financuesit fitimprurës (14%) ose donatorët individualë (13%).[56] OSHCG-të kanë mundur të zgjedhin përgjigje të shumëfishta, kështu që kjo dhe Grafikët që vijojnë nuk përbëjnë 100%-shin.

Grafiku 49. Nga cili lloj donatorësh preferoni të merrni fonde?



Sipas vendit, një përqindje më e lartë e OSHCG-ve të intervistuara preferuan të marrin fonde nga financuesit multilateralë në **Mal të Zi** (63%) dhe **Maqedoninë e Veriut** (56%) sesa në vendet e tjera, edhe pse kjo ndoshta i atribuohet pjesërisht madhësisë më të vogël të mostrës në këto vende (Grafiku 50). Disa OSHCG-të thanë që ato preferojnë mbështetje multilaterale sepse financuesit multilateralë ofrojnë mbështetje të "të rregullueshme, të disponueshme" dhe të ndjeshme. Gjithashtu, ata ofrojnë grante më afatgjata, thanë OSHCG-të.

Grafiku 50. Numri, përqindja e OShCG-ve që preferojnë financuesit multilateralë, sipas vendit



[56] Për shkak të një lëshimi, përgjigjet me zgjedhje të shumëfishta nuk përfshinin fondacionet. Sidoqoftë, katër OSHCG shkruan fondacione në kategorinë "tjetër". Duke pasur parasysh këtë numër të vogël përgjigjesh, ai nuk paraqitet në grafik.

Krahasuar me vendet e tjera, një përqindje më e lartë e OSHCG-ve preferojnë financuesit bilateralë në **Mal të Zi** (88%), **Maqedoninë e Veriut** (56%) dhe **Shqipëri** (52%) (Grafiku 51). Ata, ndër arsyet për preferencën që kanë ndaj financuesve bilateralë, renditen të kuptuarit e nevojave të OSHCG, njohjen e punës së tyre dhe kritere më të thjeshta, më fleksibile të aplikimit. Këta financues janë gjithashtu "më të ndjeshëm, kanë strategji konkrete, janë më të përgjegjshëm dhe mbulojnë të gjitha kostot", tha një përfaqësues i OSHCG.[57]



Vetëm një e treta e të anketuarve "preferuan" të marrin fonde nga fondet e grave. Edhe pse kështu, me një pyetje të ndarë, 84% mendojnë se fondet e grave janë mekanizëm i mirë për shpërndarjen e fondeve tek to OSHCG-të, megjithëse 16% nuk mendojnë ashtu. Një përqindje më e lartë mendon se fondet e grave janë mekanizëm i mirë në **Serbi** (97%) dhe **Kosovë** (93%), pasuar nga **Mali i Zi** (88%), **Maqedonia e Veriut** (81%) dhe **BeH** (69%) (shih Grafikun 52). Siç tregoi më parë Grafiku 37, fondet e grave kanë shpërndarë më shumë burime në BeH dhe Serbi sesa në vendet e tjera. Sidoqoftë, duke pasur parasysh ndryshimet në pikëpamjet në BeH dhe Serbi, shuma e fondeve të shpërndara nuk indikon domosdoshmërish nëse OSHCG-preferojnë të marrin mbështetje nga fondet e grave.



Relativisht më pak OSHCG në **Shqipëri** menduan se fondet e grave ishin një mekanizëm i mirë (48%). Disa thanë që nuk e shohin vlerën e shtuar të donatorëve ndërmjetës, duke thënë se kjo vetëm shton procedura burokratike. Disa OSHCG në **Shqipëri** dhe **BeH** shprehen shqetësime për fondet e grave, duke thënë se ato kishin: procedura burokratike, favorizim të mundshëm të OSHCG-ve në kryeqytetet, vëmendje të pamjaftueshme ndaj OSHCG-ve më të cenueshme dhe burime të pamjaftueshme të qëndrueshme për nën-grante.[58] Një OSHCG në **Serbi** deklaroi se fondet e grave duhet të punojnë duke u "bazuar në parimet e përfshirjes, barazisë dhe pa u dhënë përparësi rajoneve, organizatave, udhëheqësve të caktuar", duke sugjeruar se fondet e grave në Serbi mund të përmirësojnë përfshirjen e tyre.[59]

Disa vunë re se efektiviteti i fondeve të grave varej nga konteksti i vendit dhe se si fondet e grave merren me komunitetet e tyre. OSHCG-të cituan ideologjitë e përbashkëta,

[57] Intervista, OSHCG, Maqedonia e Veriut, 2019.
[58] Intervistat, OSHCG-të, Shqipëri, BeH, 2019.
[59] Intervista, OSHCG, Serbi, 2019.

transparencën, më shumë qasje në fonde më të mëdha, përvojën, vetëdijesimin dhe të kuptuarit e nevojave dhe prioriteteve të OSHCG-ve si elemente pozitive të fondeve të grave. Sic tha një OSHCG në BeH, "Ne kemi përvoja pozitive me to", dhe "ato i dinë nevojat".[60] Fondet e grave gjithashtu u përshtaten nevojave të OSHCG-ve, veçanërisht kur ofrojnë fonde për organizata më të vogla që nuk kanë kapacitete për të aplikuar te financuesit më të mëdhenj, thanë të anketuarit. Për shembull, OSHCG-të thanë se Fondi i Grave të Kosovës shërben si një "urë" në mes të OSHCG-ve të vogla dhe financuesve më të mëdhenj.[61] Derisa OSHCG-të më të mëdha mund të jenë në gjendje të kenë financim të drejtpërdrejtë, fondet e grave mund të jenë të dobishme për të arritur tek OSHCG-të që nuk e flasin gjuhën angleze dhe nuk mund të menaxhojnë fonde më të mëdha. Ndoshta mendimet e ndryshme mund t'i atribuohen pjesërisht përvojave individuale të OSHCG-ve me fondet e grave.

Rrjetet e grave gjithashtu kanë shpërndarë fonde më të mëdha disa OSHCG-ve, të tilla si AWEN, RrGK dhe Rrjeti kundër dhunës ndaj grave në Serbi.[62] Shumica e OSHCG-ve të intervistuara mendon se rrjetet e grave janë një mekanizëm i mirë për shpërndarjen e fondeve tek anëtarët e tyre (76%). Megjithatë, 24% thanë se nuk mendojnë se rrjetet janë mekanizëm i mirë për shpërndarjen e fondeve. Siç ilustron Grafiku 53, përqindja më e lartë e OSHCG-ve të intervistuara që mendojnë se rrjetet e grave janë mekanizëm i mirë janë në **Kosovë**, pasuar nga **Maqedonia e Veriut**, **Shqipëria**, **Serbia** dhe **Mali i Zi**. Relativisht më pak OSHCG në **BeH** mendonin se rrjetet ishin mekanizëm i mirë (31%). OSHCG-të në BeH thanë se rrjeti ekzistues në BeH është shumë joformal për të shpërndarë fonde. Një OSHCG në Maqedoninë e Veriut tha se qëllimi i rrjeteve duhet të jetë veprim i përbashkët, sesa shpërndarja e fondeve. OSHCG-të shprehën shqetësimin se në disa raste, rrjetet kanë konkurruar me anëtarët e tyre për burim ose nuk kanë përmbushur nevojat e anëtarëve të tyre. Në të kundërtën dhe siç tregohet nga përgjigjet sasiore, OSHCG-të në Kosovë duken të kënaqura me punën e RrGK dhe Fondin e Grave të Kosovës.

Grafiku 53. OShCG-të që mendojnë se rrjetet e grave janë një mekanizëm i mirë për shpërndarjen e fondeve tek OShCG-të



[60] Intervista, OSHCG, BeH, 2019.
[61] Intervista, OSHCG, Kosovë, 2019.
[62] Ndërsa AWEN dhe Rrjeti kundër Dhunës ndaj Grave nuk identifikohen si fonde të grave, RrGK ka një Fond të Grave. gjithashtu u siguron burime direkt anëtareve të saj (jo përmes Fondit të Grave të Kosovës), siç janë kur anëtarët specializohen për të punuar për çështje të veçanta (p.sh. dhuna seksuale ose dhuna në familje). Për më shumë informacion, shikoni studimet e rasteve mbi RRGK në fondet e grave dhe AWEN tek OJQ-të lokale.

Të anketuarit e OSHCG vunë re se rrjetet, si fondet e grave, mund të ofrojnë qasje në fonde për grupe që përndryshe mund të mos kenë një qasje të tillë dhe mund të zvogëlojnë barrierat administrative për financuesit në vend duke marrë përgjegjësinë për menaxhim dhe mbikëqyrjen e nëngranteve. Një benefit i shquar është njohuria e tyre për situatën dhe afërsinë me marrësit e nëngranteve, gjë që kontribuon në efikasitetin dhe efektivitetin. Rrjetet e grave arrijnë tek grupet e synuara në nivel lokal dhe në mënyrë adekuate plotësojnë nevojat specifike, duke i bërë ato avokues të mirë për OSHCG-të më të vogla dhe në thelb më të forta se organizatat individuale.[63] Ato gjithashtu ofrojnë zhvillim unik, të përshtatur të kapaciteteve.[64] Bashkëpunimi i fortë mes grupeve të grave përmes rrjeteve mund të krijojë më shumë mundësi për projekte dhe fonde. Për shembull, RrGK ka një strategji të përbashkët të krijuar nga anëtaret e saj dhe nëngrantet u mundëson anëtareve të bashkëpunojnë për të zbatuar një strategji më të gjerë, të përbashkët.[65] Posa të maturohet një rrjet dhe sigurojë bashkëpunim të ndërsjellë mes anëtareve dhe financuesve të tij si dhe të pranojë burime të besueshme, ai mund të bëhet burim i qëndrueshëm i financimit, thanë OSHCG-të.[66]

RrGK-ja është e mirëinformuar lidhur me thirrjet për projekte. Ato janë të hapura, të kuptueshme dhe të arsyeshme dhe na ndihmojnë të rishikojmë projektet tona

OSHCG, Kosovë

Ata i dinë nevojat e organizatave të grave dhe nevojat e grave në përgjithësi, mund të identifikojnë përparësitë dhe të dinë më mirë se si dhe ku t'i shpërndajnë fondet, gjë që parandalon mbivendosjen.

OSHCG, Maqedoni e Veriut

Do të ishin ideale fondet afatgjata, veçanërisht nga ambasadat dhe qeveria sepse janë më të sigurta.

OSHCG, Kosovë

Një përqindje më e lartë e OSHCG-ve të intervistuara në **Mal të Zi** (50%) sesa në vendet e tjera, preferuan fondet e qeverisë. Përsëri, kjo mund të jetë për shkak të madhësisë së vogël të mostrës (Grafiku 54). OSHCG-të në **Kosovë** dhe **Maqedoninë e Veriut** thanë se ato preferojnë fonde nga qeveria sepse fondet e tilla janë "më të qëndrueshme dhe më të sigurta".[67] Të tjerët thanë në mënyrë të ngjashme që

Grafiku 54. OShCG-të që preferojnë fondet e qeverisë



[63] Intervistat, OSHCG-të, Shqipëri, BeH, 2019.
[64] Intervista, OSHCG, 2019. Për më shumë informacion, shih Studim rasti.
[65] Intervistat, OSHCG-të, Kosovë, 2019. Për më shumë informacion, shih RRGK, *KWN Strategy 2019-2022*, 2018.
[66] Intervistat, OSHCG-të, Mali i Zi, BeH, 2019.
[67] Intervistat, OSHCG-të, Kosovë, Maqedonia e Veriut, 2019.

mbështetja institucionale afatgjate nga një kombinim i qeverive dhe ambasadave të tyre do të ishte ideale.

Relativisht më pak OSHCG preferuan të marrin fonde nga financuesit fitimprurës ose nga mbështetësit individual (Grafiku 55). Ndër ata që i preferuan, arsyeja e dhënë për preferencën ndaj financuesve të tillë ishte mundësia e rritjes së qëndrueshmërisë së organizatave. Duke pasur parasysh mungesën dhe paqëndrueshmërinë e një financimi të tillë, arsyetimi i tillë mund të duket befasues. Në të njëjtën kohë, një interpretim i këtij këndvështrimi mund të jetë që disa, OSHCG mund ta shohin këtë financim si mundësi për të diversifikuar burimet e tyre të financimit, veçanërisht në të ardhmen, e cila mund të kontribuojë në stabilitet dhe qëndrueshmërinë afatgjatë, veçanërisht nëse ka rënie të fondeve të huaja.



Përfundimi: Kush i financon të drejtat e grave në BP?

Në përgjithësi, mjedisi i financimit në BP mbetet, sipas fjalëve të AWID, "i dobët, i shtrembëruar dhe i fragmentuar".[68] Fakti që disa financues kanë politikat, strategjitë dhe kornizat e tyre kohore për financim, kontribuon në këtë fragmentim dhe minon koordinimin, pasi financuesit rrallë mund ose do të mund të përshtatin politikat e tyre të financimit për t'i përafruar me ato të financuesve të tjerë. Pjesa më e madhe e fondeve për OSHCG-të në BP nga viti 2014 deri në mesin e vitit 2019 rrjedhin nga financuesit multilateralë dhe bilateralë, shpesh duke kaluar përmes financuesve të tjerë multilateralë, fondet e grave, fondacionet, OJQN-të ose organizatat lokale. Qeveritë, OJQ-të lokale dhe fondacionet ofruan më pak mbështetje në krahasim. Financimi i barazisë gjinore, përkatësisht OSHCG-të, duket së përbën një pjesë shumë të vogël të fondeve qeveritare për shoqërinë civile në vendet e BP. Financimi nga individët dhe bizneset ishte posaçërisht minimal.

Opinionet e ndryshme të OSHCG-ve mbi atë se cilët financues preferojnë mund të lidhet me kapacitetet dhe përvojat e tyre me financues të ndryshëm. OSHCG-të janë të shumëllojshme. Derisa OSHCG-të më të mëdha mund t'u qasen fondeve multilaterale dhe bilaterale, OSHCG-të më të vogla mund të mos qasen; ato varen nga organizatat lokale, fondacionet dhe fondet e grave për mbështetje. Fondet dhe rrjetet e grave mund të ofrojnë mundësi unike për të arritur tek OSHCG të margjinalizuara dhe më të vogla që nuk mund t'i qasen ose të menaxhojnë grantet më të mëdha. Kështu, siç vuri re AWID, një "ekosistem i shëndosh, feminist i financimit" me financues të ndryshëm dhe fonde në dispozicion, duket thelbësor për plotësimin e nevojave të OSHCG-ve të ndryshme. Sidoqoftë, siç tregohet në kapitullin e parë, rënia e besimit në fondet e huaja do të kërkojë situata të përmirësuara politike, korniza ligjore dhe kulturën e dhënies, nëse OSHCG-të do të mbështesin punën e tyre duke përdorur burimet e brendshme.

[68] Miller, K. and Jones, R., *Toward a Feminist Funding Ecosystem*.

TRENDET E FINANCIMIT

Ky kapitull i përgjigjet pyetjes së hulumtimit, "Çfarë fonde kanë qenë në dispozicion për periudhën 2014-2019 për OSHCG-të, gratë dhe vajzat, përkatësisht barazinë gjinore?" Siç u përmend, ishte shume e vështirë të merren informacionet e hollësishme për trendet e financimit nga financuesit e intervistuar. Financuesit në përgjithësi ceken që ose nuk i kishin këto të dhëna, se vetëm i mbanim disa prej tyre ose nuk ishin në gjendje t'i ndanin ato. Për më tepër, financuesit shpesh e shihnin barazinë gjinore dhe të drejtat e grave si "tema të ndërlidhura". Kështu që, disa thanë se financimi i tillë është i integruar në linjat e përgjithshme buxhetore, duke e bërë të vështirë nxjerrjen e detajeve specifike. Vetëm informacionet e kufizuara ishin në dispozicion përmes faqeve të internetit, dokumenteve dhe bazave të të dhënave të dhëna nga disa financues. Kur ishin në dispozicion, informatat e tilla janë paraqitur në kapitullin e mëparshëm në studimet e rasteve për financuesit. Megjithatë, ishte e vështirë të nxirren konkluzione specifike lidhur me financimin e ofruar nga financuesit. Prandaj, ky kapitull fokusohet në financimin e OSHCG-ve, bazuar në të dhënat financiare që ofruan të anketuarit të OSHCG. Ai diskuton trendet e përgjithshme të financimit sipas fushave tematike, grupeve të synuara dhe strategjisë, përfshirë mënyrën se si fondet e disponueshme janë përputhur me prioritetet e OSHCG-ve. Ai shqyrton shumat e fondeve dhe kornizat kohore, si dhe diskuton qasjet e preferuara nga perspektiva e financuesve dhe OSHCG-ve. Në fund, ky kapitull paraqet informatat e kufizuara që janë në dispozicion në lidhje me financimin për rajonin në të ardhmen.

Trendet e përgjithshme në financim të OSHCG-ve

Në përgjithësi, 91% e OSHCG-ve të intervistuara, në ndonjë moment kishin marrë fonde (219) dhe 9% kurrë nuk kanë pasur ndonjë financim (22). Të fundit kanë punuar në baza vullnetare. Një përqindje më e lartë e OSHCG-ve në **Kosovë** (16%) kurrë nuk kishte marrë financim, krahasuar me OSHCG-të në vendet e tjera (Grafiku 56).



Grafiku 56. OShCG-të që kurrë nuk marrin fonde

Grafiku 57 ilustron fondet e përgjithshme të njohura që OSHCG-të i morën ndërmjet 2014 dhe mesit të vitit 2019, bazuar në të ardhurat e raportuara të OSHCG-ve. Financimi duket se ka rënë në mes të vitit 2014 dhe 2016, por më pas është rritur. Përsëri, viti 2019 është ilustrues, por jo i plotë.



Grafiku 57. Fondet e përgjithshme të të marra nga OShCG. në milionë

Grafiku 58 ilustron sipas vendit dhe vitit, fondet që OSHCG-të raportuan t'i kenë marrë. OSHCG-të në **BeH** duket se kanë marrë shumicën e fondeve, edhe pse financimi kishte



rënë gjatë kohës. OSHCG-të në **Kosovë** morën të dytat më shumë fonde. Edhe pse panë një rënie të fondeve nga viti 2014 deri 2015, fondet janë rritur që atëherë. OSHCG-të në **Serbi** pranuan të treta më së shumti fonde, që duken se kanë rënë në mes të vitit 2015 dhe 2017, por më pas janë rritur ndjeshëm në vitin 2018. Edhe pse kanë qenë dëshmitarë të disa ndryshimeve në financim, OSHCG-të në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi kanë pasur fonde më të qëndrueshme me kalimin e kohës, megjithëse më pak, nga ato në vendet e tjera.

Shuma mesatare vjetore e fondeve të pranuara për një OSHCG në BP nga viti 2014 deri në 2018, ishte 55,773 €. OSHCG-të që u shërbejnë grave me aftësi të ndryshme kishin përafërsisht shtatë herë më pak burime se OSHCG të tjera, që arrijnë shumën mesatare prej 8,226 € në vit në të ardhura vjetore. Ngjashëm, OSHCG-të rurale kishin ndjeshëm më pak burime, mesatarisht 7,706 € në vit, me OSHCG-të rurale në Kosovë (2,321 €) dhe Serbi (1,705 €) që kishin të ardhura mesatare edhe më të ulëta gjatë kësaj periudhe.[1] N Sidoqoftë, kjo është një pasqyrë e shtrembëriar, pasi buxheti mesatar përfshinte tetë organizata me të



[1] Në përgjithësi, OSHCG-të që ofrojnë shërbime grave Rome nuk dukej të kishin të ardhura më të ulëta vjetore sesa OSHCG-të-e tjera në rajon, përveç në Maqedoninë e Veriut. OSHCG-të rome mund të përballen me sfida të tjera të shtuara në qasjen në burime.

ardhura vjetore prej më shumë se 500,000 €. Të ardhurat e mesme (mediane) vjetore ishin vetëm 6,000 €. Grafiku 59 ilustron të ardhurat mesatare dhe median vjetore të OSHCG-ve në vit.

Për periudhën prej 2014 deri në 2018, OSHCG-të në **BeH** morën më shumë fonde në vit sesa ato në vendet e tjera, mesatarisht 123,068 € në vit (Grafiku 60). Një përjashtim ishte **Mali i Zi** në 2017 dhe 2018. Me kalimin e kohës, trendet në fondet mesatare vjetore duken të ngjashme me trendet e përgjithshme të financimit të paraqitura në Grafikun 58: në **BeH** të ardhurat vjetore mesatare për një OSHCG duket se kanë rënë; në **Shqipëri**, **Serbi** dhe **Maqedoni të Veriut** të ardhurat mesatare vjetore ndryshonin; dhe në **Kosovë** të ardhurat mesatare vjetore u rritën që nga viti 2015, megjithëse pak. Në kontrast me Grafikun 58, të ardhurat mesatare vjetore u rritën mjaft në Mal të Zi me kalimin e kohës.

Grafiku 60. Të ardhurat mesatare vjetore të OShCG-ve sipas vendit në mijëra



Situata financiare e PB OSHCG-të në 2018

€ = Të ardhura të mesme (mediane)

Numri i të anketuarve (N)=162
68% e mostrës



Pavarësisht nga fondet e raportuara të marra nga OSHCG-të, organizatat kishin perceptime të ndryshme në lidhje me fondet në dispozicion gjatë kohës. Më shumë OSHCG menduan se fondet ishin zvogëluar që nga viti 2014 (38%) nga ato që menduan se ishin rritur (24%). Ndërkohë, 8% thanë se kanë mbetur të njëjta.[2] Në një masë shumë më të madhe OSHCG në **BeH** (78%) dhe **Serbi** (66%) thanë se kishin parë ulje në fonde në krahasim me ato në vendet e tjera (shih Grafikun 61). Në të kundërtën, një përqindje më e lartë e OSHCG-ve në **Shqipëri** (39%) thanë se kishin vërejtur rritje në financim. Në të gjithë BP, por veçanërisht në Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe BeH, disa OSHCG thanë që financuesit po japin shumë më pak fonde për OSHCG-të dhe të drejtave e grave në pesë vitet e fundit. Disa thanë që ata kanë parë rënie të fondeve, pasi donatorët zhvendosën fondet në tema të tilla si lufta e korrupsioni, duke adresuar ekstremizmin e dhunshëm dhe migracionin.

Grafiku 61. Mendimi i OShCG-ve mbi atë se është rritur apo zvogëluar mbështetja financiare



Dallimet në trendet e vlerësuara të financimit të paraqitura në Grafikët e mëparshme dhe këto perceptime, mbase mund të shpjegohen nga diversiteti dhe përvojat e shumëllojshme të OSHCG-ve. Edhe pse disa organizata më të mëdha mund të kenë parë rritje të fondeve gjatë kohës, OSHCG-të më të vogla mund të mos kenë marrë burime të tillë, duke përjetuar një rënie të fondeve.

Sa i përket së ardhmes, gjysma e OSHCG-ve të intervistuara besuan se të ardhurat e tyre të përgjithshme do të ishin më shumë në vitin 2019 se në vitin 2014. Ndërkohë, 10% menduan se të ardhurat e tyre të përgjithshme do të ishin më pak dhe 12% menduan se ato do të mbeten të njëjta. Një e katërta ishin të pasigurt.[3] Më shumë OSHCG në **BeH** (28%) dhe **Mal të Zi** (25%) parashikuan ulje të fondeve në krahasim me OSHCG-të në vendet e tjera (Grafiku 62).[4] Përkundër kësaj, më shumë organizata nga **Maqedonia e Veriut** (75%), **Serbia** (66%) dhe **Mali i Zi** (50%) menduan se të ardhurat e tyre do të ishin më të larta në vitin2019 se në vitin 2014.

Grafikon 62. A prisni që të ardhurat tuaja të përgjithshme do të jenë më të larta apo më të ulëta në vitin 2019 në krahasim me vitin 2014?



[2] Përveç kësaj, 69 OSHCG thanë që nuk e dinin (29%).
[3] Dy përqind nuk u përgjigjën.
[4] N = 239.

Gjithsej, **35%** e OSHCG-ve të intervistuara thanë se nuk e kanë përmbushur buxhetin e tyre të planifikuar në vitin 2018. Siç ilustron Grafiku 63, gjysma e organizatave në **Kosovë** raportuan se nuk kishin fonde të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e tyre, pasuar nga 38% në **Mal të Zi** dhe 31% në **Maqedoninë e Veriut**. OSHCG-të në Mal të Zi thanë se kishin vështirësi të mbulonin shpenzimet komunale përfshirë energjinë elektrike, telefonin dhe internetin. "Tani [është] qershori, [dhe] kemi pasur ndërprerje të energjisë elektrike tre herë këtë vit sepse nuk kemi para", tha një përfaqësuese i OSHCG në Mal të Zi. Një përqindje e lartë e OSHCG-ve në **Shqipëri** (74%) dhe **Serbi** (69%) raportuan të kenë siguruar buxhetet e tyre të kërkuara.



Që nga viti 2014, shumica e OSHCG-ve (**82%**) kanë pasur periudha në të cilat nuk kishin burime të mjaftueshme. Vetëm 18% thanë se kishin gjithmonë burime të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre. Përqindja më e lartë e OSHCG-ve që raportoi se nuk kishte burime të mjaftueshme ishin në **Kosovë** (86%) dhe **Serbi** (86%) (Grafiku 64).



Si rezultat i mungesës së fondeve, OSHCG-të është dashur të ndërprenë aktivitetet (58%), të vonojnë ose të mos paguajnë pagat (58%), të zvogëlojnë stafin (39%) dhe/ose të ndërprenë programet (40%).[5] Më shumë OSHCG në **Shqipëri** (71%)[6] dhe **BeH** (75%)[7] raportuan që ishte dashur t'i ndërpresin aktivitetet. Një përqindje e lartë e OSHCG-ve në **Shqipëri** (53%) kishin ndërprerë programet. Ndërkohë, një përqindje e lartë e OSHCG-ve në **Maqedoninë e Veriut** (56%)[8] dhe **BeH** (50%) kishin zvogëluar stafin e tyre.

> **Është dashur të mbyllim organizatën sepse nuk kishim para për të funksionuar, për të paguar shpenzimet themelore, qiranë dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit.**
>
> OSHCG, Serbi

[5] N = 195.
[6] N = 17.
[7] N = 24.
[8] N = 27.

Që nga viti 2014, **28%** të OSHCG-ve të intervistuara thanë se kishin humbur mbështetje financiare nga një financues që i kishte mbështetur historikisht ose që kishin financues që ofronin mbështetjet por që më vonë u tërhoqën. Një përqindje pak më e lartë e OSHCG-ve në **Mal të Zi** (50%) dhe **Shqipëri** (39%) raportuan të kenë humbur mbështetjen e planifikuar sesa në vendet e tjera (Grafiku 65). OSHCG-të që humbën mbështetjen nga financuesit, në mënyrë të ngjashme thanë se u ishte dashur të zvogëlonin aktivitetet (65%), të ndërprenin programet (49%), të zvogëlojnë stafin (44%) dhe të vonojnë pagat e stafit (41%), ndër implikimet e tjera (28%).[9]



Më tej, **31%** të OSHCG-ve të intervistuara thanë se ishin në rrezik të mbyllnin organizatën e tyre për shkak të mungesës së fondeve (75) (Grafiku 66). Disa OSHCG vazhduan të punonin pa fonde, në baza vullnetare.



Edhe pse 101 organizatat thanë se kishin plane rezervë në rast se nuk siguronin fonde të mjaftueshme ose nëse fondet e tyre do të zvogëloheshin, 114 nuk e thanë këtë gjë (**48%**). Më shumë organizata kishin mungesë të planeve në **Kosovë** (53%) (shih Grafikun 67). Në situata të tilla, OSHCG-të kanë mundur t'i shesin asetet e organizatës për fonde. Përderisa 63% të OSHCG-ve të anketuara kishin asete të tilla në dispozicion, 37% nuk i kishin.



Një teknikë që OSHCG-të në **BeH** raportuan se e përdorin në situata të tilla është krijimi i fondeve rezervë, duke kërkuar nga kontraktorët të japin donacione prej 1-5% të të ardhurave të tyre në organizatë. Megjithatë, në **Shqipëri**, sipas Ligjit për OJQ-të, "nuk lejohen

[9] N = 68. Një përqindje më e lartë është dashur të zvogëlonte stafin e tyre në Shqipëri (67%) dhe Kosovë (52%); është dashur të vonojnë ose të mos paguajnë pagat e stafit në Kosovë (60%), Mal të Zi (50%) dhe Shqipëri (44%); dhe është dashur të zvogëlojnë programet në Kosovë (64%), Shqipëri (56%), Serbi (50%) dhe Mal të Zi (50%). Një përqindje më e lartë e OSHCG-ve në Kosovë (75%), Shqipëri (67%), BeH (67%) dhe Serbi (67%) u desh t'i ndërpresin aktivitetet.

fondet rezervë",[10] kështu që ata nuk mund të vendosin kursime për situatat në të cilat kanë mungesë të burimeve. Planet e emergjencave që OSHCG-të në BP i përmendën që i kanë në rastet kur ballafaqohen me mungesë të fondeve, përfshijnë zvogëlim të stafit, fokusimi në një ose dy prioritete kyce, inicimi i nismave për mbledhje e fondeve dhe/ose vullnetarizmin.[11] OSHCG-të gjithashtu raportuan se kishin ndërmarrë përpjekje më të forta avokuese dhe të shkrimit të letrave publikut dhe qeverisë për të adresuar fonde të pamjaftueshme.[12] Në Serbi, Kosovë dhe Shqipëri, OSHCG-të thanë që do të përpiqen të vazhdojnë aktivitetet e tyre në baza vullnetare.

Që nga viti 2014, 158 OSHCG (66%) kishin burime të reja të financimit që nuk i kishin më parë. Kjo përfshinte 50% të OSHCG-ve në Kosovë, 69% në Maqedoninë e Veriut, 83% në Shqipëri, 84% në BeH, 86% në Serbi dhe 88% në Mal të Zi. Thuhet se ri-grantimi nga organizatat lokale si dhe BE ka përmirësuar disponueshmërinë e fondeve në **Maqedoninë e Veriut** dhe në **Kosovë**. Në vendet kandidate për anëtarësim në BE, OSHCG-të në përgjithësi priren të kenë shpresë se anëtarësimi do të rrisë shumën e fondeve të BE-së në dispozicion në të ardhmen.[13]

[10] Intervistat, OSHCG-të, Shqipëri, 2019; Ligji nr. 8788 për Organizatat jofitimprurëse.
[11] Intervistat, OSHCG-të, Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Mali i Zi, 2019.
[12] Intervista, OSHCG, BeH, 2019.
[13] More-Hollerweger, et al., faqe 11.

Fushat tematike ose sektorët e financuar

Kjo pjesë shqyrton shumën e fondeve që OSHCG-të raportuan t'i merrnin për punën në fusha tematike ose "sektorë" të ndryshëm. Pastaj e krahason këtë me fushat që OSHCG-të i konsideruan prioritete. Grafiku 68 tregon fondet e përgjithshme që OSHCG-raportuan t'i kenë marrë sipas sektorit, nga viti 2014 deri në mes të vitit 2019. Të dhënat jo gjithmonë mund të ndahen në mënyrë të qartë sipas sektorit.[14] Ndonjëherë një kontratë ose grant i vetëm mund të kontribuonte në sektorë të shumë, të tillë si anti-diskriminimi dhe pjesëmarrja e fuqisë punëtore. Është e qartë se shumica e sektorëve do të mund të lidheshin me të drejtat e grave dhe/ose barazinë gjinore, megjithëse kjo është renditur veçmas pasi disa OSHCG kishin nisma që përqendroheshin gjerësisht në të dyja. Disa sektorë të përshkruar më poshtë do të binin teknikisht nën kategorinë e dhunës me bazë gjinore, por ato janë të paraqitura veçmas për të qenë më preciz. Të gjitha të dhëna janë koduar në bazë të sektorit më specifik të përmendur. Financimi për grupet specifike të synuara, si romët, u koduan në bazë të sektorit, siç është arsimi ose fuqizimi ekonomik, sesa në bazë të grupeve të synuara. Duke pasur parasysh këto kufizime në kodimin e të dhënave, gjetjet duhet të konsiderohen si ilustruese të trendeve, por jo gjithëpërfshirëse ose të sakta. Në përgjithësi, intervistat me financuesit konfirmuan se ata kanë mbështetur fusha të ngjashme si ato të paraqitura në Grafikun.[15]

Siç ilustron Grafiku 68, shumica e fondeve për OSHCG-të në BP nga viti 2014 dhe në mes të vitit 2019 shkuan për adresimin e dhunës me bazë gjinore, kryesisht dhunës ndaj grave. Kjo përbënte 27% të të gjitha fondeve që OSHCG-të raportuan t'i kenë marrë (€16.2 milion). Kjo kategori përshin forma të ndryshme të dhunës. Brenda kësaj kategorie, €2.7 milion shkuan drejt adresimit të trafikimit grave dhe €3 milion për dhunën në familje, në veçanti.

Photo: *Marija Jankovic*

Qendra e grave autonome dhe gratë në të zeza protestojnë në Ditën Ndërkombëtare kundër Femicidit, 6 Dhjetor 2017, Beograd.

[14] Veçanërisht në BeH, disa OSHCG u detyruan të zbatojnë projekte jashtë misioneve të tyre themelore për të mbijetuar, dhe këto nuk ishin gjithnjë të përqendruara kryesisht në trajtimin e pabarazive gjinore dhe avancimin e të drejtave të grave.

[15] Intervistat me dy financues rajonal, 2019; Rönngren, J., faqe 7.

Grafiku 68. Gjithsej fonde të cilat OShCG-të raportuan t'i kenë marrë, sipas fushave tematike



Siç ilustron Grafiku 69, fondet për adresimin e dhunës me bazë gjinore, në përgjithësi janë rritur gjatë kohës në të gjitha vendet. Deri më tani, OSHCG-të në **BeH** morën më së shumti fonde për adresimin e dhunës me bazë gjinore, në vlerë totale prej 4.5 milionë , të pasuar nga **Serbia** me 4.2 milionë € dhe **Shqipëria** me 2.9 milionë €. Përveç këtyre fondeve për dhunën me bazë gjinore, 2.2 milionë € (3.6% e të gjitha fondeve) shkuan për mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës. Shumica e këtyre fondeve janë shpërndarë në **Kosovë** (vetëm nën 2.2 milionë €) dhe u rritën me kohë, Përveç në vitin 2018. OSHCG-të në **BeH** pranuan 158,064 € për këtë qëllim. Asnjë nga fondet nuk janë shpërndarë në vendet e tjera, Përveç 5,700 € **Maqedonisë së Veriut** në vitin 2019. Përveç kësaj, OSHCG-të morën 0.3 milion € për përpjekjet për t'i dhënë fund martesës së hershme.

Grafiku 69. Fondet për dhunën me bazë gjinore në mijëra



Siç u përmend, 14% e fondeve që OSHCG-të raportuan se i kishin marrë, shkuan për të drejtat e njeriut. Fondet e tilla patën rënie në 2015-2016, por më pas u rritën nga viti 2017 e tutje. Fondet për të drejtat e njeriut u zvogëluan ndjeshëm në **BeH** pas vitit 2014, duke përbërë rënien e përgjithshme në fonde. Rritja ndodhi kryesisht për shkak të një pjesë më të madhe të fondeve të dhëna në **Kosovë** në vitin 2017, ndërsa vendet e tjera morë një shumë të ngjashme me kohë. Në përgjithësi, OSHCG-të në **BeH** morën më së shumti fonde që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, prej rreth 3.4 milionë €, e pasuar nga Kosova (€1.6 milion), Maqedonia e Veriut (1.1. milion €) dhe Serbia (pak më pak se 1 milion €).

Grafiku 70. Fondet për të drejtat e njeriut në mijëra



Mbështetja e përgjithshme organizative ose institucionale për OSHCG-të përbënte **5%** të të gjitha fondeve të shpërndara. Deri më tani, shumica e fondeve të tilla u shpërndanë në **BeH** (€1.2 milion), pasuar nga **Serbia** (€1.1 milion). Vendet e tjera morën më pak se gjysmën e kësaj shume. Sidoqoftë, ekziston mundësia që disa, mbështetje të përgjithshme shtesë janë përfshirë brenda fushës tematike të adresimit të dhunës me bazë gjinore, sepse mbështetja e përgjithshme u mundësoi OSHCG-ve të ofrojnë shërbime personave që kishin pësuar dhunë. Këto dallime ishin të paqarta në të dhëna dhe kështu nuk mund të paraqiten saktësisht këtu

Grafiku 71. Mbështetja e përgjithshme sipas vendit, në mijëra



Edhe pse mbështetja e përgjithshme mbeti e ngjashme me kohë në **BeH** (Grafiku 71), ajo ishte mjaft sporadike në **Serbi** dhe **Shqipëri**. Mbështetje minimale është dhënë në Maqedoninë e Veriut, Kosovë ose Mal të Zi.

Fuqizimi ekonomik, sipërmarrja dhe punësimi gjithashtu përbënin një pjesë mjaft të madhe të mbështetjes së ofruar (4.7%). OSHCG-të në **Kosovë** morën pjesën më të madhe

Grafiku 72. Fondet për fuqizimin ekonomik të grave, në mijëra



të fondeve (1.2 milion €), pasuar nga ato në **BeH** (849,266 €). Në përgjithësi, financimi i tillë duket se ka rënë me kalimin e kohës, veçanërisht në Kosovë (Grafiku 72). Me përjashtim të **BeH** ku ai është rritur.

Financimi për paqen, sigurinë dhe pajtimin përbënte afro 5% të fondeve që morën OSHCG-të. Përsëri, OSHCG-të në **BeH** raportuan pjesën më të madhe të fondeve (€1.1 milion), pasuar nga **Serbia** me më pak se €1 milion, **Kosova** me nën €0.5 milion dhe **Shqipëria** me pak më shumë se €0.3 milion. OSHCG-të në Mal të Zi nuk raportuan të kenë marrë ndonjë fond për këtë qëllim dhe shumë pak është raportuar në Maqedoninë e Veriut. Siç ilustron Grafiku 73, financimi ka luhatur me kohë, si në përgjithësi ashtu edhe sipas vendit.

Grafiku 73. Fondet për paqen, sigurinë dhe pajtimin, në mijëra



Financimi i të drejtave të fëmijëve përfshinte rreth përafërsisht 3% të të gjitha fondeve. Është e qartë se çështjet e tjera gjithashtu kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, siç janë martesa e hershme dhe arsimi, megjithëse paraqiten veçmas si shtesë e fondeve për të drejtat e fëmijëve.. Ndjeshëm më shumë fonde shkuan për OSHCG-të që punojnë për këtë çështje në **Shqipëri** sesa tek ato në vendet e tjera, me shumë prej 1.7 milion € që raportohen të janë shpenzuar në përgjithësi.

Grafiku 74. Fondet për demokraci dhe qeverisje, në mijëra



Përafërsisht 3% e të gjitha fondeve të njohura ishin të drejtuara për demokracinë dhe qeverisjen. OSHCG-të në **BeH** duket se kanë marrë pjesën më të madhe të këtyre fondeve, që arrijnë shumën prej 1.1. milion €, pasuar nga **Maqedonia e Veriut** dhe **Shqipëria** me afro 0.4 milion € secila. Fondet për demokracinë dhe qeverisjen gjithashtu patën luhatje me kalimin e kohës (Grafiku 74). Edhe pse fondet në **BeH** dhe **Maqedoninë e Veriut** duket se janë ulur, në **Serbi** duket se janë rritur pak.

Harmonizimi i sektorëve të financuar, me përparësitë e OSHCG-ve

Hulumtimi u përpoq të krahasonte shkallën se sa sektorët që morën fonde përputheshin me sektorët që OSHCG-të i konsideronin si prioritet. Grafiku 75 ilustron prioritetet e para të OSHCG-ve,[16] ndërsa Grafiku 76 tregon pesë prioritete kryesore të OSHCG-ve.[17]

Grafiku 75. Sektorët prioritare të OShCG-ve (Numri, përqindja e OShCG-ve)



[16] Kjo nuk përfshin 100% sepse 10% e të anketuarve identifikuan sektorë "të tjerë" (n=239).
[17] 72% e të anketuarve identifikuan sektorë "të tjerë" (n=239).

Grafiku 76. Pesë sektorët kryesorë të OShCG-ve sipas numrit të OSHCG-ve



Shumica e OSHCG-ve të intervistuara konsiderojnë adresimin e dhunës me bazë gjinore prioritetin e tyre kryesor (33%) ose ndër pesë prioritetet e tyre kryesore (63%);[18] në

[18] Në të gjitha vendet, përveç Kosovës, shumica e OSHCG-ve e konsideruan adresimin e dhunës me bazë gjinore prioritetin e tyre kryesor. Fuqizimi ekonomik i grave ishte një prioritet për shumicën e OSHCG-ve në Kosovë dhe disa në BeH, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Shumë në Kosovë, BeH, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut kishin prioritet ndërtimin e paqes. ESCR ishin përparësi për disa OSHCG në Kosovë, Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar ishin prioritet për disa OSHCG në Kosovë, Shqipëri dhe Serbi.

fakt, shumica e fondeve të dhëna OSHCG-ve ishte për këtë sektor. Fuqizimi ekonomik i grave ishte prioritet kryesor për përqindjen tjetër më të lartë të të anketuarve nga OSHCG (21%), dhe një ndër pesë prioritetet kryesore për 53% të OSHCG-ve. Financimi ishte në dispozicion për fuqizimin ekonomik të grave (2.9 milion €), megjithëse, shumë pak sesa për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Edhe pse vetëm 2% e OSHCG-ve konsideruan udhëheqjen dhe fuqizimin e grave si prioritetin e tyre kryesor, 33% e renditen atë në ndër pesë prioritetet e tyre kryesore. Përafërsisht 5% e të anketuarve i japin përparësi të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore (DESK), ose të drejtave për personat me aftësi të kufizuar. Ndjeshëm më pak fonde duket se kanë qenë në dispozicion për këto fusha specifike (Grafiku 68). Ndërtimi i paqes ishte prioritet kryesor për 4% të OSHCG-ve të intervistuara dhe adresimi i dhunës ndaj grave në konflikt dhe situatat pas konfliktit ishte prioritet për 3%. Të dyja këto fusha morën fonde. Duke qenë se OSHCG-të janë të ndryshme, ato kanë identifikuar disa prioritete të tjera, shumica e të cilave duket se kanë marrë fonde.[19]

Disa OShCG punojnë me njerëz me aftësi të ndryshme, si Organizata për Personat me Distrofi Muskulare në Prizren, Kosovë, në foto këtu. Disa OShCDG të tilla nuk mendonin se kishin fonde për punën e tyre.

Pjesa më e madhe e këtyre gjetjeve sugjeron se fondet e shpërndara për OSHCG-të në rajon, të ilustruara në Grafikun 68, duket se janë fokusuar në çështjet që OSHCG-të gjithashtu i konsideronin si prioritare. Megjithatë, këto gjetje nuk tregojnë domosdoshmërish nëse OSHCG-të morën fonde *të mjaftueshme* për fushat që ata i kishin prioritet. Në pyetje konkrete, më shumë se gjysma e OSHCG-ve të intervistuara u përgjigjen se fondet që morën adresuan prioritetet e tyre organizative. Në ndërkohë, 15% deklaruan se financimi ndonjëherë



adresonte prioritetet e tyre dhe **29%** thanë se fondet nuk i adresuan sa duhet prioritetet e tyre. Krahasimisht më pak OSHCG, në **Kosovë** (44%) dhe **BeH** (41%) menduan se fondet adresuan prioritetet e tyre.

[19]10% e të anketuarve identifikuan sektorë "të tjerë" që nuk ishin të listuar (n=23).



Edhe pse për disa sektorë të caktuar si demokracia dhe qeverisja, mjedisi dhe dhuna me bazë gjinore, disa OSHCG thanë se kishin fonde të mjaftueshme; OSHCG-të e tjera që punojnë në të njëjtin sektor thanë që nuk kishin fonde të mjaftueshme. Kjo sugjeron që asnjë sektor nuk ishte financuar sa duhet. OSHCG-të që mendonin se **fondet nuk i kishin** përmbushur nevojat e tyre, punuan në sektorët e përshkruar në Grafikun 78.[20]

Disa OSHCG shprehen shqetësime se ndonjëherë financuesit i shtynin të punojnë në fusha që ato nuk i konsideronin prioritete. Ky sentiment u dëgjua vazhdimisht në Kosovë; një OSHCG tha: "Financuesit me politikat e tyre dëshirojnë që ne të zbatojmë projekte që ata i duan dhe i konsiderojnë të rëndësishme. Jo duke u bazuar në nevojat e komunitetit dhe njohurinë e OJQ-ve". OSHCG-të in **Kosovë** dhe **BeH** theksuan se për shkak të varësisë së tyre financiare nga financuesit e jashtëm, ata ndonjëherë duhet të ndjekin qëllimet e financuesve. Financuesit dhe OSHCG-të në **Kosovë**, **Maqedoninë e Veriut** dhe **Serbi** raportuan se ekziston nevoja për fonde që adresojnë planet dhe prioritetet strategjike të OSHCG-ve.

[20]N = 107.

Financimi për grupet e synuara të caktuara

Grafiku 79. Numri i OShCG-ve që synojnë grupet specifike të moshave



Në këtë pjesë diskutohet disponueshmëria e fondeve për grupe të caktuara të synuara. Pak OSHCG raportuan të kenë marr fond për të mbështetur grup moshat specifike të grave (18%). Nga OSHCG-të që i kishin dedikuar fonde për grupe specifike të synuara, shumica kishin fonde për gratë e reja të moshës 19-30 vjeç, gratë e moshës madhore dhe adoleshentet (Grafiku 80).[21]

Disa OSHCG shprehen pakënaqësi për mospasje të financimit për grupe specifike të synuara si gratë me aftësi të ndryshme. Në **Shqipëri**, OSHCG-të identifikuan nevojën për fonde shtesë për të ndihmuar gratë e reja në rajone të largëta që të vazhdojnë arsimin e tyre dhe ti shmangen "dhunës ose marrëdhënieve të detyruara."[22]

Mbështetja e grupeve "feministe"

Lëvizjet feministë janë një forcë shtytëse për fuqizimin ekonomik dhe shoqëror.[23] Megjithatë, historikisht, jo të gjithë financuesit e kanë njohur rolin e lëvizjeve feministe në të sjellit e ndryshimeve shoqërore. Në vitet e mëparshme, disa OSHCG që identifikohen si "feministe" thanë se përballeshin me sfida për të siguruar fonde. Prandaj, si pjesë e këtij hulumtimi, financuesit u pyetën nëse do të mbështesin në mënyrë eksplicite rupet "feministe". Në përgjithësi, financuesit thanë që ata do të jenë të gatshëm të financojnë organizata të tilla. Disa financues shprehen shqetësime për grupet feministe "ekstremiste" ose "fundamentaliste". Sidoqoftë, në përgjithësi, financuesit konsideronin të parëndësishëm dallimin "feminist". Temë e përsëritur ishte që financuesit kishin tendencë të mbështesin idetë dhe propozimet, se sa organizatat specifike. "Ne nuk kemi ndonjë rregull apo qëllim specifik ndaj grupeve feministe", tha njëri. "Ne ndjekim kritere të barabarta për këdo që aplikon".[24] Disa financues treguan se nuk shohin aq dallime në mes të grupit "feminist" dhe grupeve tjera. Kjo sugjeron që grupet që identifikohen si feministe mund të kenë aftësi të përmirësuara për t'u qasur në burime, në krahasim me vitet e mëparshme. Sidoqoftë, ekzistonin informacione të kufizuara në lidhje me financimin e grupeve "feministe".

> **Nuk ka dallim të qartë mes feminizmit dhe barazisë gjinore. Feminizmi dhe barazia gjinore nuk janë me të vërtetë të ndryshme.**
>
> Financues, Kosovë

[21] N = 43. Të anketuarit kanë mundur të zgjidhnin më shumë se një përgjigje.
[22] Intervista, OSHCG, Shqipëri, 2019.
[23] Weldon, L. et al, Handmaidens or Heroes? Feminist Mobilization as a Force for Economic Justice, 2020.
[24] Intervista, financues, Shqipëri, 2019.

Financimi për strategji specifike

Kjo pjesë përshkruan llojet e strategjive që OSHCG-të preferuan t'i përdorin dhe diskuton shkallën në të cilën kanë ekzistuar fonde të mjaftueshme për ato strategji.[25] Siç ilustron Grafiku 80, shumica e OSHCG-ve në rajon (69%) priren të preferojnë avokimin, fushatat dhe lobimin si strategji.



[25] Ekipi i hulumtimit huazoi listën e llojeve të ndryshme të strategjive të mundshme nga hulumtimi i AWID *Ku janë paratë për të drejtat e grave*. Pjesëmarrësit e hulumtimit zgjodhën nga kjo listë ose identifikuan prioritete të tjera.

Strategjia e dytë zakonisht më e preferuar ishte fuqizimi i grave (56%). OSHCG-të komentuan se fuqizimi është i rëndësishëm për të inkurajuar gratë të luftojnë për veten e tyre dhe për të drejtat e tyre.[26] Disa OSHCG preferuan trajnimet dhe ndërtimin e kapaciteteve (49%), ngritjen e vetëdijes (46%) dhe ofrimin e shërbimeve direkte (46%). Në fakt, ofrimi i shërbimeve direkte ishte prioriteti kryesor për numrin e dytë më të madh të të anketuarve të OSHCG (66), pasuar nga avokimi (75). Strategjitë e tjera prioritare të përmendura ishin rrjetëzimi dhe krijimi i aleancave (20%), hulumtimi dhe dokumentimi (20%), organizimi i diskutimeve (17%) dhe angazhimi i komunitetit (13%).

Në mesin e të anketuarve në **Maqedoninë e Veriut** (56%) dhe **Kosovë** (34%), një përqindje më e lartë thanë se përdorin avokimin si strategji parësore (Grafiku 81).[27] Në **Kosovë**, OSHCG-të thanë se preferonin këtë strategji sepse bëri ndryshime, siç janë ndryshime në ligje, politika dhe vetëdijesimin e publikut. Në kontrast më këtë, disa OSHCG, veçanërisht në **Serbi** thanë se nuk preferojnë avokimin si strategji sepse financuesit shpesh e favorizuan atë, kështu që më pak fonde ndahen për ofrimin e shërbimeve, të cilin ato e konsideruan si prioritet.[28]

Grafiku 81. Strategjia primare e OShCG-ve, sipas vendit



Në Mal të Zi (63%), Serbi (59%), Shqipëri (43%) dhe BeH (31%), një përqindje relativisht e lartë e OSHCG-ve përdorin ofrimin e shërbimeve si strategji. Historikisht, OSHCG-të kanë ofruar shërbime të përfitimeve publike në mungesë të shërbimeve shtetërore (shih Kutinë 2). Ndërkohë, ofrimi i shërbimeve të përfitimeve publike, siç janë ato për personat që kanë përjetuar dhunë, gjithashtu mundëson monitorimin dhe llogaridhënien e institucioneve përkatëse. Sidoqoftë, edhe pse financimi për dhunën me bazë gjinore përbënte pjesën dërmuese të të gjitha fondeve për OSHCG-të, kjo është treguar e pamjaftueshme për ofrimin e shërbimeve direkte, duke përfshirë shërbimet sociale për gra dhe vajza më të rrezikuara, si ato që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore.[29] Të anketuarit thanë se "nuk janë ndarë fonde të mjaftueshme për shërbimet direkt" dhe se ekziston një "mungesë e fondeve për shërbimet direkte. Është shumë pak, shumë shkurt dhe shumë shpejt".[30]

[26] Intervista, OSHCG, Serbi, 2019.
[27] 27% e të anketuarve identifikuan sektorë "të tjerë (n=239).
[28] Intervistat, OSHCG-të, Serbi, 2019.
[29] Intervistat, OSHCG-të in BeH, Shqipëri, Serbia, Maqedonia e Veriut, 2019.
[30] Intervistat, OSHCG-të në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri, 2019.

Mospërputhja në dukje ndërmjet faktit se shumica e fondeve shkoi për adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe prapëseprapë mbetet i financuar pamjaftueshëm, veçanërisht në lidhje me ofrimin e shërbimeve, mund t'i atribuohet disa çështjeve. Së pari, dhuna ndaj grave mbetet e përhapur në rajon.[31] Së dyti, adresimi i dhunës me bazë gjinore në mënyrë të duhur, kërkon shumë shpenzime, duke përfshirë avokatët, shërbimet e sigurisë, psikologët, ndihmën emergjente dhe mbështetjen e rehabilitimit, ndër kostot e tjera. Ndërkohë, shërbimet qeveritare mbesin të pamjaftueshme ose mungojnë, kështu që shumë vende nuk kanë fonde për këto shërbime. Ato nuk mund të financohen thjesht përmes granteve ad hoc; për funksionim të duhur, ato duhet të kenë fonde të qëndrueshme, si ato përmes rikuperimit të kostos. Qeveritë nuk kanë paraparë buxhet si duhet për këto shërbime.

Mungojnë fondet për shërbimet direkte. Ne nuk mund të kërkojmë fonde për ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për përfituesit e veçantë sepse donatori do të thoshte që shteti ka shërbime emergjente dhe fonde. Qeveria jonë me të vërtetë e thotë këtë në raportet e tyre, por kjo nuk është e vërtetë. Ata nuk mund të mbulojnë shërbime të drejtpërdrejta për viktimat.

OShCG, Shqipëri

Në të gjashtë vendet e BP, OSHCG-të theksuan nevojën për fonde që mbështesin strategjitë si avokimi, hulumtimi, shërbime juridike dhe psikoterapi. Lidhur me vetëdijesimin, OSHCG-të thanë se ndonjëherë u mungonin burimet, veçanërisht për edukimin seksual ose barazinë gjinore.[32]

Shumat e financimit

Kjo pjesë shqyrton shumat e financimit në dispozicion për OSHCG-të. Nga 1,963 grante, kontratat dhe donacionet që OSHCG-të raportuan t'i kenë marrë (në vazhdim "fondi"), shuma mesatare e fondit ishte 31,685 €.[33] Fondet silleshin nga një minimum prej 9 € deri në maksimum prej 1,468,055 €. Shuma mesatare e fondeve të pranuara ka rënë ndjeshëm që nga viti 2014 (Grafiku 82).

Grafiku 82. Shuma mesatare e fondeve të OShCG-ve



Sipas vendit, mesatarisht, OSHCG-të në **Shqipëri** kishin tendencë të merrnin fonde me vlerë dy herë më shumë se OSHCG-të në vendet e tjera, veçanërisht për shkak të disa fondeve të mëdha që ato i morën në vitin 2015 (Grafiku 83). Edhe pse shumat mesatare të fondeve kanë rënë në shumicën e vendeve, **Kosova** dhe **Maqedonia e Veriut** patën rritje

[31] OSBE, *Sondazh i udhëhequr nga OSBE mbi dhunën ndaj grave: Raporti kryesor*, 2019.
[32] Intervistat, OSHCG-të, Maqedonia e Veriut, 2019.
[33] Në përgjithësi, madhësia mesatare e fondit ishte 32,786 €. Sidoqoftë, kur pjesëtohen me vitin në të cilin OSHCG-të morën fonde, mesatarja është më pak (31,685 €). Kjo për faktin se, në disa raste, OSHCG-të nuk cekën vitin në të cilin ato morën fonde. Financimi që nuk kishte informacion në lidhje me atë kur OSHCG-të morën ato, është përfshirë në mesataren e përgjithshme, por jo në grafik në lidhje me mesataret në vit.

të përkohshme në vitin 2017. Shumica e vendeve raportuan rritje në vitin 2018, Përveç **Maqedonisë së Veriut** dhe **Kosovës**, të cilat pësuan ulje.



Edhe pse Grafikët ilustrojnë trendet e përgjithshme, kështu që mund të çoj në një përfundim të gabuar, duke qenë se ndryshimet thelbësore që ekzistojnë tek OSHCG-të në shumat e fondeve që ato raportuan t'i kenë marrë, të mjegulluara brenda këtyre mesatareve.[34]

Qasja e lartpërmendur e ndarjes së nën-granteve mund të tregohet efektive për të arritur tek OSHCG-të më të vogla që nuk mund të aplikojnë për grante më të mëdha.[35] Për shembull, thirrjet e Fondit të BE-së për shoqëritë civile (ang. *EU Civil Society Facility*) gjithnjë e më shumë kanë inkurajuar apo madje kanë kërkuar nën-grante për të arritur tek këto organizata që nuk mund të aplikojnë për ose të menaxhojnë fondet e BE-së. Edhe pse aplikantët e OShC kanë fleksibilitet në propozimin e shumave të nën-granteve që ata do t'i japin, shpesh ata duhet të zgjedhnin mes ofrimit të disa mikro-granteve nga të cilat do të përfitojnë më shumë ose disa organizata, granteve të vogla nga të cilat përfitojnë më pak organizata, duke pasur parasysh kufijtë e përgjithshëm të buxhetit brenda thirrjeve për propozime. Në veçanti, aktivitetet rajonale të Fondit të Shoqërisë Civile të BE-së mund të jenë një sfidë për OShC-të kur planifikojnë shpërndarjen e fondeve të kufizuara për disa vjet, OShC-



[34] Shih gjithashtu tabelën 2 në Kush i financon të drejtat e grave?.
[35] Shih pjesët mbi Fondet e grave dhe OJQ-të lokale.

të partnere në disa vende dhe fituesit e nën-granteve, gjë që e bën të vështirë zgjedhjen midis ofrimit të mbështetjes financiare afatgjatë dhe shpërndarjes së fondeve për një numër akterësh me qëllim të forcimit të lëvizjes. Si rezultat, fondet që përfundimisht arrijnë në OSHCD mundësojnë vetëm aktivitete afatshkurtra ose të vogla. Në këtë mënyrë, kostot administrative të OSHCD gjithashtu rriten, sepse kjo kërkon të njëjtin vëllim të punës në dokumentacion për më pak fonde, pasi ata duhet të sigurojnë më shumë grante për të mbuluar kostot themelore.

> **Financimi shumëvjeçar na ka mundësuar të pozicionohemi në nivel politikash [dhe] të ndryshojmë plotësisht strukturën organizative, [kështu që] mund të ndërtojmë kapacitetet tona nga brenda, duke përfshirë strategjitë e komunikimit dhe marrjen e licencës për punën tonë...**
>
> OSHCG, Serbi

Financuesit vunë re se sfida për të rritur shumën e granteve për disa OSHCG ka qenë historiku i tyre financiar, pasi ato kanë menaxhuar vetëm fonde nga ato më të vogla deri tek ato të mesme. Për të shmangur rrezikun, financuesit zakonisht kërkojnë që organizatat të kenë përvojë në menaxhimin e fondeve të njëjta ose më të mëdha. Edhe pse disa OSHCG kanë kapacitetin për të menaxhuar fonde të mëdha, të tjerët mund të mos kenë. Përsëri, fakti që OSHCG-të janë të shumëllojshme do të thotë që një spektër i gjerë i madhësive të granteve dhe modaliteteve të tyre për shpërndarje mund të plotësojnë nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme.

> **Lloji ideal i financimit do të ishte fondi që ofron stabilitet, qëndrueshmëri dhe mbështetje të vazhdueshme.**
>
> OSHCG, BeH

Kornizat kohore të financimit

Në këtë pjesë diskutohen kornizat kohore të financimit. Përafërsisht gjysma e OSHCG-të intervistuara, kishte marrë në ndonjë moment, **fonde shumëvjeçare (51%)** dhe vetëm një e treta e tyre kishin fonde shumëvjeçare në vitin 2018.[36] Ndërkohë, 46% kurrë nuk kanë pasur fonde shumëvjeçare. Një përqindje më e lartë e OSHCG-ve nga **Shqipëria**, **BeH** dhe **Mali i Zi** kishte marrë fonde shumëvjeçare në vitin 2018 (Grafiku 84). Krahasuar me vendet e tjera, 72% të OSHCG-ve në **Kosovë** kurrë nuk kishin pasur financim shumëvjeçar. Kjo mund t'i atribuohet pjesërisht mostrës mjaft të madhe në Kosovë dhe faktit që pjesëmarrësit e OSHCG në hulumtim përfshinin disa organizata më të vogla, rurale dhe përndryshe të pafavorshme.

[36] Një 1% shtesë ishin të pasigurt (3) dhe 1% refuzuan të përgjigjen (2).

OSHCG-të japin shumë arsye pse është e rëndësishme mbështetja shumëvjeçare. OSHCG-të Kosovare shpjeguan: "Ne kishim më shumë përfitues dhe më shumë mundësi të zbatojmë aktivitetet brenda komunitetit. Kishte gjithashtu hapësirë të mjaftueshme për të kërkuar fonde të reja afatgjata".[37] Në Mal të Zi, mbështetja shumëvjeçare nga Fondacioni OAK ndihmoi Shtëpinë e Sigurt të Grave të qëndrojë aktive dhe të ndjekë prioritetet e saj organizative. Ata gjithashtu mbështetën Qendrën e të Drejtave të Grave në avancimin e kapaciteteve të tyre për ofrimin e shërbimeve. Çështjet që kanë të bëjnë me ngushtim të hapësirës në disa vende janë minimizuar falë financimit shumëvjeçar.

Duke qenë se shumica e granteve kërkojnë dokumente, grantet afatgjata gjithashtu mund të rrisin efikasitetin e OSHCG-ve duke reduktuar ngarkesat administrative, përfshirë kohën e konsiderueshme të burimeve njerëzore, të nevojshme për mbledhjen e fondeve dhe raportimin. Nëse OSHCG-të menaxhojnë vetëm një ose dy grante më të mëdha, afatgjate, ato kanë më pak dokumente se disa grante të vogla, që do të thotë se në vend të kësaj ato mund të përdorin kohën dhe energjinë e tyre në ndryshime shoqërore.

Fondet afatshkurta janë të vështira për t'u përdorur për të arritur qëllimet afatgjata, si reformimi i ligjeve dhe politikave.[38] Pra, financimi afatgjatë që mbulon kostot operative u identifikuan si një preferencë e financimit dhe një nevojë në tërë rajonin. Hulumtimet ekzistuese, financuesit dhe OSHCG-të njëjtë sugjerojnë që financimi afatgjatë ofron stabilitet dhe kontribuon në qëndrueshmërinë organizative. Financimi afatgjatë u lejon OSHCG-ve të zhvillojnë një identitet të fortë organizativ ndërsa ndërtojnë kapacitete të brendshme dhe shkëmbejnë njohuri.[39] Financimi shumëvjeçar mundëson OSHCG-ve të planifikojnë në mënyrë më strategjike si dhe mundëson "vazhdimësi, prosperitet dhe rezultate të mira të garantuara".[40] Një mbështetje e tillë mundëson që OSHCG-të të kenë kohë për të zhvilluar dhe zbatuar strategji që mund t'i rezistojnë ose përshtaten me ndryshimet e papritura në udhëheqjen politike dhe trazirat më të gjera gjeopolitike. Ndryshimet e vazhdueshme në rajon nënkuptojnë që OSHCG-të duhet vazhdimisht të reagojnë ndaj ngjarjeve të reja, shpesh të paparashikueshme. Përgatitja e reagimeve dhe avokimeve tjera për të adresuar çështjet e paparashikuara që ndodhin në lidhje me misionet e tyre jo gjithmonë mund të planifikohen si pjesë e projekteve të tyre dhe mund të kërkojnë kohë të konsiderueshme. Kjo do të thotë që OSHCG-ve mund t'iu merr shumë kohë për të realizuar detyrat ose aktivitetet themelore drejt arritjes së prioriteteve afatgjata.[41] Financimi afatgjatë mundëson fleksibilitet në përshtatjen ndaj ndryshimeve të shpejta që ndodhin në rajon, ndërsa ende u mundëson OSHCG-ve të kenë përparim drejt qëllimeve të tyre afatgjata.

[37] Intervista, OSHCG, Kosovë, 2019.
[38] Intervista, OSHCG, BeH, 2019.
[39] Rönngren, J., 2011, faqe 10.
[40] Intervista, OSHCG, BeH, 2019.
[41] Intervistat e ndryshme, 2019.

Qasjet dhe çështjet e financimit

Ky hulumtim synon të identifikojë cilat modalitete dhe qasje të financimit funksionojnë më së miri në mbështetjen e OSHCG-ve. Mund të gjenden prova të kufizuara shkencore në lidhje me atë se cilat modalitete të financimit kanë më shumë ndikim. Kjo është pjesërisht për shkak të mungesës së përgjithshme të vlerësimeve të nivelit të ndikimit, ose disponueshmërisë së tyre publike. Përkundër mungesës së provave zyrtare, OSHCG-të në të gjithë rajonin ndanë shembuj të asaj se Çfarë u kanë mundësuar atyre të bëjnë modalitetet dhe qasjet e caktuara të financimit. Nënseksionet e mëposhtme shqyrtojnë qasjet dhe çështjet e financimit të idenfikuara në lidhje me financimin thelbësor, kontratat kundrejt granteve, kufizimet financiare, kufizimet e burimeve njerëzore dhe kërkesat e ndarjes së kostove.

> **Mbështetja ideale financiare mbulon kosto të tilla si stafi, në mënyrë që askush nuk do të luftonte vërtet për të siguruar pagën për stafin çdo vit; një mbështetje e cila do ta paguante qiranë.**
>
> OSHCG, Shqipëri

Financimi thelbësor

"Financimi thelbësor" ose "financimi institucional" mbulon kostot operative, si qiraja, shërbimet komunale dhe pagat e stafit. Në mesin e OSHCG-ve të intervistuara, 26% kishin marrë mbështetje thelbësore nga financuesit në vitin 2018, ndërsa 56% jo. Në përgjithësi, 41% raportuan se kishin marrë ndonjëherë mbështetje institucionale. Fakti që Kosova kishte më shumë përgjigje, nga organizatat më të vogla, potencialisht zvogëlonte përqindjen e përgjithshme të OSHCG-ve që kishin pasur ndonjëherë mbështetje thelbësore. Grafiku 85 ilustron që një përqindje më e lartë e OSHCG-ve në Mal të Zi (88%), Serbi (66%) dhe Shqipëri (65%) raportuan se kishin marrë mbështetje thelbësore, ndërsa ka më pak organizata në BeH (47%), Maqedoni t[Veriut (44%) dhe Kosovë (22%) që kishin marrë vetëm ndonjëherë mbështetje thelbësore.

Grafiku 85. OShCG-të që kanë marrë mbështetje thelbësore



Nëse një organizatë ka mbuluar pjesërisht kostot themelore, do të ishte shumë më e lehtë të punohej në ndryshime, duke ndërtuar kapacitetet e punonjësve. [...] Është vështirë të zbatohen aktivitete dhe të kërkohen njëkohësisht mënyrat e financimit dhe mbështetjes së organizatës. Në situatën aktuale financiare, asnjë organizatë nuk mund të ketë ndikimin më të mirë të mundshëm tek përfituesit e tyre sepse ata janë të mbingarkuar me problemet që lidhen me qëndrueshmërinë.

OSHCG, BeH

Mbështetja thelbësore u përmend në mënyrë të përsëritur si një lloj financimi ideal, që u mundëson OSHCG-ve të fokusohen më shumë në ndikim se sa thjesht në mbijetesë. Koha e kaluar në përpjekjet për të siguruar fonde të fragmentuara për operacionet bazë dhe raportimi mbi përdorimin e fondeve të ndryshme të copëtuara morën kohë nga puna e tyre drejt ndryshimeve shoqërore. OSHCG-të

Mbështetja thelbësore është përdorur për të krijuar një hapësirë të sigurt për personat që përjetojnë dhunë me bazë gjinore, për të paguar shërbimet e psikologëve, këshilluesve ligjorë dhe shërbimet e tjera për riintegrim. Pa mbështetje thelbësore, ne nuk do të ishim në gjendje të veprojmë si qendër dhe të ofrojmë shërbime për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje.

OSHCG, Kosovë

të cilat u përgjigjën se ato kurrë nuk kishin marrë mbështetjen themelore thanë se kjo do t'u mundësonte atyre që të zbatonin strategjitë e tyre pa i harmonizuar qëllimet e tyre me ato të donatorëve. Ashtu si me mbështetje shumëvjeçare, ato do të kishin më shumë stabilitet të brendshëm dhe do të ishin në gjendje të zbatojnë aktivitete më të qëndrueshme sesa ad hoc, në komunitetet e tyre. OSHCG-të në BeH, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut gjithashtu indikuan se fondet thelbësore do t'i ndihmojnë atyre të reagojnë më mirë ndaj çështjeve të paparashikuara politike. Për shembull, do të na kishin "ndihmuar [t'i përballojmë] situatat si ajo e mosformimit të qeverisë nëntë muaj pas zgjedhjeve", tha një OSHCG nga BeH. Ashtu si mbështetja shumëvjeçare, mbështetja thelbësore është fleksibile ndaj nevojave të ndryshueshme. Mbështetja themelore, si dhe mbështetja shumë-vjeçare, lejon

[Ne kishim] mundësinë që në mënyrë strategjike të planifikojmë dhe bëjmë plane shumëvjeçare, të zhvillohemi si organizatë, të përcjellim temat dhe të jemi autonome.

OSHCG, Mali i Zi

përshtatje më fleksibile me ndryshimin e nevojave. Donatorët pajtohen, duke theksuar se financimi fleksibël është i rëndësishëm sepse lejon një ndryshim (ose mosekzistim) të afateve,

kështu që prioritetet mund të ndryshojnë në rast të ndryshimeve në grupet e synuara, fushëveprimin dhe / ose rrethanat politike

OSHCG-të që kanë pasur mbështetje thelbësore, dhanë shembuj sa i përket ndryshimeve që ata ishin në gjendje të arrinin. Mbështetja institucionale mundësoi krijimin e një qendre LGBT në Maqedoninë e Veriut dhe një strehimore në Kosovë. OSHCG-të me këtë mbështetje, thanë që ato krijuan hapësirë të sigurt për viktimat e dhunës me bazë gjinore si dhe vendosën ekspertizën mes psikologëve dhe këshilltarëve që ofrojnë shërbime të specializuara.[42] Mbështetja thelbësore u mundësoi atyre që të mbanin stafin dhe në këtë mënyrë të ndërtojnë kapacitete të stafit gjatë kohës, sesa të humbasin stafin tashmë të trajnuar për shkak të mungesës së fondeve. OSHCG-të në Maqedoninë e Veriut, në mënyrë të ngjashme, theksuan rëndësinë e mbështetjes institucionale për arritjen e qëndrueshmërisë, punësimin e një ekipi thelbësor dhe rritjen e kapaciteteve të tyre. Organizatat në Mal të Zi kanë mundur të bëjnë strategji dhe krijojnë në mënyrë të pavarur planin e tyre shumëvjeçar, bazuar në nevojat. OSHCG-të e tjera në rajon që morën këtë lloj të ndihmës ishin në gjendje të krijonin faqet e internetit, të zhvillonin procese të planifikimit strategjik dhe të merrnin pjesë në ngjarje.[43] Kështu, provat sugjerojnë që mbështetja thelbësore ka ndihmuar OSHCG-të të hartojnë dhe zbatojnë strategji organizative, t'iu përshtate çështjeve të paparashikuara sociale dhe politike, avancojnë kapacitetet e tyre të brendshme organizative dhe të forcojë kapacitetet e stafit të tyre.

Vetëm me burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme, OSHCG mund të përqendrohet më shumë në bashkëpunim, ndarjen e përvojave dhe eliminimin e konkurrencës sepse fatkeqësisht e gjithë politika lokale dhe ndërkombëtare, si dhe fonde të kufizuara kontribuojnë që OSHCG të bëhen konkurrencë e njëra-tjetrës dhe të zvogëlojnë potencialin e tyre për veprim të përbashkët

OSHCG, BeH

Fotografia: Marija Jankovic

[42] Intervista, OSHCG, Kosovë, 2019.
[43] Intervista, OSHCG, Maqedoni e Veriut, 2019.

Kontratat kundrejt granteve

Trendi në qasjet e financimit të cilën e vunë re OSHCG-të është përdorimi në rritje të kontratave, sesa të granteve. Shumica e financuesve multilateralë, si dhe disa financues bilateralë dhe fondacionet lokale, përdorin procese tenderuese konkurruese bazuar në fushat e paracaktuara të financimit. Grantet kanë tendencë të jenë më fleksibël sesa kontratat, gjë që u mundëson OSHCG të adresojnë nevojat që ato i shohin si të rëndësishme, si dhe të përshtaten me rrethanat e ndryshueshme. Për dallim nga to, kontratat jo fleksibile mund të pengojnë OSHCG-të për të realizuar prioritetet e tyre strategjike, veçanërisht kur prioritetet e tyre nuk përputhen me ato të identifikuara nga financuesit. Varësia nga burimet mund të kontribuojnë në atë që është quajtur "instrumentalizimi i OSHCG-ve": "Në vend që të vendoset një partneritet aktiv, mund të vendoset një që është i pabarabartë ose i varur e që perceptohet si 'marrëdhënie fëmijë-prind", me anë të cilit financuesit përdorin OSHCG-të vetëm për interesat e tyre sesa të ndërtohet një shoqëri civile e qëndrueshme."[44] Kjo mund të minojë qëndrueshmërinë afatgjate të shoqërisë civile, përfshirë lëvizjen e grave. Pra, OSHCG-të e shprehen shqetësimin se ato gjithnjë e më shumë po shohin se financuesit po përcaktohen më shumë për kontrata sesa grante.

Proceset e prokurimit për kontratat dhe konkurrencës shoqëruese për burimet e kufizuara, gjithashtu mund të minojnë solidaritetin në mes të OSHCG-ve dhe të pengojnë ndërtimin e një lëvizjeje efektive të grave. Qasjet e financimit që mbështesin bashkëpunimin se sa konkurrencën, mund të forcojnë lëvizjen duke OSHCG-të të punojnë së bashku sesa të konkurrojnë kundër njëra-tjetrës.[45] Në këtë kuptim, qasja mjaft unike e Fondacionit Kvinna till Kvinna për partneritete afatgjata u identifikuan si praktikë më e mirë nga OSHCG-të e intervistuara.[46]

Edhe pse financimi thelbësor afatgjatë mbetet i preferueshëm që OSHCG-të të mbeten të fokusuara në vizionet e tyre, në realitetet e tanishme të kontekstit aktual të financimit, disa OSHCG kanë zgjedhur të nënshkruajnë kontrata si eksperte dhe në këtë mënyrë të hynë në treg që në dukje është në rritje për ekspertizën gjinore. Duke pasur parasysh që palët kontraktuese shpesh preferojnë të kontraktojnë individë sesa organizata, mund të jetë e vështirë të sigurohet që burime të tilla mbështesin OSHCG-të. Përveç kësaj, OSHCG-të duhet të jenë të kujdesshme që ngarkesa e shtuar e punës të mos e mbingarkojë organizatën ose ta largojë nga puna drejt arritjes së misionit të saj. Për sa kohë që OSHCG-të kanë politika organizative në lidhje me këtë lloj të punës, në mënyrë që të mos përdoren për përfitime personale por për organizatën, kjo formë e të ardhurave mund të mbështesë OSHCG-të në diversifikimin e fondeve të tyre. Ndërsa kufizojnë potencialisht fleksibilitetin dhe liritë programatike, kontratat mund të mundësojnë një shkallë të caktuar të fleksibilitetit financiar në mënyrën se si përdoren fondet.

Kufizimet financiare dhe kufizimet në kostot e burimeve njerëzore

Përderisa grantet mund të jenë mjaft fleksibile, në varësi të financuesit, OSHCG-të kanë vu re një rritje të kontrolleve të rrepta financiare. Edhe pse shumica e financuesve theksojnë fokusimin në rezultate, OSHCG-të vërejtën që financuesit janë gjithnjë e më të rreptë në kontrollin e çdo centi të shpenzuar për secilin aktivitet dhe në kërkimin e kërkesave për rialokim për çdo ndryshim të vogël të bërë, madje edhe kur nuk kërkohet nga marrëveshjet për grante. Edhe pse transparenca dhe llogaridhënia janë thelbësore, financat

[44] Simbi, M. dhe Thom, G. "'Implementation by Proxy': The Next Step in Power Relationships between Northern and Southern NGOs?" in Lewis, D. and Wallace, T., *New Rules and Relevance: Development NGOs and the Challenge of Change*, Bloomfield, Connecticut: 2000, faqe 222, siç është cituar në Laag, B., *Northern and Southern Non-governmental Organizations and the Development Cooperation of the European Union: Impacts of EU Co-Financing*, University of Twente, School of Management and Governance, faqe 27.
[45] Intervista, OSHCG, Kosovë, 2019.
[46] Intervistat, 2019.

mikro-menaxhuese mbingarkojnë OSHCG-të me shkresat administrative. Kjo u merr gjithë kohën dhe shpërqendron nga avokimi dhe aktivitetet e tjera të tyre, pra edhe nga rezultatet.

Disa financues kanë rregulla të rrepta në lidhje me përqindjen e fondeve që mund të shpenzohet për burime njerëzore. Të tjerët nuk kanë rregulla të shkruara, por praktika udhëzuese të pashkruara, të cilat mund ta bëjnë të vështirë për financuesin të ndajë fonde të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet të burimeve njerëzore të angazhuara në aktivitete të caktuara . Për disa nisma, siç janë avancimi i kapaciteteve të institucioneve, ofrimi i shërbimeve për grupet e cenueshme, hulumtimi ose avokimi, kostot e burimeve njerëzore janë ndër të paktat shpenzime, të nevojshme për të realizuar qëllimet e veprimit. OSHCG-të vunë në dukje se ato shpesh luftojnë për të siguruar burime të mjaftueshme njerëzore për të mbuluar kostot e tyre. Në mënyrë që të pasqyrojnë se çfarë duhet të jetë kosto e burimeve njerëzore si shpenzim programatik, disa financues kanë sugjeruar që OSHCG-të të punësojnë ekspertet sesa të kontraktojnë staf për këtë punë. Kontraktimi i eksperteve nuk kontribuon në avancimin e kapaciteteve të OSHCG-ve ose shfrytëzimin e ekspertizës ekzistuese që ato e kanë. Për më tepër, OSHCG-të konstatojnë se kontraktimi i ekspertëve të jashtëm mund të jetë më i kushtueshëm dhe për këtë arsye edhe përdorim më pak efikas i burimeve të tyre të kufizuara.

Në kriteret thuhet që për mbajtjen e trajnimeve duhet të angazhohen ekspertët, por ekspertët nuk janë pjesë e stafit tonë. Pra, si mendohet se do t'i forcojmë kapacitetet tona dhe fuqizojmë organizatën tonë?

OSHCG, Shqipëri

Kërkesat për ndarje e kostos

Disa financues kërkojnë nga marrësit e granteve të sigurojnë "ndarje të kostos", d.m.th. të kontribuojnë në kostot e projektit. Shumat ndryshojnë në varësi të financuesit. OSHCG-të raportuan se sigurimi i fondeve për kërkesat e ndarjes së kostos ka qenë sfidues, pasi shumë pak financues do të ofrojnë mbështetje për këtë qëllim. Politika, procedurat dhe afatet e ndryshme të financuesve e bëjnë të vështirë koordinimin mes financuesve të ndryshëm, përfshirë edhe ndarjen e kostos. Në fakt, financuesit që përdorin vetëm thirrje të hapura dhe procese të prokurimit kanë mundësi jashtëzakonisht të kufizuara për të kontribuar ndonjëherë në financimin për ndarjet e kostove. Siç ilustrohet në pjesët e mëparshme, shumë pak OSHCG kanë burime të tyre në dispozicion për të kontribuar në këto lloje të kërkesave. Edhe pse disa financues lejojnë që kontributet në natyrë e të dokumentuara mirë të llogariten në ndarjet e kërkuara të kostos, të tjerët nuk e bëjnë. Duke lejuar kontribute në natyrë, financuesit mund t'i japin mundësi OSHCG-ve të përdorin burimet e tyre të brendshme siç janë koha e stafit dhe vullnetarizmi. Megjithatë, kontributet në natyrë që përfshijnë punë të konsiderueshme vullnetare gjithashtu mund të kontribuojnë në shterrim profesional të aktivistëve që punojnë shumë jashtë orarit për të përmbushur përgjegjësitë e tyre dhe dokumentojnë kontributet e tyre në natyrë, përtej kohës që është punuar për pagën e tyre të rregullt.

Financimi i planifikuar në të ardhmen për BP

Hulumtimi synon të identifikojë trendet e financimit në të ardhmen drejt kontributit në diskutime mbi koordinimin e mundshëm të burimeve. Megjithatë, financuesit e ndryshëm të intervistuar kishin tendencë të kenë njohuri të kufizuara në lidhje me planet e tyre të ardhshme të financimit, veçanërisht në **Shqipëri** dhe **Maqedoninë e Veriut**. Pak financues kanë mundur të sigurojnë shuma ose detaje specifike për financim të planifikuar në të ardhmen për BP ose vendet individuale. Disa, si BE dhe Sida, ishin në proces të hartimit të strategjive për shtatë vitet e ardhshme. Ndërkohë, edhe pse buxhetimi vjetor ndihmon financuesit të parashikojnë fondet e përgjithshme në dispozicion, disa thanë se nuk mund të thonë se cilat programe specifike për barazinë gjinore do të aprovohen.[47] Fakti që ata nuk mund të parashikojnë se cilat organizata do të fitojnë proceset e prokurimit, gjithashtu ishte një temë që është përsëritur. Këto gjetje sugjerojnë që shumë pak donatorë kanë përcaktuar/planifikuar fonde për barazi gjinore ose OSHCG, Përveç fondeve të grave.

Në përgjithësi, për ata që kishin disa informata rreth planeve të tyre për financim në të ardhmen, mbështetja në pesë vitet e ardhshme ishte parashikuar të vazhdonte në mënyrë të ngjashme si në të kaluarën. Për financuesit e lartpërmendur që kanë politika dhe qasje që përfshijnë integrimin e perspektivës gjinore në programe, kjo do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme. BE dhe Sida, përmes Fondacionit Kvinna till Kvinna, do të vazhdojnë të mbështesin koalicionin rajonal të OSHCG-ve që punon për të përfshirë perspektivën gjinore në procesin e anëtarësimit në BE dhe për të adresuar diskriminimin me bazë gjinore në lidhje me punën. BE do të vazhdojë mbështetjen e saj përmes UN Women për të adresuar dhunën me bazë gjinore, sipas Konventës së Stambollit. ADA do të vazhdojë të mbështesë OSHCG-të për të avancuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe, përkatësisht, për të adresuar dhunën me bazë gjinore në vendet e tyre, përmes dy rrjeteve rajonale të OSHCG-ve.[48]

Në nivel vendi, programet që synojnë përfshirjen ekonomike, fuqizimin e grave, mikrofinancimin dhe zhvillimin e nismave filantropike raportohet se do të vazhdojnë në **Shqipëri**.[49] Në **BeH**, financuesit planifikojnë të vazhdojnë fokusin në rininë, barazinë gjinore, demokracinë, pajtimin dhe ndërtimin e paqes, së bashku me OSHCG-të dhe gratë në politikë.[50] Në BeH, një financues planifikon të mbështes OJQ-në lokale në organizimin e një akademie që do të përmirësojë zotësinë politike të grave. Zhvillimi i vazhdueshëm i mekanizmave që kanë të bëjnë me drejtësinë që rrisin punësimin e grave dhe përmirësojnë qasjen e tyre në drejtësi mbetet çështje e agjendës në **Kosovë**. Financuesit në Kosovë gjithashtu shpresojnë të rrisin pjesëmarrjen e grave në pozitat vendimmarrëse, si dhe të angazhojnë gratë në programe të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ato mjedisore.[51] Financuesit si në **Maqedoninë e Veriut** ashtu edhe në **Mal të Zi** do të synojnë fushat prioritare si arsimi, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe zhvillimi ekonomik, që do të përfshijnë komponentët e barazisë gjinore.[52] Në **Serbi**, financuesi planifikojnë të mbështesin OSHCG-të që punojnë për të eliminuar dhunën ndaj grave dhe të mbështesin fuqizimin ekonomik të grave.[53]

OSHCG-të deklaruan se ndoshta ato mund të siguronin më shumë burime dhe me cilësi më të mirë nëse do të kishin më shumë mundësi për t'u takuar dhe bashkëpunuar me financuesit (76%); bashkëpunuar më shumë me OSHCG të tjera (62%); marrë më shumë informata rreth burimeve dhe strategjive nga financuesit (59%); dhe angazhuar në avokim me OSHCG-të e tjera për më shumë burime të përbashkëta (52%).

[47] Intervista, financuesi, Maqedonia e Veriut, 2019.
[48] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[49] Intervista, financuesi, Shqipëri, 2019.
[50] Intervista, financuesi, BeH, 2019.
[51] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[52] Intervistat, financuesit, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, 2019.
[53] Intervista, financuesi, Serbi, 2019.

Përveç kësaj, 40% thanë që më shumë mundësi financimi në gjuhën e tyre do të mund të ndihmonte, veçanërisht në BeH (69%) dhe Mal të Zi (50%). Ngjashëm, 41% shprehën interes për identifikimin e fondeve alternative dhe lokale.

Takimet koordinuese raportohet se janë mbajtur mes financuesve në gjashtë vende të BP. Megjithatë, këto zakonisht përfshijnë shkëmbimin e informacioneve sesa përpjekje të koordinuara në aspektin e financimit. Për shembull, në Maqedoninë e Veriut, çdo organizatë dhe shteti ka politikat e veta të brendshme dhe të jashtme, që kanë kontribuar në përpjekje jo kohezive.[54] Financuesit dhe OSHCG-të ngjashëm shprehen shqetësimin në lidhje me aktivitetet dhe financimin e duplikuar. Ata panë bashkëpunim më të strukturuar dhe të shpeshtë si mundësi për të shmangur mbivendosjen dhe për përdorimin më efikas të burimeve të kufizuara. Përderisa bashkëpunimi zyrtar mes financuesve dhe OSHCG-ve disi mungon, financuesit në të gjithë BP treguan se do të interesohen për mundësi të reja për bashkëpunim mes OSHCG-ve dhe financuesve për të krijuar strategji burimesh kolektive dhe mekanizma të financimit. Kjo do të kërkonte, megjithatë, një detyrë disi të frikshme të përafrimit të politikave të jashtme të financuesve bilateralë mbi financimin e zhvillimit ndërkombëtar me ato të BE-së, duke përfshirë ndarjen e fondeve për OSHCG-të autonome. Ciklet e reja të planifikimit dhe strategjitë në zhvillim për dekadën e ardhshme ofrojnë mundësi për përmirësimin e koordinimit, siç pajtohen si OSHCG-të ashtu edhe financuesit .

Kutia 7. Fushat tematike që nuk janë financuar mjaftueshëm

Fuqizimi ekonomik i grave
Adresimi i dhunës me bazë gjinore
Të drejtat ekonomike, social dhe kulturore (DESK)
Udhëheqja, fuqizimi dhe pjesëmarrja politike e grave
Qasja në arsim
Shëndeti
Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar
Ndërtimi i paqes
Të drejtat për punë dhe të punëtorëve
Trafikimi i qenieve njerëzore
Arti
Të drejtat për tokë, pronë dhe banim
Demokracia dhe qeverisja
Punë humanitare dhe në situata emergjente
Migrimi
Të drejtat mjedisore dhe drejtësia
Të drejtat LGBTQIA+
TIK
Të drejtat seksuale ose të kujdesit shëndetësor

Komunikimi dydrejtimësh ndërmjet financuesve dhe OSHCG-ve mund të lidhë më mirë objektivat globale me nevojat lokale dhe nismat mikro. OSHCG-të kanë nevojë për mbështetje financiare dhe organizatat ndërkombëtare kërkojnë ekspertizë lokale.[55] Pra, bashkëpunimi me OSHCG-të që dallojnë në madhësi, fusha të ekspertizës, kapacitet të qasjes, vendndodhje gjeografike dhe fokus tematik mund të krijojnë një larmi partneritetesh të afta për të përmbushur një sërë nevojash.[56] Ndoshta financuesit kryesorë si BE dhe Sida mund të konsiderojnë inicimin e përpjekjeve koordinuese më të gjera, kështu që financuesit dhe OSHCG-të mund të bashkëpunojnë në nisma më efikase, efektive dhe me ndikim.

[54] Intervista, financuesi, Maqedoni e Veriut, 2019.
[55] Intervista, financuesi, Maqedoni e Veriut, 2019.
[56] Rönngren, J., 2011, faqe 8.

Përfundimi: Trendet e financimit

Financuesit kanë tendencë që mos të kenë sisteme për të përcjell financimin për të drejtat e grave, barazinë gjinore, përkatësisht OSHCG-të. Përdorimi i integrimit të perspektivës gjinore komplikon matjen e fondeve të alokuara ose të shpenzuara. Sipas të dhënave të OSHCG, fondet duket se kanë rënë nga viti 2014 deri në 2016, por janë rritur në vitin 2017 dhe 2018. Pavarësisht kësaj, 35% e OSHCG-ve nuk kanë përmbushur buxhetin e tyre në vitin 2018. Shumica (82%) kanë pasur periudha në të cilat nuk kishin burime të mjaftueshme dhe 9% kurrë nuk morën kurrfarë fonde, por në vend të kësaj punonin vullnetarisht. Mungesat e fondeve bënë që OSHCG-të të vononin pagesat, të kenë staf që punon pa pagesë, të ndërpresin programet dhe madje të mbyllnin dyert e tyre. Më pak se gjysma kishin plane rezervë në rast se humbnin fonde.

Deri më tani, fusha tematike më e financuar ishte adresimi i dhunës me bazë gjinore, duke përbërë të paktën 27% të të gjitha fondeve. Financimi duket se është përqendruar në çështje që OSHCG-të kanë tendencë t'i konsiderojnë si prioritete. Megjithatë, disa fusha dalin se nuk kanë marrë mbështetje adekuate financiare (Kutia 7). Pak OSHCG kanë marrë fonde të dedikuara për grupe specifike të synuara dhe fondet për disa grupe të margjinalizuara si persona me aftësi të ndryshme ose persona që pësojnë dhunë, mund të jenë të pamjaftueshme. OSHCG-të priren ti japin prioritet avokimit dhe ofrimit të shërbimeve si strategji. Financimi në dispozicion për këto strategji duket i pamjaftueshëm, si dhe për hulumtime, shërbime juridike dhe psikoterapi.

Fakti që OSHCG-të janë të shumëllojshme sugjeron që një spektër i gjerë i madhësive të granteve dhe modaliteteve të tyre për shpërndarje mund të plotësojnë nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme. Financimi shumëvjeçar dhe mbështetja thelbësore mund të kontribuojnë në veprime strategjike afatgjata, ndryshimeve pozitive që kërkojnë angazhim afatgjatë, fleksibilitet mes situatave të ndryshimeve sociale dhe politike, kapaciteteve të ngritura dhe qëndrueshmëri organizative. Përdorimi i kontratave, për dallim nga grantet, mund të çojë në instrumentalizimin e OShCG-ve për interesa të donatorëve dhe të undermine bashkëpunimin drejt ndryshimit shoqëror. Kufizimet në kostot e burimeve njerëzore mund të minojnë zhvillimin e kapaciteteve dhe efikasitetin e OSHCG-ve. Kërkesat për ndarjen e kostove mund të jenë shumë të vështira për të përmbushur nga OSHCG-të.

Siç ka theksuar AWID, modalitetet më të dobishme janë ato që lejojnë fleksibilitet dhe që organizatat të vendosin se si të shpenzojnë më mirë fondet. Gjetjet sugjerojnë se "një koktej modalitetesh" që përfshin fonde fleksibile, mbështetje thelbësore, grante për projekte shumëvjeçare dhe dhënie të nën-granteve për nisma më të vogla, mund të sigurojë një "ekosistem" të shëndoshë të financimit që mbështet zhvillimin e një lëvizjeje të ndryshme, të shumanshme të grave.

Përveç fondeve të grave, financuesit prireshin të mos kenë plane të qarta për financimin në të ardhmen. Përmirësimi i koordinimit të donatorëve dhe komunikimi me OSHCG-të e ndryshme në lidhje me nevojat e tyre mund të kontribuojë në veprimet më të suksesshme në rajon.

PSE DUHET MBËSHTETUR OSHCG-TË?

Ky kapitull shqyrton gjetjet që lidhen me pyetjen e hulumtimit: "Cila është rëndësia e mbështetjes së OSHCG-ve dhe lëvizjeve të grave, në qoftë se ka?" Përtej zotimeve sa i përket politikave dhe të tjera zotimeve të bëra nga financuesit, paraqitur në Hyrje, kapitulli diskuton arsyet për mbështetjen e OSHCG-ve, përfshirë krijimin e demokracive funksionuese dhe të drejtat e njeriut; adresimin e pabarazive gjinore të vazhdueshme në BP; ofrimin e shërbimeve thelbësore të përfitimit publik; dhe nxitjen e ndryshimeve pozitive shoqërore. Pastaj, bazuar në kriteret e OECD DAC, kapitulli paraqet pikëpamjet e financuesve të intervistuar rreth rëndësisë, efikasitetit, efektivitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së OSHCG-ve. Më poshtë vijon një diskutim i shkurtë mbi financimin e OSHCG-ve, OJQN-ve, financuesve multilateralë dhe/ose organizatave tjera.

Forcimi i përpjekjeve drejt demokracisë dhe të drejtave të njeriut

Situata politike në BP po kontribuon në ngushtimin e hapësirës për OSHCG-të dhe aktivistët, fizikisht, politikisht dhe financiarisht.[1] Jo vetëm që konservatorizmi në rritje përfshinë kërcënime kundër punës dhe mirëqenies së tyre; kjo gjithashtu do të thotë se disa OSHCG kanë vështirësi për t'u qasur burimeve nga disa financues lokal që ekzistojnë në vendet e tyre, siç janë qeveritë dhe qytetarët. Konteksti aktual politik e bën të pamundur që partitë e sapo zgjedhura në rajon do të drejtojnë fonde të konsiderueshme shoqërisë civile, përfshirë OSHCG-ve. Prandaj, përkundër përpjekjeve për të diversifikuar fondet, OSHCG-të kryesisht mbështeten në fondet e huaja për të mbështetur përpjekjet e tyre për avancimin e barazisë gjinore. Financimi i vazhdueshëm i huaj mund të jetë thelbësor për mbijetesën e OSHCG-ve, të paktën për të ardhmen e afërt.

> **Organizimi di të jetë i vështirë, veçanërisht në kontekstet armiqësore. Kërkon guxim dhe diplomaci.**
>
> OSHCG, Maqedoni e Veriut

Mbështetja e OSHCG-ve në kontekstet politike ku demokracia dhe të drejtat e njeriut janë të rrezikuara, është e rëndësishme pasi OSHCG-të shpesh janë ndër grupet më aktive të shoqërisë civile që i kundërvihen nacionalizimit dhe konsevatorizimit që janë gjithnjë e më shumë në rritje, si dhe luftojnë kundër ngushtimit të hapësirës. Pra, mbështetja e OSHCG-ve mund të kontribuojë në forcimin e përpjekjeve për avancimin e qeverisjes së mirë, luftimin e korrupsioni dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e grave. Duke përdorur avokimin, OSHCG-të kanë qenë efektive në ngritjen e vetëdijes për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe mbajtjen e qeverisë përgjegjëse për t'i adresuar më mirë këto.[2] Në kontekstin e anëtarësimit në BE, mbështetja e OSHCG-ve kështu mund të kontribuojë në synimet e BE-së për të mbështetur qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit,[3] ndër kërkesat themelore për anëtarësimin në BE, të përcaktuara në Kriteret e Kopenhagës.[4]

---

[1] Shih: Konteksti politik.
[2] Intervista, financues rajonal, 2019.
[3] KE, "Upholding the Rule of Law".
[4] KE, "European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations".

Ekzistojnë pabarazi serioze në çdo nivel, veçanërisht midis grupeve të margjinalizuara.

OSHCG, Maqedoni e Veriut

OSHCG-të adresojnë pabarazitë dhe padrejtësitë e vazhdueshme

Pabarazitë gjinore mbeten të përhapura në BP.[5] Gratë janë të nënpërfaqësuara në të gjitha nivelet e qeverisë dhe proceset e vendimmarrjes.[6] Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore është dukshëm ende më e vogël nga pjesëmarrja e burrave.[7] Gratë posedojnë dukshëm më pak prona dhe pak biznese sesa burrat.[8] Diskriminimi me bazë gjinore në lidhje me punën është shumë i përhapur.[9] Dhuna ndaj grave mbetet ende mjaft e përhapur.[10] Gratë rome dhe gratë me aftësi të ndryshme përballen me diskriminim të dyfishtë dhe të trefishtë.[11]

Fotografia: Marija Jankovic

Më 8 mars 2015 në Beograd, aktivistet për të drejtat e grave rome pyetën: "Kur do të vijnë ditë të mira për gratë rome?".

Këto sfida të konsiderueshme kërkojnë angazhim strategjik, të vazhdueshëm, afatgjatë për të sjellë ndryshime sociale. OSHCG-të janë ekspertë me përvojë të gjerë në adresimin e pabarazive të tilla, duke përfshirë përvojën në propozimin e ndryshimeve specifike ligjore dhe të politikave për t'i sfiduar ato sistematikisht.[12] Adresimi i këtyre pabarazive të vazhdueshme drejtë një shoqërie të barabartë, të drejtë, kërkon fonde.[13]

---

[5] Kvinna till Kvinna, *Women's Rights in the Western Balkans*, 2019.
[6] Po aty. Përjashtimi i vetëm është qeveria e Shqipërisë ku gratë përfaqësohen në mënyrë të barabartë (faqe 4, 9).
[7] RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore në vendin e punës në Ballkanin Perëndimor* , Prishtinë: RrGK, 2019.
[8] Për Shqipërinë, gratë zotërojnë vetëm 19% të pronës (Agjencia Kadastrale Shtetërore, cituar nga BIRN Shqipëri, Sinoruka, F., *Paligjshmëria dhe tradita u mohojnë të drejtën e pronës grave dhe vajzave në Shqipëri* , 6 gusht 2019; dhe kishin në pronësi 29.7% të bizneseve në vitin 2017 (INSTAT, *Women and Men 2017*, INSTAT, 2018. Në Mali të Zi, gratë kanë në pronësi vetëm 4% të shtëpive, 8% të tokës dhe 14% të shtëpive të pushimeve; më pak se 10% të kompanive janë në pronësi të grave, dhe gratë fitojnë rreth 14% përqind më pak se burrat që kryejnë punë me vlerë të barabartë (Federata Malazeze e Punëdhënësve dhe Raporti E3 Consulting LLC, Women in Management në Mali të Zi, shkurt 2019, faqe 3, 5). Në Maqedoninë e Veriut mungojnë të dhënat përfaqësuese të sakta. Për Serbinë, shihni: Zyra e Statistikave të Republikës së Serbisë, *Gratë dhe burrat në Republikën e Serbisë* , 2017.
[9] RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore në vendin e punës në Ballkanin Perëndimor* , 2019.
[10] OSBE, *OSCE-led Survey on Violence Against Women: Main Report*, OSBE, 2019.
[11] Shih për Shqipërinë: KE, SWD, *Albania 2019 Report*, SWD (2019) 215 final, Bruksel 2019. Për Mali të Zi, "Ombudsman of Mali i Zi: The Social Exclusion of Roma Goes Unreasonably Long", *Portal Vijesti*, ANTENAM.NET, 8 prill 2019 (në gjuhën malazeze). Për Serbinë: Roma Centre for Women and Children DAJE, *Gender Based Violence against Roma Women and the Availability of Support Services*, Beograd: 2019 (në gjuhën serbe); Avokati i Popullit i Serbisë, *Ombudsman Special Report on the Reproductive Health of Roma Women, with Recommendations*, 2017; Avokati i Popullit i Serbisë, *Special Report of the Ombudsman in the Implementation of the Strategy for the Social Inclusion of Roma Men and Women, with Recommendations*, 2019; dhe Avokati i Popullit i Serbisë, *Special Report of the Ombudsman Accessibility for All*, 2018.
[12] Intervistat, OShCG-të, Shqipëri, BeH, Maqedonia e Veriut, 2019.
[13] Intervistat, OSHCG, BeH, 2019.

OSHCG-të si ofrues të shërbimeve

Ekzistojnë dëshmitë për ndikimin e OSHCG-ve në ndryshime politike dhe sociale në gjithë botën, veçanërisht në lidhje me adresimin e dhunës ndaj grave.[14] Në mënyrë të ngjashme, OSHCG-të kanë kontribuar në disa ndryshime sociale në BP, të ilustruara në këtë pjesë, që dëshmon se të mbështetësh OSHCG-të nënkupton të investosh në ndryshime sociale. OSHCG-të kanë **ofruar shërbime**, veçanërisht në mungesë të shërbimeve shtetërore dhe kanë avokuar për ndryshime konkrete legjislative dhe ato të politikave.[15] Disa kanë përvojë deri në 30 vjet të ofrimit të shërbimeve për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë. Në të gjithë rajonin, ato kanë fuqizuar mijëra gra të largohen nga dhunuesit, të mësojnë strategji për të përballuar traumën dhe, shumë prej tyre të jetojnë në mënyrë autonome. Për më tepër, asisitmi i grave drejtpërdrejt përmes menaxhimit të rasteve, mbështetjes psikologjike dhe ndihmës juridike i ka mundësuar OSHCG-të të luajnë një rol të rëndësishëm mbikëqyrës, të monitorojnë se si institucionet i trajtojnë rastet dhe të mbajnë institucionet përgjegjëse për të zbatuar kornizat ekzistuese ligjore. Ekspertiza e mbledhur gjatë viteve të punës gjithashtu ka bërë që OSHCG-të të jenë të pozicionuara mirë për të kontribuar në ndryshimet thelbësore të shumta ligjore dhe të politikave që kanë përmirësuar mbrojtjen për personat që kanë përjetuar dhunë. Kjo përfshin ligje kundër dhunës në familje, si futja e dhunës në familje si vepër penale brenda kodeve penale, dhe përcaktimi i rregulloreve specifike për trajtimin e duhur të personave që përjetojnë dhunë (shih Kutinë 8).

> **I gjithë progresi në lidhje me mbrojtjen, legjislacionin, parandalimin dhe ndryshimet e qëndrimit në lidhje me dhunën me bazë gjinore mund tu atribuohen organizatave për të drejtat e grave. Legjislacioni nuk do të ekzistonte pa organizatat e grave.**
>
> Financues rajonal

Lidhur me këtë, OSHCG-të kanë qenë instrument në **mbështetjen e komuniteteve të cenuara,** duke avancuar kështu të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut.[16] Për shembull, në Serbi, OSHCG-të kanë ofruar shërbime për pakicat, që u mundësoi atyre të luajnë rolin a mbikëqyrësit në drejtim të mbështetjes së mbrojtjes së të drejtave të njeriut.[17] Në Mal të Zi, OSHCG-të siguruan strehim për refugjatët në veri të vendit.[18] Ato kanë mbështetur krijimin e rrjeteve të grave rome.

OSHCG-të kanë kontribuar në **fuqizimin socio-ekonomik të grave**, si duke mbështetur kompanitë fillestare (BeH), ofruar trajnime profesionale dhe duke mundësuar që shumë gra të hapin bizneset e tyre private (Kosovë dhe Maqedoni e Veriut).[19]

---

[14] Htun M. and Weldon, L.
[15] Në Shqipëri dhe Kosovë, ku shteti nuk ka ende kapacitet të përgjigjet në mënyrë të duhur ndaj nevojave të grave ishte një trend i përsëritur (Intervistat 2019).
[16] Intervistat, OShCG-të, Shqipëri, Kosovë, 2019.
[17] Intervista, OSHCG, Serbi, 2019.
[18] Intervista, OSHCG, Mali i Zi, 2019.
[19] Intervista, OSHCG, 2019.

OSHCG-të si krijuesit e ndryshimeve

OSHCG-të kanë ndihmuar **vendosjen e çështjeve kyçe në agjendat për ndryshimet sociale**, të tilla si të drejtat pronësore të grave, dhuna në familje, dhuna seksuale dhe drejtësia për të mbijetuarit e dhunës seksuale. Ato kanë pasur rol të rëndësishëm në sjelljen e këtyre temave, deri tani, të injoruara ose tabu në vëmendjen e politikanëve dhe financuesve, duke nxitur kështu veprime që të adresohen këto çështje. Për shembull, në Mal të Zi, fushata e "#Unwanted (#Nezeljena)" e lansuar nga Qendra e të Drejtave të Grave, theu kodin joformal të heshtjes që rrethonte abortin gjinor, duke u bërë thirrje autoriteteve të trajtonin këtë fenomen.[20] Në Kosovë, të flasësh për dhunë seksuale gjatë luftës ishte e padëgjuar derisa aktivistët marshuan e kënduan këngë emocionuese me 8 mars, në melodinë e "We Shall Overcome" ["Do ta tejkalojmë*]. Kjo ngjalli reagimin e menjëhershëm parlamentar dhe qeveritar për një çështje që nuk u diskutua më parë në sferën publike.[21] Një video për ngacmim seksual dhe aplikacionet si "EcShlirë" të dizajnuara nga kodueset e kompjuterëve, sollën vëmendjen e publikut në këtë temë deri atëherë tabu. Ngjashëm, në Maqedoninë e Veriut, fushata "Me Too" nxiti diskurs publik dhe ministritë i bashkuan përpjekjet për të dënuar ngacmimin seksual.[22] OSHCG-gjithashtu vendosën të drejtat e pronës dhe trashëgimisë në agjendën publike. Në disa vende, OSHCG-të kanë përkrahur progresin në të drejtat e LGBTQIA+.

> **Aktivistet e grave po fillojnë biseda të vështira. #metoo në Maqedoninë e Veriut ngriti çështjen e dhunës seksuale dhe mori mbështetje nga ministritë. Diskutimet publike filluan në lidhje me temat tabu, si ato për transgjinorët, dhuna seksuale, etj.**
>
> Financues, Maqedoni e Veriut



Një video në lidhje me ngacmimin seksual që ka përjetuar një grua e re gjatë një dite në Prishtinë bëri që qytetarë të ndryshëm të ngriheshin kundër fenomeneve dhe të hapin temën për diskutim në diskursin publik.

[20] Shih faqen e interneti të Women's Rights Centre .
[21] Shih protesta e RrGK-së për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës Protesta e RrGK-së.
[22] Ministritë e arsimit dhe shkencës, punës dhe politikës sociale dhe punëve të brendshme e dënuan atë në faqet e tyre në Facebook.

Aktivistet feministe Llepa Mlagjenoviq dhe Ola Ilkiq kundër femicidit në Beograd 2017.

OSHCG-të kanë **ngritur vetëdijesimin** në gjithë rajonin e BP. Në Serbi, OSHCG-të kanë ngritur vetëdijen për të drejtat e grave dhe gjuhën e ndjeshme gjinore;[23] ngacmimin seksual, duke kërkuar veçanërisht mbrojtje të shtuar të studenteve nga ngacmimi seksual në universitete;[24] dhe për faktin që femicidi është krim i urrejtjes me bazë gjinore.[25] Në Kosovë, të dhënat e sondazhit sugjerojnë që OSHCG-të kanë kontribuar në rritjen e njohurive lidhur me rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të grave,[26] si dhe format e dhunës në familje.[27] Në Shqipëri, OSHCG-të ngritën vetëdijen për feminizmin dhe të drejtat LGBTQIA+.

OSHCG-të kanë kontribuar në ndryshim social **duke forcuar lëvizjen e grave dhe duke mobilizuar më shumë njerëz** për të kërkuar të drejta të avancuara për gratë. Ndryshimet në njohuritë dhe angazhimi përcjellës qytetar

> **Protestat e 8 marsit janë shembull i efektit të punës për avancimin e të drejtave të grave me kalimin e kohës.**
>
> Financuesi, Kosovë

[23] Intervista, OSHCG, Serbi, 2019.
[24] Media coverage Mbulimi mediatik i fushatës (në gjuhën serbe).
[25] Përkufizimi i femicidit si "vrasje me dashje të femrave (grave ose vajzave) sepse janë femra" ishte i panjohur, i pa adresuar dhe i padukshëm në Serbi derisa OShCG-të e sollën atë në vëmendjen e shoqërisë dhe vendimmarrësve WCSOs brought it to the attention (në gjuhën serbe).
[26] Zeqiri, D., *Midterm National Survey on Property Rights*, Tetra Tech, 2017.
[27] Rritja e ndërgjegjësimit dëshmohet nga të dhënat e anketës së familjeve me krahasim RrGK, *Siguria fillon në shtëpi* , Prishtinë: RrGK, 2008; dhe në *Nuk ka arsyetim*, të RrKG-së, Prishtinë: 2015.

për avancimin e të drejtave të grave janë të dukshme në Kosovë dhe Shqipëri. Për shembull, RRGK ka organizuar protesta në Ditën Ndërkombëtare të Grave (8 mars) që nga viti 2000, duke sjellë vëmendjen e popullatës tek një shkelje specifike të të drejtave të grave çdo vit. Ndërsa këto filluan si protesta që përfshinin një grup të aktivistëve të përkushtuar, që nga viti 2014 ato janë rritur vazhdimisht ku u angazhuan mijëra protestues, përfshirë burra, të rinj dhe fëmijë, duke u solidarizuar me kërkesat e grave. Protestat gjithnjë e më përfshirëse tani përfshin pankartat në gjuhë të ndryshme dhe me mesazhe të krijuara me kujdes nga një grup i organizatorëve vullnetarë. Ndërkohë, përhapja e protestave të ndryshme për të drejtat e grave në qytete jashtë Prishtinës, dëshmon për rritjen e lëvizjes. Në mënyrë të ngjashme, në Mal të Zi, OSHCG-të kanë organizuar një Marsh të Grave në rritje të vazhdueshme dhe debate për të drejtat e grave në Ditën Ndërkombëtare të Gruas.[28]

Fotografia: RrGK

"Marshojmë, s'festojmë!" Aktivistë të ndryshëm protestojnë më 8 mars 2017 në Prishtinë, Kosovë.

Foto: Rrjeti kombëtar për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave

Platforma për Barazi Gjinore organizon një prostestë më 8 mars 2020 në Shkup, Maqedoni Veriore.

Fotografia: AWEN

Anëtaret e AWEN, ndër të tjerët, protestuan më 8 mars 2020 në Tiranë, Shqipëri.

[28] Gratë malazeze marshojnë në Ditën Ndërkombëtare të Grave (në gjuhën malazeze).

OSHCG-të kanë ofruar ekspertizë, **duke thelluar më tej njohuritë dhe kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë**, ndër të tjera, lidhur me barazinë gjinore. Për shembull, në Serbi, OSHCG-të kanë ndihmuar në trajnimin e studentëve dhe të punonjësve të subjekteve shtetërore në lidhje me lëvizjen e grave dhe barazinë gjinore,[29] si dhe zyrtarëve për dhunën në familje.[30] OSHCG-të në Kosovë kanë trajnuar dhe mentoruar zyrtarët publikë në zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Në Mal të Zi, OSHCG-të trajnuan zyrtarët gjyqësor dhe publikë se si të zbatojnë standardet e Konventës së Stambollit dhe CEDAW në praktikë.[31]

Mes konflikteve etnike, fetare dhe kombëtare, të shoqëruara nga barriera të gjera sociale, fizike dhe gjeografike, OSHCG-të kanë **kaluar kufijtë dhe promovuan paqe**. Gjatë viteve të 90-ta, mes luftërave në BP, gratë në gjithë rajonin u angazhuan tek Gratë në të Zeza, duke bërë thirrje për paqe.[32] Këto përpjekje vazhduan pas luftës me shkëmbime mes OSHCG-ve në rajon, për të diskutuar përvojat e tyre personale dhe për të hapur diskutime thelbësore për trajtimin e së kaluarës. Përmes Koalicionit të Grave për Paqe, Rrjeti Gratë në të Zeza-Serbi dhe RrGK u mblodhën bashkë gratë serbe dhe shqiptare për të diskutuar përvojat e tyre. Kërkimi i parë publik i faljes nga Gratë në të Zeza për krimet e kryera nga Serbia në Kosovë u transmetua në Radiotelevizionin 21.[33] Shumë kosovarë e identifikuan si një moment krucial drejt krijimit të një themeli për paqe dhe dialog. Lobi Rajonal i Grave për paqe dhe siguri në Evropën Juglindore bashkoi aktivistët e OSHCG dhe gratë politikane në hartimin e deklaratave publike drejt paqes për çështje të ndryshme në rajon mes negociatave zyrtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.[34] Gjykata e Grave për ish-Jugosllavinë bashkoi OSHCG-

> **Gratë ishin katalizatore të para në procesin e ndërtimit të paqes, edhe gjatë luftës e veçanërisht pas saj dhe lëvizja e paqes në BeH me të drejtë mund të quhet lëvizja e grave për paqe.**
>
> Financues, BeH

> **Ne kemi kontribuar në ndërtimin e paqes, në dialogun ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe kemi angazhuar popullatën tonë. Organizuam konferenca me komunitetet në temën e pajtimi.**
>
> OSHCG, Kosovë

[29] Intervista, OSHCG, Serbi, 2019.
[30] Mbrojtësi i qytetarëve, *Special Report of the Protector of Citizens on Training for Acquisition and Improvement of Knowedge and Competencies in the Prevention and Suppression of Domestic and Intimate Partner Violence and Protection of Women from Such Violence*, Beograd, 2016, faqe 31, 37.
[31] Qendra për Trajnime në Gjyqësi dhe Prokurori Publike, *Annual Report on the Work of the Centre for Training in Judiciary and State Prosecution for Year 2018*, Podgorica, 2019, faqe 42.
[32] Për dëshmi më të fundit, shih: Aljazeera Balkans, "*Žene u crnom' u Beogradu odale počast žrtvama genocida u Srebrenici*" [Gratë në të Zeza në Beograd i nderojnë viktimat e gjenocidit të Srebrenicës], 2019 (në gjuhën serbë); dhe Balkan Insight, "*Srbija: Aktivisti za ljudska prava odali počast Albancima, ratnim žrtvama sa Kosova*" [Serbia: Aktivistët e të Drejtave të Njeriut i përkujtojnë viktimat shqiptare të Kosovës], 2019 (në gjuhën serbe).
[33] Koalicioni i grave për paqe, *Through Women's Solidarity to a Just Peace*, 2007, faqe 4.
[34] Shih për shembull "Letter to Soren Jessen Petersen, Special Representative of the UN Secretary General in Kosovë" nga RrGK, 2005; "Letter of Support for Activists in Serbia" nga RrGK, 2006; dhe "Letter to Ahtisaari, UN Special Envoy for the future status process for Kosovo" nga RrGK, 2006.

të në një qasje restauruese të drejtësisë në lidhje me dhunën seksuale të kryera gjatë luftë.[35] RrGK, Artpolis dhe Qendra për Vajza në Serbi kanë organizuar shkolla verore feministe dhe tubime të grave të reja në Kosovë dhe Serbi, duke thyer barrierat midis të rinjve. Sandglass në Serbi dhe Shoqata e Grave të Mitrovicës në Kosovë kanë sjellë së bashku aktivistet dhe gratë politikane për të diskutuar negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.[36] Dera e Hapur dhe Ruka Ruci kanë bashkuar gratë serbe dhe shqiptare në Kosovë, ku kanë dialoguar për nevojat lokale. Që nga viti 2000, në rajon janë krijuar disa koalicione formale dhe joformale të OSHCG-ve, duke ndërtuar bashkëpunim paqësor ndërkufitar për çështjet që përfshijnë dhunën në familje, anti-trafikimin, përfshirjen e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE, adresimin e diskriminimit me bazë gjinore në vend të punës dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Fotografia: *Nicole Farnsworth*

Në vitin 2007, anëtarët e koalicionit të grave për paqe nga Kosova dhe Serbia u bashkuan në një protestë në Strugë, më pas në Maqedoni, për të kërkuar paqe.

[35] Amnesty International, *"Wounds that Burn Our Souls" Compensation for Kosovo's Wartime Rape Survivors, But Still No Justice*, Amnesty International, 2017, faqe 48.

[36] Për shembull, shih: faqen e internetit të Pescanik, "Public Discussion on Women's Participation in the Belgrade - Pristina Negotiations in Kosovo Mitrovica" (në gjuhën serbe), 2019.

Fotografia: *Nicole Farnsworth*

Më 8 mars 2006, aktivistët marshojnë nëpër borë në Prishtinë, Kosovë, për të kërkuar pjesëmarrjen e grave në negociatat midis Kosovës dhe Serbisë.

OSHCG-të kanë **ndihmuar gratë të hyjnë në politikë**.[37] Ato kanë angazhuar më shumë gra në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal, fuqizuar gratë që të marrin pjesë dhe kështu kontribuuan në demokraci. Në Kosovë, Lobi për Barazi Gjinore ka ndikuar në rritjen e numrit të grave që hyjnë në politikë në të gjitha nivelet. Përmes fuqizimit, trajnimit, avokimit për kuotat dhe promovimit të grave kandidate të ndryshme, OSHCG-të kanë kontribuar në rritjen e numrit të grave në politikë dhe vendimmarrje në vendet e tyre.[38]

OSHCG-të kanë **kontribuar në disa ndryshime kyçe ligjore dhe të politikave** në vendet e tyre (shih Kutinë 8).

[37] Intervista, financues, Kosovë, 2019.
[38] Për kuotat, shih Kutinë 8.

Kutia 8. Ndryshimet ligjore që i atribuohen pjesërisht ose tërësisht OSHCG-ve[39]

Shqipëri

- OSHCG-të kanë bërë presion që ka rezultuar me sukses për përfshirjen e kuotës gjinore në Kodin Zgjedhor.[40]
- Iniciuan dhe ndikuan në hartimin e Ligjit për Masat kundër Dhunës në Familje në Marrëdhëniet Familjare dhe ndryshimet e këtij ligji.[41]
- Iniciuan hartimin dhe dhanë kontribut në Ligjin nr. 8876 për Shëndetin Riprodhues.
- Kontribuuan në hartimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 10221 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"; Ligjit nr. 10237 "Për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe Ligjin nr. 10295 "Mbi faljen".
- Informuan "Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020".
- Kontribuuan dhe ndikuan në Ligjin nr. 9355 "Për ndihmën dhe shërbimet sociale".

BeH

- Iniciuan krijimin e komisioneve për barazi gjinore nëpër komuna.[42]
- Avokuan për Ligjin për Barazi Gjinore.[43]
- Luftuan me sukses që buxheti publik për shtëpi të sigurta për viktimat e dhunës të përfshihet në ligjet për mbrojtjen nga dhuna në familje.[44]
- Bënë thirrje me sukses që Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje në Republikën Serbe45 dhe Kodi Penal i Republikës Serbe të harmonizohen me standardet ndërkombëtare nga Konventa e Stambollit.
- Avokuan për ligjet e entiteteve dhe ato kantonale për ndihmë juridike falas për të njohur gratë të mbijetuara të dhunës si përfituese.46
- Kontribuuan në strategjitë të nivelit të entiteteve, planet e veprimit për luftimin e dhunës në familje, të informuar nga hulumtimi i OSHCG-ve në të gjithë BeH.47
- Luftuan me sukses që Ligji për Zgjedhje i BeH të njohë kuotën e detyrueshme gjinore.48
- Kontribuuan në zhvillimin e protokolleve lokale për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në të gjithë BeH që përfshin ofruesit e shërbimeve të specializuara të OSHCG për mbështetjen dhe ndihmën e të mbijetuarve.49

---

[39] Kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse; është përpiluar bazuar në intervistat dhe të dhënat nga OShCG-të.

[40] Artikujt që shpjegojnë kërkesat e bëra nga OSHC-të për një kuotë gjinore të përfshirë më vonë në Ligjin për Barazinë Gjinore në Shqëri , nr. 9970, 2008.

[41] Për Ligjin Law on Measures Against Domestic Violence in Family Relations, no. 9669, 2006, and Amendments of the Law on Measures Against Domestic Violence in Family Relations, 2018, evidence of WCSOs advocacy.

[42] Law on Gender Equality in Bosnia and Herzegovina, Official Gazette of BiH nr. 16/03 dhe 102/09.

[43] Të drejtat për të gjithë (i njohur atëherë si të drejtat globale) koordinuan një koalicion prej rreth 200 OSHC të ndryshme (përfshirë OShCG-të) që avokuan për krijimin dhe miratimin e Ligjit për Barazi Gjinore (korrespodencë, janar 2020).

[44] Fondacioni Gratë e Bashkuara Banja Luka, *Financing of the Safe Houses in the Bosnia and Herzegovina, research and recommendations* (në gjuhët B-H-S) 2009.

[45]Proposal for Changes and Amendments of the Law on Protection from Domestic Violence in the Republika Srpska, 2019 (në gjuhën boshnjake).

[46] Foundation United Women, Proposal for Improving Access to Free Legal Assistance in the Republika Srpska, 2019 (në gjuhën boshnjake).

[47] Qeveria e Republikës Serbe, Information on Implementation of the Strategy for Combating Domestic Violence in the Republika Srpska Informacion mbi zbatimin e Strategjisë për Luftimin e Dhunës në Familje në Republikën Serbe(2014 -2019) për 2015 dhe 2016, 2017 (në gjuhën boshnjake); Gheender Centre of Federation BeH Government, Information on Development of the Federation BeH Strategy on Prevention and Combating Domestic Violence (2013-2017) (në gjuhën boshnjake).

[48] Qendra e Hapur e Sarajevës, 1995-2015: Women and Political Life in Post-Dayton Bosnia and Herzegovina, Kapitulli: 3.3 Futja e kuotës së grave në vitin 1998, 2015, faqe 42 (në gjuhën boshnjake).

[49] Shih Vive žene, *Protocol for Interventions in Cases of Domestic Violence for Canton Tuzla*, BeH dhe Sarajeva Lindore, *Signed Protocol on Cooperation in Cases of Domestic Violence in Sokolac*, dhe CSSP, *Signed Protocol on Cooperation of Institutions and CSOs on Prevention and Combating VAWand Domestic Violence in Brcko*

Kosovë

- Luftuan që Kushtetuta të përfshijë barazinë gjinore dhe të lejojë martesën mes gjinisë së njëjtë.
- Avokuan që ligjet për zgjedhjet lokale dhe qendrore të përmbajnë kuotë gjinore.
- Ndikuan në Ligjin për Barazi Gjinore, duke vendosur Agjencinë për Barazi Gjinore në nivelin më të lartë të vendimmarrjes dhe, më pastaj, për buxhetimin e përgjithshëm gjinor.
- Ndikuan në Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe strategjitë shoqëruese dhe planet kombëtare të veprimit, të cilat janë informuar nga hulumtimi.
- Bën thirrje për ndryshime të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre që tu mundësohen pensionet për të mbijetuarit e dhunës seksuale të kryer gjatë luftës.[50]
- Mbështetën Ministrinë e Financave për të futur kërkesat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në qarqet buxhetore.
- Bënë thirrje për përtëritje të vazhdueshme të Rregullores për Regjistrim të Përbashkët të Pronës, duke krijuar stimuj për rritjen e pronësisë së grave.
- Nisma për Drejtësi dhe Barazi zgjeroi të drejtat ligjore të grave për pronësi, duke ndryshuar Ligjin për familjen për të sqaruar se kontributet e bashkëshortëve në familje do të kenë të njëjtën peshë si kontributet financiare të bëra nga bashkëshorti tjetër.[51]
- Bën thirrje me sukses që Kodi Penal të përfshijë ngacmimin seksual dhe dhunën në familje në përputhje me Konventën e Stambollit.
- Bënë përfshirjen e perspektivës gjinore në pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zbatimin e Marrëveshjes së Standardizimit dhe Asociimit.

Mali i Zi

- Ndikuan në Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe në aktet nënligjore, strategjitë shoqëruese dhe planet kombëtare të veprimit, duke e informuar përmes të dhënave dhe praktikave të OSHCG-ve.
- Qendra e të Drejtave të Grave kontribuoi në ndryshimin e përkufizimit të dhunimit në Kodin Penal, duke propozuar një ndryshim që ofron përkufizim të ri bazuar në mungesën e pëlqimit, sesa vetëm në përdorimin e forcës.
- Bën thirrje me sukses për ndryshime të Kodit Penal, Ligjin e Familjes dhe Ligjit për Ndërmjetësim për t'i afruar ato me standardet e Konventës së Stambollit.
- Avokuan që ligji zgjedhor të përmbajë kuotën gjinore prej 30%.
- Ndikuan në Protokollin për Trajtimin, Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.
- Ndikuan në Ligjin për mbrojtje sociale dhe të fëmijëve dhe akteve nënligjore shoqëruese.

Maqedonia e Veriut

- Promovuan rëndësinë e Konventës së Stambollit dhe avokuan për ratifikimin saj.
- Avokuan për miratimin e ligjit të parë për parandalimin, mbrojtjen dhe luftimin e dhunës në familje.
- Kontribuuan në krijimin e një Ligji të ri mbi format e ndryshme të dhunës ndaj grave, përshirë dhunën në familje, në përputhje me Konventën e Stambollit.
- Kontribuuan në përmirësimin e legjislacionit për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve.
- Kontribuuan në përmirësimet në Ligjin për Ndihmën Juridike Falas.

District, BeH, dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Rinisë të kantonit të Sarajevës, *Signed Protocol on Cooperation of Institutions in Cases of Domestic Violence in Canton Sarajevo*.

[50] Amnesty International, *"Wounds that Burn Our Souls"*, faqe 33.

[51] Intervistat me OSHCG; Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, *Gender Rights Researcher has Legal Success to Protect Women's Property Rights*, Kombet e Bashkuara, 2019.

- Avokuan për përmirësimet në Ligjin kundër diskriminimit dhe Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.
- Avokuan me sukses dhe mbështetën grupin punues që hartonte Ligjin e ri, progresiv për ndërprerjen e shtatzënisë/Ligjin për abortin.
- Krijuan protokolle dhe mekanizma referimi për viktimat e dhunës në familje.
- Krijuan standarde minimale për shërbimet e specializuara për dhunën në familje.[52]
- Kontribuuan në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazinë Gjinore (2018-2020).
- Avokuan me sukses për rritjen e kuotës gjinore për Parlamentin në Ligjin Zgjedhor në 40%.

Serbi

- Avokuan dhe informuan për Ligjin për parandalimin e dhunës në familje.[53]
- Avokuan me sukses për ratifikimin e Konventës së Stambollit.
- Bënë thirrje me sukses për futjen udhëzimeve për mbrojtje emergjente në kornizën ligjore serbe.[54]
- Avokuan dhe informuan për ndryshimin e Ligjit për barazi gjinore.[55]
- Avokuan dhe informuan për disa politika dhe ligje të tjera, përfshirë Kodin Penal,[56] Ligjin për Rendin Publik dhe Paqen,[57] Ligjin për Azilin dhe Mbrojtjen e Përkohshme[58] dhe Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Viktimave dhe Dëshmitarëve të Krimit.[59]
- Avokuan me sukses që 18 maji të shpallet Dita Zyrtare Përkujtimore e Grave të Vrara, Viktimave të Dhunës.[60]
  Apeluan me sukses tek Ministria e Brendshme lidhur me standardizimin e procedurave dhe sjelljen e policëve kompetentë në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe për krijimin e një linje pune për veprën penale dhuna në familje.61
- Drejtuan me sukses propozime për Projekt Strategjinë për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna për periudhën 2018-2022.62

---

[52] Lindquist, W., Siminitz, J., Sumlinski, M., Petri, M., *Montenegro: Selected Issues*. IMF Country Report No. 17/277, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2019; Ministria e Drejtësisë, *Public Discussion Report- Draft Law on Amendments the Criminal Law of Mali i Zi*, 2017, faqe 6-8; Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve, Decision on the formation of gender equality council, 1/06/2016; Ministria e Punëve të Brendshme, The decision to select a candidate for a member of the Operational Team for Combating Domestic Violence and Violence Against Women, 12/02/2018; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Decision on the Selection of Candidates for Members of the Work Group on the Drafting of the Protocol on the Treatment, Prevention and Protection against Domestic Violence, 10/04/2018.

[53] Republika e Serbisë, Parlamenti, Ligji për parandalimin e dhunës në familje nr. 94/2016, at: (në gjuhën serbe).

[54] Ising, *Public debate*, 2016 (në gjuhën serbe).

[55] Qendra e Grave Autonome (AWC), *"Comments of the AWC on the Draft Law on Gender Equality",* 2020.

[56] Ising, "AWC's Proposals for the amendments to the Alterations and Modifications of the Criminal Code", Beograd, 2016.

[57] AWC, "WNAV appeal to Women's Parliamentary Network", 2016 (në gjuhën serbe).

[58] AWC, "Ministry of Interior accepted the majority of comments that Autonomous Women's Centre had submitted to the Draft Law on Asylum and Temporary Protection", 2016.

[59] AWC, "Comments on the work text of the National Strategy on the Rights of Victims and Witnesses of Crime", 2020.

[60] Qeveria e Republikës së Serbisë "Day of Remembrance for Murdered Women Victims of Violence proclaimed", Beograd, 2017 (në gjuhën serbe).

[61] AWC, "Ministry of Interior has accepted AWC's suggestions regarding the Law on the Prevention of Domestic Violence", 2017.

[62] Draft Strategy for the Prevention and Protection of Children from Violence (në gjuhën serbe).

Monitorimi dhe avokimi nga OSHCG-të gjithashtu kontribuoi në **avancimin e zbatimit të legjislacionit ekzistues**. Për shembull, një koalicion i OSHCG-ve në gjithë rajonin po punojnë për të zbatuar legjislacionin kundër diskriminimit në vendet e tyre. OSHCG-të kanë qenë instrumental në monitorimin dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit që ka të bëjë me dhunën në familje, trafikimin dhe në krijimin e shërbimeve sociale cilësore.

> **Organizata po punon për përmirësimin dhe zbatimin e ligjit kundër dhunës në familje duke punuar ngushtë me institucionet dhe komunitetin.**
>
> OSHCG, Shqipëri

Më konkretisht, OSHCG-të kanë **shfrytëzuar proceset ndërkombëtare për të çuar përpara ndryshimet sociale**. OSHCG-të në gjithë rajonin kanë përdorur mekanizmat e të drejtave të njeriut, të tilla si Rishikimi Periodik Universal për të avancuar të drejtat e grave dhe siguruar rregullisht raport për Organet e Traktatit të KB (p.sh., CEDAW, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Pakti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore), si dhe për Grupet e Ekspertëve të Këshillit të Evropës (p.sh., për zbatimin e masave kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje , masave kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore). OSHCG-të kanë përdorur UNSCR 1325 dhe GAP II të BE-së si platforma për avancimin e prioriteteve të tyre.[63]

Fotografia: Nicole Farnsworth

Aktivistet mbajnë Rezolutën 1325 për gratë, paqen dhe sigurinë për t'i bërë thirrje qeverisë së Kosovës që të sigurojë pjesëmarrjen e tyre në negociatat me Serbinë. Aktivistet shpesh citojnë këtë rezolutë, ndër të tjera, kur kërkojnë të drejtat e tyre.

[63] Intervista, financues, Kosovë, 2019.

Lidhur me këtë, OSHCG-të kanë **kontribuar në progresin drejt anëtarësimit në BE** në rajon, veçanërisht duke integruar perspektivën gjinore në proceset e anëtarësimit.[64] Pyetësori i BE-së për BeH përfshiu përgjigjet e OSHCG-ve në lidhje me paqen, pajtimin dhe fuqizimin ekonomik të grave.[65] Në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi, OSHCG-të kanë hartuar rekomandime për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së për barazi gjinore (*EU Gender Equality Acquis*) dhe, në disa raste, shtynë përpara miratimin e tyre.[66] Në Kosovë dhe Mal të Zi, OSHCG-të kanë huazuar ekspertizën e tyre ZBE, Delegacioni (ZBE) dhe zyrtarëve qeveritarë, duke integruar perspektivën gjinore në Dokumentet e planifikimit sektorial, Dokumentet e Veprimeve dhe Termat e Referencës për programet IPA II. Në të gjitha vendet, OSHCG-të kanë dhënë kontribut të rregullt për raportet vjetore të vendeve të KE, duke kontribuar në integrimin më të mirë të perspektivës gjinore në këto raporte. Disa programe të zbatuara nga OSHCG-të janë strukturuar qëllimisht për t'u përshtatur me dhe për t'i çuar përpara reformat në përputhje me legjislacionin e BE-së (*EU Acquis*).[67] Në përgjithësi, OSHCG-të gjithashtu kanë ndarë informacione rreth procesit të anëtarësimit në BE me akterë të ndryshëm shpesh të pa arritshëm nga BE dhe/ose qeveritë, duke "përkthyer" konceptet dhe kërkesat shpesh në dukje të paqarta të anëtarësimit në BE në mënyrë që popullsia e përgjithshme të mund t'i kuptojë ato më mirë. Një vetëdijesim i tillë është thelbësor për të kontribuar në zbatimin e reformave duke u dhënë qytetarëve njohuri dhe aftësi me të cilat monitorohen dhe çohen përpara këto reforma.

Pra, ekzistojnë mjaft dëshmi që OSHCG-të kontribuojnë në ndryshime sociale në vendet e tyre dhe në rajon. Këto dëshmi sugjerojnë që investimi në OSHCG mund të jetë një mjet efektiv për të kontribuar në ndryshimet sociale drejt arritjes së barazisë gjinore në BP.

Fotografia: AWEN

"Mos hesht!" Stafi, anëtarët dhe vullnetarët e AWEN përgatiten për protestën e 3 shtatorit 2017 kundër femicidit në Tiranë, Shqipëri.

[64] Intervista, financues, BeH, 2019.
[65] Intervista, OSHCG, BeH, 2019. Shih: *Answers of the Civil Society Organisations to the Questionnaire of the European Commission for the Preparation of the Opinion on the Application of Bosnia and Herzegovina for Membership of the European Union*; dhe Ćatović, A., Idžaković, F., Šehić D. for Rights for All, *Women's perspectives: Alternative Responses to the European Commission Questionnaire*, 2017.
[66] Në Serbi, OSHCG-të morën pjesë në Konventën Kombëtare për Grupin Punues të BE-së për kapitullin 23. Shih gjithashtu: RrGK, *Kosovo's Progress in Aligning its Laws with the European Union Gender Equality Acquis*, 2017.
[67] Intervista, OSHCG, Shqipëri, 2019. Për shembull, OSHCG-të shqiptare kontribuuan në reformat gjyqësore duke dhënë rekomandime për Ligjin e Ndihmës Juridike Falas, përgatitjen e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut dhe monitorimin e zbatimit të reformës gjyqësore në Shqipëri. Një koalicion rajonal i OSHCG-ve po punon për të zbatuar legjislacionin mbi diskriminimin me bazë gjinore ndaj grave në lidhje me punën, i mbështetur nga BE dhe i bashkëfinancuar nga Sida.

Pikëpamjet e financuesve rreth rëndësisë, efikasitetit, efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe ndikimit të OSHCG-ve

Kriteret e OECD DAC janë përdorur gjerësisht për të monitoruar dhe vlerësuar ndryshimet në lidhje me ndihmën e zhvillimit dhe investimet, megjithëse ka disa kritika, të tilla si paragjykimi imanent pozitiv dhe probabiliteti i ulët që konsulentët e kontraktuar do të japin ndonjëherë vlerësim negativ dhe do të "kafshonin duart që i ushqejnë".[68] Pyetjet e standardizuara mund të kufizojnë vlerësimet, pra të pamundësojnë të menduarit krijues "jashtë kutisë" (jashtë të menduarit konformal).[69] Për më tepër, kriteret janë kritikuar se nuk janë të ndjeshme ndaj interesave të akterëve dhe konteksteve të ndryshme.[70]

Kritikët feministë kanë vërejtur se masat e rrepta mund të mos kapin ndryshimet sociale, të cilat masa mund të jenë të ndërlikuara, afatgjate dhe të vështira për të matur ose vendosur atribut të drejtpërdrejtë. Pra, kriteret e OECD DAC mund të mos jenë qasja më e mire për ekzaminimin e punës së ndërlikuar të OSHCG-ve. Megjithatë, ndërsa pranuar këto mangësi, hulumtuesit i përshtaten/riformuluan pyetjet e tyre për financuesit lidhur me punën e OSHCG-ve, duke përdorur kriteret e OECD DAC, si ndër kriteret të përdorura më së shpeshti nga financuesit për vlerësimin e rëndësisë, efikasitetit, efektivitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë.[71] Hulumtuesit hipotezuan që nëse financuesit shumë të ndryshëm do të vlerësonin pozitivisht përpjekjet e OSHCG-ve, bazuar në këto kritere të pranuar gjerësisht, kjo do të siguronte dëshmi të pavarura se pse financuesit mund të dëshironin t'i mbështesin OSHCG-të. Edhe pse një vlerësim i pavarur gjithëpërfshirës ishte përtej fushëveprimit të këtij hulumtimi, këto kritere u përdorën për të mbledhur prova fillestare nga një grup i financuesve të profileve të ndryshme në lidhje me pikëpamjet e tyre për rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe ndikimin e OSHCG-ve. Gjetjet janë nxjerrë kryesisht nga intervistat me financuesit dhe vlerësimet ekzistuese të pavarura.

Përgjigja që përsëritej mes financuesve të intervistuar ishte se **OSHCG-të kanë dëshmuar rëndësinë e tyre**.[72] OSHCG-të kanë përshtatur përpjekjet e tyre me kontekstin politik dhe plotësuan nevojat e komuniteteve të tyre, thanë ata. Afërsia e OSHCG-ve me njerëzit që ato shërbejnë u mundëson atyre të njohin çështje dhe të zhvillojnë programe që adresojnë nevojat në mënyrë adekuate. Vlerësuesit konstatuan si të rëndësishme punën e OSHCG-ve lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, sepse ato aktivisht avokojnë për përfshirjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në këtë proces.[73] Për më tepër, puna e tyre përputhet me

> **Grupet e grave kanë ngritur gjithmonë çështjet më të dhimbshme, si ato të krimeve të luftës, dhunës, luftërave, ato që lidhen me grupe të ndryshme etnike dhe përgjithësisht grupet e ndryshme shoqërore.**
>
> Financuesi, Serbi

[68] Bisedat e RrGK-së me aktivistët. On positive bias: Clemens, Paul, "Improving Learning and Accountability in Foreign Aid", *World Development* (125), 2019, faqe 9.
[69] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[70] Espinosa 2013 dhe Ligero 2011, cituar Espinosa, J. *Gender Mainstreaming Approaches in Development Programming: Being Strategic and Achieving Results in an Evolving Development Context*, 2013.
[71] Chianca, T., "The OECD/DAC Criteria for International Development Evaluations: An Assessment and Ideas for Improvement", *Journal of Multidisciplinary Evaluation*, Vëllimi 5, Numri 9, ISSN 1556-8180, 2008.
[72] Relevanca i referohet rëndësisë së punës së OSHCG-ve në kontekstin politik dhe shoqërore, veçanërisht për nevojat e grupeve të tyre të synuar.
[73] Newkirk, J., Lidstrom, A., Popovicki Capin, A., Conflict Management Consulting, *Mid-term Review and Evaluation: The Kvinna till Kvinna Foundation's Western Balkan Regional EU Advocacy Programme*, 2017, faqe 9.

kornizën e anëtarësimit në BE, misionin e saj për të përmirësuar reformat sociale dhe qëllimet e saj për të integruar të gjithë akterët relevantë në këtë proces.[74] Sigurimi i të dhënave të detajuara nga OSHCG për zyrtarët e BE-së gjithashtu forcon vizibilitetin e barazisë gjinore brenda procesit të anëtarësimit në BE.[75]

Financuesit kishin tendencë të tregojnë se OSHCG janë dëshmuar shumë të **efektshme**.[76] Një financues vuri re se disa OSHCG mund të "shpenzojnë më me mençuri".[77] Ekzistojnë mundësitë për përmirësimin e koordinimit midis OSHCG-ve, përafrimin e strategjive dhe ndarjen e detyrave për të bërë më efikas përdorimin e burimeve të kufizuara. Megjithatë, financuesit pajtoheshin që, duke marrë parasysh rrethanat e vështira dhe strukturat patriarkale të rrënjosura, OSHCG-të kanë vepruar mirë me burimet e kufizuara që kanë pasur. Pasi OSHCG-të punojnë në teren, ato mund të shpërndajnë në mënyrë efikase informatat dhe t'u përgjigjen shpejt çështjeve, thanë financuesit. Afërsia dhe njohuria e tyre për përfituesit e tyre rrit efikasitetin në kohën dhe burimet, duke arritur tek grupet e synuara siç janë gratë nga grupet etnike minoritare dhe/ose zonat rurale. "OSHCG-të janë efikase në ofrimin e shërbimeve të specializuar dhe në nivel lokal", tha një financues, por me vërejtjen se: "Ato nuk janë efikase në nivel më të gjerë".[78] Ky financues vuri re që OSHCG-të mund të mos jenë në gjendje të shpërndajnë fonde në mënyrë efikase përtej nivelit lokal. Sidoqoftë, ekzistojnë shembujt e rrjeteve dhe fondeve të grave që shpërndajnë në mënyrë efikase OSHCG-ve në nivel nacional dhe atë rajonal.[79] Disa financues theksuan që OSHCG-të kanë kosto dukshëm më të ulëta operative dhe programatike sesa OJQN-të dhe financuesit multilateralë. Krahasimi i shpenzimeve të përditshme komunale ose të pagave dëshmon qartë për efikasitetin e OSHCG-ve. Një financues ka konkluduar: fuqizimi i shoqërisë civile dhe OSHCG-ve ka dëshmuar të jetë një "shumëzues i fuqishëm i zhvillimit të qëndrueshëm" dhe që nga ana tjetër mund të sigurojë efikasitetin e vazhdueshëm të OSHCG-ve në aftësinë e tyre për të rrjetëzuar dhe shfrytëzuar burime të kufizuara.[80]

> **Kjo nuk ka të bëjë aq me punën vullnetare sa për ekspertizën, njohuritë dhe përvojën në lidhje me atë se çfarë funksionon e çfarë jo. Shumica e OSHCG-ve nuk do të shpenzonin para kot në konferenca ose për të bërë përsëri studime bazë.**
>
> Financues rajonal

OSHCG-të kanë qenë **efektive** në arritjen e disa ndryshimeve ligjore dhe politike.[81] Ndërsa hulumtimi i vazhdueshëm, avokimi dhe zbatimi janë të nevojshëm, disa ligje në të gjithë rajonin janë më të ndjeshëm ndaj gjinisë falë përpjekjeve të OSHCG-ve. OSHCG-të gjithashtu kanë mësuar të "paketojnë" më mirë të dhënat dhe argumentet brenda kontekstit të procesit të anëtarësimit në BE, gjë që ka kontribuar në efektivitetin e tyre në përmbushjen e objektivave lokale dhe rajonale të barazisë gjinore.[82] Ato krijuan "një mjedis të bazuar në

---

[74] Po aty
[75] Po aty, faqe 10.
[76] Efikasiteti i referohet efektivitetit të kostos të ndërhyrjeve të zhvillimit, nëse ndërhyrjet përdorin burimet më pak të kushtueshme të mundshme për të arritur rezultatet e dëshiruara.
[77] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[78] Intervistat, financuesit, BeH, Serbia, Maqedonia e Veriut, 2019.
[79] Për shembull: Fondi i Grave të Kosovës, Fondi i Grave për Rindërtimi në Serbi, Qendra e Grave Autonome, Fondacioni Lara në BeH dhe AWEN në Shqipëri të gjitha shpërndajnë me efikasitet fonde OSHCG-ve. Për shembull, FGK u vlerësua si mjet efektiv dhe efikas (Mainlevel Consulting, *External Evaluation of the Kosovo Women's Network, its Strategy for 2015-2018 and Key Programs Contributing to this Strategy*, 2018, faqe 11).
[80] Agjencia Austriake për Zhvillim, *Making Budgets Gender-Sensitive: A Checklist for Programme-Based Aid*, 2009, faqe 3.
[81] Shih shembujt specifikë në nën-seksionin e fundit, Kutia 4.
[82] Newirk, J. et al, faqe 13.

shume lidhje dhe shoqata, në të cilën njerëzit bashkohen vullnetarisht së bashku për të trajtuar ankesat e zakonshme [nga cili] lind një frymë qytetare e cila në anën tjetër lehtëson efektivitetin ekonomik dhe politik".[83] Një mobilizim i tillë efektiv i njerëzve çon në ligje dhe politika më efektive që plotësojnë nevojat e njerëzve. Roli i OSHCG-ve si mbikëqyrës gjithashtu ka qenë i efektshëm në mbajtjen përgjegjëse qeveritë.[84] Ato përmbushën në mënyrë efektive funksionet e rëndësishme të ofrimit të shërbimeve.[85]

Ndërkohë, OSHCG-të kanë qenë disi efektive në dhënien e kontributit në ndryshimet në normat dhe marrëdhëniet shoqërore, sugjeruan financuesit. Ato kanë mobilizuar njerëzit që të ndërmarrin veprime për adresimin e temave që më parë ishin tabu.[86] Megjithatë, konteksti më i gjerë politik shpesh ka krijuar sfida për OSHCG, duke kontribuar në gjysmë pune efektive, siç është ndryshimi i normave shoqërore. Një financues vërejti se mbase efektiviteti i tyre mund të përmirësohet përmes zgjerimit të mëtejshëm të grupeve të synuara për të pasur ndryshime shtesë në normat sociale.[87]

Ndikimi[88] më i dukshëm i OSHCG-ve kanë qenë ndryshimet që i kanë prek në ligje dhe politika.[89] Këto ligje kanë krijuar mbrojtje të reja sociale për grupet e cenueshme, si dhe promovuan barazinë gjinore. Për shembull, Ligji për Barazi Gjinore në Shqipëri, i ndikuar nga OSHCG-të, ka bërë që më shumë gra të përfaqësohen në të gjitha nivelet politike. Ndikimi i OSHCG-ve në ndërtimin e paqes gjithashtu u njoh, veçanërisht në BeH dhe Kosovë.[90] Madje, edhe duke marrë parasysh sfidat politike dhe sociale, OSHCG-të kanë ndikuar në disa ndryshime të qëndrueshme në qëndrime dhe ngritje të vetëdijes, veçanërisht në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Financuesit përmendën marshimin e grave në Ditën Ndërkombëtare të Gruas si një tregues kyç të ndikimit, duke theksuar se protesta është rritur e fuqizuar gjatë dekadës së fundit, duke demonstruar ndryshime shoqërore. Megjithëse është e vështirë që ndryshimi t'i atribuohet një përpjekjeje, shpërndarja e informacionit nga OSHCG-të padyshim që ka kontribuar në vetëdijesimin e qëndrueshëm për të drejtat e grave, u shprehen financues.[91]

> **Kemi dëshmi që tregojnë se pak gjëra janë po aq të rëndësishme sa një lëvizje e fortë feministe në mënyrë që të avancohet barazia gjinore dhe legjislacioni për barazinë gjinore. Përmirësimet në barazinë gjinore kanë qenë rezultat i lëvizjeve feministe për dekada.**
>
> Financues rajonal

[83] Landau, D., Uggla, F., *Mapping Assignment for Continued Swedish Support to Human Rights Defenders in Kosovo* 2018, faqe 4.
[84] Shih shembujt specifikë në nën-seksionin e fundit.
[85] Shih shembujt nën-seksioni e fundit.
[86] Shih nën-seksionin e fundit.
[87] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[88] Ndikimi mund të definohet si ndryshime afatgjata që ndodhin si rezultat i punës së OSHCG-ve.
[89] Shih shembujt specifikë në nën-seksionin e fundit.
[90] Intervistat, financuesit, BeH, Kosovë, 2019.
[91] Intervistat, financuesit, Kosovë, 2019.

Puna e OSHCG-ve në BP është në përgjithësi e **qëndrueshme**, thanë financuesit e intervistuar. Përgjigjet bënë me dije se po ndryshojnë qëndrimet themelore në lidhje me të drejtat e grave dhe ky ndryshim do të jetë vështirë të kthehet me gjithë kundërsulmin ndaj patriarkatit. Një financues vërejti, "kur keni gra në hapësira publike, nuk mund të ktheheni mbrapa".[92] Edhe pse disa ndikime të përpjekjeve të tyre mund të mbesin të qëndrueshme, ekzistojnë shqetësime për qëndrueshmërinë e vetë OSHCG-ve.[93] Përtej qëndrueshmërisë financiare, disa financues shprehen shqetësime për qëndrueshmërinë financiare, për shkak të çështjeve të ndërlidhura të stresit profesional, shterrimit profesional, niveleve të ulëta të pagave dhe burimeve të pamjaftueshme për kujdesin personal.[94]

> **Organizatat për të drejtat e grave shpesh nuk kanë mjete të mjaftueshme, kështu që shumicën e punëve i kryejnë me bazë vullnetare [...]. Kjo i vë ato në pozitë të cenueshme dhe i ekspozon ndaj stresit.**
>
> Financues rajonal

Si përfundim, financuesit e ndryshëm të intervistuar kishin prirje të konsiderojnë punën e OSHCG-ve si shumë të rëndësishme, si dhe mjaft efikase dhe efektive, me sugjerim të shtuar për përmirësim. Gjithashtu ekzistojnë dëshmitë e efektivitetit dhe ndikimit të tyre, megjithëse këto varen nga faktorë jashtë kontrollit të OSHCG-ve, në mjediset e tyre operative. Ndryshimet që ato kanë sjellë duken të qëndrueshme, por shqetësimet ekzistojnë rreth qëndrueshmërisë së OSHCG-ve dhe vetë aktivistëve.

[92] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[93] Landau, D., Uggla, F., 2018, faqe 4.
[94] Wassholm, C., Intervistat, financues rajonal, 2019.

Një ekuilibër delikat: Financimi i OSHCG-ve, OJQN-ve dhe organizatave multilaterale

Të mirat dhe të këqijat e mbështetjes së OJQN-ve dhe organizatave multilaterale,[1] në krahasim me mbështetjen e OSHCG-ve lokale që kryejnë punë të ngjashme, ishin temë përsëritëse që u ngrit gjatë hulumtimit. Kjo pjesë paraqet gjetjet e hulumtimit për të nxitur reflektimin dhe diskutimin për këto çështje.

Organizatat multilaterale si agjencitë e KB kanë mandat për avancimin e barazisë gjinore, duke përfshirë edhe progresin drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.[2] Duke pasur parasysh mandatet dhe punën e tyre në disa vende, organizatat multilaterale shpesh kanë përvojë më të madhe, plane veprimi dhe mjete më të gjera të zhvillimit të politikave që u mundësojnë atyre të sjellin perspektivën globale për punën e tyre në nivel vendi.[3] Kjo mund të mundësojë strategji dhe shkëmbim të ideve në të gjitha vendet, megjithëse idetë e tilla shpesh kërkojnë përshtatje në kontekstin lokal. Organizatat multilaterale mund të promovojnë, mbështesin dhe inkurajojnë ratifikimin e konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në nivel kombëtar.[4] Organizatat multilaterale zakonisht kanë fuqi negociuese dhe lidhje me palët e interesuara të nivelit të lartë, të cilat mund të kontribuojnë në efektivitetin e tyre, veçanërisht në kontekstet ku OSHCG-të kanë hapësirë të kufizuar për të vepruar dhe kështu kanë ndikim tek qeveritë.[5] Në mjedis politik armiqësor, "organizatat ndërkombëtare si KB kanë autoritet më të madh" dhe homologët qeveritarë mund të pranojnë më me gatishmëri nismat e tyre për shkak të madhësisë dhe reputacionit të tyre.[6] Organizatat multilaterale mund ta përdorin këtë autoritet për të njohur dhe shfaqur ekspertizën e OSHCG-ve lokale, duke mbështetur marrëdhëniet e përmirësuar në mes të OSHCG-ve dhe zyrtarëve qeveritarë.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh sistemet e tyre të menaxhimit financiar, disa financues i shohin organizatat multilaterale[7] dhe OJQN-të si zgjidhjen më të thjeshtë për shpërndarjen e fondeve të mëdha, siç është përmes dhënies së nën-granteve.[8] Financuesit thanë se mund të jetë më lehtë për ta që të shpërndajnë drejtpërdrejt grante më të mëdha organizatave multilaterale ose OJQN-ve për administrim, veçanërisht në kontekstet ku financuesve u mungojnë burime njerëzore për të menaxhuar thirrje të mëdha për propozime, ose për të monitoruar zbatimin e disa projekteve të vogla të OShC-ve.[9] Disa financues besojnë se sistemet e organizatave multilaterale dhe OJQN-ve dhe qarkullimi i konsiderueshëm vjetor i bëjnë ata më pak "të rrezikshëm" OShC-të lokale për shpërndarjen e fondeve më të mëdha.[10] Në situata jostabile dhe të pasigurta, financuesit ndonjëherë e konsiderojnë më të sigurt të shpërndahen fonde përmes OJQN-ve dhe organizatave multilaterale për të shmangur rrezikun

---

[1] Për një shpjegim të përdorimit dhe diferencimit të termave OJQN-të dhe organizatat multilaterale, shih Fjalorin e termave.
[2] Zyra e Kombeve të Bashkuara për Partneritete, Sustainable Development Goals.
[3] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[4] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[5] Intervistat, financuesit, 2019.
[6] Intervistat, financuesi në BeH, Maqedoninë e Veriut, Serbi, 2019.
[7] Edhe pse përfaqësuesit e agjencive të KB shprehen në mënyrë të qartë se ata nuk janë donatorë, (Intervistat, 2019), ata shpërndajnë fonde OSHCG-ve.
[8] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[9] Për shembull, KE parasheh përdorimin e granteve "shpërblim i drejtpërdrejtë" pa thirrje për propozime në situata të monopolit de-fakto ose specializimit teknik (PRAG, 6.4.2.).
[10] Intervista, financuesi rajonal, 2019.

potencial të mbështetjes së pa dashje të grupeve të panjohura lokale që mund të kenë prirje fetare ose pulitke të cilat nuk mund të detektohen lehtë.[11]

> **Organizatat ndërkombëtare dhe multilaterale janë sisteme të ngadalshme dhe kanë pritje të mëdha administrative nga organizatat që ato i mbështesin. Kjo lehtëson punën e qeverisë dhe institucioneve që përmes tyre të ndajnë fondet grupeve dhe lëvizjeve të grave, por kjo njëkohësisht pengon qasjen në fonde për organizatat.**
>
> Financues, Serbi

OJQN-të dhe organizatat multilaterale gjithashtu mund të ofrojnë mbështetje fillestare që ndihmon nismat. Megjithatë, disa financues thanë që është e rëndësishme që akterë të tillë ndërkombëtarë të mos "mbajnë përgjithmonë dorën" e organizatës lokale por që në një moment të caktuar, eventualisht të dorëzojnë udhëheqjen e tyre tek ta. Grupet lokale duhet të fitojnë më shumë vetëbesim për të punuar në mënyrë të pavarur, në mënyrë që të mund të mbështesin ndryshimin shoqëror dhe demokracinë, pasi kjo lidhet me kontekstin lokal.[12]

Nëse OJQN-të dhe organizatat multilaterale synojnë të mbështesin zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e OShC-ve, ata duhet të jenë vigjilente ndaj pozitës së tyre relative të pushtetit në krahasim me OShC-të që ata synojnë të mbështesin, theksuan aktivistët. OSHCG-të shprehën shqetësimin se OJQN-të dhe organizatat multilaterale po e përvetësojnë punën e tyre, duke marrë mbi vete çështjet që OSHCG-të i kanë udhëhequr historikisht, duke monopolizuar kështu fondet tashmë të kufizuara.

> **Kemi parë shembuj ku agjencitë e KB-së aplikojnë për grante të vogla të cila përndryshe do mund të shkonin për OSHC-të ose ku marrin përsipër koordinimin e OSHC-ve dhe kanë shumë ndikim në to.**
>
> Financuesi bilateral

"Shumë shpesh organizatat ndërkombëtare konkurrojnë me organizatat lokale dhe marrin një rol implementues", tha një OSHCG në Shqipëri. Një financues bilateral u pajtua: "Ne kemi parë shembuj të agjencive të KB që konkurrojnë për fonde të vogla të cilat kishin mundur të shkojnë tek OShC-të, ose ku agjencitë e KB marrin përsipër koordinimin e OShC-ve dhe kanë shumë ndikim në to".[13] Aktivistët në disa vende të BP përshkruan përvojat personale ku përfaqësuesit të agjencive KB penguan pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes ose duke minuar qasjen e tyre në burime. Në situata të tjera, disa OSHCG raportuan se kishin marrëdhënie pozitive me përfaqësuesit e agjencive të KB.

> **Janë më shumë efikas nga KB-a, UNDP, OSBE-ja, veçanërisht kur i krahasojmë buxhetet.**
>
> Financues, Kosovë.

Disa financues vërejtën që puna përmes OShC-ve lokale mund të kontribuojë në efektivitetin dhe efikasitetin e kostos, veçanërisht mund të jetë e rëndësishme në lidhe përdorimin e parave të tatimpaguesit.

---

[11] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[12] Intervista, financuesi, Kosovë, 2019.
[13] Intervista, financuesi bilateral, 2019.

Organizatat ndërkombëtare zakonisht kanë paga dhe shpenzime më të larta se OSHCG-të lokale. Megjithatë, këto dallime duhet të reflektohen në kontekstin e pagës së barabartë për punë të barabartë. Aktivistët shprehen shqetësim se akterët ndërkombëtar ndonjëherë marrin deri në dhjetëfish të ardhurat se ekspertët lokalë, edhe në situata të punës së barabartë. Aktivistët gjithashtu shprehen shqetësime për OJQN-të dhe organizatat multilaterale që absorbojnë shumicën e fondeve ndërsa kërkojnë aktivistët të kryejnë pjesën më të madhe të punës, pa kompensim të drejtë dhe të barabartë. Një aktivist komentoi "organizatat ndërkombëtare marrin 'mishin' e neve na lënë eshtrat".[14]

Duke pasur parasysh madhësinë, të ardhurat e përgjithshme dhe qasjen e tyre në burime, organizatat multilaterale dhe OJQN-të zakonisht kanë relativisht më shumë burime njerëzore dhe financiare se OSHCG-të, gjë që u mundëson atyre të negociojnë për burime siç është financimi direkt. Në disa raste, negocimi i fondeve të drejtpërdrejta mund të kontribuojë në konkurrencë të padrejtë, veçanërisht në kontekstet ku OSHCG-të lokale kanë kapacitete për të kryer detyra të ngjashme. Për shembull, BE-ja konsideron ofrimin e fondeve direkte OJQN-ve dhe organizatave multilaterale pa thirrje të hapura për propozime në situata të caktuara siç janë monopolet *de facto,* specializimi teknik ose situata emergjente.[15] Për më tepër, BE-së iu është dhënë është mandati nga shtetet anëtare të veprojë përmes agjencive të KB si pjesë e një qasje të koordinuar në arritjen e objektivave globale, përfshirë ato që lidhen me barazinë gjinore.[16] Për këtë arsye, BE-ja ka siguruar, në raste të ndryshme, fonde direkte për agjencitë e KB-së në BP.

Megjithatë, duke pasur parasysh zotimin e BE-së për konkurrencë të drejtë,[17] në kontekstin aktual të BP, ku disa OShC lokale kanë kapacitete për të menaxhuar fonde më të mëdha, ofrimi i fondeve të tilla direkte duket gjithnjë e më i vështirë për tu justifikuar. I tërë qëllimi i procesit të para-anëtarësimit të BE-së është të përgatisë përfituesit, përfshirë OShC-të në këto vende, për anëtarësimin eventual në BE. Më konkretisht, duke pasur parasysh qëllimin e Fondit të BE-së për Shoqërinë Civile (*Civil Society Facility*) për të avancuar kapacitetet e shoqërisë civile,[18] ai duhet të përdoret për të mbështetur grupet e shoqërisë civile. Përtej ndërtimit të kapaciteteve siç është trajnimi, investimet e drejtpërdrejta në shoqërinë civile janë të nevojshme për të avancuar aftësitë e tyre për menaxhimin e fondeve të BE-së. Edhe pse ndoshta nuk është qëllimi kryesor i Fondit, kjo mund të jetë e rëndësishme për krijimin e sistemit të tyre për përcjelljen e financimit, në mënyrë që ato eventualisht të pozicionohen për të menaxhuar fonde më të mëdha të BE-së, madje edhe pas anëtarësimit eventual në BE . Pra, disa aktivistë kanë interpretuar financimin e Fondit të BE-së për

---

[14] Intervista me OSHCG, Kosovë, 2019.

[15] PRAG. Për më tepër, organizatat multilaterale, agjencitë nga shtetet anëtare të BE-së dhe OJQN-të që kanë kaluar të ashtuquajturin "vlerësim të shtyllës" të KE, që do të thotë që KE mund t'u besojë atyre detyrat e zbatimit të buxhetit, gjithashtu zbatojnë ndihmën financiare të BE-së përmes menaxhimit indirekt. Në raste të tilla, rregullat e tyre, modelet dhe modalitetet e tyre për të menaxhuar fondet janë të zbatueshme. BE përdor këtë qasje ndonjëherë, për shembull, në mbështetjen e sektorit të IPA. Përsëri, nëse një qëllim është të avancojë kapacitetet lokale, OShC-të lokale të kualifikuara duhet të kenë mundësinë që t'i nënshtrohen vlerësimit të shtyllës dhe të demonstrojnë aftësinë e tyre për të trajtuar fondet e BE-së.

[16] The Treaty of Lisbon, Traktati i Lisbonës, neni 188, Paragrafi 1. "Unioni krijon të gjitha format e përshtatshme të bashkëpunimit me organet e Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë e tyre të specializuara, Këshillin e Evropës, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik." UNDP, për shembull, ka memorandume mirëkuptimi me KE. Agjencitë e KB financohen ose nga kontributet vullnetare ose nga kontributet e vlerësuara, të cilat llogariten ndaj detyrimeve që vendet paguajnë për të qenë anëtare e KB (UN, Funds, Programmes, Specialized Agencies and others). Secila prej 193 organizatave anëtare të të KB duhet të paguajë një përqindje të buxhetit të rregullt operativ të KB dhe buxhetit të paqeruajtjes (Amanda Shendruck, *How is the UN funded? A simple explanation of a complex system*, QUARTZ).

[17] PRAG.

[18] PE, Rregullorja Regulation No 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për krijimin e një instrumenti për ndihmën e para-anëtarësimit (IPA II), 2014, neni 2.1 (a) (viii) dhe neni 5.6. Shih gjithashtu: Aets Apave për Komisionin Evropian, *Mid-Term Evaluation of the Civil Society Facility for the Western Balkans and Turkey*, 2017, faqe 17.

Shoqërinë Civile (*Civil Society Facility*) rajonal të organizatave multilaterale dhe OJQN-ve si një mospërputhje në logjike para anëtarësimit. Në BP, duke pasur parasysh natyrën unike të financimit para anëtarësimit në BE, rregullat e BE-së do të lejonin BE të kufizojë të drejtën për të aplikua për fondet e Fondit të BE-së për Shoqërinë Civile (*Civil Society Facility*), në mënyrë që vetëm OShC-të të mund të aplikojnë, drejt kontributit në synimet para anëtarësimit në BE për zhvillimin e shoqërisë civile.[19]

Investimi direkt në OSHCG-të lokale mund të ketë vlerë të shtuar për sa i përket veprimit të qëndrueshëm, vuri re një financues. Financuesit vunë në dukje se OSHCG-të lokale: "njohin mentalitetin [dhe] do të vazhdojnë të qëndrojnë në vend."[20] "Organizatat lokale janë më efektive" dhe "në pozitë më të mirë për të arritur tek gratë [sepse ato janë] pjesë e komunitetit [dhe] nuk do të largohen kur të përfundojë projekti"; prandaj, investimi në OSHCG-të do të thotë të investosh në qëndrueshmëri.[21] Mbështetja e OSHCG-ve nënkupton investimin në kapacitetet e tyre, të cilat ato mund të vazhdojnë t'i përdorin në të ardhmen. Kishte shqetësime se "organizatat ndërkombëtare nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me komunitetet dhe përfituesit."[22]

Si përfundim, OSHCG-të, organizatat multilaterale dhe OJQN-të, të gjitha mund të kenë rol të rëndësishëm në avancimin e barazisë gjinore. Mbështetja për OJQN-të, organizatat multilaterale dhe OSHCG-të nuk do të thotë domosdoshmërish mos mbështetje për të tjerët. Në fakt, ekzistojnë shembuj të "trekëndëshit" të suksesshëm të bashkëpunimi mes OSHCG-ve, qeverisë dhe agjencive të KB-së, të cilët kontribuojnë në ndryshime thelbësore ligjore dhe të politikave për avancimin e barazisë gjinore në BP. Sfida, duket, është të gjendet ekuilibri dhe qasja e duhur në një kontekst të caktuar. Gjetjet duket të sugjerojnë që vlerësimi i tërësishëm i akterëve ekzistues, kapaciteteve dhe përvoja në një kontekst të caktuar është thelbësor për zgjedhjen e qasjes dhe modalitetit të duhur të financimit. Më konkretisht, logjika sugjeron që Fondi i BE-së për Shoqërinë Civile (*Civil Society Facility*) duhet t'i japë OShC-ve lokale mundësinë për të aplikuar përmes thirrjeve për propozime me të drejtë të kufizuar për organizata të regjistruara në vendin e synuar dhe me një mjet përcjellje që funksion atje, në mënyrë që të ndihmojë arritjen e qëllimeve të procesit të anëtarësimit në BE për këto vende.

Mbështetje për organizatat e tjera

Si pjesë e mbështetjes së përgjithshme për avancimin e të drejtave të njeriut, OSHCG-të kanë vërejtur një trend në rritje për të financuar grupet e të drejtave të njeriut që fokusohen në disa çështje, përfshirë barazinë gjinore. Pjesëmarrësit në hulumtim diskutuan të mirat dhe të këqijat e mbështetjes së organizatave që nuk identifikohen qartë si OSHCG për të punuar në çështjet e të drejtave të grave.

Financuesit kishin tendencë të vërejnë se zakonisht ka shumë punë që duhet të bëhen për të drejtat e grave sa që është e rëndësishme të mbështetet çdo organizatë, megjithëse kjo varet nga organizata. Për më tepër, të drejtat e grave duhet të jenë prioritet në çdo demokraci, pra duhet të adresohen nga çdokush që është në gjendje dhe i gatshëm të punojë me këtë.[23] Organizatat që nuk janë OSHCG-të mund të promovojnë të drejtat e grave, si pjesë e vëmendjes së tyre në të gjitha të drejta e njeriut, duke i bërë çështjet e të drejtave të grave të rëndësishme për gjithë punën e tyre.[24] Njerëzit shpesh përfshihen në projekte sepse janë

---

[19] PRAG, 2.3.9.b, duke cituar nenin 8(7) CIR, nenin 1(8)(9) të Shtojcës IV të Marrëveshjes së Cotonou dhe nenin 89(1)(f) e Vendimit për vendet dhe territoret përtej detit.
[20] Intervista me financues, Kosovë, 2019.
[21] Intervista me financues, Kosovë, 2019.
[22] Intervistat me financues në Serbi dhe Shqipëri, 2019.
[23] Intervista, financues, Maqedoni e Veriut, 2019.
[24] Intervista, financues, Kosovë, 2019.

të apasionuar pas kësaj teme, tha një financues. Nëse burrat përkushtohen të shtyjnë përpara të drejtat e grave, mund të jetë e dobishme të lihen të punojnë në këto çështje.[25] Sidoqoftë, është e rëndësishme që organizatat të punojnë në vakum dhe të bashkëpunojnë ngushtë me OSHCG-të, ishte vërejtja nga disa financues.

Mangësitë e mbështetjes së organizatave që nuk janë OSHCG që punojnë në çështjet e të drejtave të grave përfshijnë që ato mund të mos i kuptojnë plotësisht nevojat e grupeve të synuara ose të mos jenë në gjendje të fitojnë besimin e grupeve të synuara. Për shembull, të mbijetuarat e dhunës nga burrat mund të mos ndjehen rehat të marrin shërbime këshillimi juridik dhe psikologjik nga burrat. Disa financues theksuan se është e rëndësishme që të drejta e grave të adresohen nga ekspertë të fushës, zakonisht gra.[26] Mungesa e ekspertizës në lidhje me pabarazitë gjinore, shkaqet rrënjësore dhe qasjet e duhura mund të shkaktojnë dëme, edhe nëse pa dashje. Ekzistojnë shqetësime se disa organizata mund të mos jenë të përkushtuara në avancimin e të drejtave të grave, por përkundrazi, vetëm sa për "sy e faqe" sa për të përmbushur kërkesat e financimit ose për të "ndjekur fonde". Financuesit vunë në dukje rëndësinë e shqyrtimit në mënyrë kritike të strategjive dhe përvojës së OShC-ve për tu siguruar që ato me të vërtetë merren me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave para se të alokojnë fonde për punë të tillë.[27] Për sa kohë që projektet bazohen në analizën gjinore, kanë të përfshirë perspektivën gjinore dhe OShC-të kanë histori të konfirmuar të punës me dëshmi të rezultateve që lidhen me barazinë gjinore, financuesit në përgjithësi thanë që do të ishin të gatshëm të mbështesin grupe të tilla për të punuar në çështjet për të drejtat e grave.[28]

[25] Intervista, financues, Maqedoni e Veriut, 2019.
[26] Intervistat, financuesit, Kosovë, 2019.
[27] Intervista, financues, Serbi, 2019.
[28] Intervista, financues, Serbi, 2019.

Përfundim: Pse të mbështeten OSHCG-të?

Ekzistojnë disa arsye për financimin e OSHCG-ve. Siç përshkruhet në Hyrje, zotimet në politika, si ato në GAP II të BE-së dhe Qasjen Strategjike të BE-së, njohin rolin e rëndësishëm të OSHCG-ve në realizimin e objektivave të barazisë gjinore dhe bëjnë thirrje për fonde të BE-së për barazi gjinore, përfshirë mbështetjen e OSHCG-ve. Disa shtete anëtare dhe financues të tjerë kanë politika që kërkojnë integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha programet dhe inkurajojnë mbështetjen e programeve që fokusohen në barazinë gjinore, të cilat OSHCG-të janë në pozicion të mirë për t'i mbështetur. Në kontekstin aktual politik të BP, OSHCG-të janë ndër zërat kryesorë që kërkojnë qeverisje të mirë dhe promovojnë të drejtat e njeriut, veçanërisht për grupet e cenueshme. Është e qartë që pabarazitë gjinore mbeten gjerësisht të përhapura në BP, dhe OSHCG-të janë në pozicion të mirë për t'i adresuar ato. Dëshmitë sugjerojnë që OSHCG-të kanë kontribuar në disa ndryshime shoqërore në BP, dhe për këtë arsye janë të përshtatshme për t'u ngritur mbi këto arritje, duke kontribuar në ndryshime të mëtejme shoqërore. Ato mund të vazhdojnë të informojnë, avokojnë dhe monitorojnë zbatimin e ligjeve dhe politikave, përfshirë ato që kanë të bëjnë me anëtarësimin në BE. Ekzistojnë dëshmi të pavarura për rëndësinë dhe efikasitetin e OSHCG-ve. Edhe pse kanë qenë efektive dhe me ndikim në sjelljen e disa ndryshimeve kryesore, situata politike, kundërsulmi patriarkal dhe qasja e dobët në burime mund të ndikojë negativisht në efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e tyre. Megjithëse ndikimi i disa prej përpjekjeve të tyre mund të jetë i qëndrueshëm, si avokimi i suksesshëm për ligjet dhe ngritjen e vetëdijesimit publik, ekzistojnë shqetësime për qëndrueshmërinë e vetë OSHCG-ve.

Fotografia: Nicole Farnwworth

Aktivistet për të drejtat e grave në BP përdorin Ditën ndërkombëtare të grave, 8 marsin, si mundësinë për të ngritur çështjet e shumta në lidhje me të drejtat e grave, prej të drejtave riprodhuese, dhunës ndaj grave dhe pagës së barabartë për punë të barabartë deri në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit.

REKOMANDIMET

Rekomandimet e mëposhtme rrjedhin nga gjetjet e hulumtimit. Të adresuar për akterët e ndryshëm, OSHCG-të, financuesit e ndryshëm, përfshirë BE-në në veçanti dhe qeveritë e BP, rekomandimet synojnë të nxisin diskutime dhe veprime të përbashkëta drejt përmirësimit të ekosistemit të financimit për OSHCG-të në BP dhe avancimit të barazisë gjinore dhe të të drejtave të grave.

Për OSHCG-të

- **Ndani fuqinë. Ndani burimet.** Mbështetni në mënyrë aktive dhe avokoni për fonde që promovojnë solidaritet se sa konkurrencë. OSHCG-të më të mëdha duhet të njohin pozicionin e tyre relativ të fuqisë në krahasim me OSHCG-të më të vogla, duke identifikuar mënyra për të mbështetur kolegët e tyre drejt fuqizimit të lëvizjes.
- **Avokoni bashkërisht për burime më të mira**, përfshirë edhe për kujdesin ndaj aktivistëve të të drejtave të grave dhe OSHCG-ve, në drejtim të mbështetjes së lëvizjes.
- **Përmirësoni koordinimin** e programeve me OSHCG-ve, duke harmonizuar strategjitë dhe duke ndarë detyra për përdorim edhe më efikas të burimeve të kufizuara.
- **Zgjeroni në mënyrë strategjike bazën e mbështetjes së lëvizjes.** Ti kundërviheni konservatorizmit dhe lëvizjeve anti-gjinore duke përshtatur mesazhe më të mira për grupe të ndryshme, veçanërisht në zonat rurale, duke ndryshuar kështu në normat sociale mënyrë efektive. Përveç angazhimit të më shumë përkrahësve në avancimin e të drejtave të grave, mbështetja e komunitetit mund të shndërrohet edhe në mbështetje financiare. Identifikoni mbështetës të mundshëm individualë dhe ndërtoni një strategji të mbledhjes së fondeve rreth tyre dhe interesave të tyre. Shfrytëzoni një gamë të gjerë të burimeve ekzistuese të mbledhjes së fondeve.
- **Përmirësoni transparencën mes të gjitha OSHCG-ve,** duke inkurajuar fuqimisht publikimin e shpenzimeve vjetore dhe, aty ku është e mundur financiarisht, raportet e auditimit. Buxheti për auditimin si pjesë e projekteve dhe kontratave. Mbështetni organizatat më të vogla për të përmirësuar më tej sistemin e tyre të menaxhimit financiar.
- Kur ato nuk ekzistojnë, konsideroni krijimin e **strategjive më të forta të monitorimit dhe vlerësimit** për përcjelljen e ndryshimeve në lidhje me strategjitë organizative, programet e financuara nga donatorët, dhe përkatësisht ndikimin afatgjatë. Kjo mund të ndihmojë në ndërtimin e një organi më të fortë të provave në lidhje me ndryshimet që kanë bërë OSHCG-të.
- Për OSHCG-të më të mëdha, punoni për të kuptuar më mirë trendet globale të financimit dhe si të ndikoni në to; bashkëpunoni me koalicione më të gjera, të ndryshme të organizatave të angazhuara në **ndikimin në trendet e financimit globalisht**.

Për financuesit

- Mbështetni zhvillimin e një "**ekosistemi financimi**" gjithëpërfshirës, dinamik që plotëson nevojat e OSHCG-ve të ndryshme. Investimi në një ekosistem të tillë mund të rrisë ndjeshëm ndikimin politik dhe shoqëror të OSHCG-ve dhe të kundërveprojë me klimën aktuale të ngushtimit të hapësirës.
- **Bashkëpunoni më shumë me fondet e grave** për të shpërndarë grante OSHCG-ve më të vogla, bazuar në praktikat më të mira të identifikuara në dhënien e nën-granteve.

Inkurajoni dhe mbështesni fuqimisht përdorimin e dhënies së granteve në gjuhët vendore, për të arritur tek organizata ndryshe më të vogla, të margjinalizuara.

- Nxisni **dialogun më të thellë** me OSHCG-të për nevojat e tyre për financim, mënyrat më të mira për të adresuar nevojat e tyre dhe metodat më të mira për avancimin e barazisë gjinore.
- **Ndani fondet në të ardhmen** posaçërisht për avancimin e barazisë gjinore dhe, kur është e mundur, në mënyrë eksplicite për OSHCG-të, jepni përparësi fondeve për të adresuar pabarazitë e dukshme të identifikuara përmes analizave gjinore.
- Vazhdoni të financoni OSHCG-të, veçanërisht përmes **mbështetjes shumëvjeçare, financimit thelbësor**, granteve dhe **financimit më fleksibël**. Alokoni fonde për mbështetjen e OSHCG-ve me **ndarje të kostove**. Lejoni kontributet në natyrë të dokumentuara mirë në ndarjet e kostos.
- **Përmirësoni koordinimin e donatorëve** dhe planifikim e përbashkët strategjik për avancimin e barazisë gjinore.
- **Thjeshtoni procedurat e aplikimit dhe raportimit,** duke zvogëluar kohën e kaluar e financuesvet dhe OSHCG-ve në administrim, në mënyrë që të mund të shpenzohet më shumë kohë në aktivitete. Kur është e mundur, **përdorni fondet investuese** dhe **raportim të përbashkët** me donatorët e tjerë drejt minimizimit të ngarkesave administrative Kur është e mundur, përdorni **fonde investuese** dhe **raportime të përbashkëta** me financuesit e tjerë, duke minimizuar ngarkesat administrative dhe duke kontribuar në përdorimin më efikas të kohës për OSHCG-të.
- Kërkoni **analizën *ex ante*** të detyrueshme **gjinore** dhe **integriminin e perspektivës gjinore në të gjitha programet** bazuar në praktikat më të mira të financuesve si ADA ose Sida, që kërkojnë analizë gjinore dhe vëmendje ndaj pabarazive gjinore në të gjitha programet.
- **Kërkojini përfituesve të qeverisë** të përfshijnë perspektiven gjinore në programet e e financuara përmes mbështetjes së financuesve, posaçërisht kur një financim i tillë përfshihet në politikë, siç është miratimi i programeve të financuara nga IPA nga shtetet.
- **Përmirësoni sistemet për përcjelljen e shpenzimeve** për barazinë gjinore, të drejtat e grave, gratë dhe vajzat dhe mbështetje direkte për OSHCG-të, përkatësisht. Duke përdorur praktika më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, përmirësoni masat e fondeve të alokuara dhe të shpenzuara.
  Inkurajoni dhe mbështesni politikisht diskutime më domethënëse, të informuara nga hulumtimi midis financuesve të huaj, qeverive dhe ekspertëve të OSHCG, **për planifikimin/krijimin e duhur të fondeve të përhershme** për shoqërinë civile, siç është financimi normativ, për ofruesit joqeveritarë të shërbimeve me përvojë që punojnë për të adresuar dhunën me bazë gjinore. Financimi i qeverisë duhet të konsiderojë çështjet e ndjeshme, thelbësore të autonomisë së OSHC-ve dhe sigurimin e shërbimeve cilësore nga ofruesit me përvojë.
- **Konsideroni të mbështetni programet** fushat që janë mbështetur pamjaftueshëm:
  - Strategjitë si ofrimi i shërbimeve, avokimi, hulumtimi, shërbimet juridike dhe psikoterapia;
  - Pushimet në vendet që ofrojnë privatësi dhe siguri, psikoterapia dhe format e tjera të vetë-kujdesit të identifikuara nga aktivistët, për të parandaluar shterimin profesional të aktivistëve;
  - Nismat për të adresuar pabarazitë gjinore dhe shkaqet e tyre thelbësore, veçanërisht në komunitetet rurale;

Duhet të kujdes më shumë për anëtaret e grupeve të grave, përfshirë kujdesin ndaj vetës.

OSHCG në Serbi

- Fuqizimi, udhëheqja, politika, demokracia dhe qeverisja e grave;
- Financimi bazë për ofruesit e shërbimeve të OSHCG që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për personat, të cilët kanë pësuar dhunë me bazë gjinore, duke përfshirë shërbime juridike dhe të psikoterapisë, strehim për përfituesit dhe vizita falas shëndetësore deri sa të jenë ndarë fondet e qarta, të qëndrueshme, autonome nga qeveritë
- Forma të ndryshme të dhunës ndaj grave, përfshirë adresimin e shkaqeve thelbësore, bazuar në nevojat e identifikuara me OSHCG-të specializuar në këtë fushë;
- ESCR, punësimi, fuqizimi ekonomik i grave, të drejtat e punës dhe të punëtorëve, KIT, dhe të drejtat e pronës dhe strehimit;
- Edukimi, veçanërisht investimi në arsimin e hershëm drejt transformimit të roleve tradicionale, të socializuara gjinore, duke mundësuar kështu që më shumë gra të punojnë, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e rezultateve arsimore të fëmijëve, siç njihen nga Objektivat e Barcelonës;[1]
- Ndihmë humanitare, punë urgjente dhe mbështetje në lidhje me migracionin;
- Të drejtat mjedisore dhe drejtësia;
- Të drejtat seksuale dhe shëndeti riprodhues;
- Të drejtat për personat me aftësi të kufizuar dhe puna me gratë me aftësi të ndryshme;
- Vëmendje për përfshirjen e burrave dhe grupeve jo binare; Të drejtat e LGBTQIA +;
- Gratë në media; dhe
- Hulumtim i mëtejshëm mbi mundësitë për zhvillimin e filantropisë dhe dhënien vendore posaçërisht për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore; mbështesni programet pilot për të testuar zgjidhje të mundshme inovative të identifikuara përmes hulumtimit.

- Si pjesë e mbështetjes, merrni në konsideratë përfshirjen e fondeve për krijimin e kapaciteteve për të ndihmuar OSHCG-në krijimin e **planeve të emergjencave** për situatat në të cilat ata nuk kanë fonde.
- Konsideroni financimin e një studimi gjithëpërfshirës të pavarur mbi ndikimin e ndërhyrjeve të barazisë gjinore në rajon me kalimin e kohës për të identifikuar qasjet, modalitetet dhe praktikat më të mira të financimit që kanë kontribuar në shoqëri, drejt informimit të investimeve të ardhshme në ndryshim.

Për BE-në

- Siç rekomandohet nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore, të prezantojnë "detyrimin për **shpenzimin në barazi gjinore, ngritje të kapaciteteve** në mes të zyrtarëve përkatës për **përfshirjen e perspektivës gjinore në MFF** dhe proceset buxhetore dhe për kryerjen e **analizës gjinore** të të gjitha programeve të financimit për të analizuar ndikimin e tyre në barazinë gjinore".[2]
- Të vendosin **kërkesa më të fuqishme, detyruese për avancimin e barazisë gjinore përmes financimit të jashtëm,** duke siguruar që si në IPA III ashtu edhe në Instrumentin e Fqinjësisë, Zhvillimit dhe të Bashkëpunimit Ndërkombëtar është integruar perspektiva gjinore. Brenda këtyre rregulloreve:
  - Të kërkojnë ***ex ante* gender vlerësimet e ndikimit gjinor** për të gjitha veprimet; dhe që këto analiza informojnë qëllimet, treguesit dhe objektivat e qarta drejt barazisë;
  - Ndani fonde për barazinë gjinore, siç janë ndarë tashmë për mbrojtjen e mjedisit;
  - Të bëjnë të detyrueshëm **buxhetimin e përgjegjshëm gjinor**;

[1] KE, *Barcelona Objectives: On the development of childcare facilities for young children with a view to increase female labour participation, strike a work-life balance for work parents and bring about sustainable and inclusive growth in Europe*, 2018.
[2] EIGE, 2018, faqe 20.

- Të kërkojnë që **<u>të gjitha</u> vlerësimet të shqyrtojnë efektet në barazinë gjinore**; dhe
- Të kërkojnë **përcjellje dhe raportim të rregullt të shpenzimeve aktuale** për barazinë gjinore, gratë dhe vajzat dhe OSHCG-të.

- Me qëllim të ndërtimit në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme të kapaciteteve të OShC (G)-ve brenda vendeve përfituese të IPA-së, të përfshijnë **kushtëzimet në kriteret e pranueshmërisë së të gjithë** mbështetjes **së Fondit të BE-së për Shoqërinë Civile (*EU Civil Society Facility*)**, duke siguruar që këto fonde mbështesin vetëm organizatat lokale të regjistruara në vendet përfituese me përvojë që punojnë në këto vende.
- **Planifikoni fondet e ardhshme** posaçërisht për avancimin e barazisë gjinore dhe, kur është e mundur, në mënyrë eksplicite për OSHCG-të, duke i dhënë përparësi fondeve për të adresuar pabarazitë e rëndësishme të identifikuara përmes analizës gjinore.
- Drejt sigurimit të përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha programet në përputhje me GAP II (dhe potencialisht GAP III), të vendosin procedura dhe procese më të standardizuara të **rishikimit të cilësisë së barazisë gjinore të të gjitha programeve** në nivelet e EUD dhe EC, duke kërkuar që standardet e caktuara të përmbushen dhe të dhënat relevante për barazinë gjinore në programin të futen në sistemet e BE-së për menaxhimin e të dhënave.
- Si pjesë e **mbështetjes direkte buxhetore për qeveritë përfituese, gjithmon të kërkojnë së paku një tregues që lidhet me avancimin e barazisë gjinore**, **të** identifikuara bazuar në analizën gjinore dhe diskutimet me OSHCG-të dhe mekanizmat kombëtar të barazisë gjinore. Si pjesë e dialogut politik dhe mbështetjes financiare për vendet përfituese, kjo mund të inkurajojë përparimin në barazinë gjinore në vend.
- Monitoroni dhe raportoni çdo vit në mënyrë të standardizuar për **situatën e OSHCG-ve në raportet e vendit**, duke përfshirë dhunën ndaj grave, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe ngushtimin e hapësirës.
- Përmes dialogut politik në lidhje me procesin e pranimit në BE, **inkurajoni veprimet e qeverisë për të përmirësuar barazinë gjinore**, duke përfshirë edhe shpërndarjen e duhur të burimeve për këtë qëllim.
- Drejt zbatimit të CEDAW, Konventës së Stambollit, dhe legjislacionit tjetër kombëtar përkatës, mundësoni diskutimin domethënës që rrjedh nga hulumtimi dhe përvoja ndërkombëtare, shtrimet e sakta të kostos në vend,[3] dhe angazhon ekspertizën e OSHCG-së se si të **dizajnohen shërbime të zbatueshme, të qëndrueshme, me cilësi, normative të mirëqenies sociale**, veçanërisht për personat që kanë pësuar dhunë. Procesi i anëtarësimit në BE, duke përfshirë mbështetjen e sektorit për krijimin e sistemeve funksionuese të mirëqenies sociale, mund të ofrojë një mundësi për diskutime të tilla dhe për monitorimin e zhvillimeve, të tilla si përmes raporteve të vendit. Një mjedis rregullator normativ i aftë, i përqendruar në përfitues, mund të lejojë që ofruesit e shërbimeve të licencuar, të aftë, të drejtuar nga akterë të shoqërisë civile ose të tjerët, të kenë qasje në fonde mbi bazën e performancës (p.sh. skemat e rikuperimit të kostos) dhe jo domosdoshmërish në formën e ad hoc të fondeve e OSHC-ve.
- Brenda GAP III, forconi angazhimet për **koordinimin strategjik të donatorëve** drejt barazisë gjinore në bashkëpunim të ngushtë me mekanizmat kombëtar të barazisë gjinore dhe OSHCG-të.
- **Promovoni përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile** në realizimin e barazisë midis grave dhe burrave, siç kërkohet nga Këshilli Evropian nën rishikimin e zbatimit të Platformës së Pekinit për Veprim në ShA-të e BE-së.[4]

---

[3] Për një shembull, megjithëse të vjetërsuar, shih: Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Ekonomi, M., Shima, A., dhe Dauti-Kadriu, D. for RRGK, *At What Cost? Budgeting for the Implementation of the Legal Framework Against Domestic Violence in Kosovo*, UNDP: Prishtinë, 2012.

[4] EIGE, "Beijing + 25: the fifth review of the implementation of the Beijing Platform for Action in the EU Member States", 2019.

- **Përfshini më shumë OSHCG-në në procesin e anëtarësimit në BE**, duke u bazuar në përparimin e qartë dhe praktikat e mira të arritura deri më tani. Strategjitë dhe nismat shtesë që integrojnë barazinë gjinore në sektorë të ndryshëm mund të ndihmojnë OSHCG-të të forcojë përfshirjen e tyre në këtë proces, "përktheni" procesin tek palët e interesuara dhe përfituesit në komunitetet e tyre, dhe më pas të përmirësoni përpjekjet për pranimin e BE-së.

Për Qeveritë

- **Zbatoni zotimet** ligjet, politikat, programet dhe buxhetet me perspektivë gjinore të integruar, duke përfshirë përdorimin e duhur të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Duke vepruar kështu, **të angazhojnë OSHCG-të**, duke u siguruar atyre fonde të mjaftueshme dhe kompensim për ekspertizën e tyre.
- **Përmirësoni kornizat ligjore dhe mundësoni të krijojnë hapësirë për OShC-të që të mbledhin fonde** nga individët dhe bizneset, si dhe të paguhen për ekspertizën e tyre.
- **Krijoni fonde të qëndrueshme**, të tilla si fonde normative, përmes një linje të përhershme buxhetore për mbulimin e kostos për shërbimet e përfitimeve publike të ofruara. Alokoni burimet për OSHCG-të autonome, veçanërisht për ofruesit e shërbimeve të përfitimeve publike me ekspertizë që ka të bëjë me adresimin e dhunës me bazë gjinore, drejt sigurimit të burimeve të qëndrueshme për këto shërbime thelbësore të parapara me Konventën e Stambollit.
- **Ndani fonde** për hulumtime, duke përfshirë analizën *ex ante* gjinore, ekspertizën gjinore, monitorimin e pavarur dhe vlerësimin nga OShC (G)-të.
- Të sigurojnë **dhënie transparente dhe të drejtë të fondeve**. Të vendosin masa për të lehtësuar rreziqet e keqpërdorimit, siç janë thirrjet e hapura me kritere të qarta të përzgjedhjes, angazhimi i vlerësuesve të pavarur dhe sigurimi i mekanizmave funksional të ankesave.
- Bëni të **qasshme** të dhënat sa i përket **shpenzimeve të dhëna shoqërisë civile**. Publikoni në internet emrat, shumat dhe veprimet e OSHCG-ve, drejt transparencës.
- **Arrini tek më shumë, OSHCG-të më të ndryshme** për të rritur pjesëmarrjen e tyre në konsultime publike, përfshirë këtu edhe procesin e pranimit në BE. Konsideroni nivelin e tyre të ndërgjegjësimit, ekspertizës, qasjes në transport dhe kohën e nevojshme për të marrë pjesë në këto procese në mënyrë që të inkurajoni, planifikoni siç duhet, dhe mbështesni pjesëmarrjen e tyre të përmirësuar.
- Rritni mbështetjen politike dhe **financiare për mekanizmat kombëtar të barazisë gjinore.** Vendosni burimet për forcimin e kapaciteteve të tyre dhe për të siguruar që ata të bashkëpunojnë ngushtë me OSHCG-të të ndryshme.

Për Koordinimin

- Inicioni një përpjekje të koordinuar **për t'i mbajtur më të përgjegjshëm të gjithë donatorët/financuesit** për të bashkëpunuar në planifikimin e përbashkët të mbështetjes për avancimin e barazisë gjinore. Kërkoni **reduktimin e duplikimit dhe të përmirësohet** përdorimi **efikas, efektiv dhe me ndikim** të burimeve të kufizuara. Ndoshta financuesit si BE dhe Sida mund të konsiderojnë fillimin e përpjekjeve më të zgjeruara të koordinimit, kështu që financuesit dhe OSHCG-të njësoj mund të bashkëpunojnë në nisma më efikase, efektive dhe me ndikim.
- Identifikoni mundësitë për përdorim më të mirë të **fondeve investuese dhe raportimit të përbashkët**, drejt përdorimit më efikas të burimeve njerëzore.

Aktivistet bëjnë shenjën e paqes për të mbështetur gratë e Kurdistanit, në Beograd në vitin 2016.

PUNIMET E CITUARA

Aets Apave për Komisionin Evropian, *Vlerësimi Afatmesëm i Lehtësisë së Shoqërisë Civile për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë,* 2017, në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/csf_evaluation_report_BPt_dig.pdf.

Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare, website, "Historia" qasur në prill 2020, në: https://awenetwork.org/historia-misioni/

Aljazeera Balkans, Women in Black in Belgrade pay tribute to the victims of the Srebrenica genocide [*"Žene u crnom' u Beogradu odale počast žrtvama genocida u Srebrenici'*] , 2019, at: http://balkans.aljazeera.net/video/zene-u-crnom-u-beogradu-odale-pocast-zrtvama-genocida-u-srebrenici

Amnesty International, "Plagë që të djegin shpirtin" Kompensim për të mbijetuarit e përdhunimit gjatë luftës, por drejtësi s'ka akoma., Amnesty International, 2017, në: https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017ALBANIAN.PDF

Arutyunova, A. and Miller, K., *Count Me In! Money & Movements Convening*, 2018, në: https://www.mamacash.org/media/conferences/cmi_money_and_movements_funding_data.pdf

Shoqata për Zhvillimin e të Drejtave të Grave, W*atering the Leaves, Starving the Roots: The Status of Financing for Women's Rights Organizing and Gender Equality*, 2013, at: https://www.AWID.org/sites/default/files/atoms/files/WTL_Starving_Roots.pdf.

Austrian Development Agency, *Making Budgets Gender-Sensitive: A Checklist for Programme-Based Aid*, 2009, në: https://www.entwicklung.at/fileadmin/user_upload/Dokumente/Publikationen/Downloads_Themen_DivBerichte/Gender/CHECKLIST_12032009_barriere.pdf.

Qendra e grave autonome (AWC), "Komentet e AWC mbi Projektligjin për Barazinë Gjinore", 2020, në: https://www.Womenngo.org.rs/en/news/1166-comments-of-the-AWC-on-the-draft-Law-on-gender-equality.

_____,"Komente mbi tekstin e punës së Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Viktimave dhe Dëshmitarëve të Krimit", 2020, në: https://www.Womenngo.org.rs/en/policy-activities/advocacy/1498-2019-support-for-victims-of-violence-a-strategy-on-the-rights-of-victims-and-witnesses-of-crimes.

_____, "Apeli i WNAV në Rrjetin Parlamentar të Grave", 2016, tek: https://www.Womenngo.org.rs/vesti/430-mreza-zene-protiv-nasilja-zenskoj-parlamentarnoj-mrezi-za-kaznjavanje-kupaca-u-prostituciji (Në gjuhën serbe).

_____, "Ministria e Punëve të Brendshme pranoi shumicën e komenteve që Qendra Autonome e Grave i paraqiti Projektligjit për Azilin dhe Mbrojtjen e Përkohshme", 2016, në: https://www.Womenngo.org.rs/en/news/785-Law-on-asylum-ministry-of-interior-accepted-the-majority-of-comments-that-autonomous-Women-s-center-had-submitted-to-the-draft-Law-on-asylum-and-temporary-protection.

_____, "Ministria e Punëve të Brendshme ka pranuar sugjerimet e AWC në lidhje me Ligjin për Parandalimin e Dhunës në Familje", 2017, në: https://www.Womenngo.org.rs/en/neës/1056-ministry-of-interior-has-accepted-AWC-s-suggestions-regarding-the-Law-on-the-prevention-of-domestic-violence.

_____, "Ministria e Punës shkel Ligjet: një letër nga AWC drejtuar Drejtorisë së Prokurimit Publik", 2018, në: https://www.Womenngo.org.rs/en/news/1324-the-ministry-of-labor-violates-the-Laws-a-letter-from-the-AWC-to-the-public-procurement-directorate.

_____, "Pyetje të hapura për Ministrinë e Punës, Punësimit, dhe Çështjeve Sociale", 2018, në: https://www.Womenngo.org.rs/en/news/1323-open-questions-to-the-ministry-of-labor-employment-veteran-and-social-affairs.

_____, "'Pilotimi i Ligjit për Parandalimin e Dhunës në Familje", 2017, në: https://www.Womenngo.org.rs/vesti/941-pilotiranje-zakona-o-sprecavanju-nasilja-u-porodici (në gjuhën serbe).

Balkan Insight, "Serbia: Aktivistët e të drejtave të njeriut u japin homazhe shqiptarëve, viktima të luftës nga Kosova" [Srbija: Aktivisti za ljudska prava odali počast Albancima, ratnim žrtvama sa Kosova], 2019, në: https://balkaninsight.com/2019/03/26/srbija-aktivisti-za-ljudska-prava-odali-pocast-albancima-ratnim-zrtvama-sa-kosova/?lang=sr (në gjuhën serbe).

Bjelanovic dhe Myers për CEE FC, Bratislava, "Një rast studimi i Fondacionit TRAG", 2017, në: https://www.ceefundraising.org/wp-content/uploads/2017/10/Bjelanovic_Myers_Trag_Fondacioni_Major_Donor_Case_Study.pdf.

Britannica, Marrëveshja e Prespës: Histori e Ballkanit, 2019, at: https://www.britannica.com/event/Prespa-Agreement.

Borgen Project, "Çfarë është një organizatë multilaterale?", Borgen Project website, qasur më 18 Maj 2020, në: https://borgenproject.org/what-is-a-multilateral-organization/.

Catalyst Balkans, Raporti Vjetor mbi Gjendjen e Filantropisë – *Serbia 2018*, 2019, në: https://www.slideshare.net/CatalystBalkans/annual-report-on-the-state-of-philanthropy-serbia-2018.

_____, Ligjet mbi taksat që prekin filantropinë në vendet e Evropës Jugore, 2013, në: https://catalystbalkans.org/DownloadFile.axd?strategy=contentitemdocument&fileName=81c1e19f-97c8-496f-aa2e-f34fbdc6421b.pdf.
Ćatović, A., Idžaković, F., Šehić D. për Të Drejta për të Gjithë, perspektiva e Grave: Përgjigjet alternative të pyetësorit të Komisionit Evropian, 2017, at: http://rightsforall.ba/project/1580/.
Qendra për Trajnim në Sistemin Gjyqësorë dhe Prokurorinë Publike, Raporti vjetor për punën e qendrës për trajnim në sistemin gjyqësorë dhe prokurori të shtetit për vitin 2018, Podgoricë, 2019, në: http://cosdt.me/wp-content/uploads/2019/05/Annual-Report-2018-JCT_ENG-finalni.pdf.
Fondacioni i Ndihmës së Bamirësisë, *Indeksi Botëror i Dhënies: Dhjetë vite të Trendeve të Dhënies*, Tetor 2019, qasur më 10 Janar 2019, në: https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-publications/caf_wgi_10th_edition_report_2712a_web_101019.pdf.
Chianca, T., "Kriteret e OECD / DAC për Vlerësimet e Zhvillimit Ndërkombëtar: Një Vlerësim dhe Ide për Përmirësim ", *Gazeta e Vlerësimit Multidisiplinar*, Vëllimi 5, Numri 9, ISSN 1556-8180, 2008, në: http://journals.sfu.ca/jmde/index.php/jmde_1/article/download/167/183.
Qyteti i Sarajevës Lindore, *Protokolli i Nënshkruar për Bashkëpunimin në Rastet e Dhunës në Familje në Sokolac*, në: https://gradistocnosarajevo.net/sokolac/sokolac-potpisan-protokol-o-saradnji-i-postupanju-u-slucajevima-nasilja-nad-zenama-i-u-porodici.
Platforma e Fuqizimit të Shoqërisë Civile, "Protokolli i Nënshkruar për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje në Rrethin Brcko BeH, 2018, në: https://cssplatform.org/signed-protocol-cooperation-institutions-organizations-prevention-combating-vaw-domestic-violence-brcko-district-bih-potpisan-protokol-o-saradnji-institucija-organizacija-u-s.
Clemens, Paul, "Përmirësimi i mësimit dhe përgjegjësisë në ndihmën e huaj", World Development (125), 2019, në: https://reader.elsevier.com/reader/sd/pii/S0305750X19303183?token=D50D630A7F9C0DD7468022405C0F1228EE7490E971A94B453DCA25BD2E898AD50021FC4C0E01B3763278522C31295FF2.
Alarmi i Koalicionit PrEUgovor, Raporti i Koalicionit për Progresin e Serbisë në Kapitujt 23 dhe 24, 2018, në: http://preugovor.org/Alarm-Reports/1460/Coalition-prEUgovor-Report-on-Progress-of-Serbia.shtml.
Këshilli i Evropës, *Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*, Seria e Traktatit - Nr. 210, Stamboll, 2011, në: https://rm.coe.int/168008482e.
Këshilli i Bashkimit Evropian, Qasja Gjithëpërfshirëse për zbatimin nga BE të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325 dhe 1820 mbi Gratë, paqen dhe sigurinë, Bruksel, 1 dhjetor 2008, në: http://www.seesac.org/f/img/File/Res/Gender-and-Security-Resources/EU-implementaion-of-the-UNSC-resolutions-Women-639.pdf.
_____, Përfundimet e Këshillit për Gjininë në Zhvillim, 2019, në: http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-9242-2015-INIT/en/pdf.
_____, Përfundimet e Këshillit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Bruksel, 10 dhjetor 2018, në: https://www.consilium.europa.eu/media/37412/st15086-en18.pdf.
_____, Plani i veprimit gjinor 2016-2020 - Përfundimet e Këshillit, në: https://www.consilium.europa.eu/media/24467/st13201-en15.pdf.
